

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave shoqërore

Viti XLIX i botimit

Nr. 69

Shkodër, 2019

REDAKSIA

Kryeredaktor - Prof. dr. Artan HAXHI
Sekretar shkencor - Prof. as. dr. Nevila DIBRA
Anëtarë - Prof. dr. Mimoza PRIKU,
prof. dr. Tomor OSMANI, prof. dr. Alfred ÇAPALIKU,
prof. as. dr. Alma HAFIZI

DREJTOR I REVISTËS
Prof. dr. Adem BEKTESHI

Korrektori dhe punoi në kompjuter: Arta Bajrami

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
Seria e Shkencave Shoqërore
Tel/fax: ++399 22 43747

PASQYRA E LËNDËS

- *Gjuhësi*

Evalda PACI

Për një vështrim antropologjik dhe gjuhësor të nocioneve themelore të botës romake dhe latine në programet universitare shqiptare
On an anthropologic and linguistic view of the basic notions of the roman and latin world in the Albanian university programs.....7

Artan HAXHI & Tefë TOPALLI

Terminologjia si sistem (Fjalor i termave të gjuhësisë)
Terminology as a system (Glossary of Linguistics Terms)23

Orjeta BAJA

Fjalët frënge në gjuhën shqipe sipas “Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe” të akademikut Kolec Topalli
French words in Albanian Language according to "Etymological Dictionary of Albanian Language" by Academician Kolec Topalli33

Merita HYSA

Analiza e fonemave në tipare dalluese
Analysis of phonemes in distinctive features.....49

Elvis BRAMO

Rreth disa greqizimeve në veprën “*Cuneus Prophetarum*” të Pjetër Bogdanit (1685)
(Nga vepra “Leksiku historik i gjuhës shqipe IV” i Kolë Ashtës)
About some Greek words in the work of Pjetër Bogdani “Cuneus Prophetarum” (1685)
(From the work “*Historic lexicon of the Albanian Language IV*” of Kolë Ashta).....63

Abdulla BALLHYSA & Aurela BASHA

Mbi disa veçori dalluese të teksteve të Sevasti Qiriazit

*On of some distinguishing features of the textbooks of S. Qiriazit.....*79

Matilda ÇOLLAKU

Diskursi i Luigj Gurakuqit – dëshmi e çmuar e vlerave të Komissisë Letrare.

Luigj Gurakuqi Discourse – Valuable Testimony to the Values

*of Literary Nationality.....*89

Eliana LAÇEJ

A shkruajmë siç flasim? Rasti i rrjeteve sociale.

*Do we write as we speak? The case of social networks.....*101

Lindita KAZAZI

Ndikime të ndërsjella mes gjuhëve - Rasti i huazimeve italiane në shqip

Mutual influence between languages - Italian borrowings in albanian

*language.....*109

Jonida CUNGU

Shprehësia leksikore e poezisë së Ilirjana Sulkuqit

*Lexical expression of the poetry of Ilirjana Sulkuqi.....*117

• *Letërsi*

Alfred ÇAPALIKU

Përkthimet e Kolë Thaçi

*Translations of Kolë Thaçi.....*125

Alma HAFIZI

Mes dy detesh dhe shumë kulturash. Refleksione mbi veprën

e Karmine Abates

Between two seas and more cultures. Reflections on the work

*of Carmine Abate.....*133

Rrok GJOLAJ

Vështrim për përmbledhjen me poezi “Dëgjohet një poezi, në suferinë...” të Anton Goçajit

A glimpse at poetry collection of Anton Goçaj under the title “Dëgjohet një poezi në suferinë ...”143

• **Histori**

Anelmo SPAHIJA

Diversiteti fetar në Arbërinë mesjetare dhe politika përbashkuese e Skënderbeut

Religious diversity in medieval Albania and the unifying politics of Gjergj Kastrioti Skanderbeg.....147

• **Gjeografi**

Sokol AXHEMI

Evolucioni i faktorëve dhe i formave të migrimit në vendin tonë (1945-2019). Efekte dhe risi.

Evolution of factors and forms of migration 1945- 2019 in our country. Effects and innovation155

Flora GJONI & Nertila DILAVERI

Oportunitetet e prirjeve globale të shkëmbimeve tregtare, kusht për rritjen ekonomike. Konteksti i rastit të bashkëpunimeve ndërkufitare midis Shkodrës dhe Malit të Zi.

The opportunities of global openness of trade opening, a condition for economic growth. The context of cross - border cooperation between Shkodra and Montenegro.....165

Dritan RRUSTJA

Infrastruktura si faktor zhvillimi aktual dhe perspektiva në njësinë administrative Rrethinat - Shkodër

The infrastructure as a factor of actual and perspective development in the administrative unit rrethinat – Shkodër.....173

**Ervis KRYMBI & Alkida HASAJ & Ornela HASRAMA
& Imeldi SOKOLI**

Instrumenti i bashkëpunimit ndërkufitar. Rasti i rajonit
Shkodër - Podgoricë dhe zonat përreth liqenit të Shkodrës
*Instruments of cross-border cooperation. Case-studies: the region
Shkoder-Podgorica and the areas around Shkoder lake*.....183

RECENSIONE

Ermira ALIJA: Alfred Çapaliku: Veli Stafa (Platonicus)
Jeta dhe vepra
(Monografi)

*Veli Stafa (Platonicus)
Life and work
(Monograph)*.....199

JETA SHKENCORE

I. Veprimtari shkencore
Scientific activity.....203
II. Botime
Publishing.....213

Evalda PACI

**PËR NJË VËSHTRIM ANTROPOLOGJIK DHE
GJUHËSOR TË NOCIONEVE THEMELORE TË BOTËS
ROMAKE DHE LATINE NË PROGRAMET
UNIVERSITARE SHQIPTARE**

Nam cum sit hoc natura commune animantium, ut habeant libidinem procreandi, prima societas in ipso coniugio est, proxima in liberis; deinde una domus, communia omnia. Id autem est principium urbis et quasi seminarium reipublicae.¹

Një lëndë formimi *par excellence* që nuk ka pasur të njëjtin pasqyrim në vite dhe periudha të caktuara të zhvillimit të arsimit në viset tona ka qenë dhe ajo e gjuhës dhe e letërsisë latine, e pranishme në dekadat e para të shekullit të kaluar dhe në programe liceale të specializuara në drejtimin gjuhësor dhe filologjik, ndërkohë që mbështetej dhe nga tekste shkollore të përpiluara mbi baza të qarta programatike. Prania konkrete dhe kërkesa e vazhdueshme për ta pasur si lëndë formimi në gjimnazet tona dëshmon rëndësinë që i jepej kësaj të fundit në disa pikëpamje: përbënte kjo gjuhë klasike një mbështetje të mirë për formimin filologjik dhe human të nxënësve të liceut të asaj kohe, por përfaqësonte dhe një drejtim konkret për ta orientuar këtë të fundit drejt një rrugëtimi që shihte nga antikiteti dhe bota greke e romake, nga një civilizim që ndikoi vërtet gjatë në skemat mendore të popujve të Evropës, duke jetuar dhe përmes korpusesh gjuhësore që u shtrinë dhe u bënë pjesë e mjaft regjistrave specifike që mbështesin drejtime studimore si jurisprudenca, shkenca e letërsisë, gjuhësia historike dhe ajo e krahasuar, filologjia romane, filologjia e tekstit dhe studimet mbi ligjërimin biblik, jo më pak dhe terminologjia mjekësore, e mbështetur në disa linja dhe nga elemente formative të greqishtes së vjetër.

E cekur dhe më parë nga ana jonë dhe e përfshirë në punime të mëparshme më të zgjeruara dhe më të tematizuara, çështja e mësimi dhe e studimit të gjuhës latine kryesisht në shkolla të specializuara në formimin filologjik dhe human të nxënësve si gjimnazi i etërve jezuitë në Shkodër në

¹ Cicero, *De Officiis*, I, 17.

dekadat e para të shekullit të kaluar, nuk do të përbëjë një argument qendror të kësaj trajtese, po gjithsesi do të mund të shërbejë si element për t'u marrë si shembull në veçanti kur bëhet fjalë për tekste të veçanta në të cilat vështrimi ndërdisiplinor dallohet qartë si prirje që ka orientuar që në krye të herës autorët e tyre dhe vetë shkollat për të cilat të tilla manuale ishin paracaktuar.² Në të vërtetë, mjaft tekste të përpiluara nën një shtysë që kishte të bënte me edukimin me disiplina sa humane aq dhe konkrete si historia e antikitetit, gjeografia e antikitetit, filologjia romane dhe historia e gjuhës plotësojnë një panoramë të pasur në botime, sado që këto të fundit janë ofruar për brezat si mjete për edukimin liceal dhe gjimnazik të studentëve. Nuk mund të mos tërheqë vëmendje dhe të mos zgjojë kureshtje një terminologji e posaçme që dëshmon përkushtimin e autorëve në pasqyrimin e gjuhës shqipe dhe të mjeteve të saj për t'u përgjigjur mjaft termave dhe emërtimeve nga një gjuhë mjaft e pasur dhe e ndryshme dhe nga vetë bijat e saj neolatine për nga nocionet gramatikore dhe elementet paradigmatiche në të cilat për hir të së vërtetës shqipja mund të përbëjë një paralele më të përshtatshme krahasimesh më shumë se këto të fundit. Një fakt i tillë është vënë re dhe nga studiues paraardhës të historisë së dy gjuhëve, përkatësisht latinishtes dhe vetë shqipes, ndërkohë që dhe vetë shqipërimet që ne disponojmë në gjuhën tonë janë një tjetër dëshmi e faktit që duke u përkthyer në një tjetër gjuhë dhe vepra të letërsisë latine që përbëjnë memorandume të një qytetërimi ekzemplar në shumë pikëpamje, sjellin vështrime krejt të mëvetësishme sa u përket elementeve gjuhësore që vihen në përdorim për të pasqyruar një leksik të specializuar që ka të bëjë me sakralen, me flijimin si rit në situata të caktuara që përfshijnë personazhe hyjnore dhe njerëzore, me institucione të rëndësishme në të cilat nderimi për individin njerëzor në të gjallë dhe pas vdekjes përbën një linjë mjaft të rëndësishme.³ Shqipja jonë jo rrallë, por veçanërisht në rastin e klasikëve më në zë të antikitetit është shfaqur e pasur, e plotë dhe plotësisht e denjë për t'i shërbyer një konteksti të veçantë që e mundëson pikërisht vetë tematika e veprave kryesisht në vargje e letërsisë antike, ndër të cilat do të veçonim poemat e Homerit dhe të Virgjilit.

² Shih ndër të tjera dhe Paci E., *Elemente të mësimin të gjuhës latine në disa gramatika të gjysmës së parë të shekullit të kaluar në shkollat shqiptare*, në *Hylli i Dritës*, n.1, 2018, f.8-17; shih gjithashtu dhe Paci E., *Për një studim të thelluar dhe përmbajtësor të elementeve institucionale të gjuhës latine*, në *Buletin shkencor, Seria e Shkencave shoqërore*, n.68, Shkodër, 2018, f.27-37.

³ Paribeni R., *La famiglia Romana*, Roma, 1929, f.17: La tomba era una necessità indispensabile per la tranquillità dello spirito del defunto, la privazione della sepoltura è molto più temuta della morte stessa, perchè porta con sè una permanente irrequietezza, una durevole infelicità.

Pasqyrimi i një qytetërimi që nuk u konsolidua njëherësh dhe nuk paraqitet linear në ecurinë e vet, por ndoqi një rrugëtim vërtet të gjatë sa vetë historia e një qyteti që arriti të mbiquhet jo rrallë dhe *Caput mundi*, sa të ndërmendet dhe sot e kësaj dite si referencë dhe për kultet e krishtërit si besim fetar dhe për figurat më të rëndësishme që ndërtuan një mendësi të tërë që ka ndërhyrë dhe në vetë historinë e qytetëritit romak mbas shekullit të parë pas Krishtit, nuk është aspak e lehtë, por mund të bëhet dhe duke njohur më së miri vepra themelore që përfaqësojnë arritje që për shekuj me radhë kanë qenë dhe zëdhënese të një ideali apo të një inspirimi që sunduesit e kohëve të caktuara mund të kenë pasur dhe kanë dashur ta konkretizojnë nëpërmjet autorësh që kanë arritur të plotësojnë me shkrintarinë e tyre një prirje të tillë.

Vështrime të natyrës antropologjike mbi elemente të caktuara të një bote jo të afërt në kohë si ajo latine bëhen të mundura nëpërmjet studimit të përdorimit në kontekste të caktuara të fjalëve të veçanta, në veçanti të atyre fjalëve të cilat tradicionalisht trajtohen e konsiderohen si të përbashkëta të paktën në komponentin rrënjor në disa gjuhë të vjetra të familjes gjuhësore i.e. Përdorimi i tyre në tekste të natyrës juridike dhe historike, referimi ndaj tyre në përpilime me rëndësi themelore për të drejtën romake e veçanërisht sa i përket familjes, zakoneve, mënyrës së jetesës dhe ruajtjes së religjionit bën të mundur dhe të reflektohet mbi vlerën semantike përkatëse në periudha të caktuara të evolucionit të gjuhës e të shoqërisë përherë në rrugëtim emancipimi që e përdorte dhe lëvronte atë. Nuk kanë munguar sprovat që kanë pasur qëllim studimi nxjerrjen në pah të afrive apo përkimeve mes botës romake dhe asaj ballkanike, ndërkohë që dhe analiza sado të përgjithshme të paragrafeve të të ashtuquajturit *mos maiorum* mundësojnë reflektime mbi elemente të tilla, të pranishme dhe në botën shqiptare.

Konservatorizmi në ndërtimin e familjes romake, në veçanti centraliteti i një figure si ajo e atit të familjes (*pater familias*) zgjon dhe sot e kësaj dite një kureshtje jo të zakonshme për këdo që studion më në thellësi tekste të autorëve të caktuar latinë që kanë referuar në disa periudha dhe në lidhje me këtë figurë burrërore që përfaqësonte edhe autoritetin, edhe një lloj jurisperiti me të drejta pothuaj të pakufizuara në raportet me familjarët e vet. Duhet thënë e pohuar dhe në këtë rasë që autorë të botës latine që sot e kësaj dite i lexojmë dhe në formate botimesh kritike e në një kornizë komentesh dhe interpretimeve që lehtësojnë brendësimin kuptimor të teksteve përkatëse, dallohen pikërisht për një tematikë të tillë të rrahur, duke qenë se fakti që u janë kushtuar figurave që mbaheshin bazilare në familjen romake vijon t'i evidentojë si trajtues të një fushe juridike që ka të

bëjë me rregullimin e marrëdhënieve brenda saj.⁴ Tematika e veçantë që sigurisht pasqyrohet në mjete gjuhësore dhe regjistra gjuhësorë po aq të përveçëm dallon autorët nga njëri-tjetri e një dallim i tillë nuk ka një vlerë të natyrës thjesht kronologjike.

Tekstet latine që sot shërbejnë si burime referenciale që dëshmojnë për një botë relativisht të largët në kohë, mbeten thesare me një vlerë të pamohueshme, duke pasur parasysh faktin që transmetimi gjeneratë pas gjenerate i një mendësie që sigurisht ka lënë gjurmë dhe në shekujt që pasojnë shpërbërjen e një imperiumi që qoftë dhe konceptualisht ndikoi gjerësisht në psiken e popujve të Evropës, është kushtëzuar nga rrethana kryesisht fizike që kanë shpënë si rrjedhojë dëmtimin e tyre, por dhe kalimin nga një kopist në tjetrin në variante që pa dyshim nuk mund të jenë përherë të njëjta me origjinalin.

Raporti i teksteve që na transmetohen nëpërmjet kopistëve të kohës, kryesisht të mesjetës me ato origjinale mund të bëhet objekt i një vëmendjeje që sigurisht nuk ka munguar në katedrat evropiane dhe atyre jashtë Evropës, duke qenë se sjellja me besnikëri e teksteve nuk mund të bëhet objekt interesi pa konsideruar dhe faktin që përmbajtja e mirëfilltë është në të vërtetë dhe burimi më i besueshëm në lidhje me perceptimin e ngjarjeve, por dhe të teksteve të autorëve që në kohën që jetuan përpiluan veprat e tyre në disa fusha të dijes në të cilat mund të bëjnë pjesë dhe ato të shkencave të natyrës. Në këtë vështrim dhe çdo mësimdhënës i lëndës së gjuhës dhe kulturës latine fare mirë në proces konsultimi dhe këshillimi të literaturave dhe burimeve themelore siç duhen konsideruar autorët latinë të çdo periudhe, duhet të ketë parasysh referimin ndaj varianteve më besnike në pikëpamje filologjike dhe përmbajtësore, të cilat në shumicën e rasteve dallohen dhe në drejtim të shenjave grafematike që janë vënë në përdorim ndërkohë që përgatiteshin e kujdesoheshin filologjikisht vepra të caktuara të letërsisë së shkruar latine.

Autorët latinë duhen konsideruar si ndër kryesorët në pikëpamje të sjelljes së botës në të cilën ata vetë u formuan dhe që në proces të shndërrimit të saj simbas periudhave, por dhe figurave të përveçme që shënuan historinë e saj ka ndikuar dhe në shkrimtarinë dhe performimin e

⁴ I pandarë nga ky koncept mbetet dhe trajtimi dhe konsiderimi i figurës së gruas në gjirin e familjes romake, e cila shihet se ndërmendet me respekt në jo pak traktate të natyrës juridike. Përveç një nomenklature të gjerë që lidhet me emërtime të periudhave të ndryshme moshore të gruas e që mund të bartin dhe konotacione të lehta pozitive apo përkëdhelie, një citim serioz në lidhje me rolin e gruas së martuar që ndeshet te Arnobi, mund ta konfirmojë një fakt të tillë: *Matres familias nostrae in atriis operantur domorum.* (Arnobius, *Adv. Not. II*, 67).

tyre në një habitat që ruante patjetër dhe përmasat publike. Duhet kuptuar kështu kompleksiteti i disa personaliteteve që kanë lënë gjurmë në historinë e letërsisë së shkruar latine, ndërkohë që vetë historia i evidenton dhe si bashkëkohës të personave që ndërtuan me ambicet e tyre dhe imazhin e një shteti të stërmadh që më tej do të emërtohej për një kohë të gjatë perandori (*imperium*). Ambicet e vetë Romës së lashtë dhe prijësve që në çdo rasë janë individualitete që nuk përsëriten lehtë, nuk mjaftoheshin me zaptimin e ndonjë njësie kufitare që fati do t'i donte të gjindeshin gjeografikisht qoftë dhe në kontinente fqinje. Mjafton të kujtojmë dhe në këtë rasë sa e kushtueshme që për Romën në pikëpamje kryesisht njerëzore armiqësia e pakthyeshme me një fuqi dominante në pikëpamje politike dhe ushtarake të kohës si Kartagjena. Duket madje se mosnjohja e kufirit apo e masës dhe në këtë drejtim një ditë të caktuar do të godiste pikërisht dhe soliditetin e kësaj tërësie që vështirë që në çdo kohë të ketë qenë realisht një njësi, jo vetëm në pikëpamje gjuhësore. Diversiteti pas gjasash ekzistues në shumë drejtime mjafton të provohet dhe me gjuhët e quajtura romane apo neolatine që gjetën terren për t'u ngjizur dhe për t'u zhvilluar më tej si të tilla falë disa faktorësh gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë, ndër të cilat dhe substrati vendas që u asimilua me të ashtuquajturën latinisht popullore, e cila jo në çdo provincë romake u përtyp apo u përthith në të njëjtat përmasa dhe rrethana. Për këdo që ka zgjedhur ose i është dashur të dijë më shumë për gjuhët që tradicionalisht janë quajtur dhe bija të latinishtes (e kemi fjalën për latinishten popullore, jo klasiken), qoftë dhe kur i studion në këndvështrimin e formësimit të tyre dhe konsolidimit si gjuhë më vete, është fare e qartë që dhe pse kanë një prejardhje të përafërt në pikëpamje gjenetike, kulturat që transmetohen nëpërmjet tyre e kryesisht përmes leksikut përkatës, kanë tipare që nuk ndeshen në secilën në të njëjtën masë apo mënyrë.⁵

Interpretimi i teksteve të këtyre autorëve ka tërhequr pa ndërprerje vëmendjen e studiuesve të antikitetit romak, por dhe atij grek, duke qenë se jo në pak raste vetë autorët latinë ruajnë qartë gjurmët e një formimi personal që kishte të bënte të paktën me gjuhën dhe kulturën greke. Epërsia që u jepte pikërisht individëve të caktuar njohja e kësaj kulture të konsideruar përherë si superiore dhe sfiduese në pikëpamje të elementeve që e dallonin e në veçanti në drejtim të filozofisë rreth botës së individit a të personit nuk ka qenë pengesë që në raste të caktuara këta të fundit të

⁵ Schlösser R., *Le lingue romanze*, Il Mulino, Bologna, 2005.

nënvizionin gjithsesi rëndësinë e lidhjes me dheun amë e me atë tërësi që për ta përfaqësonte atdheun. Dhe pse njohës të mirë të të dyja veprave të Homerit, etërit e botës romake kishin të qartë se duhej të trajtonin si primare Odisenë ndaj Iliadës, duke qenë kjo e fundit një vepër vërtet lapidare në pikëpamje të përfaqësimit të një modeli krijimtarie dhe narracioni, por gjithnjë me objekt trajtimin e një konflikti që sillej më tepër rreth individit sesa rreth koncepteve më të rëndësishme, siç ishin atdheu dhe mbrojtja e integritetit të tij.

Në këtë rasë duhet theksuar dhe një fakt jo pa rëndësi për këdo që është i interesuar të ndjekë në diakroni ecurinë e studimeve të caktuara apo të trajtimit të argumenteve të caktuara e veçanërisht konkrete si reflektuese të aspekteve të jetës romake të kohës:

Autorë latinë kanë lënë emër me trajtesat përkatëse në drejtim të disiplinave të caktuara, ndërkohë që vijohet të merren si burime referenciale për maksimat apo shprehjet të cilave me kalimin e kohës veçse u përforcohet vlera sentenciale përkatëse. Jurisprudenca mbi të gjitha, e drejta romake si drejtim i konsoliduar disiplinor juridik, e drejta familjare, rregullimi i marrëdhënieve familjare e në veçanti dallimet mbi bazë gjinore që në disa raste bëhen më se të qarta, statusi i skllavit dhe skllavëria si institucion, të drejtat e gruas pas martesë, çështje të disponimit nga ana e saj e pasurisë materiale dhe të drejtat mbi pasardhësit, vetë terminologjia që lidhet me martesën si institucion dhe divorcin si nocion dhe praktikë që rrjedh pazgjidhshmërisht nga kjo e fundit, mbeten linja me interes studimor, por që gjithsesi ndiqen si të tilla kryesisht përmes burimeve më të drejtpërdrejta të shkruara në gjuhën latine. Është po aq e vërtetë dhe e qartë që dhe vetë terminologjia që përfaqëson një fushë të tillë semantike është diktuar që në themel nga terma latinë që dhe në pikëpamje etimologjike ruajnë kthjelltësisht lidhjen me elementet bazike që i ndërtojnë ato në drejtim të formimit.⁶

Pasurimi i korpuseve gjuhësore kryesisht të së drejtës romake me studime, konsiderata dhe interpretime që herë në trajtë artikujsh, herë në formate punimesh monografike përqendrohen në këto aspekte, plotësimi në dimensione kritike dhe me anë shpjegimesh filologjike i thënieve më të njohura latine që cekin lamijet e sipërpërmendura, bazohen në konsultime të teksteve të autorëve latinë, emri i të cilëve lidhet pikërisht me fusha të caktuara të shkrimit e të dijës, gjithashtu dhe të së drejtës dhe ligjit. Falë konceptimit të korpuseve të tëra që kanë bërë të mundur të evidentojnë dhe

⁶ Shih në veçanti trajtimin e zërit *Matrimonium* në *Dizionario giuridico romano, botim i përgatitur nga Anna d'Angelo*, Edizioni Simone, Napoli, 2006, f.338-341. Shih po aty dhe zërin *Divortium*, botim i cituar, f.167-168.

të rendisin si tematikisht, ashtu dhe kronologjikisht autorë dhe argumente të rëndësishme jetësore të trajtuara prej tyre, mund të gjejmë të sistemuara dhe në kontekstin e veprave që kanë synim të nënvizojnë rëndësinë e proverbialitetit në botën latine edhe fraza nga tekstet biblike, përfshirë dhe ato të Besëlidhjes së Re. Mjafton të ndërmendim dhe në këtë rasë shpeshësinë e referimit ndaj një autori që mbahet dhe si ndër më përfaqësuesit e një periudhe me emër në historinë e gjuhës së shkruar latine, asaj klasike. Ciceroni, autor i shekullit të parë para Krishtit është një ndër më të cituarit në korpuse si ai me titull *Antiquitatum Romanarum corpus absolutissimum*, variant i vitit 1685, që përmban dhe shtjellime me rëndësi qoftë mbi shoqërinë romake në disa periudha, qoftë dhe mbi çështje themelore që lidhen me të drejtat e liritë e individit në rang familjar dhe shoqëror. Korpuset që janë paracaktuar të përmbajnë tekste të tëra në të cilat qoftë dhe në trajtë frazash trajtohen problemet themelore të së drejtës dhe të raporteve të individit me pronën, me paraardhësit dhe pasardhësit, në të vërtetë mbeten dhe burimet më të shfrytëzuara për të vjelë prej kësosh thënie dhe fjali që me kalimin e kohës përforcojnë në kontekste kryesisht didaktike, madje dhe universitare statusin e sentencës apo të proverbit.

Sigurisht që paraqitet pak e vështirë që në kuadër të një trajtесе të vetme të arrihet të trajtohet dhe brendia e thënieve të caktuara latine që lidhen me ligjshmërinë, lirinë dhe të drejtat e individit, besën dhe fjalën e dhënë, brishtësinë e jetës njerëzore, pazgjidhshmërinë e martesës dhe raportet përkatëse me fuqi supreme hyjnore që në atë kohë konceptoheshin brenda një panorame të mirëfilltë politeiste, por pa dyshim që në çdo rasë citimi i burimit dhe i historikut të thënies të shpie te një autor i veçantë dhe në periudhën që lidhet me të, sigurisht si rrjedhojë dhe në krijimin e idesë mbi një kontekst sa kohor, aq dhe social e kompleks.

Rëndësia e konsultimit të veprave të autorëve të caktuar latinë, të cilët kanë mbetur të përjetësuar si në historinë e Romës, ashtu dhe në atë të historisë së letërsisë e të gjinive shkrimore në gjuhën latine konkretizohet nëse kihen parasysh komentarët e përpiluar nga Jul Cezari, njeriu që la gjurmë të pashlyera në një panoramë historike që u shënuar si prej tij, si prej personazheve që falë tij u bënë dhe më të fuqishëm dhe gjithashtu fort gjatë të përmendur nëpër kronika dhe buletine të kohës. I lindur në periudhë trazirash për qytetin që ishte paracaktuar të ishte i një rëndësie përherë në rritje në kontekstin e arealit të cilit i përkiste, i rritur dhe me ambicien për të ndikuar si në pikëpamje intelektuale, aq dhe politike dhe shoqërore, i bërë objekt sulmesh personale, por me premisa thellësisht politike, Cezari do të jetë për pasardhësit para së gjithash njeriu i reformave të mëdha shtetërore që Romën sigurisht do ta konsolidonin në pikëpamje të bërthamës urbane

që përfaqësonte, dhe pse çdo gjë si rrjedhojë do të përqendrohej në duart e tij. Ky personalitet burror që u përfol gjatë dhe gjerësisht dhe prej biografëve e oratorëve të kohës, guxoi të marshonte drejt Romës në një moment mjaft delikat e me synimin që të mbetej pikërisht një prijës (më saktë, *dictātor*), pushteti dhe fuqia vendimmarrëse e të cilit nuk do të vihej në diskutim nëse arrinte të bënte të vetën idenë e prioritetit si shtetar i saj. Prejardhja nga një familje (gens Julia) që njihej për përkatësi fisnike dhe sprovime në periudha lufërash civile mjaft të rrepta për historinë e Romës, do t'i motivonte Jul Cezarit ambicie që në të vërtetë nuk ishin dhe nuk paraqiten aq të thjeshta për kritikët dhe studiuesit e biografisë së tij të zakonshme, duke qenë se ky bir i një familjeje patricësh nuk synonte thjesht konsullatin përmes përfshirjes në një marrëveshje tejet private siç ishte triumvirati i parë që ai shtrëngoi me Krasin e Pompeun, marrëveshje e lidhur privatisht, por me synime të qarta politike për tre anëtarët e sipërcituar.

Kapërcimi i një *limesi* siç ishte në atë kohë lumi Rubikon dhe për më tepër në krye të një ushtrie të armatosur më së miri, përbënte një “cënim” të sakralitetit jo vetëm territorial të botës romake e në këtë mënyrë Cezari arrin jo vetëm të priret lirisht drejt një kauze që ishte synim dhe qëllim primar për të personalisht, por dhe të përkujtohet gjatë si prej bashkëkohësve që jetuan pas vdekjes së tij, si prej shumë brezave që i referohen sa herë ndërmendin thënien e famshme latine *Alea iacta est*. (it. Il dado è tratto). Një personazh si ai i Jul Cezarit nuk do të harrohet ndonjëherë nga historianët që shkruan si për Evropën, si për Romën dhe për modelin që ajo ofroi edhe falë figurave që shënuan historinë përkatëse me veprime dhe pjesëmarrje në ngjarje që do të ishin vendimtare për një të ardhme që nuk do të konceptohej pa vetë personazhin, ambiciet përkatëse dhe rrjedhojat e vendimeve përkatëse. Vetë personazhi i Cezarit politikan, magjistrat, prijës ushtarak dhe *leader* i ushtrive që udhëhiqte, personazhi i Ciceronit, oratorit të shquar që shkroi e jetoj dhe në pikëpamje ambiciesh personale çka po ndodhte realisht në Romën e shekullit të parë para Krishtit, personazhi i Katilinës që provoi gjithsesi duke u nisur nga prejardhja jo e padenjë dhe rrethi politik që mendonte se e mbështeste të arrinte një pozicion të lavdërueshëm politik, të gjithë këta individë rijetojnë shekull pas shekulli në situatën politike dhe historike të shumë vendeve, anembanë botës. Vetë rrugëtimi biografik dhe politik i Jul Cezarit në veçanti nuk është tjetër veç një përballje e vazhdueshme me një sistem normash e kanonesh që në të vërtetë janë elemente konstitutive të një mënyre jetese dhe një sërë zakonesh që kishin ekzistuar prej kohësh në Romë. Historia e një *imperiumi* që u formësua pas funksionimit në shekuj

të një sërë formash konstitucionale, u bë dhe nga të tilla personazhe, ambiciet e të cilëve shënuan arritje dhe të natyrës institucionale që do të përmenden gjatë gjithë historikut të studimit të shtetformimit në studimet evropiane e jo vetëm evropiane. Me Jul Cezarin në veçanti morën një domethënie krejt specifike një sërë emërtesash hierarkike në Romën e asaj kohe, duke qenë ky i fundit aktor i denjë i një skenari politik sa të ndërlikuar, aq dhe kompleks e të veçantë në shumë pikëpamje.

Dihet fare mirë që *De bello civili* (*Mbi luftën civile*) u shkrua pikërisht nën qëllimin që të përshkruheshin më mirë episodet e një lufte civile që jo vetëm nuk qe pa pasoja për shtresat shoqërore të qytetit të madh të Romës, por dhe që bëri të mundur që ky personazh, Jul Cezari të sfidonte dhe njerëz që një herë e një kohë kishin qenë të afërt dhe në rang familjar me të. Veprat e Cezarit, të ofruara në formatin e komentareve dhe përshkrimeve që paraqiten të zhveshura nga figuracioni i tepërt dhe nga stilemat e tepruara, përbëjnë dhe një mundësi për të eksploruar më tej mbi natyrën e vendeve që përshkohen nga ushtarët e tij, për të krijuar një ide mbi nomenklaturën e toponimeve, hidronimeve dhe njësive të tjera gjeografike që paraqesin interes në vështrim diakronik dhe etnokulturor. Përshkrimet që ai sjell në një vepër më të gjatë dhe më të zgjeruar dhe që e bënë më me emër Cezarin në historinë e prozës latine (*De bello Gallico*), por dhe në historinë e qytetërimeve të hershme në Evropë janë në të vërtetë një tërësi të dhënash mbi mënyrën e jetesës së popullsive që për nga zakonet, doket dhe përkatësia etnike ishin të ndryshëm nga shumica e atyre që jetonin në Gadishullin Italik e më tej. Kthimi në një provincë të Romës të viseve të tjera ku jetonin galët,⁷ të cilët përshkruhen pasazh pas pasazhi në shumë aspekte nga autori i komentareve të sipërpërmendura qe një ndër ndërmarrjet më të vështira të marra përsipër prej tij, por njëkohësisht dhe një dëshmi e faktit që kur një personalitet ndiqet e vështrohet si *leader* nga ushtarët që e ndjekin dhe jetojnë me të, dhe arritjet e dëshiruara do të vijnë në një mënyrë a në një tjetër.⁸ Komentaret e sipërcituara u vlerësuan në pikëpamje të kontiguitetit gjuhësor dhe tekstor dhe nga Ciceroni vetë, i cili vlerësonte pikërisht thjeshtësinë dhe koncizitetin në të shkruar të autorit të tyre, pa lënë mënjane dhe vlerën që vetë gjinia në fjalë përfaqësonte dhe që mund të përfaqësojë dhe sot e kësaj dite nëse kemi parasysh faktin që çdo

⁷ Është e qartë që Cezari synonte dhe ngulmonte të përparonte drejt së ashtuquajturës *Gallia Belgica*, me qëllimin e qartë të arrinte deri në brigjet britanike e të zgjeronte sa më shumë kufijtë e sundimit romak.

⁸ Sa i përket emërtimit *leader* në lidhje me Jul Cezarin shih në veçanti kreun me titull *Prigioniero dei pirati* (75-74 a.c.), në Canfora L., *Giulio Cesare, il dittatore democratico*, Editori Laterza, Bari, 2009, f.14.

autor i klasicitetit latin ka përruar me shkrimtarinë përkatëse modele unike në pikëpamje kompozicioni, letrarësie dhe të shkruari. Një tipar i veçantë i kompozicionit tekstor të këtyre komentareve mbetet dhe përdorimi në mënyrë të përsëritur i vetës së tretë njëjës, fakt që e distancon në njëfarë mënyre dhe vetë autorin nga ç'ka zgjedhur të përshkruajë. Cezari vijon të mbetet një prej autorëve më të rëndësishëm të letërsisë së shkruar latine, më saktë, të prozës së shkruar latine duke qenë se përmes kësaj gjinie që ai e lëvroi më së miri arriti të përjetësonte momente të rëndësishme të historisë së Romës së shekullit të parë para Krishtit, por dhe të linte për brezat modelin e një qëndrimi të autorit ndaj episodeve dhe ngjarjeve që ai zgjedh të përshkruajë dhe të trajtojë, ndaj të cilave nuk ishte aspak indiferent dhe për më tepër, ishte më i përfshirë se kushdo tjetër që i lexonte ato.

Në botën romake mund të gjurmohen e evidentohen një sërë emërtesash që dëshmojnë një nomenklaturë të gjerë ofiqesh që mbulohen nga burrat. Nuk mjafton t'i referohemi vetëm emërtimit *rex* që mbetet një lemë që ka referencë të parët sundimtarë të Romës, të përmendur që në analet e para në të cilat ndërmerret si sprovë rindërtimi i historisë së Urbs-it, i pranuar në to e më tej nga autorë pasardhës se është themeluar të paktën që në vitin 753 p.e.s. Çdo emërtesë që mund t'i shtohet një fushe të caktuar semantike e që ka të bëjë pikërisht me të tilla emërtesa dhe me ofiqet përkatëse i shërben idesë se një shoqëri e tillë në shumë kompetenca dhe detyra përfaqësohej nga burra: oratorë, kuestorë,⁹ liktorë, censorë¹⁰, historianë,¹¹ duces (prijës ushtarakë), sacerdotë (përfshirë), consules (konsuj), duke qenë se ishin dy deri vonë dhe zgjidheshin çdo vit) etj. Një pjesë e mirë e këtyre emërtesave jo vetëm që trajtohen dhe shpjegohen në elemente të caktuara të programeve shkollore evropiane që kanë të bëjnë me gjuhën dhe me kulturën latine, por dhe përfaqësojnë raste kur shpjegimet e natyrës etimologjike që mund t'i vjelim nga leksikonet më me emër në historinë e leksikografisë latine, shpien qartë dhe natyrshëm te

⁹ Lat. quaestor, quaestōris m., -kuestor. Kuestori përfaqësonte një prej magjistraturave më të hershme minore në Romën e vjetër, që vijoi të ekzistonte si detyrë e ngarkuar dhe gjatë konsullatit të dy konsujve që zgjidheshin çdo vit. Mbetet një prej emërtesave më të rëndësishme në nomenklaturën e administratës romake, kryesisht me referencë ndaj çështjesh financiare apo administrative.

¹⁰ Lat. censor, censōris m. -censor, një magjistrat i rëndësishëm në botën romake, i institucionalizuar si i tillë që në vitin 443 p.K. Censorët ishin dy, zgjidheshin një herë në pesë vjet dhe ndër të tjera ishin të ngarkuar dhe të bënin regjistrimin (census-in) e popullsisë. Një magjistraturë e tillë ekzistoi deri në kohën e perandorit Domician.

¹¹ Duhet parë në këtë pikëpamje dhe kuptimi që në gjuhën latine merr emri *scriptor*, *scriptōris* m. - historian, shkruar, autor, kopist etj.

vetë historia e fjalës.¹²

Nëse ka një botë të përveçme që për shumë kohë ka tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe hulumtuesve si të teksteve dhe autorëve, aq dhe të periudhave që përfaqësohen nëpërmjet tyre, pikërisht antikiteti (ndoshta më i vonë në fillesa në rastin e romanitetit dhe latinitetit) është argumenti dhe lamija që ka bërë të mundur të zgjerohen dijet, të kërkohet më tej në pikëpamje burimesh, por dhe të dhënash mbi shoqërinë, familjen, pasurinë dhe të drejtat mbi të, përfshirjen në politikë, pushtetin e individit dhe të marrëdhënieve që degëzoheshin më tej falë këtij fakti, religjiozitetin e personit dhe të shoqërisë, barazinë gjinore etj.

Gjuha latine në vetvete pikësepari mbetet një prej burimeve kryesore në disiplina që lidhen me gjuhësinë i.e. dhe atë të krahasuar bashkë me elemente analoge kryesisht leksikore të gjuhëve të njohura si i.e. të lashta: sankritishtja, greqishtja e vjetër dhe ndonjë tjetër e zbuluar më vonë dhe e dëshmuar me shkrim në mënyra origjinale dhe po aq me interes për studimet mbi fillesat dhe zhvillimin e kulturave shkrimore në botë.

Relativiteti kronologjik që ka të bëjë në vështrimin tonë me një kohë më të largët në pikëpamje të kontestimit me shkrim nëse e qasim me gjuhët e sipërpërmendura, nuk zvetënon rëndësinë e fjalëve që në të vërtetë mbeten tharmi i kësaj gjuhe dhe njëkohësisht një rrugë për të hulumtuar në një botë që nuk mund të jetë vetëm e historianit që merret me fillesat dhe me evoluimin e pandalshëm të një bërthame që më tej do të shndërrohet në *imperium*, vetëm e filologut të teksteve latine dhe të ndikimeve greke në to, apo vetëm e gramatologut që në vështrim të parë duket se i duhet të jetë sa më sistemik në drejtim të njohjes së klasave themelore që do t'i nënkuptonim si kategori flektive në dijen e gramatologjisë dhe të morfologjisë historike. Për këdo që hulumton në lidhje me origjinën a zanafillën e një disipline të veçantë si dija mbi gjuhët dhe kulturat i.e., është më se e qartë që fjalë që lidhen me atësinë si koncept, me të qenit si folje që shpreh ekzistencë, vendndodhje, gjendje të individit, me të tjera elemente që lidhen me afrinë fisnore dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore nuk janë elemente sido që renditen thjesht për të konfirmuar afri të supozuara mes gjuhësh dhe kulturash që përfaqësohen nëpërmjet tyre. Janë pikërisht të tilla elemente që falë ekzistencës në variante të afërta në pikëpamje ligjësish fonetike, por dhe kuptimi themelor i kanë shërbyer rindërtimit të dijes mbi gjuhët dhe kulturat e popujve i.e., njëkohësisht kanë qenë shtysë dhe për të reflektuar mbi tipare të përbashkëta dhe diferencime nga

¹² Shih ndër të tjera dhe Guizot F.P.G., *Storia generale della civiltà in Europa dalla caduta dell'Impero Romano alla Rivoluzione Francese, versione con note di Antonio Zoncada*, Milano, 1841.

njëra kulturë në tjetrën.

Proverbialiteti vijon të mbetet një aspekt karakterizues i një bote të hershme që shënoi shekuj të tërë të një Evrope që do të konsolidohej vërtet shumë më vonë, por do të vijonte t'u njihje gjuhëve klasike vlera dhe merita të padiskutueshme. Legjislacioni, familja, drejtësia, fati dhe rastësia, dija dhe avantazhet që ajo sjell në jetë, besimi fetar dhe sfera semantike fort e përcaktuar që lidhet me të, janë temat që dhe pse në mënyrë të thukët dhe koncize janë cekur e bërë objekt vëmendjeje në të tilla korpuse proverbash e thëniesh. Rimarrja e tyre dhe në botime të natyrës anastatike, dhe në botime thellësisht kritike e të tematizuara që në thelb të konceptimit përkatës, por që njohin traditën e konsiderimit në pikëpamje rëndësie të këtyre thënieve e sentencave nuk përfaqëson tjetër veç rikonfirmimin e rëndësisë që vijon të ketë për brezat kryesisht të edukatorëve dhe didaktëve kjo pasuri që u ka rezistuar kohërave dhe ka vazhduar të përcojë elemente të një mençurie e maturie që ka zënë fill në përvoja mjaft të largëta në kohë e që vetë gjuha latine, e ruajtur dhe e transmetuar falë një ndërgjegjeje të fortë mbi kulturën dhe vlerën e saj për edukimin e pasqyron më së miri dhe fatmirësisht mjaft natyrshëm.

Omnia cum tempore: çdo gjë në kohën e vet (Ekleziasti), përbën një thënie mjaft koncize që thërret në kauzë maturinë dhe durimin e njeriut në pritshmëritë e veta; ***Gutta cavat lapidem:*** pika e gërryen gurin, (Ovidi), përfaqëson një tjetër maksimë që njihet si e tillë dhe në botën latine e që nënvizon idenë se këmbëngulja dhe persistenca gjithsesi shpjen në përfundime të pritshme apo të dëshiruara.¹³

Një autor si Lucius Anneus Seneca vijon të jetë i pranishëm jo vetëm në manuale që kanë objekt historinë e letërsisë latine, por dhe në traktate që kanë në qendër të vëmendjes karakterin njerëzor dhe sfidat e njeriut në kontekstet sociale: ***Imperare sibi maximum imperium est,*** dëshmon përherë sa i vështirë dhe sprovues mbetet sundimi i vetvetes dhe përballimi i situatave në të cilat njerëzillëku dhe maturia vihen në provë.

Thëniet vërtet të shumta në numër që shihet se i janë kushtuar fatit dhe ndodhive të jetës dëshmojnë një aspekt me rëndësi të besimit apo të besimeve të një populli që për më tepër, siç dhe historia e ka dëshmuar jo pak herë, ndikohej dhe nga kulturat me të cilat ndodhnin kontakte a shkëmbime. Në Dicionarët e gjuhës latine do të gjurmohet dhe *Fortuna* si zë më vete (me shkronjë të parë të madhe), fakt që tregon se njihet e konsiderohej si hyjni e gjinisë femërore. Për të do të shkruhet dhe në

¹³ Më vonë mendohet se është plotësuar a zgjeruar më tej në variantin e mëposhtëm: *Gutta cavat lapidem, non vi, sed saepe cadendo.* Mund të gjindet e përdorur dhe në autorë të tjerë latinë.

traktate mbi religjionin romak e ndërkohë rezulton të jetë përjetësuar dhe në monumente dedikatore në periudha të ndryshme të historisë së Romës. *Fortuna* shpjegohet hollësisht dhe në pikëpamje etimologjike në çdo botim serioz dhe voluminoz mbi historinë e leksikut latin, ndërkohë që nuk mungon as frazeologjia përkatëse që do të shihet se ka ekzistuar me kohë dhe në gjuhë që ruajnë lidhje derivacioni apo birnie me latinishten. I reflektuar si koncept dhe në botën ballkanike, duhet vënë në dukje se një emërtim ekzistues në gjuhën shqipe e gjithashtu dhe në burime më të hershme shkrimore të saj duket qartë që ka një prejardhje i.e., ndërkohë dhe në gjuhën latine ndeshim përdorime të së njëjtës fjalë qoftë dhe në numrin shumës, fakt që e bën më me interes përqasjen në pikëpamje përdorimesh dhe kontekstesh në të cilat gjen hapësirë i njëjti nocion.¹⁴

Fortuna caeca est (Fati është i verbër), do të shprehet Ciceroni; *Fortuna fortes metuit, ignavos premit*,¹⁵ do të shprehet Seneca, duke i mëshuar sërish si dhe autorë të tjerë paraardhës faktit që guximtarët janë më me fat në jetë. Brishtësia e fatit në jetë nënvizohet sërish dhe në këtë thënie më të zgjeruar të P.Sirit: *Fortuna vitrea est, tum cum splendet, frangitur*- Fati është prej qelqi, pikërisht kur ndrit, thyhet, shkrëmoqet.

Ligjshmëria gjithashtu përveç faktit që është sistemuar dhe evidentuar në vepra të përmasave që kapërcejnë të zakonshmen e që datojnë dhe në shekuj të mëvonë kur gjuha latine ishte në një rrugë të pandalshme shpërbërjeje dhe derivacioni në të tjera gjuhë, paraqitet si një çështje mjaft me rëndësi në konceptimin e autorëve latinë.

Nulla lex satis commoda omnibus est (Tit Livi), që evidenton faktin që asnjë ligj nuk është plotësisht i kënaqshëm për të gjithë, është gjithashtu mjaft aktuale në çdo situatë dhe periudhë të zhvillimit të shoqërisë dhe të shteteve të civilizuar.

Mens et animus et sententia civitatis posita sunt in legibus, mbetet një thënie që sintetizon se te ligjet qëndron mendja, shpirti dhe dituria e një qytetërimi. (Ciceroni, *Pro Cluentio*, 53, 146).¹⁶

Bota latine nuk konceptohet dot pa trashëgiminë kulturore që transmetojnë thëniet dhe sentencat që prej shekujsh u janë atribuar autorëve që kanë qenë

¹⁴ Në literatura të shumta ceket përdorimi i emrit asnjës *Fatum* dhe kontekstet në të cilat gjen përdorim ky i fundit. Në këtë kuptim do të vinim në dukje dhe faktin që këtij asnjësi i shtohen në pikëpamje përkatësie apo afrie semantike dhe të tjera fjalë që kanë të njëjtën rrënjë në pikëpamje etimologjike.

¹⁵ Në përkthimin italisht do të gjejmë dhe variantin gjegjës: *La fortuna teme i forti e opprime i deboli*.

¹⁶ Vërej dhe shprehjen po aq të ngjashme *Salus civitatis in legibus sita est*, një tjetër thënie e Ciceronit në të njëjtën vepër të cituar, *Pro Cluentio*, 53) e që rinëvizon rëndësinë e ligjshmërisë në botën romake.

dhe aktorë skenash sa politike, aq dhe historike, njëkohësisht kanë qenë dhe shkrimtarë që duke pasë zgjedhur të përpilojnë vepra apo seri vepërash që i shërbenin së njëjtës linjë tematike, lanë pas dhe gjini të papërsëritshme jo vetëm në kuptimin letrar e stilistikor, por dhe të modelit të vënë në zbatim në proces të hartimit të teksteve të tyre.

Nëpërmjet veprave të këtyre autorëve është e mundur të ndiqet një ecuri që dëshmon hap pas hapi si evoluon një sistem i tërë vlerash që u përçua sa qe e mundur dhe nga letërsia e shkruar dhe nga kontributi i tyre, që në jo pak raste përjetësuan me shkrimtarinë e tyre dhe çka lanë pas paraardhësit. Është një fakt jo i rastësishëm që në pasazhet e autorëve të rëndësishëm latinë të gjejmë interpretime mbi veprat e paraardhësve, ose bashkëkohësve, duke u bërë e mundur kësisoj të gjurmohen dhe grimca kritike që vijojnë të kenë vlerë dhe në ditët e sotme.¹⁷

Para së gjithash, autorët latinë si Tit Livi, Ciceroni, Cezari, Salusti, Taciti, Virgjili, Horaci, Tibuli, Ovidi, Seneka etj., emri i të cilëve jeton natyrshëm dhe kënaqshëm në korpuse të tëra që janë ndërtuar mbi proverbialitetin latin dhe historinë e mendimit përkatës, kanë bërë të mundur të rindërtohet mjaftueshëm imazhi i një bote që nuk është konsoliduar njëherazi, por ka kaluar faza të njëpasnjëshme që nuk janë lënë jashtë vëmendjes nga studiuesit e veçanërisht nga historianët. Bëhet e mundur të gjurmohet përmes veprash dhe ligjëratave të caktuara edhe historia e institucioneve politike, por dhe e aspekteve të tjera të *jetës romake*, për ta emërtuar këtë të fundit me një sintagmë që jo rrallë është përdorur nga historianë dhe antropologë të Romës së vjetër. Nga ana tjetër, gjurmimi kryesisht semantik dhe semiologjik i një sërë përdorimesh që i përkasin një bote kaq të ndërmendur dhe të hulumtuar bollshëm në studime dhe trajtesa të mirëfillta shkencore nuk bëjnë tjetër veç të ndihmojnë dhe të mbështesin natyrshëm në ecurinë përkatëse dijen e antropologjisë dhe të sociologjisë mbi mendimin antik, në veçanti atë romak dhe latin.

¹⁷ Shih në veçanti veprën e cituar: *Della lingua Latina e dei classici scrittori di essa; Prelezioni storiche di Agostino Salvioni a' giovani studenti di Latina filologia*, Paolo Cavalletti Librajo, Milano, 1842.

BIBLIOGRAFI :

- Bauduin P., *Désigner les parents : Le champ de la parenté dans l'œuvre des premiers chroniqueurs normands*, në *Anglo-Norman Studies XXIV*, përgatitur nga J.Gillingham, The Boydell Press, Woodbridge, 2002.
- Bruno M.G., *Il lessico agricolo latino e le sue continuazioni romanze*, Istituto Lombardo di Scienze, Milano, 1958.
- Bruno M.G., *Il lessico agricolo latino(seconda edizione)*, Adolf Hakkert publisher, Amsterdam, 1969.
- Benveniste É., *Termes de parenté dans les langues indo-européennes*, L'Homme, 1965.
- Benveniste É., *Essere di parola. Semantica, soggettività, cultura*, Mondadori, 2009.
- Bettini M., Short M.W., *Con i romani. Un'antropologia della cultura antica*, Il Mulino, Bologna, 2014.
- Bettini M., *Dei e uomini nella città. Antropologia, religione e cultura nella Roma antica*, Carocci editore, Le Frecece, 2015.
- Canfora L., *Giulio Cesare, il dittatore democratico*, Editori Laterza, Bari, 2009.
- Carcopino J., *La vita quotidiana a Roma*, Laterza, Bari, 2003.
- Collart J., *Histoire de la langue latine*, Paris, 1967.
- Chantraine P., *Études sur le vocabulaire grec*, Paris, 1956.
- De Meo C., *Lingue tecniche del latino. Testi e manuali per l'insegnamento universitario del latino*, Pátron editore, Bologna, 1983.
- Durante M., *Dal latino all'italiano moderno. Saggio di storia linguistica e culturale*, Zanichelli, Bologna, 1982.
- Fox R., *Anthropologie de la parenté. Une analyse de la consanguinité et de l'alliance*, Paris, 1972.
- Grimal P., *La mythologie Grecque*, Presses Universitaires de France, 1972.
- Grimal P., *La littérature Latine*, Éditions Fayard, 1994.
- Grimal P., *La civilization romaine*, Éditions Flammarions, 2009.
- Guizot F.P.G., *Storia generale della civiltà in Europa dalla caduta dell'Impero Romano alla Rivoluzione Francese, versione con note di Antonio Zoncada*, Milano, 1841.
- Heather P., *La caduta dell'impero romano(una nuova storia)*, Garzanti, Milano, 2008.
- La Penna A., *Sallustio e la "rivoluzione romana"*, Milano, 1968.
- La Penna A., *Epos e civiltà del mondo antico*, Loescher editore, Torino, 1990.
- Lentano M., *Nomen: Il nome proprio nella cultura romana*, Il Mulino, Bologna, 2018.
- Löfstedt E., *Il latino tardo*, Paideia editrice, Brescia, 1980.
- Mazzarino S., *Il pensiero storico classico*, Bari, 1966.
- Meillet A., *Lineamenti di storia della lingua greca*, Einaudi editore, Torino, 2003.
- Milizia P., *Le lingue indoeuropee*, Carocci, Romë, 2008.
- Mori E., *Dizionario dei termini giuridici e dei brocardi latini*, CELT, Piacenza, 2008.

- Ogilvie R.M., *Le origini di Roma*, Il Mulino, Bologna, 1995.
- Oniga R., *Il latino, breve introduzione linguistica*, Franco Angeli, Milano, 2007.
- Paci E., *Elemente të mësimit të gjuhës latine në disa gramatika të gjysmës së parë të shekullit të kaluar në shkollat shqiptare*, në *Hylli i Dritës*, n.1, 2018.
- Paci E., *Për një studim të thelluar dhe përmbajtësor të elementeve institucionale të gjuhës latine*, në *Buletin shkencor, Seria e Shkencave shoqërore*, n.68, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, 2018.
- Palmer L.R. *La lingua latina*, Einaudi, Torino, 2002.
- Paribeni R., *La famiglia Romana*, Casa editrice “Optima”, Roma, 1929.
- Poccetti P., Poli D., Santini C., *Una storia della lingua latina*, Carocci, Roma, 2003.
- Ramat P., Anna Giacalone, *Le lingue indoeuropee*, il Mulino, Bologna, 1996.
- Riganti E., *Lessico latino fondamentale*, Pàtron editore, Bologna, 1989.
- Schlösser R., *Le lingue romanze*, Il Mulino, Bologna, 2005.
- Spinosa A., *Cesare, il grande giocatore*, Le Scie, Mondadori Editore, Milano, 1986.
- Spinosa A., *Augusto, il grande baro*, Mondadori Editore, Milano, 1996.
- Traina A., Perini G.B., *Propedeutica al latino universitario*, Pàtron, Bologna, 1972.
- Vineis E., *Il latino*, Il Mulino, Bologna, 2005.

On an anthropologic and linguistic view of the basic notions of the roman and latin world in the Albanian university programs

ABSTRACT

The anthropology of antiquity actually remains one of the most interesting traces for the researchers of the Greek and Roman antiquity. Romanists and hellenists can be involved in it, tracing a number of aspects of a period or distant periods of time, but which provide many arguments for the study and research.

Two ancient civilizations such as those of Greece and Rome continue to influence by various forms of creativity, among which, antique literature continue to be an important part of the European and world cultural arsenal. The history of Greek and Roman antiquity, the history of Roman law, and the most important wars that triggered the expansion and empowerment of a great power of time like have marked and continue to influence many studies in various fields of human knowledge. Primary sources that have specifically evidenced the life of Rome, but have also influenced the development of literature and literary genres, remain to this day essential elements in the creation of a definite idea of the imperium and its political and administrative outlook.

Artan HAXHI & Tefë TOPALLI

TERMINOLOGJIA SI SISTEM

(Fjalor i termave të gjuhësisë)

(vijon)

AFORISTIK

Aforistik (nga greq. *aphoristikós*, që rrjedh nga *aphorismós* “*përkufizoj*”) quhet një tekst që përdor aforizma ose fjalë të urta. Është karakteri i një teksti të caktuar, i cili shpreh një gjykim me karakter përgjithësues, të dhënë shkurt, që nuk bën argumentime, por merr formën e një gjykimi dhe dëshiron të merret si i mirëqenë.

AFORIZËM

Me *aforizëm* kemi parasysh një pohim me natyrë gjykuese apo cilësuese – përshkruese, në formën e një gjykimi apo të një vëzhgimi të mprehtë. P.sh. :

“*Fuqia tenton të korruptojë dhe fuqia absolute korrupton tërësisht*”
(Lord Acton).

“*Historia është shkenca e gjërave që nuk përsëriten*” (Paul Valery)

Në kuptimin e saj parë fjala është përdorur në fushë të mjekësisë dhe është dëshmuar në Korpusin e porosive të mjekut dhe filozofit Hipokrati i Kosit, në shek. IV para erës sonë. Termi u rimor dhe u përdor më pas në letërsinë artistike nga Dante dhe Petrarca, kurse në periudhën e Mesjetës ai jepet i pandryshuar në kontekstin e saj mjekësor. Vetëm në vitet ’600 shënohet një pikë kthese: komentuesit italianë e spanjollë të Tacitit fillojnë ta përdorin këtë term në sferën politiko-morale, përmes përdorimit të metaforës për shtetin si një trup i sëmurë, të cilin virtytet terapeutike të princit-mjek duhet ta rishërojnë (ta kthejnë në jetë) dhe në atë të vlerës stilistike të shkurtësisë. Aforizmi vendoset në bashkimin e ligjërimit dialektik dhe të ligjërimit retorik, duke i dhënë karakterin e aksiomës një deklaratë, objektet e së cilës ose futen brenda fushëveprimit të mundshëm, ose lihen pas dore dhe tregohen si përjetësisht të parashikueshme, në mënyrë që të vijnë të stolisura me një vlerë doktrinare.

AFRAZI

Afrazi (verbale) është një term i përdorur në ambientin →logopedik amerikan (*apraxia of speech*) që shërben për të treguar një çrregullim në

prodhimin e fonemave, një programim me të meta të lëvizjeve të organeve që shërbejnë për prodhimin e tingujve gjuhësorë. Termi *afrazi* shërben gjithashtu për të shënuar përpjekjet e një pacienti me *afazi motorike* për të gjetur pozicionin e organeve të artikulimit dhe për të vënë në rend të saktë tingujt e një fjale shumërokëshe. Ndeshet tek fëmijët, kur kanë probleme në shqiptimin e tingujve, rrokjeve dhe fjalëve. Fëmija e di se çfarë dëshiron të thotë, por truri i tij ka vështirësi në koordinimin e lëvizjeve të muskujve të nevojshëm për të artikuluar ato fjalë. Ndeshet gjithashtu edhe tek të moshuarit dhe zakonisht shkaktohet nga dëmtimi i trurit (si pasojë e ictusit, traumës së kokës ose ndërhyrjeve kirurgjikale). Folësit janë në gjendje të lëvizin muskujt organeve të përfshira në procesin e artikulimit, por kanë vështirësi në të shprehur për shkak të zvogëlimit të kontrollit të vullnetshëm të këtyre muskujve. Duket sikur pacienti ka harruar se si të prodhojë tingujt e fjalës.

AFRI –shih afinitet

AFRIKAT

Afrikate ose mbylltore (nga lat. *affricatus*, pjesore e së shkuarës e *affricāre* “me fërku”) janë bashkëtingëllore të klasifikuara sipas llojit të pengesës. Sipas këtij klasifikimi, afrikatet bëjnë pjesë në grupin e bashkëtingëlloreve mbylltore të zhurmëta. Afrikatet janë një klasë tingujsh që kanë veçori edhe të bashkëtingëlloreve mbylltore, edhe të atyre shtegore. Ato janë tinguj të prodhuar nëpërmjet një mekanizmi artikulor që mbulon së pari një mbyllje të plotë të kanalit të gojës dhe më pas, në mënyrë të shpejtë, një tingull frikativ (fërkimor), pra, janë tinguj të përbërë me një fillim mbylltor dhe me mbarim shtegor, d.m.th. për nyjëtimin e tyre organi aktiv e mbyll plotësisht pengesën, por në fazën e fundit të nyjëtimit mbyllja kthehet në shteg dhe rryma e ajrit del jo me shpërthim, po duke u fërkuar në anët e shtegut. Pra, afrikatet janë bashkëtingëllore që nisin të shqiptohen si bashkëtingëllore shpërthyes dhe mbarojnë si bashkëtingëllore fërkimore. Të tilla janë alveolaret afrikate *c* (alveolare, afrikate, e shurdhët, sipas organit aktiv majore) dhe *x* (alveolare, afrikate, e zëshme, sipas organit aktiv majore); alveoqiellzoret afrikate *ç* (alveoqiellzore, mbylltore, afrikate, e shurdhët, nga organi aktiv paragjuhore) dhe *xh* (alveoqiellzore, mbylltore, afrikate, e zëshme, nga organi aktiv paragjuhore).

AFTËSI

Në parimet themelore të gjenerativizmit ekziston një hipotezë sipas së cilës

aftësia gjuhësore është e lindur gjenetikisht. Sipas *gramatikës universale* njohuritë e lindura përbëhen nga një predispozitë gjenetike që shërben si bazë për përvetësimin e gjuhës, e cila përmban në vetvete disa parime abstrakte të gramatikës, të cilat nuk mund të përftohen në mënyrë induktive në bazë të përvojës aktuale gjuhësore.

Me këtë hipotezë mund të shpjegohet, nga njëra anë, kompetenca gramatikore e folësit, pra, aftësia e tij për të kuptuar, prodhuar dhe gjykuar si gramatikore ose jogramatikore një numër potencialisht të pafundëm frazash të gjuhës së tij amtare edhe kurrë më parë të dëgjuara ose prodhuara prej tij; nga ana tjetër, mënyra e jashtëzakonshme në të cilën kjo aftësi zhvillohet duke filluar nga të dhëna përfundimtare dhe të fragmentarizuara, në mënyrë homogjene brenda një komuniteti gjuhësor, edhe pse përvoja mund të ndryshojë nga folësi në folës, në mënyrë spontane dhe relativisht të shpejtë, pa përpjekje të dukshme dhe pavarësisht nga inteligjenca individuale, në një moshë të përcaktuar mirë, jo përtej periudhës së pubertetit, pa kryer të gjitha gabimet teorikisht të mundshme.

Çomski thekson se *aftësia gjuhësore* është e pavarur nga aspektet e tjera të gjuhës. Këtë pavarësi ai e argumenton me natyrën unike të njohjes së gjuhës dhe me përdorimin e formave speciale të përvetësimit, që janë të dallueshme nga ato të aftësive të tjera mendore.

Hipoteza për karakterin unik të parimeve të gjuhës tregon ekzistencën e një zone autonome të trurit, që ka si detyrë njohjen e gjuhës, duke e parë në këtë mënyrë "*aftësinë gjuhësore*" të ndarë nga aftësitë e tjera mendore. Teoria e ndan trurin në pjesë apo module të veçanta, secila përgjegjëse për një aspekt të veçantë të veprimtarisë mendore. Teoria e *gramatikës universale* merret vetëm me modulën e gjuhës, i cili përmban një tërësi parimesh të veçanta, të ndryshme nga ato të moduleve të tjera dhe nuk hyn në lidhje me ta. Pra, kjo teori supozon që, ashtu si trupi përbëhet nga organe të ndryshme, edhe mendja/truri përbëhet nga organe mendore të veçanta: organi i logjikës, organi i matematikës, organi i gjuhës etj.

E metë e kësaj teorie është lokalizimi i këtyre organeve në vende të caktuara të trurit, çka ende nuk është vërtetuar shkencërisht.

AGJENT-i

Agjenti - vepruesi (nga *lat. agens < ago "me ba"*) është roli semantik i një frymori apo sendi, i shprehur në fjali nga elementi emëror, që është zbatues (bërës) i një ngjarjeje, pra, kryen veprimin e shprehur nga folja. Një agjent është zakonisht subjekt gramatikor i foljes në një fjali vepror. Një agjent prototipik është i vetëdijshëm, vepron me vullnet (ka një qëllim) dhe kryen një veprim që ka efekt fizik, të dukshëm.

Në gjuhët indoevropiane ai është shprehur nga subjekti; në sistemet që paraqesin rasi morfologjike, ai shprehet me emër rasën emërore. Në frazat pasive roli i agentit nuk është i mbuluar nga subjekti gramatikor, por nga i ashtuquajtimi plotës i agentit, morfologjikisht i shprehur nga një rasë e zhdrejtë ose përmes një sintagme parafjalore (p.sh. *nga* + emër).

Djali vrapoi në rrugë.

Ai u ndoq nga qeni.

Në tipologjinë sintaksore të propozuar nga Bloomfield (1933), nocioni i agentit identifikon atë që kryen veprimin, normalisht subjekt i një foljeje kalimtare.

AGJENTIV-e

1. *Agentive* quhet një formë gramatikore (rasë e vepruesit) përmes së cilës tregohet ai që kryen veprimin në një fjali (agjenti i veprimit), që shprehet, si rregull, nga emra frymorësh. Në gjuhët indoevropiane forma veprare apo ajo joveprare e foljes ndërvepron me emrin në funksion *agentiv* nga momenti që ai përkon me subjektin gramatikor, në qoftë se folja është jokalimtare ose kalimtare veprare; në këtë rast agentivi është i shënuar nga rasi emërore. Nëse folja është në formën joveprare, funksioni i agentit nuk pajtohet më me atë të shprehur sipërfaqësisht nga emërorja, por, si rregull, shprehet përmes përdorimit të një sintagme parafjalore në të cilën emri është në një rasë të zhdrejtë. P.sh.

Agroni e kapi lepurin

frazë veprare

Lepuri u kap nga Agroni

frazë pasive me plotës agjenti

(kryefjala logjike e fjalisë së dytë është *Agroni*, sepse ai e kryen veprimin, kurse lepurit thjesht i përgjigjet pyetjes kryefjalore "*kush*").

2. Në hapësirën e gramatikës së rasave, të përpunuar nga Fillmore¹ (1968), *agentivi* tregon një rasë të veçantë, brenda një numri të kufizuar rasash me vlerë parësore semantike. Bëhet fjalë për rasën që shpreh kryerësin e veprimit të shprehur nga folja.

Në këtë perspektivë teorike ekziston një korrespondencë semantikisht e bazuar ndërmjet subjektit të një fraze me folje kalimtare dhe plotësit të veprimit të një fraze me folje pasive.

Në frazat latine *mater vocat puellam* dhe *puella vocata est a matre*, e njëjta rasë *agentive* duhet të jetë shënuar jo vetëm nga emri *mater* (në rasën emërore) të frazës së parë, por edhe nga sintagma emërore *a matre*

¹ Fillmore, Ch. J. (1968), The Case for Case, in E. Bach e R.T.Harms, Universals in Linguistic Theory, Holt, Rinehart & Williston, New York, fq. 1-88.

(parafjalë + emri në rasën rrjedhore) të frazës së dytë.

3. *Sintagmë agjentine* quhet plotësi i veprimit të frazave pasive, thënë ndryshe kundrinori i zhdrejtë me parafjalë i fjalive që e kanë foljenkallëzues në diatezën pësore.

AGLOMERAT

Aglomerat (nga lat. *agglomerare*, rrjedh nga *glomus*, “me mbledhë tok”) – grumbullim, term që përdoret në dy kuptime :

1. *Aglomerat fonetik* – quhet një grup prej dy zanoresh apo dy bashkëtingëlloresh të njëpasnjëshme. P.sh. ka një aglomerat bashkëtingëllor [ks] në fjalën latine *dux* “shef, kryesor”.
2. *Aglomerat semantik* – quhet një njësi e rëndësishme, ku semat, me tipare dalluese të qenësishme, nuk kanë ndërmjet tyre ndonjë marrëdhënie të veçantë, por thjesht i shtohen njëra-tjetrës; kështu, *vajzë* është një *aglomerat semantik* i formuar nga [+ njerëzor], [-femër]. Aglomerati semantik i kundërvihet →*konfigurimi*, ku semat kanë ndërmjet tyre një marrëdhënie të veçantë; kështu, për *gjigand* [+ njerëzor], [+mashkull] përfshihet edhe dimensionin [+ i madh].

AGLUTINIM

Aglutinimi (nga lat. *agglutināre* “me ngjitë”) ose përngjitja është një mënyrë fjalëformimi me anë të së cilës formohen fjalë të reja nga leksikalizimi i një sintagme apo i një grupi fjalësh, si pasojë e përdorimit të gjatë pranë njëra-tjetrës. Lidhjet sintaksore ndërmjet gjymtyrëve të sintagmës a të togut në përgjithësi ruhen të qarta edhe në strukturën e fjalës së re të përngjitur, p.sh. *domethënë* (do me thënë), *farefis* (farë e fis), *kushdo* (kush do), *drejtpërdrejt* (drejt për drejt), *tungjatjeta* (t’u ngjattë jeta), *askush* (as kush) etj.. Ky proces ka një rëndësi të madhe në evolucionin diakronik të një gjuhe.

AGLUTINUES

Aglutinues (përngjitës) është përcaktuar tipi gjuhësor që paraqet karakteristika strukturore të aglutinimit, domethënë pranëvënie të ndajshmesave rrënjore të dallueshme për të shprehur marrëdhënie gramatikore, pra, kanë mundësinë për të kombinuar në çdo fjalë të veçantë shumë morfema qartësisht të dallueshme dhe të segmentueshme. Kjo ndodh për shkak të pandryshueshmërisë së morfemave të veçanta, të cilat, ndryshe nga sa ndodh në gjuhët sintetike, nuk pësojnë fenomene të dukshme të transformimit në aspektin fonologjik. Shembull paradigmatic i një tipi gjuhësor *aglutinues* është turqishtja.

AGLUTINATIV

Quhen *aglutinative* (përngjitëse) gjuhët në të cilat fjalët janë të përbëra nga disa morfema të dallueshme, të lidhura sipas një rendi linear, ku secili përbërës i kuptimit është përfaqësuar nga morfema e vet. Shembull i një gjuhe të tillë është turqishtja, ku, p. sh., fjala *evlerinizden* – “nga shtëpitë tuaja”, përbëhet nga morfemat *ev-ler-iniz-den* me kuptimin: *shtëpi+tregues i shumësit (të) + tuaja + nga*.

ose në gjuhët çukçi :

*t*E -meyN*E -levt*E -p*E*ft -*Erk*En*

“Unë kam një dhimbje koke të madhe”.

E kundërta e një gjuhe aglutinative është një gjuhë fuzionale (shkrirëse).

AGMË

Agmë (nga greq. *αγμα*, “pjesë”) është një lloj tingulli bashkëtingëllor i përdorur në varietete të folura të disa gjuhëve. Bëhet fjalë për shqiptimin e tingullit ‘ng’, një bashkëtingëllore hundore prapaqellëzore, që në Alfabetin Fonetik Ndërkombëtar përfaqësohet nga simboli η, si p.sh. në anglisht *thing* (θɪŋ), *long* (lɒŋ) ose *tank* (tæŋk) ose në shqip (gegërisht) *kangë* (kaŋɛ) etj..

AGRAFI

Agrafi (nga greq. *a* parashtesë mohuese + *gráphein* “me shkru”) term i përdorur në fushë të neurolinguistikës, që i referohet humbjes së aftësisë për të komunikuar përmes shkrimit. Ajo vjen si pasojë e sëmundjeve cerebrovaskulare, të traumave të kokës etj.. Agrafi e pastër është atëherë kur kemi njëkohësisht mungesë të të shprehurit me gojë dhe humbje të aftësisë për të lexuar (→gjithashtu *aleksi*, *afrazi*). Dallohet nga disgrafia.

AGRAMATIZËM

Agramatizmi (nga lat. e vonë *agrammātus*, gr. ἀγράμματος “analfabet”) është humbje e aftësisë për t’u shprehur në mënyrë gramatike të saktë apo për të paraqitur idetë përmes renditjes së saktë sintaksore të fjalëve në ligjërim. Ai është një formë e humbjes së të folurit sintaktik, ku pacienti fjalët i shqipton saktë, por jo me një strukturë të rregullt nga ana gramatikore. Ndryshimi i strukturës gramatikore në këtë rast ka të bëjë me vështirësi në zberthimin sintaksor të mesazheve verbale dhe në prodhimin verbal me thyerje të rregullave të gramatikës përmes përdorimit të emrave, mbiemrave, përemrave, foljeve pa konkordanca morfologjike.

AKADEMIK, ~u m.sh. ~ë, ~ët

Akademik (nga greqishtja *akadémeia* - vendi ku jepte mësim filozofi grek Platoni) është një term që përdoret me disa kuptime :

1. Dikush që i përket shkollës filozofike të Platonit (shek. V para erës sonë).
2. Që lidhet me një person apo një vepër të thellë shkencore dhe me erudicion.²
3. Anëtar i një akademie të shkencave.
4. Titull shkencor që i jepet një dijetari, një shkrimtari, një artisti etj. nga një akademi.

AKADEMIK, ~e, mb.

1. Që ka të bëjë me akademinë, i akademisë; që është i një niveli të lartë teorik, shkencor e artistik, që u përgjigjet kërkesave më të përpunuara e të rrepta të një fushe (titull akademik, botim akademik etj.).
2. Në kuptim të figurshëm: Që është tepër teorik e i stërholluar, që është i palidhur me jetën e me praktikën; i ftohtë, pa ndjenja (me frymë akademike, diskutim akademik, gjuhë akademike, stil akademik, që ndonjëherë merr edhe nuanca përkeqësuese, si një vepër apo shkrim i cili nuk ka vlera origjinale etj.).
3. Një vepër që shquhet për respektimin e rregullave dhe të formave tradicionale të hartimit të saj.
4. Që ka të bëjë me jetën e me veprimtarinë mësimore të shkollave të larta (vit akademik, orë akademike, jeta akademike etj.).
5. Mbrëmje *akademike* është një mbrëmje me karakter solemn, që i kushtohet përkujtimit të një ngjarjeje të rëndësishme.
6. Pikturë *akademike* është piktura që ndjek parimet e akademizmit.
7. Shkrim *akademik* lëndë që mësohet në shkollë të lartë.

AKIROLOGJI

Akirologji (nga gr. ἀκυρολογία (*akyrología*) < ἄκυρος (*ákyros*) – i privuar nga autoriteti, jolegal, jo i vlefshëm + -λογία (*lógia*) – fjalim, ligjërime) është përdorimi jokorrekt dhe i papërshtatshëm i fjalëve, që prodhon paronimi dhe kakologji, pra, shprehje logjikisht ose stilistikisht me të meta (difektoze). Në letërsinë artistike përdoret edhe si figurë retorike (e quajtur ndryshe edhe *katakreze* - keqpërdorim, abuzim), e cila nënkupton përdorimin e një fjale në vend të një tjetre më të përshtatshme, ose pse ajo

² Ferdinand Leka, *Fjalori i termave të letërsisë*, INFBOTUES, Tiranë, 2013, fq. 10.

mungon në gjuhën tonë, ose për qëllime stilistikore. Është një formë e metaforës me anë të së cilës emri i një gjëje shtrihet tek një tjetër për shkak të mungesës së fjalës së duhur, duke marrë një kuptim figurativ: "qafa" e shishes, "këmbët" e tabelës, "gjiri" i detit, "gjuha" e tokës, në "gjoks" të malit; ose një fjalë që përdoret me një kuptim që është në kundërshtim me atë fillestar: *muzg i detit*, *kaligrafi e keqe*, *ëmbëlsia e hidhur* etj..

"Unë kam ardhur në vend të çdo drite të heshtur".

AKLIMATIZIM

Aklimatizim (përshtatje) është procesi në të cilin një organizëm i veçantë përshtatet ndaj një ndryshimi gradual të mjedisit të tij. Kjo është e njëjtë edhe për gjuhët. Përdoruesit e një gjuhe të caktuar mund të lëvizin nga një vend në tjetrin, duke bartur me vete gjuhën e tyre. Kjo gjuhë mund të mbijetojë për një kohë të caktuar, duke bashkëjetuar me gjuhët e tjera të vendit ku janë shpërngulur bartësit e saj, por gjithashtu ajo mund të lëshojë rrënjë dhe të bëhet gjuhë e vetme e folur në atë vend (me pasojë mënjanimin e gjuhëve të tjera burimore). Në të njëjtën mënyrë se si një kafshë e i transportuar nga një vend i caktuar *aklimatizohet* (përshtatet) në një vend të ri, ndoshta duke humbur një pjesë të karakteristikave të tij, edhe gjuhët përshtaten, duke marrë në njëfarë mënyre ngjyra lokale. Kështu, hollandishtja, për shembull, ka njohur në Indonezi një periudhë *aklimatizimi*, më pas u zhduk. Nga ana tjetër, portugalishtja në Brazil është pasojë e një procesi *aklimatizimi*. Ajo mënjanoi pjesën më të madhe të gjuhëve vendëse (popullsisë gjuhësore) duke zënë vendin e tyre, por në të njëjtën kohë ajo u ndikua prej tyre, duke u transformuar pjesërisht.

Një specie që të aklimatizohet duhet domosdoshmërisht të transformohet, të përshtatet me kushtet lokale, në veçanti me kushtet klimaterike. Kjo është e njëjtë edhe për gjuhët (ndonëse klima nuk luan asnjë rol këtu). Aklimatizimi i spanjishtes në Kubë apo në Argjentinë ka sjellë ndryshime të saj në fonologji, në leksik dhe në sintaksë, si pasojë e ndikimeve të pësuar nga gjuhët vendëse. Edhe pse nuk e dimë nëse aktualisht frëngjishtja njihet në Afrikë aklimatizim apo është në fazën e aklimatizimit para se të zhduket, ne mund të vërejmë tek ajo modifikime, përshtatje që bëjnë të mos flitet më për të njëjtën gjuhë që përdoret në rrugët e Bamakos (Mali), të Abixhanit (Bregu i Fildishtë), të Libreville-s (Gabon) dhe në ata të Parisit. Nga ky vëzhgim del qartë: "e njëjta gjuhë" merr forma të ndryshme në hapësira të ndryshme.

ADOPTIM

Adoptim - përshtatje (nga *lat. adoptare*, e përbërë nga *ad-* dhe *optare*, “*me dëshirë, me zgjedhë*”) është term i përdorur në sociolinguistikë në dy kuptime të ndryshme.

1. Nga këndvështrimi mikrosociolinguistik paraqet një aspekt të fenomenit të huazimit gjuhësor;
2. Nga pikëpamja makrosociolinguistike, ai përfaqëson një nga katër llojet e procesit të futjes së një folësi (ose një bashkësie gjuhësore) në një kontekst gjuhësor të ndryshëm nga ai i origjinës. Përshtatja përfaqëson një formë të ndryshme të integritimit, në të cilën një folës (ose një bashkësi e folësve) e pranon kontekstin e ri pa “*vlerën negative*” që mund të karakterizojë integrimin dhe merr pjesë aktive në këtë proces, që do të jetë shumë më i rëndësishëm sa më shumë i zgjeruar është rrjeti shoqëror i referencës dhe sa më e gjallë është situata shoqërore që përcakton futjen.

BIBLIOGRAFI:

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë.
- Beccaria, G.L. (2004), *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Piccola Biblioteca Einaudi.
- Belluscio, G. & Rrokaj, Sh. (2011), *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë.
- Dubois, J. & Giacomo, M. & Guespin, L. & Marcellesi, Ch. & Marcellesi, J. & Mevel, J. (2001), *Dictionnaire de linguistique*, Larousse, ISBN : 2-03-532047-X.
- Dubuc, R. (1992), *Manuel Pratique de terminologie*. Linguatex: Brossard.
- Scalise, S. (1994), *Le strutture del linguaggio: morfologia*, il Mulino, Bologna.
- Leka, Ferdinand (2013), *Fjalori i termave të letërsisë*, INFBOTUES, Tiranë, ISBN 978-9928-173-11-9.
- Fillmore, Ch. J. (1968), *The Case for Case*, in E. Bach e R.T.Harms, *Universals in Linguistic Theory*, Holt, Rinehart & Willston, New York.

Terminology as a system (Glossary of Linguistics Terms)***ABSTRACT***

This article comes is a continuation of the article with the same title which was published in the previous publications. In it, 20 language terms have been explained, which we come across in the field of literature, both in contemporary and traditional one. In our explanations, we have tried to preserve the particular characteristics that often reflect the original value they have, according to different linguistic theories or which might be revised by the Science of Albanian Language to different concepts.

Orjeta BAJA

**FJALËT FRËNGE NË GJUHËN SHQIPE
SIPAS “FJALOR ETIMOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE”
TË AKADEMIKUT KOLEC TOPALLI**

1. Gjuha shqipe dhe kontaktet e saj gjuhësore ndër shekuj

Të gjitha gjuhët huazojnë fjalë nga gjuhët e tjera, fqinje apo më të largëta, e për rrjedhojë edhe “japin hua” gjithashtu, dhe gjurmët e këtyre marrëdhënieve pasqyrohen në leksikon e tyre. Nga kjo pikëpamje, edhe fjalët, sikurse objektet dhe njerëzit, “udhëtojnë” nga një vend në një tjetër, nga një kulturë në një tjetër, duke bërë që asnjë gjuhë të mos shfaqet “puro” brenda këtij procesi të natyrshëm dhe të pandalshëm. Historia e gjuhëve e tregon qartë këtë dukuri universale, *huazimin e fjalëve*, i cili merr pjesë gjerësisht në dinamikën e gjuhëve dhe zgjerimin e pasurimit e fjalorit të tyre.

Edhe shqipja, duke ndjekur udhën e gjatë të historisë së kombit shqiptar, gjithashtu ka marrë e ka dhënë me gjuhët e popujve me të cilët është takuar gjatë historisë, duke u pasuruar me fjalë e shprehje që i janë përshtatur sistemit të saj, sa nganjëherë është vështirë të dallohen nga fjalët e trashëguara. Si rezultat i kontakteve të vazhdueshme gjuhësore ndër shekuj me popullsi të ndryshme, gjuha shqipe është përballur me fjalë të huaja burimesh të ndryshme, si: latine, greke, sllave, turke, romane (italishtja, frëngjishtja) e angleze. Kujtojmë këtu: - kontaktet me gjuhët e popujve që erdhën si pushtues në trevat e banuara nga shqiptarët, - kontaktet e fqinjësisë gjeografike, - kontaktet me gjuhët e popujve me të cilët shqiptarët kanë pasur lidhje për shkaqe ekonomike, politike, shoqërore e kulturore. Sigurisht, ndikimet gjuhësore, sidomos ato leksikore, nuk kanë qenë të së njëjtës peshë; në periudha të caktuara, njëra gjuhë ka pasur pozitë dominuese dhe nga ajo janë huazuar një numër i madh fjalësh, më pas ky ndikim i asaj gjuhe është dobësuar, duke i lënë vend dominues një gjuhe tjetër.

2. Ndikimi i huazimeve frënge në gjuhën shqipe

Lidhje të shumta kulturore e intelektuale ekzistojnë prej shumë kohësh mes Francës e Shqipërisë, duke bërë që kultura franceze të gjejë

pasqyrim në jetën dhe kulturën shqiptare, me gjurmë të ndjeshme edhe në gjuhë. Një numër i madh librash francezë gjenden në bibliotekat shtetërore dhe ato private shqiptare, ku, si fakt interesant do të përmendnim se "... në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë, libri i parë në frëngjisht i përket vitit 1577"¹.

Sipas studiuesit Jani Thomaj, "huazimi më i hershëm i fjalëve nga frëngjishtja në shqipe i përket kryesisht fundit të shekullit XIX e fillimit të shekullit XX."² Në këtë periudhë e në vazhdim, sidomos *pas shpalljes së Pavarësisë* (më 1912), në përputhje me kushtet e reja shoqërore, ekonomike, politike e kulturore, gjuha shqipe njohu mjaft zhvillime e lëvizje, kryesisht në leksik. Në fusha të ndryshme të veprimtarisë gjuhësore dhe nga shtresa shoqërore të caktuara, nisën të përdoren emërtime të reja, shumë prej tyre me fjalë të huazuara. Siç vihet në dukje përsëri nga leksikologu Thomaj: "Në vitet '20 të shekullit XX, në gjuhën shqipe hynë fjalë nga gjuhët neolatine, nga frëngjishtja e nga italishtja, më shumë në fushën e terminologjisë."³ Mund të përmendim këtu terminologjinë juridiko-administrative që ka karakter të theksuar frëng, kjo, nisur nga fakti se krijimi i shtetit shqiptar në vitet '20 të shekullit të kaluar bazohej kryesisht në juridiksionin frëng. "Janë dy etapa të rëndësishme në procesin e konstituimit të terminologjisë juridike shqipe: një periudhë e vjetër që shtrihet deri te fillimet e shekullit XX dhe një etapë moderne që nga ajo kohë e deri më sot. Ajo që karakterizon etapën e dytë, është origjina latine dhe romane, sidomos frënge e shumicës së termave administrativo-juridikë. Gjatë kësaj periudhe të dytë, shumica e termave turkë, grekë, sllavë të huazuar më herët eliminohen dhe zëvendësohen me neologjizma kryesisht frëngë. Të dhënat mbi termat juridikë shqip japin një imazh të kontributit të frëngjishtes në modernizimin e gjuhës administrativo-juridike shqipe, si dhe në formimin e një gjuhe juridike ndërkombëtare."⁴ - vë në dukje gjatë një hulumtimi studiuesja B. Bajrami. Po sjellim disa raste termash me burim latin e roman nga terminologjia administrativo-juridike shqipe: *testament* (it.), *dekret* (it., fr., prej lat.), *incident* (it., fr., prej lat.), *mandat* (lat., it.), *replikë* (fr., it., prej lat.), *akuzë* (it., prej lat.), *apel* (fr., it., prej lat.)

¹ Mahir Hoti, *Fjala e hapjes e rektorit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"*, në "Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare" (Studime shqiptare 13), Shkodër, 2005, f. 7.

² Jani Thomaj, "Leksikologjia e gjuhës shqipe", Tiranë, 2006, f. 258.

³ Po aty, f. 250.

⁴ Bade Bajrami, *Prurjet frënge në terminologjinë administrativo-juridike shqipe*, në "Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", Prishtinë, 2010, f. 307.

etj., apo disa të tjera që dëshmojnë se kjo lloj terminologjie është e hapur në mënyrë të veçantë ndaj frëngjishtes, me të tilla raste, si: *anketë (fr.)*, *krim (fr.)*, *kriminel (fr.)*, *shantazh (fr.)* etj.

Në këtë periudhe (gjysma e parë e shek. XX), edhe në fushën e arsimit, kemi ndikime të ndjeshme nga frëngjishtja në shqipe. Kujtojmë këtu ekzistencën e Liceut francez të Korçës, që konsiderohej si një nga institucionet më të rëndësishme të kohës në vend. *Liceu Kombëtar i Korçës* ose *Liceu Francez* ishte një shkollë e mesme në qytetin e Korçës, financuar nga qeveria shqiptare, por që përhapte kulturën franceze dhe vlerat evropiane. Shkolla funksionoi plotësisht në vitet 1917-1939. Po brenda kësaj periudhe, më 1926, daton njëkohësisht hapja e një shkolle infermierie e Kryqit të Kuq francez.

Vite më vonë, gjatë periudhës së izolimit të Shqipërisë, gjatë kohës së komunizmit, Franca ishte i vetmi vend në Perëndim me të cilin Shqipëria mbante lidhje diplomatike e kulturore. Për rrjedhojë, kjo marrëdhënie do të linte sigurisht gjurmët e saj në gjuhë: së pari, nga fakti që frëngjishtja ishte bërë pjesë e programit shkollor parauniversitar e universitar; së dyti, nga fakti që për një numër njerëzish, edhe pse shumë i kufizuar (për arsye të kohës), ofroheshin bursa studimi për specializime në Francë. Kjo situatë do të zgjaste deri më 1990; për të kaluar më pas në një epokë tjetër, në atë të demokracisë, me hapje të kufijve të Shqipërisë e lëvizje të lirë të popullsisë.

Ndërkohë, *pas viteve '90*, si rrjedhojë e ndryshimeve të mëdha social-politike dhe e ndryshimeve të reja në ekonomi, në demokratizimin e jetës dhe në hapjen e vendit në marrëdhënie me botën, leksiku i shqipes përjetoj një lëvizje të brendshme të vrullshme në disa shtresa, mes të cilave edhe në atë të huazuar, e për rrjedhojë edhe në atë frënge.

Më 1992, krijohet Komiteti i Aleancës Franceze të Tiranës, ku kjo iniciativë kishte për qëllim mbështetjen e mësimit të frëngjishtes në Shqipëri. Që nga ai vit, pas krijimit edhe të rrjetit të saj (përbërë nga pesë struktura që ndodhen në: Tiranë, Shkodër, Elbasan, Korçë dhe Durrës, dhe nga anekse në qytetet e Beratit, Lezhës, Librazhdit dhe Pogradecit), Aleanca Franceze është e përkushtuar ndaj mësimit të gjuhës franceze përmes një përqasjeje që nxit dialogun kulturor në një shoqëri gjithnjë e më multikulturore, duke organizuar herë pas here edhe aktivitete kulturore - shprehje të kulturës franceze dhe frankofone -, që, sigurisht, lënë gjurmët e veta edhe në gjuhë.

* * *

Në këtë punim do të ndalemi pikërisht tek *huazimet frënge*, tek kjo shtresë me ndikim jo të vogël në gjuhën shqipe:

Huazimet frënge në gjuhën shqipe, sikurse edhe huazimet e tjera, kanë prekur të gjitha rrafshet e saj gjuhësore, diku më shumë e diku më pak: *fonetikën, leksikun, morfologjinë e sintaksën*. P.sh., janë huazime sintaksore frënge në shqipe ndërtime të tilla: *është kjo një (ditë) ...* (nga fr. *c'est un (jour) ...*) apo *është për këtë arsye që ...* (nga fr. *c'est pour cette raison que ...*) etj. Por, vëmendjen tonë në këtë punim e ka tërhequr *leksiku*, si rrafshi që preket drejtpërdrejt dhe më shumë nga huazimet. Ndikimi frëng ka depërtuar aq shumë në nivel leksikor, duke u përdorur vazhdimisht ato leksema, sa jo rrallëherë është bërë e vështirë të dallohet cila fjalë është e gjuhës shqipe dhe cila e huaj (frënge). Kjo gjë duket qartë nga leksiku me huazime frënge që kemi nxjerrë për studim në këtë punim. Për realizimin e këtij kërkimi, i jemi referuar veprës së akademikut Kolec Topalli “Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe” (Tiranë, 2017), duke pasur parasysh se - siç shprehet edhe vetë autori -: “Me fjalorë të tillë mund të dallohen shtresat e ndryshme të huazimeve historike, si edhe të ndiqen rrugët e hyrjes së tyre në gjuhën shqipe, me një fjalë, shtegtimitet e fjalëve, që mund të jenë të drejtpërdrejta ose të tërthorta, nëpërmjet një gjuhe tjetër”⁵.

Leksiku i vjelë për këtë trajtesë (paraqitur më poshtë) përmban fjalë që shqipja i ka huazuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga frëngjishtja. Rastet e huazimeve frënge të ardhura në shqip në mënyrë të tërthortë, prej gjuhësh të tjera ndërmjetëse, nuk i kemi përfshirë në punim, të tilla si: *buxhet* (huazim nga ang. *budget*, me burim prej fr. vj. *bougette*), *damë* (huazim nga it. *dama*, me burim prej fr., që ka si bazë lat. *domina*), *damixhanë* (huazim nga it. *damigiana*, prej fr. *dame-jeanne*) etj. Gjithashtu, rastet që në Fjalor përcaktohen si huazime latino-romane apo romane (pra, mes tyre huazuar edhe nga frëngjishtja), nuk i kemi bërë objekt studimi, të tilla si: *abdikoj*, *absolut*, *absorboj*, *abstenoj*, *acetik*, *acid*, *aderoj*, *administroj*, *admiroj*, *adoptoj*, *afekt*, *aglomerat*, *aksesor*; *abonuj*, *abuzoj*, *adekuat*, *akreditoj*, *akustik*, *alkool*, *binom*, *biografi*, *delikat*, *demarkacion*, *demografi* etj.

⁵ Kolec Topalli, “Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2017, f. 5.

Fjalët frënge
që shqipja i ka huazuar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej kësaj gjuhe
(shkronjat: A, B, C, D, E)

Fjalë frënge të përshtatura në gjuhën shqipe:	Fjalë frënge në gjuhën shqipe në trajtën e kësaj gjuhe dhënëse:
Abazhur <i>em. (m)</i>	Abat-jour <i>n. (m)</i>
Abordazh <i>em. (m)</i>	Abordage <i>n. (m)</i>
Adaptoj <i>f.</i> (adaptim)	Adapter <i>v.</i>
Adresë <i>em. (f)</i> (adresoje, adresim)	Adresse <i>n. (f)</i>
Afische <i>em. (f)</i> (afishoj, afishim)	Affiche <i>n. (f)</i>
Aforfe <i>ndf.</i>	A forfait <i>adv.</i>
Agrement <i>em. (m)</i>	Agrément <i>n. (m)</i>
Aksident <i>em. (m)</i> (aksidentoj, aksidentim, aksidental, aksidentalisht)	Accident <i>n. (m)</i>
Aksion <i>em. (m)</i> (aksionist, aksionar, aksioner)	Action <i>n. (f)</i>
Albatros <i>em. (m)</i>	Albatros <i>n. (m)</i>
Aliazh <i>em. (m)</i>	Alliage <i>n. (m)</i>
Alo <i>pasth.</i>	Allô <i>interj.</i>
Ambalazh <i>em. (m)</i> (ambalazhoje, ambalazhim, ambalazhues)	Emballage <i>n. (m)</i>
Ambasadë <i>em. (f)</i> (ambasador)	Ambassade <i>n. (f)</i>
Amidon <i>em. (m)</i>	Amidon <i>n. (m)</i>
Amper <i>em. (m)</i>	Ampère <i>n. (m)</i>
AND <i>em. (f)</i>	AND <i>em. (f)</i>
Anekdotë <i>em. (f)</i> (anekdotik)	Anecdote <i>n. (f)</i>
Angazhoje <i>f.</i> (angazhim, i paangazhuar)	Engager <i>v.</i>
Ankand <i>em. (m)</i>	Enchère <i>n. (f)</i>
Anketë <i>em. (f)</i> (anketoje, anketim, anketues)	Enquête <i>n. (f)</i>
Ansambël <i>em. (m)</i>	Ensemble <i>n. (m)</i>
Antrakt <i>em. (m)</i>	Entracte <i>n. (m)</i>
Artizan <i>em. (m)</i>	Artisan <i>n. (m)</i>

(artizanal, artizanat)	
Asamble <i>em. (f)</i> (asamblast)	Assemblée <i>n. (f)</i>
Atashoj <i>f.</i> (atashe)	Attacher <i>v.</i>
Atelie <i>em. (f)</i>	Atelier <i>n. (m)</i>
Autodidakt <i>em. (m), mb.</i>	Autodidacte <i>n., adj.</i>
Azhur <i>em. (m)</i>	Ajour <i>n. (m)</i>
Azhurnoj <i>f.</i> (azhurnim)	Ajourner <i>v.</i>
Bagazh <i>em. (m)</i>	Bagage <i>n. (m)</i>
Baladë <i>em. (f)</i>	Ballade <i>n. (f)</i>
Balancë <i>em. (f)</i> (balancoj, zhbalancoj, balancim, zhbalancim)	Balance <i>n. (f)</i>
Barazh <i>em. (m)</i>	Barrage <i>n. (m)</i>
Barrikadë <i>em. (f)</i>	Barricade <i>n. (f)</i>
Basen <i>em. (m)</i>	Basin <i>n. (m)</i>
Beshamel <i>em. (m)</i>	Béchamel <i>n. (m)</i>
Beton <i>em. (m)</i> (betonaj, betonim, betonues, i betontë; betonarme, betonierë)	Béton <i>n. (m)</i>
Bezhë <i>mb.</i>	Beige <i>adj.</i>
Biberon <i>em. (m)</i>	Biberon <i>n. (m)</i>
Bide <i>em. (f)</i>	Bidet <i>n. (m)</i>
Bilë <i>em. (f)</i> (bilardo)	Bille <i>n. (f)</i>
Bizhuteri <i>em. (f)</i>	Bijouterie <i>n. (f)</i>
Bizon <i>em. (m)</i>	Bison <i>n. (m)</i>
Blindë <i>em. (f)</i> (blindo, blindim, blindazh)	Blinde <i>n. (f)</i>
Bluzë <i>em. (f)</i>	Blouse <i>n. (f)</i>
Bohem <i>em. (m)</i>	Bohème <i>n. (m)</i>
Boksit <i>em. (m)</i>	Bauxite <i>n. (f)</i>
Bonbone <i>em. (f)</i> (bonboneri, bonbonierë)	Bonbon <i>n. (m)</i>
Bordero <i>em. (f)</i>	Bordereau <i>n. (m)</i>
Broshurë <i>em. (f)</i>	Brochure <i>n. (f)</i>
Bufe <i>em. (f)</i> (bufetier)	Buffet <i>n. (m)</i>
Bulevard <i>em. (m)</i>	Boulevard <i>n. (m)</i>
Buqetë <i>em. (f)</i>	Bouquet <i>n. (m)</i>

Burokrat <i>em. (m)</i> (burokratik, burokraci, borokratizëm, burokratizoj)	Bureaucrate <i>n. (m)</i>
Bursë <i>em. (f)</i> (bursist)	Bourse <i>n. (f)</i>
Butik <i>em. (m)</i>	Boutique <i>n. (f)</i>
Byro <i>em. (f)</i>	Bureau <i>n. (m)</i>
Ceremoni <i>em. (f)</i> (ceremonial)	Cérémonie <i>n. (f)</i>
Cezarian <i>mb.</i>	Césarienne <i>adj.</i>
Daktilografoj <i>f.</i> (daktilografi, daktilografim, daktilografist)	Dactylographier <i>v.</i>
Dantellë <i>em. (f)</i>	Dentelle <i>n. (f)</i>
Debat <i>em. (m)</i> (debattoj, debatim, debatues)	Débat <i>n. (m)</i>
Debil <i>mb., em. (m)</i>	Débil <i>adj., n. (m)</i>
Debutoj <i>f.</i> (debutim, debutues)	Débuter <i>v.</i>
Deduksion <i>em. (m)</i>	Déduction <i>n. (f)</i>
Deficit <i>em. (m)</i>	Déficit <i>n. (m)</i>
Dekadë <i>em. (f)</i>	Décade <i>n. (f)</i>
Deklaroj <i>f.</i>	Déclarer <i>v.</i>
Dekolte <i>em. (f)</i>	Décolleté <i>n. (m)</i>
Dekompozuj <i>f.</i>	Décomposer <i>v.</i>
Dekor <i>em. (m)</i>	Décor <i>n. (m)</i>
Dekovil <i>em. (m)</i>	Decauville <i>n. (m)</i>
Demokrat <i>em. (m)</i>	Démocrate <i>n.</i>
Departament <i>em. (m)</i>	Département <i>n. (m)</i>
Depo <i>em. (f)</i>	Dépôt <i>n. (m)</i>
Desant <i>em. (m)</i>	Descente <i>n. (f)</i>
Detaj <i>em. (m)</i>	Détail <i>n. (m)</i>
Detachment <i>em. (m)</i>	Détachement <i>n. (m)</i>
Devizë <i>em. (f)</i>	Devise <i>n. (f)</i>
Dezertoj <i>f.</i>	Désertier <i>v.</i>
Dezhurn <i>em. (m)</i>	De jour
Diafragmë <i>em. (f)</i>	Diaphragme <i>n. (m)</i>
Difteri <i>em. (f)</i>	Diphthérie <i>n. (f)</i>
Diftong <i>em. (m)</i>	Diphthongue <i>n. (f)</i>
Disiplinë <i>em. (f)</i>	Discipline <i>n. (f)</i>
Dizenteri <i>em. (f)</i>	Dysenterie <i>n. (f)</i>
Domen <i>em. (m)</i>	Domaine <i>n. (m)</i>

Doşje <i>em. (f)</i>	Dossier <i>n. (m)</i>
Drenazh <i>em. (m)</i>	Drainage <i>n. (m)</i>
Duajen <i>em. (m)</i>	Doyen, enne <i>n. (m, f)</i>
Dubloj <i>f.</i>	Doubler <i>v.</i>
Eklektik <i>mb.</i>	Éclectique <i>adj.</i>
Eklips <i>em. (m)</i>	Éclipse <i>n. (f)</i>
Ekran <i>em. (m)</i> (ekranizoj, ekranizim)	Écran <i>n. (m)</i>
Eksitoj <i>f.</i> (eksitim, eksitues)	Exciter <i>v.</i>
Ekskursion <i>em. (m)</i> (ekskursionist fr.)	Excursion <i>n. (f)</i>
Ekspres <i>mb.</i> (ekspresiv fr., ekspresivite fr., ekspresionizëm fr., ekspresionist fr.)	Express <i>adj.</i>
Ekstradoj <i>f.</i> (ekstradim)	Extrader <i>v.</i>
Ekstrem <i>mb., em. (m)</i> (ekstremist fr., ekstremizëm fr., ekstremizoj, ekstremizim)	Extrême <i>adj.</i>
Ekupazh <i>em. (m)</i>	Équipage <i>n. (m)</i>
Elozhe <i>em. (m)</i>	Éloge <i>n. (m)</i>
Emal <i>em. (m)</i> (emaloj, emalim)	Émail <i>n. (m)</i>
Emfazë <i>em. (f)</i> (emfatik fr.)	Emphase <i>n. (f)</i>
Epruvetë <i>em. (f)</i>	Éprouvette <i>n. (f)</i>
Ese <i>em. (f)</i> (eseist fr., eseistikë)	Essai <i>n. (m)</i>
Eskortë <i>em. (f)</i>	Escorte <i>n. (f)</i>
Estradë <i>em. (f)</i>	Estrade <i>n. (f)</i>
Etalon <i>em. (m)</i>	Étalon <i>n. (m)</i>
Etapë <i>em. (f)</i>	Étape <i>n. (f)</i>
Etazher <i>em. (m)</i>	Étagère <i>n. (f)</i>
Etiketë <i>em. (f)</i> (etiketoj, etiketim)	Étiquette <i>n. (f)</i>

Siç dallohet, fjalët nga frëngjishtja, përgjithësisht, bëjnë pjesë në leksikon profesional e terminologjik dhe mjaft prej tyre kanë karakter ndërkombëtar. Janë fjalë që përdoren në administratë, në drejtësi, në shkollë, në jetën shoqërore e politike, në teknikë, në mjekësi, në arte, në

modë, në sport etj. Ata kanë hyrë në shqipe kryesisht nëpërmjet gjuhës së shkruar ose edhe asaj të folur përmes shtresës së arsimuar të popullsisë, duke ruajtur në përgjithësi tiparet e shqiptimit ose të fjalëformimit të gjuhës dhënëse.

3. Tipare të huazimeve frënge në gjuhën shqipe

Më sipër paraqitëm të listuar leksikun që do t'i referohemi në këtë analizë (me shkronjat: A - E), të cilin, shqipja e ka huazuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga frëngjishtja. Për të vënë në dukje disa tipare të këtyre huazimeve në gjuhën shqipe, po i sjellim ata përmes një grupimi, duke iu referuar dy kritereve: *burimit* dhe *strukturës*.

Dhe pas një vëzhgimi e kërkimi të vëmendshëm të leksikut frëng në “Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe”, nga pikëpamja e *burimit* dallohen dy grupe fjalësh:

1 - Huazime frënge të drejtpërdrejta, ku gjuha dhënëse është edhe gjuhë burimore;

2 - Huazime frënge të drejtpërdrejta, ku gjuha dhënëse nuk është gjuhë burimore; pra, në këtë rast, frëngjishtja është gjuhë ndërmjetëse.

Si huazime frënge të drejtpërdrejta, ku gjuha dhënëse është edhe gjuhë burimore, veçojmë: *abazhur, adresë, afishe, agreement, aliazh, ambalazh, angazhoj, anketë, antrakt, artisan, atelie, azhur, azhurnoj, baladë, barazh, barrikadë, beshamel, bezhë, bide, bilë, bizon, bizhuteri, bluzë, bohem, bonbone, bordero, broshurë, bufe, buqetë, burokrat, butik, byro, ceremoni, dantellë, debat, debutoj, ekran, ekuipazh, epruvetë, ese, eskortë, etazher* etj.

Sa i përket, huazimeve frënge të drejtpërdrejta, ku gjuha dhënëse nuk është gjuhë burimore, shkëpusim: *albatros* (fr., me burim prej port.), *alo* (fr., prej ang.), *amidon* (fr., prej gr.), *anekdotë* (fr., prej gr.), *autodidakt* (fr., prej gr.), *blindë* (fr., prej gjerm.), *boulevard* (fr., prej hol.), *daktilografoj* (fr., prej gr.), *eklektik* (fr., prej gr.), *eklips* (fr., prej gr.), *elozhe* (fr., prej gr.), *emal* (fr., prej gjerm.), *emfazë* (fr., prej gr.), *estradë* (fr., prej sp.), *etalon* (fr., prej gjermanik.), *etapë* (fr., prej hol.), *etiketë* (fr., prej hol.) etj. Këto huazime (me burim nga port., ang., gr., gjerm., hol., sp.) janë *huazime të tërthorta*. Në këto raste, frëngjishtja shërben si ndërmjetëse; pra, gjuha shqipe i ka huazuar ato drejtpërdrejt nga frëngjishtja, por ajo vetë (frëngjishtja) i ka huazuar nga gjuhë të tjera, si: portugalishtja, anglishtja, greqishtja, gjermanishtja, holandishtja, spanjishtja etj. Siç bie në sy edhe nga rastet e këtij grupimi, frëngjishtja ka huazuar më tepër fjalë nga greqishtja.

Fjalët e grupimit të parë, ku frëngjicizmat në gjuhën shqipe nuk njohin një gjuhë tjetër burimore (*gjuhë dhënëse (fr.) = gjuhë burimore (fr.)*) janë më të shumta se ato të cilat rezultojnë vetë si huazime nga gjuhë të tjera (*gjuhë dhënëse (fr.) # gjuhë burimore*).

Nga pikëpamja e strukturës, dallojmë këto lloje huazimesh:

- 1 - Huazime leksikore;
- 2 - Huazime ndërtimore ose kalke;
- 3 - Huazime të rreme ose kuazihuazime.

Huazimet leksikore, në rastet kur huazohet fjala e tërë, me formën dhe me kuptimin që ka në gjuhën dhënëse, përbëjnë pjesën më të madhe të fjalëve me burim frëng në gjuhën shqipe, si: *abazhur, adresë, aksident, ambasadë, beton, biberon, bizhuteri, bluzë, bordero, buqetë, bursë, butik, ceremoni, debat, deficit, dekadë, dekolte, deduksion, demokrat, dekor, departament, depo, detaj, diftong, disiplinë, dosje, drenazh, eklips, ekran, ekskursion, ekspres, ekuipazh, ese, etapë, etiketë* etj.; sikurse edhe këto formime prapashtesore: *aliazh, ambalazh, bagazh, garazh, plazh* etj., me prapashtesën - *azh* (fr. - *age*), që vjen mjaft karakterizuese për gjuhën frënge.

Gjatë punës analizuese, ndeshëm edhe huazime të një tipi tjetër, huazimet ndërtimore ose kalke, ku nuk huazohet fjala si kompleks tingullor, por vetëm ndërtimi morfemor i saj dhe kuptimi i morfemave të huaja, kurse materiali (parashtesa, rrënja, prapashtesa) është marrë nga vetë brumi i shqipes. Pra, është imituar modeli, që është mbushur pastaj me materialin e gjuhës marrëse, si: *shtypje* sipas fr. *press + ion*; *nëndetëse* sipas fr. *sousmarin* etj.

Të ngjashme me kalket, dallohen edhe të ashtuquajturat huazime të rreme ose kuazihuazime, ku vetëm njëri nga elementet përbërëse përkthehet, kurse tjetri mbetet siç është, si p.sh. në fjalën: *kulturor*, në vend të prapashtesës frënge *-al (cultural)* është përdorur përgjegjësja shqipe *-or*.

4. Zhvillimi i huazimeve frënge në truallin e shqipes

Gjuha, si një organizëm i gjallë, është në zhvillim të pandërprerë. Në këtë pikëpamje, edhe fjalët e marra nga frëngjishtja, të cilat janë bërë pjesë e leksikut të shqipes, kanë zhvillimin e tyre. Këto fjalë i janë nënshtruar sistemit fonetik e gramatikor të gjuhës sonë, d.m.th., shkruhen e shqiptohen sipas vlerës fonike të alfabetit tonë, eptohen sipas klasave gramatikore dhe sipas rregullave përkatëse.

Gjuha shqipe i ka marrë dhe i ka përpunuar huazimet frënge si fjalët e veta. Kështu, ata vijonë të zhvillohen në truallin e gjuhës sonë, duke u

bërë edhe tema prodhuese, si p.sh.: nga *bursë* – bursist, nga *ekstradoj* – ekstradim etj. Fjalët e prejardhura në këtë mënyrë, janë formime të shqipes e nuk mund të quhen më huazime. Këto formime me ndajshtesa (kryesisht me prapashtesa), me emërtimin *rrjedhoja* në Fjalorin etimologjik ..., sigurisht, nuk janë shënuar si zëra më vete aty, por i janë bashkangjitur fjalës-bazë frënge, prej së cilës janë krijuar: Sipas zhvillimit që ato kanë pasur në gjuhën shqipe, me disa prej tyre janë krijuar çerdhe fjalësh me prapashtesa të ndryshme të shqipes: *-o, -im, -ist, -ues* etj, si: nga *daktilografoj* - daktilografi, daktilografim, daktilografist; nga *debat* - debatohet, debatim, debatues; nga *debutoj* - debutim, debutues; nga *ekran* - ekranizoj, ekranizim; nga *eksituj* - eksitim, eksitues; nga *emal* - emaloj, emalim; nga *etiketë* - etiketohet, etiketim etj. Por, nuk janë të pakta rastet, kur çerdhet e huazimeve frënge në Falorin etimologjik përbëhen jo vetëm nga formimet me prapashtesa shqipe, por edhe nga vetë fjalë të prejardhura frënge, si derivat i fjalës bazë po frënge, si në këto raste: nga *ekstrem* - ekstremist (fr.), ekstremizëm (fr.), ekstremizoj (formuar brenda shq.), ekstremizim (formuar brenda shq.); nga *ekspres* - ekspresiv (fr.), ekspresivitet (fr.), ekspresionizëm (fr.), ekspresionist (fr.); nga *ese* - eseist (fr.), eseistikë (formuar brenda shq.) etj.

Si grupim më vete kemi veçuar edhe fjalët frënge që në gjuhën shqipe nuk janë zhvilluar më tej, pasi nuk kanë shumë hapësirë për t'u zgjeruar nga ana kuptimore apo, në disa raste, ato kanë ardhur së bashku edhe me tiparet e përdorimit të saj nga vendi dhënës. Ndër to përmendim: *aliazh, abordazh, agreement, atelie, azhur, basen, bezhë, bulevard, butik, byro, dezurn, domen, dosje, estradë, eskortë, etalon, etazher* etj.; apo, edhe fjalët në vijim me burim nga emra të përveçëm, si: *amper* (prej emrit të fizikanit e matematicienit André-Marie Ampère, themeluesi kryesor i shkencës elektromagnetike), *beshamel* (prej emrit Louis de Béchamel, kryeshërbyesi i mbretit të Francës, Luigjit XIV), *boksit* (prej emrit të vendit Les Baux (Francë), ku u gjet së pari një shtresë me këtë mineral), *dekovil* (prej emrit të konstruktorit francez Paul Decauville) etj.

5. Vendi i huazimeve frënge në leksikon e shqipes dhe qëndrimi ndaj tyre

Pas një pune hulumtuese rreth huazimeve të një gjuhe, sigurisht lind natyrshëm edhe pyetja: *Çfarë vendi zënë ato huazime në leksikon e gjuhës marrëse sot?* Si për çdo gjuhë tjetër, edhe në rastin e frëngjishtes, është vështirë të vlerësohet me saktësi se sa fjalë ka huazuar gjuha shqipe nga frëngjishtja, por, falë veprës “Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe” të

akademikut Kolec Topalli, tashmë, mund të përcaktojmë më saktë. Kështu, pas një përllogaritjeje mbi lemat me burim të drejtpërdrejtë nga gjuha frënge (pa llogaritur huazimet frënge përfshirë të *Rrjedhjet*), rezulton se: gjuha shqipe njihet rreth 4 % huazime të mirëfillta frënge në leksikon e saj, në të cilat dominon kategoria leksiko-gramatikore e *emrit*, për t'u ndjekur me një numër shumë më të vogël *foljesh* e *mbiemrash*, e në raste më të rralla, edhe me ndonjë *ndajfolje* a *pasthirmë*.

Po ç'qëndrim duhet mbajtur kundrejt huazimeve në fjalë? A duhen pranuar ato si pasurim i gjuhës sonë apo duhen larguar nga përdorimi kur ekziston gjegjësjë në shqip?

Sipas disa studiuesve, fjalët e huaja e pasurojnë gjuhën; sipas të tjerëve, ato e prishin gjuhën dhe prandaj duhen nxjerrë nga përdorimi (sigurisht kur kanë gjegjësen në shqip). Dhe në të vërtetë, pjesa më e madhe e huazimeve frënge janë bërë pronë e leksikut të shqipes dhe zëvendësimi i tyre me fjalë të tjera nuk mund të bëhet më. Të tilla janë fjalët që kanë hyrë herët dhe që janë përvetësuar plotësisht nga shqipja, si dhe ato që kanë hyrë bashkë me një realie a koncept të caktuar që nuk ekzistonte në Shqipëri. Këto fjalë nuk i dallojmë më nga fjalët e tjera të shqipes, pasi e kanë përcaktuar tashmë vendin e tyre në leksikon e gjuhës sonë e nuk i përgjigjet një fjalë ekuivalente në shqip. Këto raste rezultojnë të jenë shumica e leksikut frëng në shqip (referuar *Fjalorit të gjuhës shqipe* (2006)), të tilla si: *abazhur, adresë, afishe, aksident, alo, ambasadë, amper, anekdotë, ankand, ansambël, autodidakt, azhur, bagazh, baladë, beton, bezhë, biberon, bide, bizhuteri, bluzë, bordero, burokrat, bursë, ceremoni, debat, deklaratë, dekolte, demokrat, departament, diafragmë, difteri, diftong, dizenteri, dosje, ekip, eklips, ekran, ekskursion, ekuipazh, epruvetë, ese, eskortë, estradë, etiketë* etj.

Këto huazime kanë vlerën e vet pasuruese për shqipen, por, në rastet e tjera kur për ato kemi fjalë gjegjëse, plotësisht me të njëjtin kuptim, më të njohura, më të përpikta e të qarta për folësit e shqipes, duhen bërë përpjekje që të përdoret në vend të tyre fjala shqipe që ekziston. Po përmendim disa raste të tilla, ku fjala frënge mund të zëvendësohet me fjalë shqipe, pa qenë nevoja të jenë pjesë e *Fjalorit të gjuhës shqipe* huazimi frëng, si: *adaptoj* (me *përshitas*), *aksion* (me *veprim*), *azhurnoj* (me *përditësoj*), *balancë* (me *peshore*), *basen* (me *pellg*), *bohem* (me *endacak*), *buqetë* (me *tufë lulësh*), *butik* (me *dyqan*), *deduksion* (me *përfundim*), *deklaroj* (me *shpall, pohoj*), *dekompoztoj* (me *shpërbëj*), *dezertoj* (me *braktis*), *detaj* (me *hollësi*), *domen* (me *pronë*), *eksitoj* (me *ngacmoj*), *ekstrem* (me *i skajshëm*), *elozhe* (me *lëvddata*), *etazher* (me *raft librash*), *etalon* (me *gjedhe, model*) etj.

Një ndihmesë të rëndësishme për zëvendësimin e leksikut të huaj me fjalë të shqipes ka dhënë Aleksandër Xhuvani me librin: “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”, që më 1956, i cili vë në pah rëndësinë e pastrimit të gjuhës nga fjalët e huaja, prej shek. XVI, me Budin e këndej, duke u shprehur: *“Nji nga çashtjet që rrihen e bisedohen shumë herë në gjuhësi është edhe ajo e pastrimit të gjuhës nga fjalë e nga konstrakte të hueja. Letrarët e shkrimtarët e çdo gjuhe të botës janë interesue dhe përpjekë që gjuha e tyre të shkruhet e të flitet, sa është e mundun, e pastër dhe e qërueme nga elemente të hueja. Ky interesim për ta pasture gjuhën nga fjalë e konstrakte jo shqipe ka ndodhë edhe në gjuhën tonë. ... Kjo i ka të vjetra rranjat: për këtë pastrim të gjuhës janë kujdesë shkrimtarët tonë të hershëm qysh prej Budit e tëhu.... Këtë punë e shofim edhe te shkrimtarët e Rilindjes sonë. Të gjithë këta kanë qenë të bindun se gjuha shqipe duhet përdorë e shkruet sa më e pastër, tue u nxjerrë jashtë gjithë fjalët e hueja...”*⁶. Edhe studiuesi Gjovalin Shkurtaj në librin e tij “Urgjenca gjuhësore”, më 2015, ndjek dhe ka po atë tematikë e synim të etërve të pastrimit e pasurimit të shqipes, ku mes të tjerash shkruan: *“Hullinë e mbarë gjuhëmbrojtëse, gjuhëruajtëse e gjuhëpastruese të Xhuvanit, Çabejt, Ajetit, Domit, Kostallarit etj. pa u lodhur, e kanë peng nderi e brengë jete edhe një yjësi gjithmonë e më e madhe gjuhëtarësh e letrarësh të ditëve tona.”*⁷

Në mbyllje, theksojmë se hyrja e fjalëve të tjera frënge (dhe jo vetëm) në leksikun e shqipes (përderisa ndikimi francez në Shqipëri vazhdon të jetë real), konsiderohet e përligjur për të gjitha ato raste kur mungon fjala a shprehja për ndonjë nocion, kuptim a koncept të ri; ndërsa, për raste të tjera, kur ekziston fjala gjegjëse shqipe për të njëjtën realie, mund të konsiderohet pa nevojë pranimi e përdorimi i tyre.

⁶ Aleksander Xhuvani, “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”, Tiranë, 1956, f. 3.

⁷ Gjovalin Shkurtaj, “Urgjenca gjuhësore”, Tiranë, 2015, f. 7.

BIBLIOGRAFI:

- **Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë**, “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006.
- **Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë**, “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”, Tiranë, 1998.
- **Aleksander Xhuvani**, “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”, Tiranë, 1956.
- **Bade Bajrami**, *Prurjet frënge në terminologjinë administrativo-juridike shqipe*, në: “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2010.
- **Eqrem Çabej**, “Studime etimologjike në fushë të shqipes” I, Tiranë, 1982.
- **Gjovalin Shkurtaç**, “Urgjenca gjuhësore”, Tiranë, 2015.
- **Jani Thomaj**, “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006.
- **Kolec Topalli**, “Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2017.
- **Mahir Hoti**, *Fjala e hapjes e rektorit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*, në: “Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare” (Studime shqiptare 13), Shkodër, 2005.
- **Orjeta Baja**, *Features of french borrowings in the Albanian lexicon*, në: “Social and natural sciences – global challenge 2018”, Vienna (Austria), november 2018.
- **Orjeta Baja**, *Mario Rok (Mario Roques) për gjuhën shqipe*, në: “Shqipëria dhe Franca: Vështrime dhe shkrime të kryqëzuara [Albanie e France: Regards et écritures croisées]”, Tiranë, 2013.
- **Orjeta Baja**, *Kristian Gyt (Christian Gut) për gjuhën shqipe*, në: O. Baja “Shqipja përmes shkrimtarit”, Shkodër, 2014.
- **Vedat Kokona**, “Fjalor shqip – frëngjisht”, Tiranë, 1998.

**French words in Albanian Language
according to "Etymological Dictionary of Albanian Language" by
Academician Kolec Topalli**

ABSTRACT

This article is focused on French loanwords, this stratum which has had no small impact on the Albanian language.

French loanwords in the Albanian language, just like other loanwords, have impacted all linguistic planes: phonetics, lexicon, morphology and syntax, but the focus of this paper is primarily the lexicon. French influence has penetrated so much on the lexical level and is used so frequently that quite often, it's become difficult to learn which word is an Albanian word and which is foreign (French). In order to complete this research, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe* (Tiranë, 2017) of the academician Kolec Topalli is being used as a reference.

There are words that are used in administration, justice, in the academic setting, in the social and political settings, the technical setting, in medicine, in the arts, in fashion, in sports etc. Some examples of French borrowings in the Albanian lexicon are: *abazhur, adaptoj, adresë, afishe, aksident, aksion, aliazh, alo, ambalazh, ambasadë, amper, anekdotë, angazhoj, ankand, anketë, ansambël, artizan, asamble, atashoj, autodidakt, azhur, azhurnoj, baladë, balancë, barrikadë, basen, beshamel, beton, bezhë, bizhuteri, bluzë, bordero, broshurë, boulevard, buqetë, burokrat, bursë, butik, bagazh, garazh, plazh* etc., etc.

The selected lexicon for this subject contains loanwords, which Albanian has borrowed in a direct way from French. In order to point out some characteristics of French loanwords in the Albanian language, they are being categorized by referring to two criteria: the source and the structure.

After a mindful research and observation of this lexicon, one can identify two groups of words as far as the *source* of these words: 1 - Direct French loanwords where the source language is the lending language; 2 - Direct French loanwords where the source language is not also the lending language; in this case, French is the (intermediary) loaning language.

Language, as a living organism, is in uninterrupted evolution. From the point of view of *structure*, the French loanwords, which have become part of the Albanian lexicon have had their own development. These words have been subjected to the Albanian phonetic and grammatical system,

meaning they are written and pronounced according to the phonetic value of the Albanian language and inflect according to the grammatical classes and applicable regulations.

As with every other language, it is difficult to accurately evaluate how many words the Albanian language has borrowed from French, but referring to the *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe* (Tiranë, 2017), this can be determined more precisely. Thus, after a calculation, it is estimated that: the Albanian lexicon analyzed for this paper contains about 4 % French borrowings (referred to the selection criteria mentioned in this article).

Merita HYSA

ANALIZA E FONEMAVE NË TIPARE DALLUESE

Mes çështjeve teorike të pjesës më të madhe të gjuhësisë së shekullit XX, konceptet e artikulimit, linearitetit dhe mbi të gjitha segmentimit të zinxhirit gjuhësor në njësi, përbëjnë aksiomat bazë të asaj që mund të quhet “paradigma segmentore”, koncept ky i krijuar formalisht nga strukturalizmi evropian dhe i përsosur nga shkolla blumfildiane. Në thelb ai lidhet me idenë se gjuha është krijuar materialisht nga “pjesë” segmentesh të prodhuara dhe të përpunuara në mënyrë diskrete dhe të kombinuara mes tyre në një rend linear për të formuar shkallë-shkallë njësi më të larta që u përkasin niveleve të ndryshme të analizës.

Duke u nisur nga supozime të tilla “zinxhiri” i fjalës, edhe kur ajo identifikohet si një valë zanore, e folur, përmes së cilës realizohet akti gjuhësor, jepet nën formën e një fluksi të vazhdueshëm e të pandërprerë tingujsh që është lehtësisht i segmentueshëm në pjesët përbërëse të tij: *thënia, fraza, sintagma, fjala, fonema* (në planin e shprehjes këto të fundit, përfaqësohen nga fone dhe alofone që identifikohen në bazë të karakteristikave artikuluese e akustike që u korrespondojnë “tipareve dalluese”).

Ligjërimi duhet konsideruar si një sistem auditiv simbolesh, në kuptimin që sistemi ynë fonator, përfshihet në shkallën më të lartë, në çastin kur duhet të prodhohen vargjet tingullore. Tiparet fonologjike duhet të përkufizohen sipas termave të konceptit të imazhit akustik: kështu, përfaqësimi i tingullit gjuhësor, nuk bëhet vetëm mbi bazën e karakteristikave të tij nyjetimore dhe akustike, por edhe nga modelet që përcjellin informacionin dhe perceptohen në sinjalet e të folurit.

Tingujt që përbëjnë një varg, janë fonetikiisht të vazhdueshëm, por fonologjikiisht diskretë¹. Ndarja e fjalëve në segmente (zanore dhe bashkëtingëllore) bazohet në teorinë sipas së cilës, një përfaqësim në të cilin një tingull gjuhësor shpërbëhet në një sekuencë tiparesh diskrete, është një lloj abstragimi nga kontinuumi fizik i tij.²

Njësitë tingullore na shfaqen si njësi të segmentueshme dhe të prejardhura nga pranëvënia e disa elementeve që quhen tipare. Përfaqësimi

¹ J., Pierrehumbert, *Phonological and phonetic representation*, Journal of Phonetics, (1990) 18, f.376.

² G.N., Clements, E., Hume, *The internal organization of speech sounds*, In The Handbook of Phonological Theory, Oxford: Blackwell, 1995, f. 250.

ynë mendor për segmentet është i përbërë nga një varg tiparesh që bazohen mbi veçoritë nyjëtimore të tingujve. Tiparet dalluese të foneve shfaqen si karakteristika fizike themelore dhe të pandashme më tej.

Duke e vështruar në një nivel më të gjerë analizën e tinguj-fonemave, do t'i referoheshim pa dyshim, konceptit të teorisë fonologjike. Një teori fonologjike, në thelb, ka tri përbërës themelore:

-*së pari*, një inventar njësisish fonologjike;

-*së dyti*, një varg rregullash, të cilat shërbejnë për të përshkruar marrëdhëniet mes entiteteve fonologjike;

-dhe *së treti*, një model për të përshkruar formën se si rregullat ndërveprojnë, në mënyrë që bashkimet e fonemave, të jenë modele të afta për të gjeneruar fjalë dhe fraza të ndryshme në një gjuhë.³

Në këtë mënyrë, ritheksojmë funksionin ndërtues të fonemave, si elemente me të cilat ndërtohen njësitë fonologjike më të mëdha, si rrokjet apo fjalët. Megjithatë, ajo që na intereson më tepër nga perceptimi dhe segmentimi i valëve tingullore, është aftësia që kanë këto njësi diskrete, të varen paradigmatisht nga njëra-tjetra. Këto zëvendësime jorastësore e vendosin theksin në aftësinë që kanë ato për t'u diferencuar pikërisht përmes tipareve që i përbëjnë.

Duhet të kemi parasysh se fonema është segmenti më i vogël në të cilin mund të ndahet shenja gjuhësore, dhe në këtë këndvështrim ajo na paraqitet si njësi e pandashme më tej. Por fonemat mund të analizohen edhe mbi bazën e karakteristikave nyjëtimore që i dallojnë, gjë që bëhet e mundur pikërisht përmes konceptit të tipareve dalluese. Ky koncept, synon të vërë në dukje ato karakteristika të fonemave që kontribuojnë për të realizuar kundërvëniet fonologjike të qëndrueshme, duke krijuar kështu shenja gjuhësore me një shenjues dhe një të shenjuar.

Në fakt, fonema në vetvete nuk është një shenjë gjuhësore, duke qenë se ajo ka vetëm shenjues, por funksioni i saj shfaqet në mënyrën e kombinimit me fonema të tjera, për të krijuar një shenjë gjuhësore (që i ka të dy planet, të shprehjes dhe të përmbajtjes).

Trubeckoi, në *Parimet e fonologjisë*, e kishte përkufizuar fonemën si “një tërësi tiparesh fonologjikisht të qëndrueshme, të një forme të caktuar fonike”⁴, d.m.th., si një tërësi tiparesh fonetike që i lejojnë një tingulli të kombinohet me tinguj të tjerë (me karakteristika të ndryshme fonetike), për të krijuar shenja brenda një sistemi gjuhësor. Por përpara Trubeckoit, ishte

³ G.N., Clements, E., Hume, *The internal organization of speech sounds*, In *The Handbook of Phonological Theory*, Oxford: Blackwell, 1995, f. 253.

⁴ N.Trubeckoi, *Parimet e fonologjisë*, Prishtinë, 1985, f. 68.

Leonard Blumfeld ai që formuloi nocionin e tiparit dallues⁵: “Këto tipare dalluese paraqiten në nyje (ose grup), secila prej të cilave quhet fonemë”. Tiparet dalluese dalin në pah nga kundërvëniet fonologjike që ekzistojnë në gjuhë, sidomos në ato që vërehen në çiftet minimale të fjalëve. P.sh.: /t/~b/, kanë të përbashkët, mënyrën e formimit, mbylltore dhe vendin e formimit, dybuzore, i dallon pjesëmarrja e zërit, pra tipari dallues *e shurdhët ~ e zëshme* që dallon këtë çift fonemash, lejon të kundërvihet çifti minimal i fjalëve /tel~/del/.

Përmes teorisë së tipareve dalluese, fonetika dhe fonologjia gjetën pika të përbashkëta midis tyre, sepse e para, më konkrete, ofron të dhëna për një përpunim më të hollësishëm teorik të së dytës.

Çdo gjuhë përzgjedh kontraste fonike për të krijuar kundërvënie dalluese, ndërsa disa diferenca të tjera fonike nuk janë shumë domethënëse (një fonemë në fakt mund të ketë variante të ndryshme kombinatorë ose të lira).

Duke përqasur formën fonike me strukturat kimike, mund të krahasojmë fonemën me molekulat: ashtu siç molekulat mund të shpërbëhen në një varg atomesh, analiza fonologjike mund të shpërbëjë fonemat në elemente që quhen tipare dalluese.

Teoria e tipareve dalluese binare, u zhvillua nga Roman Jakobson, në “*Preliminaries to Speech Analysis*”, për shkrimin e së cilës, bashkëpunoi me Gunnar Fant dhe Morris Halle. Një teori e tillë synonte të përshkruante të gjitha kundërvëniet fonologjike të qëndrueshme në gjuhët e ndryshme të botës, përmes një katalogu tiparësh disi të kufizuar, por në të njëjtën kohë universal tiparësh dalluese. Këto tipare u përkufizuan si me terma akustikë: [±kompakt], [±difuz], [±i mprehtë], [±i rëndë], ashtu edhe nyjetimorë [± i përparmë], [±i prapëm], [± i lartë], [± i ulët], [±kontinuant] etj., edhe pse përshkrimi akustik ishte disi më dominant, në dhënien e veçorive të fonemave.

Një parim i rëndësishëm i kësaj teorie, ishte parimi i binarizmit, i cili mundësonte karakterizimin si të zanoreve ashtu edhe të bashkëtingëlloreve përmes tipareve binare (me dy vlera), në kuptimin që një fonemë ose e ka, ose nuk e ka një veçori të caktuar. Supozohej se binarizmi ishte një parim themelor jo vetëm në strukturën gjuhësore, por edhe në dijen njerëzore në përgjithësi (sikurse mendohet se edhe në kodet informatike të bazuara në alternimin e vlerave 1 dhe 0, ose në disa operacione logjiko-matematikore që bazohen në alternativat e saktë~ e

⁵ L.Blumfeld, *Language*, London, 1995, f.135.

gabuar)⁶. Për një tipar të caktuar, një fonemë specifikohet me [+], kur e ka tiparin ose [-], kur tipari mungon (mundësia e tretë është se tipari nuk është qenësor për fonemën në fjalë).

Tiparet nuk përshkruhen, dallohen, ose ndahen në klasa të veçanta, vetëm për të parashtruar dhe pasuruar inventaret tingullore të studiuara nga foneticienët dhe fonologjistët. Qëllimi i përkufizimit të tyre, që në fillim ishte të përshkruanin në mënyrë të pagabueshme njësitë segmentore në nivel fonologjik, si dhe të hidhnin dritë mbi ndërrimet e ndryshme fonetike.

Përshkrimi i një segmenti duhet të përfshinte aq tipare, sa të diferencojë lehtësisht nga segmentet e tjera në gjuhë. Numri i përgjithshëm i tipareve në vetvete, mund të konsiderohet si një strukturë e nevojshme për të përshkruar dallimin për çdo fonemë të gjuhës (me fjalë të tjera, segmentet dallohen jo vetëm nga natyra e tipareve, por edhe nga numri i tyre). Kështu p.sh., për përshkrimin e zanoreve të shqipes, nevojiten vetëm pesë tipare binare, që paraqesin shterueshëm natyrën e tyre. Këto tipare janë⁷:

	u	o	y	i	e	ë	a
[±e lartë]	+	-	+	+	-	-	-
[±e ulët]	-	-	-	-	-	-	+
[±e prapme]	+	+	-	-	-	-	+
[±e përparme]	-	-	+	+	+	-	-
[±buzore]	+	+	+	-	-	-	-

Segmentet konsiderohen si kombinime tiparesh, çdo tipar funksionon si një aks bipolar, ku kundërshtia është baza e tij. Sjellim shembullin e fonemave /p/ dhe /b/, të cilat dallohen nga tipari [+/- e zëshme], dhe të dy këto fonema dallohen nga dybuzorja mbylltore /m/, nga tipari [+ hundore].

Specifikimi i plotë i segmenteve, u përdor për t'i dalluar ata nga njëri-tjetri. P.sh., në qoftë se kemi një segment me tiparet [+ vokalik] dhe [-konsonantik], atëherë vetvetishëm kuptohet që kemi të bëjmë me një zanore, pasi këtë tipar e kanë vetëm zanoret. Sikurse mund të jetë edhe tipari [+ silabik], të cilin në shqipe e kanë vetëm zanoret. Përmes këtyre dy tipareve kryesore, dallohen tingujt zanorë nga tingujt bashkëtingëllorë në shqipe.

⁶ C.P., Browman, & L., Goldstein, *Articulatory gestures as phonological units*, *Phonology*, 6, 1989, f. 218.

⁷ R. Memushaj, *Fonetikë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2014, f. 57.

Bashkëveprimi, fshirja ose ndryshimi i tipareve gjatë proceseve fonologjike (p.sh. ndërrimet e fonemave), është rezultat i ndikimit të disa rregullave fonologjike. Format e gjeneruara, prekin disa tipare të segmenteve në një kontekst të dhënë. Sipas këtyre rregullave fonologjike, transformimi i tipareve ndodh atëherë kur krijohen kushtet për një ndryshim të tillë, të cilat kushtëzohen si nga tipare me natyrë fonetike, pjesërisht edhe nga veçori fono-morfologjike (p.sh. apokopimi i tingujve fundorë në temat fjalëformuese). Të tilla ndryshime janë të detyrueshme.

Përveç tyre, ekzistojnë edhe ndryshime të tjera, të mundshme, aplikimi i rregullave për të cilat varet nga faktorë të jashtëm si stili i të folurit, shpejtësia etj.

Tiparet kanë tri funksione të ndryshme⁸:

-*Funksion kompozicional*: për të specifikuar karakteristikat që formojnë në mënyrë të njëkohshme një segment ligjërimor. Përshkruhet çdo fon, si një varg tiparësh, pra izolohet një njëkohësi tiparësh në kontinuumin e mesazhit zanor. {P.sh. për zanoren [i] tiparet e njëkohëshme [+e përparme], [+e lartë], [+e pabuzorëzuar]}.

-*Funksion klasifikues*: i cili përkufizon klasat natyrore të tingujve, d.m.th., synon të grupojë segmentet në grupe që kanë një ose më shumë tipare të përbashkëta. Mund ta përkufizojmë si klasë natyrore, një tërësi fonesh që kanë një ose më shumë karakteristika fonetike të përbashkëta. P.sh.: *mbylltoret* formojnë një klasë natyrore, sepse kanë të njëjtën mënyrë artikulimi, po ashtu shtegoret dhe dridhëset.

- *Funksioni kufizues*: përcakton kufizimet fonotaktike që vërehen në një gjuhë të caktuar. Shpesh dukuritë fonologjike të një gjuhe, nuk veprojnë në nivel të foneve të veçanta, por të një tërësie fonesh, që kanë karakteristika fonetike të përbashkëta. Pra, dukuritë fonologjike zbatohen në segmentet që ndajnë tipare të ngjashme.

Tiparet lidhen edhe me kufizimet fonotaktike të sistemeve fonologjike, të cilat përcaktojnë se cilët segmente mund të kombinohen mes tyre dhe cilët jo, d.m.th., cilat janë sekuencat e mundshme tingullore që mund të krijohen nga kombinimi i tingujve. Këtu bëhet fjalë për kufizimet mbi përndarjen e foneve/fonemave ose të një klase fonesh/fonemash; (në kuptimin që rregullojnë kombinimet e mundshme të foneve/fonemave, sikurse sintaksa rregullon kombinimet e mundshme të fjalëve). Për shembull, në shqipe, [t] nuk mund të vendoset përpara [p], {[tpa], nuk është një fjalë e mundshme në shqipe}.

⁸ R. Memushaj, *Fonetikë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2014, f. 227.

Në të vërtetë mund ta përgjithësojmë këtë lloj kufizimi në klasën natyrore të mbylltoreve. Kufizimi teorik mund të formulohet në këtë mënyrë: Në gjuhën shqipe, një bashkëtingëllore mbylltore nuk mund të ndiqet nga një bashkëtingëllore tjetër mbylltore (jo vetëm [tp] nuk është një sekuencë e mundshme, por edhe [td],[kd],[bk] etj). Kjo pamundshmëri në përdorimin e këtyre sekuencave tingullore ka të bëjë me natyrën e shqipes që nuk i lejon nyjet (sekuencat e segmenteve) e krijuara prej mbylltoreve të zhurmëta. Megjithatë vërehen disa përjashtime, sidomos në kombinimet mes hundoreve dhe mbylltoreve shpërthyes, në grupet konsonantike *mb, nd, ng, ngj* etj.

Nëse do të kundronim grupet dyshe fundore të bashkëtingëlloreve në fund të fjalëve, do të shihnim se më të shpeshta janë kombinimet sonante + mbylltore: *-jk (bujk), -jt (drejt), -lb (kalb), -lg (shelg) etj* dhe sonante + shtegore: *-jf (qeif), -jth (ajth), -ls (puls), -mf (triumf), -msh (lëmsh) etj*.

Më pak ndeshen kombinimet mbylltore – mbylltore: *-kt (akt), -pt (koncept), -tk (petk)* dhe shtegore – shtegore: *-fsh (afsh)* dhe shumë rrallë grupet mbylltore + sonante dhe shtegore +sonante. Këto të fundit janë më të rralla, ndeshen në pak fjalë, kryesisht të huazuara. Bashkë me leksemat e huazuara, kanë hyrë në shqipe edhe mundësi kombinatorë të reja, të cilat nuk vërehen vetëm në strukturat fundore të fjalëve.

Shtrohet pyetja, përse gjuhët vendosin të tilla kufizime fonotaktike?

Shpesh, të tilla kufizime motivohen nga faktorë të tipit nyjësor dhe akustio-perceptiv. Duke qenë se të folurit karakterizohet nga një vazhdimësi (continuum), në të cilën fonet transmetohen në mënyrë shumë të shpejtë, gjuha imponon kufizime fonotaktike për të minimizuar gabimet në shkëmbimin e mesazheve, duke përjashtuar disi sekuencat më të vështira nga pikëpamja artikulative dhe akustike.

Niveli i kushtëzimeve fonotaktike, ndonëse shpeshherë është ndërgjuhësor, lidhet pa dyshim me veçoritë e sistemeve fonologjike. Kështu p.sh., ka gjuhë (anglishtja, gjermanishtja etj.)⁹ të cilat lejojnë të paktën disa nyja mbylltoresh që nuk lejohen në shqipe, siç i pamë më sipër.

Megjithëse kufizimet motivohen nga veçori nyjësore dhe akustike, ato nuk mund të jenë universale, pasi gjuhët gjenerojnë sekuenca të veçanta tingullore për të ndërtuar njësi të planit të shprehjes, si rezultat edhe kombinimet e tyre janë arbitrare.

⁹ R. Memushaj, *Fonetikë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2014, f. 222.

Sipas Jakobson dhe të tjerëve, tiparet janë në pjesën më të madhe të organizuara në mënyrë binare, d.m.th., vetëm me dy vlera, një pozitive dhe një negative (edhe pse ekzistojnë edhe tipare që kanë nevojë për më shumë se një vlerë për të identifikuar një segment, siç është rasti i zanoreve të mesme, /ë/-ja psh.)

Mes shumë tipareve fonetike të qëndrueshme për përshkrimin e një segmenti, disa janë fonologjike më qenësore: ato që na lejojnë të dallojmë segmentet dhe të shprehim në mënyrë të përgjithshme sjelljen fonologjike të tyre, e thënë me qartë, tërësinë e mënyrave të kombinimit të segmenteve, kushtëzimet fonotaktike që vendosin gjuhë të ndryshme etj. Çdo segment do të jepet në këtë mënyrë me një varg tiparesh, që do të jenë të mjaftueshme për ta karakterizuar atë në mënyrë të qartë.

Një rishikim i rëndësishëm iu bë teorisë jakobsoniane të tipareve dalluese nga Noam Chomsky dhe Morris Halle në *Sound Pattern of English* (1968), vepër nga e cila u zhvillua e ashtuquajtura fonologji gjenerative. Në SPE synohej të merrej parasysh kompetenca fonologjike e folësve përmes një aparati minimal teorik.

Teoria e tipareve dalluese, kaq shumë e lëvruar, nuk synon aq të përshkruajë mekanizmat e prodhimit të fjalëve, se sa të krijojë një tërësi elementesh që lejojnë të arrihet në një analizë formale të sistemeve fonologjike, p.sh. përmes formulimit të rregullave fonologjike.

Në çastin kur kalohet nga fonetika tek fonologjia, karakteristikat nyjetimore “përkthehen” në karakteristika më abstrakte e formale, nën formën e tipareve dalluese fonologjike, të quajtura ndryshe tipare binare. Këto tipare organizohen në mënyrë binare përmes dy vlerave të mundshme, pozitive (+) dhe negative (-), sipas pranisë ose jo të një karakteristike të dhënë, në artikullimin e një tingulli. Binariteti (si tipar), nuk është i pranishëm në nivel fonetik, ai varet nga përfaqësimi ynë mendor mbi tingujt.

Vlera pozitive që lidhet me një tipar të caktuar dallues quhet markë (shenjë), ajo negative, shënon një vlerë të pamarkuar.

Edhe segmentet mund të jenë ose jo të markuar, p.sh., në procesin e neutralizimit, segmentet e pamarkuar janë më të prirur për të mbijetuar, duke marrë një status të veçantë, atë të arkifonemës, siç e quante Trubeckoi.¹⁰

Tiparet binare paraqiten përmes disa klasave kryesore¹¹:

¹⁰ N.Trubeckoi, *Parimet e fonologjisë*, Prishtinë, 1985, f. 128.

¹¹ R.Memushaj, *Fonetikë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2014, f. 114.

a- Tiparet kryesore

Këto tipare përkufzojnë klasat më të rëndësishme të tingujve, për të përshkruar dukuritë fonologjike të gjuhëve. Ato diferencojnë tiparet përmes të cilave dallohen grupet e medha të segmenteve, dhe janë:

1. [±sonorant]: tingujt [+sonorantë], prodhohen me një hapje të aparatit zonor, e mjaftueshme, që presioni i ajrit në kavitetin e gojës, të jetë i ngjashëm me atë të jashtëm. Të tillë tinguj janë zanoret dhe sonantet (m,n,nj,j,l,ll,r,rr). Tingujt [-sonorant], karakterizohen nga një presion i brendshëm shumë më i lartë se ai i jashtëm. Të tilla janë bashkëtingëlloret mbylltore shpërthyes (p,b,t,d,q,gj,k,g) dhe afrikate (c,x,ç,xh) dhe shtegoret e zhurmëta (f,v,th,dh, s,z,sh,zh,h).

2. [±silabik]: janë silabikë ata tinguj që përbëjnë bërthamën e një rrokjeje. Në shqipen standarde, këtë veti e kanë vetëm zanoret. Ndërsa tingujt e tjerë janë [-silabikë], pra bashkëtingëlloret, sonante dhe të zhurmëta.

3. [±konsonantik]: tingujt [+konsonantikë] prodhohen nga pengimi i rrymës së ajrit në pika të ndryshme të kanalit të zërit, {bashkëtingëlloret, prodhohen nga ngushtimi i pjesës qendrore të aparatit të folurit}, ndërsa tingujt [-konsonantikë] prodhohen pa një ngushtim të tillë {zanoret}.

b-Tiparet e vendit të formimit

Kanë të bëjnë me pikat e kanalit të zërit ku ndodh artikulimi dhe specifikimi i tipareve të tingujve. Ky tipar të zanoret lidhet me lëvizjen horizontale të gjuhës. Tiparet janë:

1. [±i përparme], janë tingujt që realizohen në pjesën e përparme të rezonatorit të gojës, të tilla janë zanoret e përparme, bashkëtingëlloret buzore, dhembore dhe alveolare., fonemat e tjera janë [- të përparme].
2. [±i prapme] Tingujt e formuar në zonën nga qiellza e butë deri të glota janë [+ të prapme], kurse gjithë të tjerët janë [-prapme].¹²
3. [±koronal] Çdo tingull i nyjëtuar me majën e gjuhës të ngritur mbi pozicionin neutral është [+koronal]. Të tilla janë dhemboret, alveolaret dhe alveoqiellzoret. Tingujt e tjerë janë [- koronalë].¹³

c- Tiparet e shkallës së hapjes

Lidhen me lëvizjen vertikale të gjuhës, si dhe ndarjes që i bën ajo rezonatorit të gojës.

1. [±i lartë] Tingujt e artikuluar me trupin e gjuhës mbi pozicionin neutral janë [+ të lartë]. Të tilla janë zanoret e mbyllura, dhe bashkëtingëlloret qiellzore dhe velare.
2. [±i ulët] Për artikulimin e tingujve [+ të ulët], trupi i gjuhës pozicionohet mbi velum dhe nuk kryen asnjë lëvizje. Të tillë tipar e ka vetëm zonorja /a/ në shqipe, tingujt e tjerë janë [- të ulët].

d- Mënyra e artikulimit

Këto tipare i referohen modifikimit që pëson rryma e ajrit nëpër kanalim e zërit.

1. [± kontinuant] Këta tinguj prodhohen nga ngushtimi i kavitetit oral, që i lejon rrymës së ajrit të dalë pa ndonjë vështirësi. Të tilla janë zanoret dhe shtegoret. Tingujt e tjerë janë [-kontinuantë].
1. [±i qartë], është një tipar që lidhet me natyrën akustike dhe ka të bëjë me kalimin e rrymës së ajrit mes dy sipërfaqeve të afuara, duke krijuar një fluks ajri

¹² R.Memushaj, *Fonetikë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2014, f. 114.

¹³ Po aty.

që perceptohet si zhurmë. Tinguj [+ të qartë] janë shtegoret më përjashtim të /th/, /dh/, si dhe afrikatat dhe bashkëtingëlloret e tingullta.

2. [± i zëshëm] Tingujt e zëshëm janë [+ të zëshëm], ndërsa të shurdhëtit janë [- të zëshëm].
3. [± hundor] Ky tipar ka të bëjë me pozicionin e uvulës. Janë [+ hundorë], tingujt e artikuluar me uvulën e ulur poshtë dhe [- hundorë], tingujt e tjerë.
4. [± lateral]: në prodhimin e tingujve [+ lateralë], pengohet kalimi qendror i fluksi i ajrit nëpër rezonatorin e gojës dhe rryma e ajrit kalon nëpër anët e gjuhës. Të tilla janë bashkëtingëlloret /l/, /ll/. Tingujt e tjerë janë [- lateralë].

Seria e tipareve binare krijon një kuadër të hollësishëm lidhur me elementet minimale nga të cilat përbëhen fonemat. Ne mund ta përkufizojmë një fonemë, përmes një vargu tiparesh, por në analizën fonologjike, ekzistojnë edhe mënyra të tjera të dhënies së tipareve dalluese. Për shembull, është e mundur që për të paraqitur një inventar fonematik të një gjuhe, përmes një matrice tiparesh ose një diagrame që sjell në mënyrë horizontale, fonemat e gjuhës dhe vertikalisht, tiparet e nevojshme dalluese për t'i diferencuar këto fonema, siç e kemi të paraqitur më poshtë për disa nga fonemat e shqipes. Tiparet binare të fonemave të shqipes standarde, duke pasur parasysh cilësimin sipas klasave të mësipërme, i ka parashtruar studiuesi R. Memushaj.¹⁴

	i	y	u	o	e	ë	a	r	rr	l	ll	k	g	h
Silabik	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-
Konsonantik	-	-	-	-	-	-	-	+	+	+	+	+	+	-
Sonorant	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-
I lartë	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	+	+	+	-
I ulët	-	-	-	-	-	-	+	-	-	-	-	-	-	+
I prapmë	-	-	+	+	-	-	+	-	-	-	-	+	+	+
I përparmë	+	+	-	-	+	-	-	+	+	+	+	-	-	-
Buzor	-	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Koronal	-	-	-	-	-	-	-	+	+	+	+	-	-	-
Hundor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Anësor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	+	+	-	-	-
I zëshëm	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	-	+	-
I vazhduar	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	+
I qartë	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-
Shtypje e lartë nënglotore (SHLN)	-	-	-	-	-	-	-	-	+	-	-	-	-	-

¹⁴ R. Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Tiranë, 2014, f.115.

Në këtë kuadër teorik çdo segment përshkruhet si një tërësi linearisht e parregullt tiparesh, të cilat shfaqin karakteristika që janë njëkohësisht të pranishme në artikulimin e vetë segmentit. Pra, ndërkohë që segmentet fonologjike qëndrojnë pranë njëri - tjetrit në rend linear të përcaktuar, duke formuar fjalën, tiparet, që shprehin karakteristika fonetike, nuk është e thënë të ndjekin një rend linear, por më tepër duhet të japin në mënyrë të drejtpërdrejtë veçoritë fonetike të një segmenti, duke e kundërvënë natyrshëm me një tjetër. P.sh.: nuk është e nevojshme të specifikojmë përmes tipareve fonemën /i/, për ta kundërvënë me fonemën /y/ ose /e/. Tiparet [+i lartë], [+i përparmë] dhe [+i pabuzorëzuar], nënkuptohen, në çastin kur kjo fonemë është zgjedhur për t'u përdorur në një rrethim të caktuar, duke e veçuar atë pikërisht përmes këtyre tipareve dalluese nga fonemat e tjera, që mund të jenë të ngjashme në ndonjë tipar me të, si në rastin {dy~ di} etj.

Dallimi mes nocionit të fonit dhe fonemës (si rrjedhim të fonetikës dhe fonologjisë), parakupton se në brendësi të strukturës fonologjike, ekzistojnë dy nivele të përfaqësimit: një fonemik (që mund t'i korrespondojë atij që në sintaksë quhet struktura e thellë), dhe një fonetik (që lidhet me strukturën sipërfaqësore, nivelin e realizimit tingullor).

Ndodh që një fonemë, të cilën e kemi në përfaqësimin tonë mendor, mund të modifikohet fonetiki kur realizohet bashkë me fonema të tjera për të formuar një fjalë dhe më pas një frazë. Pra, një fonemë e caktuar në gjuhë, mund të përftojë karakteristika fonetike të ndryshme, gjë që pohon për çka thamë më sipër: mes nivelit fonologjik dhe atij fonetik ndërhyjnë të ashtuquajturat procese fonologjike. Për shembull, një fonemë mund të asimilohet në një ose më shumë tipare, në varësi të rrethimit fonetik, siç është rasti i hundores alveolare /n/, e cila ndryshon vendin e formimit në varësi të fonemave që ka pranë, përkatësisht në palatale para fonemave /q, gj/: {qengj} dhe velare para fonemave /k, g/: {enkas, brenga}.

Proceset fonologjike nuk janë të rastësishme, por sistematike dhe një prej detyrave të fonologjisë është të kuptojë dhe të përshkruajë mekanizmin e funksionimit të tyre, përmes një trajtimi teorik të drejtpërdrejtë. Në këtë mënyrë nënkuptohet ekzistenca e një niveli më kompleks, që shfaqet përmes përfaqësimeve fonologjike, të cilat, falë rregullave transformacionale, projektohen në një nivel sipërfaqësor, që u korrespondon formave reale të prodhuara nga folësit¹⁵.

¹⁵ G.Clements, George N., *The geometry of phonological features*, Phonology Yearbook 2, 1985, f. 229.

Në teorinë segmentore të fonologjisë, përfaqësimi ka të bëjë me një sekuençë lineare, në të cilën segmentet përfaqësohen nga zanoret dhe bashkëtingëlloret, ndërsa josegmentet nga kufijtë e morfemave (shënohen me simbolin +) dhe ato të fjalëve (që shënohen me simbolin #), si dhe mbisegmentesh (d.m.th. theksi, tonet etj). Në brendësi të këtij mekanizmi teorik, fonemat (të quajtura edhe segmente), janë njësi diskrete, (d.m.th., dallohen nga njëra-tjetra në mënyrë kundërvënëse), që analizohen në nivel linear dhe dallohen nga josegmentet.

Në këtë mënyrë, segmentet mund të ndahen nga josegmentet si në fjalinë e mëposhtme: #Míra# #shëtís+te# #búze# #dét+i+t#.

Në këtë këndvështrim, segmentet konceptohen si njësi të përbëra nga një varg tiparesh të bazuara në kritere nyjëtimore dhe pa ndonjë rend hierarkik, d.m.th. ato konfigurohen si një tërësi linearisht e parregullt tiparesh, që shfaqin karakteristika të njëkohshme, të pranishme në artikulinimin e segmentit.

Tiparet dalluese binare shërbejnë për të dhënë një informacion të hollësishëm lidhur me inventarin fonologjik të një gjuhe. Përmes tyre, krijohen një varg veçorish, të cilat diferencojnë fonemat prej njëra-tjetrës. Ato janë një përfaqësim abstrakt i gjesteve artikulatore edhe për një arsye tjetër: dihet që mekanizmi i funksionimit të aparatit të të folurit, ka një efekt vazhdimësie, i cili nuk përfundon menjëherë pas shqiptimit të një tingulli, gjë që krijon shkrirjen e fazave të artikulimit të tingujve, duke u falur atyre disa nuanca të përbashkëta tiparesh.

Artikulimin e përzier, e ndeshim tek dukuria e labializimit, njëfarë akomodimi që ndodh gjatë kontaktit mes tingujve që e kanë tiparin [+buzor] dhe atyre që nuk e kanë, p.sh., në fjalët /tullë/, /rrugë/, bashkëtingëlloret nistore fitojnë njëfarë nuance buzorëzimi, pikërisht nga kontakti me zanoret e labializuara, rezultat ky i interesimit të një pjese të aparatit zanor (rezonatorit të buzëve në këtë rast).

Si përfundim mund të themi se funksioni i këtyre tipareve dalluese, mbetet thjesht teorik, në qoftë se shihet i veçuar nga kontekstet e shumta në të cilat vërehet përdorimi i fonemave. Duke qenë se studimi i njëjësive gjuhësore, është i shkallë-shkallshëm, ajo që na intereson më tepër, është mënyra se si shfaqen këto veçori fonotaktike në brendësi të vetë sistemit gjuhësor.

Identifikimi i rolit që luan substanca tingullore, brenda formave gjuhësore të niveleve më të larta, lidhet me nivelet e përfaqësimeve fonologjike dhe të strukturave sipërfaqësore të gjeneruara, pikërisht nga përzgjedhja e këtyre sekuençave tingullore. Gjenerativistët i përdornin tiparet binare, duke i renditur në matrica tiparesh, të cilat zbulonin jo vetëm

veçoritë e secilit prej tyre, por edhe diferencat të cilat lejojnë kombinimet e ndryshme, të lejueshme fonotaktike të tyre brenda sekuencave më të mëdha ligjërimore.

Tiparet nuk ndërtohen dhe përshkruhen thjesht për të pasuruar inventarin konceptual të sjellë nga foneticienët dhe fonologët. Që në fillim, ato u konceptuan për të përshkruar njësitë segmentore që përfshihen në procese të ndryshme fonologjike. Përshkrimi i një segmenti duhet të përfshijë aq tipare sa ta diferencojë atë nga segmentet e tjera në gjuhë. Kjo do të thotë që numri i tipareve duhet të jetë minimal, për të dalluar çdo fonemë të një gjuhe, me fjalë të tjera, nuk mund të ekzistojnë dy segmente të ndryshme që të kenë të njëjtin përshkrim.

BIBLIOGRAFIA:

- Blumfeld, L., *Language*, London, 1995, f.135.
- Browman, C.P., & L.,Goldstein, *Articulatory gestures as phonological units*, *Phonology*, 6, 1989.
- Chomsky, N., Halle, M., *The sound Pattern of English*, The MIT Press, Cambridge Mass.,1968.
- Clements, G. N. and Hume, E., *The internal organization of speech sounds*, in *The Handbook of Phonological Theory* Oxford: Blackwell, 1995.
- Clements, G. N., *The geometry of phonological features*, *Phonology Yearbook* 2, 1985.
- Goldsmith, J., *Autosegmental and metrical phonology*, Cambridge, 1993.
- Ewen, C.J., H.van der Hulst, *The phonological structure of words*, Cambridge, 2009.
- Memushaj, R., *Fonetikë e shqipes standarde* Tiranë,2014.
- Memushaj, R., *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2009.
- Nespor, M., *Fonologia, Bologna*, 1993.
- Odden, D., *Introducing Phonology*, Cambridge University Press, 2005.
- Pierrehumbert, J., *Phonological and phonetic representation*, *Journal of Phonetics*, (1990) 18.
- Spencer, A., *Phonology*, Blackwell Publishers, Oxford, 1996.
- Tronk, B., *General Laws of Phonemic Combinations*, *Selected Papers in Structural Linguistics*, 1982.
- Trubeckoi, N. S., *Parimet e fonologjisë*, Prishtinë, 1985.

Analysis of phonemes in distinctive features***ABSTRACT***

Phonemes are individual sounds described as a bundle of phonetic features that differ from each other in at least one feature. For example, we know that /p/ and /b/ are both bilabial plosives and yet they are not identical. In order to understand how they are distinguished from each other, we can create a simple feature chart, marking features with binary values as '+' or '-'. In doing so, we discover that the distinguishing feature is voicing. This is referred to as a minimal distinction or a distinctive feature.

Distinctive features enable us to classify phonemes into categories, distinguish classes of phonemes from one another, formulate predictions as to how classes of phonemes will behave, and display language-specific constraints. They also provide articulatory, perceptive (auditory), and acoustic information that help us distinguish between closely related phonemes and allophones, provide categories for showing contrast between sets of sounds, and are the basis for creating natural classes.

Feature theory was most famously developed for phonology by Trubetzkoy (1939), with significant extensions by Jakobson, Fant, Halle (1952) and Chomsky and Halle (1968).

Elvis BRAMO

**RRETH DISA GREQIZMAVE NË VEPRËN
“CUNEUS PROPHETARUM” TË PJETËR BOGDANIT”
(1685)**

(Nga vepra “Leksiku historik i gjuhës shqipe IV” i Kolë Ashtës)

Hyrje

Pjetër Bogdani është shkrimtari më i madh i grupit të shkrimtarëve të vjetër të Veriut. Ai është i vetmi që hartoi një vepër origjinale “Cuneus Prophetarum”, me të cilën dëshmoi jo vetëm aftësitë e tij krijuese, por edhe mundësitë shprehëse të shqipes letrare të asaj kohe, kur dialektet e gjuhës sonë kishin anë të përbashkëta e pak dallime, krahasuar edhe me kohën tonë. Ai është cilësuar nga albanologjia jonë si *lëvruesi më i shquar i gjuhës shqipe përpara Rilindjes Kombëtare*.¹ Më tej, gjuhëtari A. Kostallari nënvizon dhe ngre lart përpjekjet e Bogdanit për të ruajtur pastërtinë e gjuhës shqipe e vlerat e saj të trashëguara prej shekujsh, drejtimet e rrafshet kryesore të pasurimit leksikor e frazeologjik të gjuhës letrare shqipe në “Çetën e profetëve”, fushat kryesore të terminologjisë së përpunuar nga Bogdani dhe veçoritë e kësaj terminologjie të parë njëkohësisht edhe si vijim i një tradite; diferencimet stilistike të mishëruara në këtë vepër si bilanc e si sintezë madhore e arritjeve në shkrimin e shqipes përpara Rilindjes Kombëtare, si krijues i vlerave estetike, si prozator e si poet”.²

Lidhur me ligjëratën tonë, duhet pohuar se greqizmat në veprën origjinale të P. Bogdanit ndryshojnë mjaft nga ato të paraardhësve të shkrimtarëve të Veriut: ato nuk rrjedhin si huazime të gjuhëve në kontakt, ato nuk janë vetëm terma kishtarë dhe janë përdorime letrare me kuptime nga më të ndryshmet. Do të veçojmë, sa të jetë e mundur, se cilat lema janë të greqishtes së vjetër e cilat të greqishtes së re, duke bërë rishikimin e tyre sipas etimologëve të sotëm të gjuhës moderne greke dhe studimeve autoritare akademike.

¹ ASHRSH, (1991), Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Pjetër Bogdani dhe vepra e tij*, Tiranë, f. 17.

² Androkli Kostallari, po aty, f. 14. Në një vend tjetër të ligjëratës së tij, mbajtur në Konferencën shkencore të 300-vjetorit të vdekjes së shkrimtarit, A. Kostallari ka përcaktuar: “Në veprën e tij u brumos e para koine e mirëfilltë letrare e gegërishtes që ishte një sintezë e drejtpërdrejtë dhe mjaft e thelluar e vlerave të trojeve të hapëta gjuhësore – që nga të folmet verilindore e deri tek ato Veriperëndimore.” (f.45)

amaxonë-a, em. Ital. amazzone, nga greq. e vjetër, *αμαζών* f. 110, Amazonë “Kisha e Hanesë (= tempulli i Dianës)...kjo trajtuem prej amaxonash grā “ 1,10, ndërkohë që sot fjalorët kryesor të greqishtes moderne vjen si: grua që bën pjesë në një fis luftëdashës, grua që ushtrohet në kalërim, etj. *Οι μικρές αμαζόνες του ιππικού θα κάνουν επίδειξη.*³ Sipas fjalorit etimologjik grek⁴ fjala amazon rrjedhon nga supozimi se amazonat prisnin ose digjnin gjirin e djathtë tek fajzat e vogla në mënyrë që të qëllonjë më mirë me shigjetë. Gjithsesi shkrimtarët e lashtë si: Hipokrati dhe Dhiodhor Siqelioti kanë vënë në dyshim këtë legjendë.

anagogji-a. Ital. Anagogia nga greq. e vjetër *αναγωγή* f. 111 ”ngritje”. Në veprën e Bogdanit “Cuneus Prophetarum”, pjesa e parë, shkalla II, ligjërta I, përdoren disa terma latine e greke, që dëftojnë për nxjerrjen e anëve kuptimore të ndryshme të teksteve e veçanërisht e ka fjalën për ato biblike: kuptimi leteral apo historik (i letrës apo i kallëzimit, letërisht apo historikisht) ndahet në kuptimin etiologjik dhe analogjik; kuptimi i shpirtshëm ndahet në atë alergjik, moral o tropologjik dhe anagogjik. Interpretimin e tekstit biblik në pikëpamje mistike e quan “anagogjia” I II, I, 8. Sot në fjalorët kryesor të greqishtes moderne⁵ vjen si: rikthimi i ushqimit nga stomaku në ezofag e më pas në gojë. Ndërsa në fjalorin etimologjik grek: ngritje në lartësi.⁶

analogji-a em. Ital. Analogia nga greq. e vjetër *αναλογία* f. 112 Lidhje apo ngjasim i pjesshëm në mes gjërave të ndryshme quhet analogji. Bogdani thotë “analogjia është, kur kallëzohetë se e vërteta e njit’shkruemitnukë kundërshton me të drejt (ën)

³ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 169.

⁴ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 105.

⁵ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 190.

⁶ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 116.

(= të vërtetën) e së t'jetërit, po njimendenë” I Ii, I, 9 “analogia è quando si dimostrache la veritad’una scrittura non ripugna alla veritad dell’altra, ma non convergono.” Në fjalorin e sotëm të greqishtes⁷ fusha semantika mbulon kuptimin: raport sasiar, raport mes dy përmasave. Në fj. etim. ⁸ema del në shumë gjuhë të ndryshme si term shkencor me të njëjtin kuptim të referuar më lart.

aspër- a em. Greq. e mesme *ασπρον* f.118. E ka me kuptim të përgjithshësuar, para, të holla “regji ka me pasë nevojë për dy milljonj’ ar për të ruajtunëdhen’e prej anëmijshtit’, e i vobeku ka me pasë nevojë për pak aspre me u ruejtunë ujët” I I, VI, 15: “il re, per aventura, havevà bisogno di due milioni d’oro per difendere da’nemici il suo stato, et il povero haverà bisogno di poca moneta per difendere dalla fame.” Në fjalorin e sotëm të greqishtes së re gjendet me kuptimin: monedhë bizantine ose turke prej argjendi, ⁹pasuri në të holla. Nga fjal. etim. grek rezulton: monedha të reja të sapo prera, të cilat ishin ende të ashpra në relievin e tyre dhe nuk ishin lëmuar ende nga përdorimi. Nummi asperi.¹⁰

bibliotekë -a em. Ital. Biblioteca nga greq. e vjetër *βιβλιοθήκη* f. 126 “libër” ...”kashë, roje”. “Këto letëra gjindenë ndë Eusebit Caesar. Lib.1, kap. 15, i sillti thotë se i gjet ndë Bibliotekë të gjytetsë Edesësë me kallëzimet m (e) regjit Abbagar” II II, I, 19. Në greqishten e sotme do të thotë: mobilje-mbajtëse librash, koleksion librash, ndërtesë ku strehohen libra.¹¹

çikë=a em. Xixë, shkëndijë, rreze. Gjarpër me çikë është ai që në latinishten quhet *cerastes* e greqisht *χεραστής* f. 135 “i britë”,

⁷ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 199.

⁸ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 123.

⁹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 351.

¹⁰ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 224.

¹¹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 422.

si brirë”; është emër i përgjithshëm nepërkash afrikane, prej të cilave disa specie kanë një si bri të vogël sipër gropës së syrit: duke sa ka shkëlqim për deri sa thotë gjarpër me çikë, me xixë “gjarpënë ... me çikë” II IV, (V): cerastes do me thanë gjarpënë me çikë o brijënambë krye” II IV, (V), 3. Kjo fjalë nuk gjendet në fjalorët e sotëm të greqishtes së re.

djall-i em. Greq. e vjetër *διάβολος* f. 149, lat. Diabolus “djalli” I I, I, 9: “demonio” – del e pashpjeguar në Leksikon historik të gjuhës shqipe IV, hartuar nga Ashta. Në fjalorët e sotëm del me kuptimin: shpirti i të keqes, shpallja e një inati të madh, vendi ku gjendet djalli.¹² Në fjalorin etimologjik kjo fjalë i përgjigjet foljes: διαβάλλω- ndërhyj dhe gjendet e shtrirë në shumë gjuhë të ndryshme.¹³

djemën – itë em. Greq. e vjetër *δαίμονε* f. 150 jo lat. daemon-ónis, ônem. Është prej atyne emrave që ka vetëm shumësin “dau...engjijtë djemënish” I I, IV 5. Në fjalorin e sotëm gjendet me kuptim: djali i padëgjueshëm e i pabindur, person që të shqetëson moralisht. Οι δαίμονοι με τις μηχανές χαλούν τον κόσμο.¹⁴ Në fjalorin etimologjik vjen me kuptimin: i keq, me qëllime negative.¹⁵

drandofille-ja em. Greq. e mesme *τραντάφυλλον* f. 154 “ta mbukuronjë me drandofille e vjolëza II III, III, 13; “drandofille” Vjersha e Lukë Bogdanit. Në fjalorin e sotëm të greqishtes së re gjendet me kuptimin: lule me ngjyrë të bukur dhe erë të mirë-άνθος με ωραίο χρώμα και άρωμα.¹⁶ Në fjalorin etimologjik grek: rrjedhon nga tridhjet e më shumë petale.¹⁷

¹² Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 549.

¹³ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 348.

¹⁴ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 519.

¹⁵ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 330.

¹⁶ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1969.

¹⁷ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1454.

engjëllë-i em. Lat. Angelus, greq. e vjetër *ἄγγελος* f.164. Emrat mashkullorë, që mbarojnë me *ll* Bogdani i shkruan me *ë* “engjëllë” II I, I, 9: “angiolo” e në të shquarën “engjëlli” I I, III, 18: “angelo”; në shumës “engjijtë” I I, I, 27, “i engjijet” I I, II, 9 e sot me y epentetike, i engjëjet: “me të fole të engjijet” I II, I, 1: “con parlar delli angeli”. Në greqishten e sotme vjen me kuptimin: cilido prej ndjekësve qiellor të perëndisë, person që simbolizon të mirën, person që personifikon mesazhin ose lajmin e mirë.¹⁸ Sipas etimologjisë greke: lajmëtar, përcjellës lajmesh e mesazhesh. Kuptimësia helenistike sipas Dhjatës së re e të vjetër: qenie e padukshme që i shërben perëndisë.¹⁹

etiologji -a em. Ital. etiologia nga greq. e vjetër *αἰτιος λόγος* f.165 “që është shkak”, për “bisedë”, “etiologia asht kur na vjen kallëzues arrësyeja e fjalësë” I II, I, 9: “l’etiologia è quando s’assegma la causa del parlare. Në greqishten moderne do të thotë: shpjegim, prezantim arsyesh, kërkimi i arsyes.²⁰ Ndërkohë sipas etimologjisë greke: *nuk jepet për këtë fjalë asnjë shpjegim.*

fis-i em. Greq. e mesme *φύσις* f.173 1. Brezni të rrjedhura nga një stërgjysh i përbashkët “prej kujit giuni (= prej giunit së të cilit) e fisi janë” I I, III, 12; “della cui discendenza sono”, farefis “me rrjedhunëndëfarët’e fis të tijnaj” I I, VII, 9. 2. gjinia njerëzore “me çpërblëm fisnë e mërit” I III, III, 7, “per redimere il genero humano”. Në greqishten e sotme vjen me kuptimin: tërësia e organizmave shtazorë dhe bimorë (flora dhe fauna)- hapësirë e blertë, mënyra e thjeshtë e të jetuarit.²¹ Në fjalorin etimologjik nuk jepet asnjë shpjegim.

flamburë-a em. Greq. e mesme *φλάμμουρον* f.174. Flamur, por te Bogdani me *b* të shtuar pas *m*-së ashti si e ka edhe te fjala *fambulli*, çka

¹⁸ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 79.

¹⁹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 57.

²⁰ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 130.

²¹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 2102.

ngjet shpesh në shqipen “erdh për mbi gjithë ta mbë fëtyrë të zjarmit pasi një flamburë” III IV, III, 3; “flamburë” Vjersha e Lukë Bogdanit. Para tij Frang Bardhi e shkruan *m e jo mb* “vaxillum: bajrak, flamurë” 183; veç kësaj shihet edhe një huazim i dytë e ky i marrë nga turq. *bajrak*²² e kështu ngjet mjaft herë që dy fjalë gjuhësh së ndryshme të jenë huazuar në shqipen në kohë të ndryshme e të dalin si sinonime. Në fjalorin e sotëm të greqishtes së re do të thotë flamur luftarak – το φλάμπουρο της επανάστασης.²³ Në etimologji na vjen me kuptimin: Flamur luftarak që përcjell imazhin e një zjarri.²⁴

gëzofth-i em. Greq. e vjetër *γαυσάπης* 182 lat. *gausana*. Gëzof i vogël, gëzof + th “tue marrë gëzofthinë e vet të barisë, me krahanoshe të vet, ndë të sijët, pat shtim pësë gurë, me baet ndore votë me u përprjekunë me gjigantin, anëmikn’e e vet” I III, II, 7: “pretendo la sua pellicetta con il suo zaino, nel quale havea messo cinque sasi e con la fionda in mano, andò ad incontrar il gigante, suo avversario.” Kjo fjalë nuk gjendet në fjalorët e greqishtes së re dhe as në fushën etimologjike ku është kërkuar.

gojartë mb. Është kompozitë e përbërë (e ngjizur) me emër + mbiemër për të sajuar një mbiemër gojë + (i) artë. Është përkthim pjesë – pjesë i fjalës greke *krisostom χρυσόστομος* f.184 “Sh.Gjon Gojarti” I I, VI, 15: “S.Gio Grisostomo. Në fjalorin e gjuhës së sotme greke do me thënë: ai që flet me fjalë të arta, emër i përveçëm i një mashkulli, emër i Shën Joanit At i Kishës dhe Patriark i Konstandinopojës²⁵. Në fjalorin etimologjik grek nuk jepet asnjë shpjegim.

hipostatik mb. Lat. E shkruar *hypopstaticus* nga greq. e vjetër *υπόστασις* f. 199: hypo “nën”, Greqisht istëm “vë”. Si fjalë do të thotë të vënit nën një gjë tjetër, si term është i filozofisë, e mjekësisë dhe

²² Dizdari, T. (2006), *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i qytetërimit Islam. Tiranë, f. 58.

²³ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 2076.

²⁴ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1546.

²⁵ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 2166.

e teologjisë, sipas së cilës e ka edhe Bogdani “nye hipostatik” II I, III,10; “stretto vincole hypostatico”; “të shtërnguem hipostatik” I III, VI, 9: “unione ipostatica”. Në fjalorin e gjuhës së sotme greke kemi: ekzistencë, tërësi elementesh që përbëjnë një fiziognomi, veçantitë e tipareve të fytyrës.²⁶ Në etimologji jepet si: mbështetje, bazament dhe substancë themelore, qenie.²⁷

idhullatrë – i em. Lat. idolatra, greq. e vjetër *ειδολολάτρης* f. 201. Idhulltar, ose idhujtar “rodh ndë për Esaunë, prej të sillit rodhnë sirlantë e idumejtë, gjentilia e idhollatrë” I II,III, 2. Në greqishten e sotme do të thotë: adhurim ndaj perëndish false, dhe përngjasime të tyre, dashuri e pafund dhe e ekzagjeruar.²⁸ Në etimologji nuk jepet asnjë shpjegim.

kallëm-i em. Greq. e vjetër *καλαμός* f. 205 Kallam “tue i dhanë një kallëm ndore” II III, II, 14. Në greqishten e sotme do të thotë: kallam, kallamishte, lloj bime.²⁹ Në etimologji do të thotë: lloj lloj gdhendjeje, mënyrë gdhendjeje.³⁰

kosmograf -i em. Ital. cosmografo nga Greq. *κόσμος* + *λόγος* f. 217. Ai që merret me përshkrimin ose studimin e gjeografisë astronomike. Del në shumës me *i* të italishtes e me nyjën e shquar *të* të shqipes “thonë kosmografitë” II, V, 8: “cosmografi”. Në fjalorin e sotëm grek do të thotë: ai që merret me studimin e universit, ai që merret me prejardhjen e universit.³¹ Në fjalorin etimologjik nuk jepet asnjë shpjegim.

kulshedrë -a em. Lat. *chersidrus* e jo greq. e vjetër *κερσίδος* f. 221. Shtasë mitologjike “kulshedrë” I III, IX, 6: “dragone”; “kulshedra” I II,

²⁶ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 2038.

²⁷ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1508.

²⁸ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 635.

²⁹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 918.

³⁰ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 616.

³¹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1052.

I, 20: “dragone”. Për këtë zë nuk jepet asnjë shpjegim dhe as që nuk ekziston e shprehur me formën e autorit.

lajm-i em. Greq. e re *λάλιμα* f.226 “të folur pa pra”, “dërgova të lajmitë” I II, IV, 10: “nuncios misi”; “flitke aj i lajm” I III, V, 2: “detto nunzio parlava”; “nji lajm për të çpejtë kje dërguem” II II, VI, 1: “messo”. 2. Lajm-i “gjithë i prenë n’shpatet tue shpëtujem aj vetëmë me prum të lajmitë” I III, V, 2: “tutti ucissero con la spada scapolando egli solo per dare l’avviso”. Në fjalorin e greqishtes së re gjendet me kuptimin: të humbas dikush logjikën e tij, zhurmë melodike.³² Në fjalorin etimologjik gjendet me kuptimin: fjalim, fjalë të pakuptimta dhe boshe.³³

lumbardhë – a em. Greq. e re *λουμπάρδα* f. 237. Topi si mjet nga del predha, bomba, “ban atë bumbullimë posi balla kur del lumbardhet” I I, V, 27: “come da un artiglieria causa quel orribile strepito.” Në fjalorin e greqishtes së sotme: i thonë topit.³⁴ Në fjalorin etimologjik i thonë: topit, kishës së Shën Dhimitrit të Lubardharit.³⁵

mag-u em. Ital. mago, i maghi nga greq. e vjetër *μάγος* f. 239 do të thotë pjesëtar i ortës (ital. casta) priftërore të Medies, të asaj krahine që shtrihej mes Asirisë (Kurdikistan), Persisë e Detit Kasp, por këtu mag quhej pjesëtari i ortës, e cila trashëgonte shkencën e asaj kohe në atë vend “të dijëshmitë qi u thonë magji” I II, III, 16; fjala në këtë formë është marrë nga Bogdani sipas ital. (i) magi. Në fjalorin e sotëm të greqishtes gjendet me kuptimin: person që ushtron magji, person që bën truke në publik.³⁶ Në etimologji gjendet me kuptimin: interpretë të endrrave.³⁷

³² Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1107.

³³ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 758.

³⁴ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1146.

³⁵ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 793.

³⁶ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1156.

³⁷ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο

mirrë – a em. Lat. e shkruar myrrha, greq. e vjetër *μύρρα* f. 254. Një lloj rrëshire nga trugu i disa bimëve të Afrikës e të Azisë që përdoret si ilaç për të lyer “venë përziem me mirrë” II III, 3; “përzienë me venë mirreje helmthinë” II III, III, 3. Në greqishten e sotme: substancë me aromë të mirë, në ngjyrë të verdhën, çdo vaj aromatik me erë të mirë.³⁸ Në etimologji gjendet me kuptimin: dhjamë, rrëshirë.³⁹

monarkë -a em. Ital. monarca, greq. e mesme *μονάρχης* f. 256 ka me kjanë një i madh monarkë me forcë të kësaj jetë” II IV, (V), 4. Në greqishten e sotme: udhëheqës i lartë me pozitë të trashëguar.⁴⁰ Në etimologji: udhëheqës i vetëm, dinast.⁴¹

parabolë -a em. Ital. parabola, greq. *παραβολή* f. 292. Bisedë nëpërmjet përngjasimit. “Shembëlltyrë e paraqitur si kallëzim alegorik “parabola” I II, I, 8. Në fjalorin e sotëm të greqishtes së re: Krahasim, rrëfim alegorik.⁴² Në etimologji: vendos pranë.⁴³

parafrazë – a em. Ital. parafraasi, greq. *παράφρασις* f. 292. Shpjegim i zgjeruar i një teksti “kjene çtjellë ndë parafrazet të Gjonotan (it)” I I, III, 5. Në fjalorin e sotëm të greqishtes: dhënia e kuptimit, them me fjalë të tjera.⁴⁴

pëllambë -a em. Greq. e vjetër *παλάμη* f. 299. Masë gjatësie që bëhet duke e shtrirë dorën nga gisht i madh tek i vogli. “(janë) të vobegitë po me dyrdht, (= hardhi) me tri dele e me një pëllambë dhe të kopështit (të) tynej” II, I, VI, 15. Në fjalorin e sotëm të greqishtes

Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 804.

³⁸ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1291.

³⁹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 906.

⁴⁰ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1246.

⁴¹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 872.

⁴² Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1465.

⁴³ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1038.

⁴⁴ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1486. Po i njëjti kuptim edhe në fjalorin etimologjik.

së re: sipërfaqja e brendshme e dorës.⁴⁵ Në etimologji do me thënë: i gjerë dhe i sheshtë.

pigmé – u em. Ital. pigmeo nga greq. *πυγμαίχος*, nga *πυγμή* f. 310, që do të thotë grusht, por edhe kut, pra, masë prej përkuljes së bërrylit deri te grushti te gishti i mesëm i dorës. Pigmejtë parafytyroheshin trupshkurtër nja dy pëllëmbësh, banorë mitologjikë të Indisë o të Afrikës “pigmejtë qi gjellijnë ndë ma të mëdha male t’Indistanit, banjënë luftë për herë me korrilat” II II, I, 3: “ndë pigmejt nuk’është mbërre me kjanë i vogëlë.” II II, I.3. Në greqishten e sotme: sportisti i boksit.⁴⁶ Në etimologji: nuk jepet referent shpjegues i fjalës.

probatikë -a em. Fjalë greke e teksteve *προβατινός* f. 318 “ai që kujdeset për delet”. Bogdani shkruan “ndë probatikë të pishinësë” I II, III,9: “Probatca Piscina”; pra, kishte për të qenë shqip: ndë Pishinë Probatike”. Në fjalorin e greqishtes së sotme: ai që merret me delet.⁴⁷ Në etimologji nuk jepet asnjë shpjegim.

Profeti – a e, Greq. *προφητεία* 318 “profetia” I I, I 17 . Në greqisht do të thotë: parashikim mbi gjëra që do të ndodhin në të ardhmen.⁴⁸ Në etimologji nuk jepet asnjë shpjegim.

putir -i em Greq. e re *ποτήρι* f. 320. Kupë “nukë lanjinë aqa shpesh duertë e putirët (e) tryesësë” II II, IV, 17. Në greqishten e sotme: gotë prej së cilës pijmë lëngje.⁴⁹ Në etimologji nuk jepet asnjë shpjegim.

qefali – a em. Greq. e mesme *κεφαλής* f. 321. I pari i një vendi “qefali” I I, I, 19: “princeps”; “ u ba qefalia i zoti i tyne” I III, II, 15: “ si

⁴⁵ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1449.

⁴⁶ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1674.

⁴⁷ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1627.

⁴⁸ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1662.

⁴⁹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1612.

fece loro capitano e precipe”. Në greqishten e sotme: Udhëheqësi, ai që paraprin.⁵⁰ Në etimologji: Majë.⁵¹

rrshajë -të em. Lat. rosàlia “festë me drandofillë. Rrëshajë-a, përdoret në shumë në italisht thuhet *pentecoste*, greq. *πεντηκοστή* f. 336. “rrshajëshsit” I III, VI, 6 “nella Pentecoste”. Në greqishten e re: Festë kishtarë kristiane që festohet pesë ditë pas Pashkëve.⁵² Në etimologji: qëndrimi i shpirtit të shenjtë përmbi nxënësit e Krishtit.⁵³

sibilë -a em. Sipas lat. sibila nga greq. e vjetër *σιβύλλα* f. 340 “e silla (= kjo) punë munë thoemi se mirretë (graf. Mirrene) vesht për këto vashëza Sibila, përse ata (= atë) që kallëzuenë ndë kankë e lodërti, gjithë kënduenë” I IV, I, I: “il che puo intendere di questo donzelle, delle Sibile, poiché quello che loro prediscero, tutto prediscere in suoni e canti.” Në greqishten e sotme: Σίβυλλα- person enigmatik.⁵⁴ Në etimologji: priftëreshë mitike.⁵⁵

sinderes – i em. Sipas greq. *συνδιαίρω* f. 341 “veçoj” për të djuem të keqenë e për të nxitunëmbë të mirë e ashtë sinderesi” I I, VI, 18. Në fjalorin e greqishtes së sotme: Nuk jepet asnjë shpjegim.

sinekdokë -a em. Ital. sinèddoche nga greq. *συνεκδοχή* f. 341 unum “flet për sinekdokë, mer anetë për të gjithë qish ka mbrenda” I I, IV, 6. Në greqishten e sotme: formë fjale, pjesë e ligjëratës që tregon tërësinë në të cilën përket diçka.⁵⁶ Në etimologji: Ndaj të njëjtën

⁵⁰ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 995.

⁵¹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 672.

⁵² Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1521.

⁵³ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1080.

⁵⁴ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1750.

⁵⁵ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1268.

⁵⁶ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1870.

përgjegjësi në të njëjtën mënyrë.

staterë -a em. Ital. statére, greq. *στατήρ* f. 344. Lloj monedhe “ke me gjetunë staterën si kur me thanë një grosh të Spanjësë” II II, V, 11. Në greqishten e sotme gjendet me kuptimin: njësi nomismatike vlera e së cilës ndryshon nga njëri qytet në tjetrin.⁵⁷ Në etimologji: Njësi nomismatike.⁵⁸

stole -ja em. Sipas lat. stola, greq. *στολή* f. 344 “ke me lamndë venë stolën e vet” Ii III, II, 13. Në greqishten e sotme: veshje.⁵⁹ Në etimologji: përgatije e ushtrisë; veshje.⁶⁰

stolisunë fol. Greq. e re *στολίζω* f 344 “tu’estolisunë me aqa bukuri” Ii I, I, 1 “adornando”. Në greqishten e sotme: zbukuroj me stoli, vishem me rroba të bukura.⁶¹ Në etimologji: përgatis ushtrinë, vesh, zbukuroj.⁶²

Shpellë -a em. Greq. e vjetër *σπήλαιο* f. 352 “është ajo shpellë e pafundë” I I, V, 3: “spelunca”; “hini vetëm ënd atë shpellë” I III, II, 17; “grotta”; “duel shpellet” I III, II, 18: “grotta”. Në greqishten e sotme: Mjedis natyror nëntokësor i zbrazët, zgavër e madhe.⁶³ Në etimologji: bodrum nëntokësor.⁶⁴

temel -i em. Greq. e re *δεμέλιον* f.360. Themel “shtinë temel” I II, III, 3: “fondamento”. Në greqishten e sotme: Θεμέλιο- baza

⁵⁷ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1811.

⁵⁸ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1324.

⁵⁹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1825.

⁶⁰ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1338.

⁶¹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1825.

⁶² Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1338.

⁶³ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1799.

⁶⁴ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1313.

materiale, mbështetje esenciale.⁶⁵ Në etimologji: mbështetje.⁶⁶

tetriarkë – a em. Ital. tetriarca nga greq. *τετράρχης* f. 361. Sundimtar i katër krahinave të një shteti o të katër qyteteve “tetrarka” II II, V, 22. Në greqishten e sotme: nuk haset më. Po ashtu nuk haset as në fushën etimologjike me këtë kuptim.

tron -i em. Ital. trono greq. *θρονος* f.365. Seli, fron “ e treta valle është e tronet” I I, IV, 9: “il terso coro e de’ Troni”. Në greqishten e sotme: ndenjësë luksoze, pushteti, selia e Patriarkanës.⁶⁷ Në etimologji: sjell, mbështes, mbaj.⁶⁸

tropologji -a em. Ital. tropologjia nga greq. *τρόπος + λόγος* f.365 “metaforë” e logos “bisedë”. Bisedë tropologjike, e figuruar, alegorike; kuptim tropologjik, figurativ “tropologjik” I II, I, 8. Në greqishten e sotme: ndryshimi i çështjes, tekst i shkurtër që ndërfitet në tekstin Ligjor.⁶⁹ Në etimologji: amendament.⁷⁰

tryesë -a em. Greq. e mesme *τράπεζα* f. 366 “tryezë të shtruem me gjithë duer gjellash “ I I, I, 5: “tavola”. Në greq. e sotme: mobilje me katër këmbë.⁷¹ Në etimologji po ashtu, mobilje me katër këmbë.⁷²

Është interesant të vëmë në dukje se autori i Leksikut historik të shqipes, prof.Kolë Ashta, jo vetëm tek vepra origjinale e Bogdanit, por edhe tek autorët e tjerë, përveç etimologjive të prejardhjes së fjalëve nga gjuhët e

⁶⁵ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 842.

⁶⁶ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 558.

⁶⁷ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 859.

⁶⁸ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 571.

⁶⁹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2012, 1978.

⁷⁰ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1461.

⁷¹ Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1963.

⁷² Μπαμπινιώτης, Γ. *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα 2011, 1448.

huaja, ka sjellë edhe familjet e fjalëve, siç shohim tek termat e mëposhtëm, pas të cilave gjejmë:

- **temelisinë** fol. Themelsi, themeloj “temelisinëmb atë vend” II II, I, 6.
- **temelitur** fol. Themeloj “është temelitur” I III, III, 25: “fondare”.
- **temelitur**, i mb. I themelitur “duhetënierit (të) temelitur” Të primitë para letërarit 2. Themelim “janë për t u goditur me një të temelitur të palëkundur” I II, I, 1.

vështëri -a: “veshtërī -a.	vollëndet – ja	[vullëndet=ja]	zgedhës -i
vështërim – i: vështërim-i.	vollëndetshim	[vullëndetshim]	zgedhunë
vështruem: vështëruem.	vollëndetunë	[vullëndetunë]	zgedhunë, i
vështruem-itë, të:	vollënduem	[vullënduem]	
“vështruem -itë, të”	(f. 376, 379, 386) ⁷³		

PËRFUNDIME

Nga një vështrim i tillë, i pjesshëm, vetëm për helenizmat e nxjerra nga gjuhëtari Kolë Ashta, mund të përfundojmë:

- I. Punime të tilla rreth historisë së lëvrimin të gjuhës shqipe, na çojnë njëkohësisht edhe tek njohja e raportit të huazimeve, jo veç për greqishten, por edhe nga gjuhë të tjera në kontakt ose jo që ka pasur shqipja, si: me turqishten, italishten dhe me herët me latinishten.
- II. Vërejmë se në pikëpamje numerike, huazimet greke në veprën e P. Bogdanit, janë më të pakëta se autorët e tjerë pararendës si Budi, Bardhi e Buzuku.
- III. Përgjatë ndjekjes së këtyre huazimeve, bie në sy se turqizmat zënë një vend mjaft të gjerë në veprën e Bogdanit, çka tregon se, duke qenë ai më i fundmi shkrimtar i Veriut, leksemat nga turqishtja janë shtuar për së tepërmi.
- IV. Lidhur me lemat greke, shihet se autori i sjell ato jo veç si terma kishtarë e filozofikë, teologjikë, por edhe nga fusha të diturive të tjera (si nga letërsia), edhe në kuptime të figurshme.

⁷³ Ashta Kolë, Leksiku historik i gjuhës shqipe IV, Shkodër, 2018, f. 376 – 386.

- V. Me familjet e fjalëve që sjell Ashta në këtë vepër themelore të albanologjisë, mund të ndiqet mjaft mirë edhe procesi i fjalëformimit, mjetet që kanë vepruar në kohën kur hartoheshin këto vepra dhe ana sasiore e tyre.
- VI. Brenda synimit tonë, themi se për hetimin e veprimit semantik: si ngushtim apo zgjerim kuptimi, do të duheshin tekste më të gjera krahasuar me ato ku është mbështetur Ashta.

BIBLIOGRAFIA:

1. ASHRSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë: Pjetër Bogdani dhe vepra e tij, Tiranë, 1991.
2. Ashta, K. (2002): *Leksiku Historik i Gjuhës Shqipe*, «Camaj-Pipa», Shkodër.
3. Dizdari, T. (2006): *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i qytetërimit Islam. Tiranë.
4. Μπαμπινιώτης, Γ. (2011): *Ετυμολογικό λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα.
5. Μπαμπινιώτης, Γ. (2012): *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα.

**About some Greek words in the work of Pjetër Bogdani
“Cuneus Prophetarum” (1685)**

(From the work “Historic lexicon of the Albanian Language IV”
of Kolë Ashta)

ABSTRACT

In this article, we have as subject of our work an overview of the Greek words in the original work “Cuneus Prophetarum” of the renowned pre-renaissance writer, Pjeter Bogdani, based on the famous study of Kolë Ashta “Historic lexicon of Albanian language”.

This research aims to highlight not the explanations of the linguist Ashta, but mainly the place that the borrowed Greek words have in the prose and poetry of Bogdani, and the relationship with other foreign words such as: Latin, Italian, Slavic and Turkish words. Despite this, we aimed to note, according to the current data of the Greek linguistics, the etymologic and semantic plan of the listed lemma for this author in the work of Prof. Ashta: lexemes with an expansion and narrow of understanding , its usage as only as a term, but even in other functions too.

In this article, our research about these Hellenic words, shows that the number of borrowed words from Greek is lower than the other authors previous to Bogdani.

Key words: Greek words, borrowings, etymologic plan, semantics.

Abdulla BALLHYSA, Aurela BASHA

MBI DISA VEÇORI DALLUESE TË TEKSTEVE TË SEVASTI QIRIAZIT

Një vepër e caktuar e cilitdo lloji qoftë (shkencore /joshkencore) është, ndër të tjera, e lidhur fort me kohën kur është hartuar. Ajo, thënë ndryshe, konsiderohet prodhim i një konteksti të dhënë historik e shoqëror: ka marrë jetë dhe gjallon për shkak të shërbimit që i kërkojnë rrethanat e interesat e asaj kohe. Prej këtej del se këto vepra duhen vlerësuar jo vetëm nga ana teknike, por, mbi të gjitha, për nga rëndësia dhe mënyra e shërbimit që ato kryejnë e që janë destinuar.

Duke u mbështetur në këtë parim metodologjik, do të ndalemi tek tekstet e hartuara nga Sevasti Qiriazit, e, në veçanti, te teksti **“Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare”**, si ndër të parat gramatika shkollore me kërkesa të qarta formuese (pedagogjike, gjuhësore...) dhe, padyshim, me pikësnyime të larta atdhetare, sikundër diktonte ajo kohë.

Objektivi didaktik i kësaj gramatike shkollore (ashtu siç ndodh në të gjitha veprat e autorëve të sotëm perëndimorë) shpallet qysh në krye të saj, kur autorja thotë: *“Shkaku që më nguli të shkruanj këtë gramatikë, nuku është, që të bëj një veprë akademike të plotë për shkolla të lartra; po, vetëm një librë të vogël, që të jetë si udhëheqëse për shkollat filltare”*.¹

Më tej ajo mëton të theksojë arsyen pse duhet mësuar gramatika, jo vetëm si një njohuri gjuhësore, por edhe si mjete që sendërton në mënyrë të plotë e të qartë mendimet dhe idetë tona në të folur e në të shkruar. Përdorimi i saktë i njohurive gjuhësore (leksikore e gramatikore) pasqyron nivelin e kompetencës tonë gjuhësore në komunikimin me të tjerët dhe për qëllime të ndryshme. Kjo shprehet më së miri përmes fjalëve të autores në *Hyrje të tekstit: Qëllimi, që mësojmë gramatikën, është të stërvitemi si të përdorim drejt fjalët në fjalime; edhe kështu, të stërvitemi të përdorim në të folur edhe në të shkronjtur, më të mirën mënyrë për të treguarë ndjenjat edhe mendimet t’ona. Si edhe të tjerat dituri, të mësuarit e gramatikës na jep një arësim mendjeje të paçmuarë*.²

Përmbushja e këtij qëllimi parakuptonte një ndërmarrje jo vetëm të

¹ Dako, Q. S. *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare*, Manastir, Shtypëshkronja “Tregëtare Ndërkombëtare”, 1912, f. 1.

² Po aty, f. 2.

rëndësishme, por edhe mjaft me përgjegjësi nga shumë pikëpamje: nga ajo didaktike, gjuhësore dhe shkencore. Edhe pse Sevasti Qiriazit për hartimin e një gramatike shkollore e kishte një gjedhë paraprijëse siç qe *Gramatika* e Sami Frashërit³, prapëseprapë ndërmarrja kërkonte kujdes të veçantë e guxim shkencor.

Në rastin e *gramatikës* së S. Qiriazit nuk kemi thjesht një vepër shkencore, por kemi një vepër që do t'i duhet të përmbushë kushtin themelor të qenies, të ekzistencës së vet; para së gjithash, ajo është një gramatikë për shkollat fillore, një gramatikë jo aq për studim se sa për përdorim të përditshëm.

Së pari, e krye së gjithash, duhej marrë në konsideratë mosha e fëmijëve së cilës i drejtohej ky tekst, duke nënkuptuar e vënë në zbatim këtu disa veçanti të zhvillimit mendor e gjuhësor të saj. Vetë S. Qiriazit e shpreh qartë dhe drejtpërdrejt në ballinën e librit kujdesin që lënda mësimore të jetë e qartë, e thjeshtë dhe e përkapshme për mendjen e fëmijës, sipas moshës së tij: *Përkthesat mund të përmbliidhen dhe me pesë; po, na nuku e bëmë, sepse, do të ishte një ngatërrim për mendjen e fëmijëvet të vegjël.*

Mbi të gjitha sa thamë, duhet theksuar një fakt që bie në sy sapo shfleton këto tekste: Ato kanë si tipar dallues *qartësinë*, qartësinë e ndërtimit, të strukturës, të shprehjes etj., për të cilat do të ndalemi më vijim të shtjellimit.

Çfarë përmendëm, përbën edhe qëllimin kryesor të punimit tonë: shqyrtimi i *një tipari karakteristik dallues të teksteve të hartuara nga Sevasti Qiriazit: Qartësia. Për këtë jemi ndalur më shumë tek Gramatika elementare.*

Qartësia e teksteve të sipërpërmendura përftohet si rezultat i zbatimit në mënyrë të ndërthurur të disa prej parimeve bazë të hartimit të një teksteve shkollor, atij didaktik, gjuhësor e shkencor.

Duke qëndruar tek *Parimi didaktik* na rezultojnë se teksteve është i organizuar mirë nga ana strukturore në funksion të përmbajtjes lëndore; lënda mësimore organizohet në pjesë, krerë, njësi dhe përbërës didaktikë; shoqërohet me aparatën përkatëse pedagogjike, si edhe metoda, strategji e teknika mësimore që i japin dorë mësuesit për një përvetësim sa më të mirë të kësaj lënde prej moshës shkollore së cilës i drejtohet teksteve në fjalë.

³ Kujtojmë se aso kohe gramatika që i shërbeu si model S. Qiriazit, ndër gramatika të tjera pararendëse, ishte gramatika e Sami Frashërit, *Shkronjëto e gjuhës shqipe* (1886), me 141 faqe. Ajo merr nga gramatika e Frashërit një pjesë mjaft të konsiderueshme të koncepteve dhe termave gjuhësore (gramatikore).

Sa i përket *parimit gjuhësor* duhet thënë se lënda mësimore: përkufizimet, shpjegimet, shembujt ilustrues, duke shkuar deri te kërkesat/ushtrimet (stërviçet, sipas S. Qiriazit) etj., jepet përmes një gjuhe të qartë e të kuptueshme afër gjuhës dhe ligjëritimit të moshës së nxënësve që do ta përdornin atë gramatikë, por, për më tepër, edhe të aftësive përthithëse (kapacitetit linguistik e mendor të tyre).

Duke marrë në analizë *parimin shkencor* del se ai drejtpërdrejt përshfaqet në saktësinë e konceptimit dhe formulimit shkencor të lëndës gjuhësore mbi koncepte e termat gjuhësore, të tilla si: kategoritë leksiko-gramatikore (kuptimet dhe veçoritë e tyre përkatëse leksikore dhe gramatikore), funksionet sintaksore dhe rregullsitë gramatikore të tyre, kërkesat/ushtrimet dhe shembujt që formulohen qartë dhe me një saktësi shkencore të përshtatshme për nivelin e këtij lloj teksti për kohën.

Parimi i fushave konceptore, të reja edhe për tekstet e sotme, zbatohet lirshëm dhe thjesht në materialin që po analizojmë. Konceptet rimerren dhe lidhen midis tyre duke përfutur fusha konceptore. Kjo është shprehje e jo vetëm ngritjes shkencore të autores, por edhe të një lloj përvoja si hartuese tekstesh shkollore në përgjithësi.

Parimi i sipërpërmendur forcohet edhe më, me mënyrën koherente të trajtimit dhe shtjellimit të lëndës gjuhësore, koncepteve dhe termave gjuhësorë (gramatikorë) të përfshirë në tekst. Ajo dëshmon një tipar tjetër jo vetëm të natyrës shkencore, por edhe strukturore të një teksti (teksti një njësi e vetme, e lidhur nga pikëpamja semantike dhe strukturore).

Prej sa thamë, lind nevoja e qartësisimit të mënyrës dhe mjeteve gjuhësore e didaktike ku gjejnë shprehje e sendërtohen këto parime:

a. *Parimi didaktik* pasqyrohet para së gjithash në mënyrën se si është konceptuar e ndërtuar aparati pedagogjik i tekstit. Ai është i strukturuar në dy pjesë kryesore që paraprihen nga *Parathënia* dhe *Hyrja*. Në *Hyrje* parashtrihen në mënyrë të sintetizuar 4 çështje: a. *Gjyha* (gjuha si sistem dhe strukturë, edhe si mjet komunikimi); b. *Gjuha Shqip* (si dëshmi e trashëgimisë kulturore, lashtësisë dhe etnicitetit të kombit shqiptar); c. *Gramatika* (njohuria gramatikore e parë jo vetëm si kompetencë gjuhësore, por edhe si shprehje gjuhësore e komunikuese); d. *Të ndarit e Gramatikës* (*orthografi*/drejtshkrim, *etimologji*/morfologji, sintaksë dhe prozodi).

Pjesët e kësaj gramatike përbëhen nga krerë të veçantë. Pjesa e parë, e emërtuar *Njoftimet Paraprake Të Përgjithëshme*, përbëhet nga pesë krerë, si: *Fjalimetë*, *Rrjeshtat Edhe Të Përdorurit E Fjalëvet*, *Farët e Fjalëvet e Të Klasifikuarit e Tyre* etj. Që në fillim të kësaj pjese të bie fillimisht në sy sesi autorja e sheh gjuhën të pandashme nga mendimi, një qëndrim ky mjaft novator për kohën në të cilën është shkruar kjo vepër.

Konkretisht, teksa shtjellon koncepte dhe termat gjuhësorë, ajo ndalet edhe te ato logjikë. P.sh., *kafshë* (send), *idhe/të treguarit e idhevet* (ide), *mejtme/Të treguarit e mejtmevet* (mendime), *fjalë* (shenjë gjuhësore).

P.sh.: *Që të tregojmë idhetë t'ona, na përdorim fjalë.*⁴ Ose në përkufizimin *Fjalë quhetë shënja e një idheje, dhe ajo munt të flitetë ose të shkruhetë.*⁵

Në pjesën e dytë, lënda gjuhësore (gramatikore) zë një vend më të gjerë. Ajo është e konceptuar nën emërtimin “*Etimologjia*” (morfologjia) dhe përbëhet nga dhjetë krerë. Në to rimerren dhe trajtohen në mënyrë më të zgjeruar kategoritë leksikore dhe gramatikore, si: *emëri, nyjetë, miemëri, përemëri, foljetë, mifolje, parjetë, lidhjetë dhe thirrjetë* me veçoritë gramatikore përkatëse të tyre, si edhe rregulla për drejtshkrimin e tyre, me shënime për raste të veçanta përjashtuese.

Ato konceptohen dhe shtjellohen në mënyrë të përshkallëzuar, duke u rimarrë, zgjeruar me njohuri të reja përkatëse dhe të ndërthurura me njëra-tjetrën. Një shtjellim i tillë vërehet si te përbërësit e njëjësive mësimore, (rubrika të caktuara brenda një njësie), ashtu edhe në korpusin e shembujve ilustrues.

Sa për ilustrim sjellim si shembull fragmente të njëjësive të ndryshme mësimore, si edhe shembujve të ndryshëm në tekst:

Në pjesën e parë, emri trajtohet në këtë mënyrë:

Emërë quhetë një fjalë, që tregon një gjë të lëndtë ose të palëntë.

Kështu fjalëtë, gur, mal, shpirt, lumë, ëngjëll, thes, mjaltë etj., janë emëra.

Stërvitje. Tregoni cilët fjalë janë emëra në këto fjalime”

Skënderi fle në djept. Shiu ujit dhenë. Burimi është i kulluarë. Peshku është i kripurë etj.⁶

Ndërsa në pjesën e dytë rimerren, përsëriten dhe shtjellohen më gjerë njohuritë gjuhësore; parimi i njohur didaktik i rrathëve bashkëqendrorë.

Kështu, rimerret kategoria leksiko - gramatikore e emrit dhe shtjellohet më gjerë, duke u ndalur edhe në veçoritë gramatikore të tij, si: veta, numuri, gjindja/gjinia, rrënjë/rasa, të përkthyerit/lakimi etj.

P.sh.: **Emërë** quhetë një fjalë, që tregon një njeri, një shtëzë, a një gjë të lëntë a të pa-lëntë.⁷

Sa i përket shembujve që ilustrjnë përkufizimet mbi konceptet e termat përkatës gjuhësorë (gramatikorë), si edhe ushtrimet, si fjalët, ashtu

⁴ Dako, Q. S. *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare*, Manastir, Shtypëshkronja “Tregëtare Ndërkombëtare”, 1912, f. 9.

⁵ Po aty, f. 23.

⁶ Dako, Q. S. *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare,...*, 1912, f. 13

⁷ Po aty, f. 24.

dhe fjalitë, renditen duke respektuar parimin didaktik nga më të thjeshtat deri tek ato më komplekset qoftë si strukturë, apo dhe si përmbajtje.

Në pjesën e parë fjalët bartin në të shumtën e rasteve kuptim konkret dhe të drejtpërdrejtë. P.sh.: *libër, kalë, lule, bukë, bar, dru, kartë; vras, godit, shkruanjë, këndonj, burgos, thyej*, e në pak raste kuptim abstrakt e të figurshëm, si: *trim, mirësi, djalë i çkëlqyerë, i diturë* etj.

Ndërsa në pjesën e dytë përdoren fjalë me kuptim abstrakt e të figurshëm, si: *Të miretë (mirësia), të drejtën (drejtësia), e mirë, e ligë, i vyer* etj.

Fjalitë në pjesën e parë, nga pikëpamja strukturore, janë në më të shumtën e rasteve të thjeshta dhe konkrete semantikisht. P.sh., kuptimi i tyre ka si bërthamë bazën sendore-konceptore, përshkrime a konstatime të dukurive konkrete të rrokshme nga shqisat, si: *Zogu fluturon; Hëna perëndon; Dielli lind; Kali hingëllin; Shiu ujit dhenë, Manastiri është qutet i math; Plumbi është një metal i rëndë*, etj.; ndërsa në pjesën e dytë ato shprehin gjykime, këshilla; përdoren shprehje frazeologjike, shprehje të figurshme, fjalë të urta, etj., si: *Trim' i mirë me shok shumë; Folë pak e dëgjo shumë; Kurse kohënë; Fjalë shumë e gur në trastë; Përrindi duhetë të nderonetë; Shtëpinë e lart e tunt tërmeti më shumë; Burrat e mënçmë e duan mëmëdhenë.*

Gjithashtu, në pjesën e dytë, për njësi të caktuara mësimore shtohen përbërës të tjerë didaktikë, të tillë si: **rregulla (rregulla të përgjithëshme dhe të veçanta/rregulla drejtshkrimore, pikësimore⁸, shënime (përrjashtim nga rregulla) etj.**

P.sh., te *gjindja e emërit* (gjinia e emrit) pasqyrohen shtatë rregulla dhe dy shënime⁹. Gjithashtu, shtohet edhe përbërësit: **të përdorurit, të përhapurit, të çfaqurit, të klasifikuarit, të analizuarit etj¹⁰**, domethënë, ku gjejnë përdorim, dallohen/gjenden dhe analizohen kategori leksiko-

⁸ Në tekstin e S. Qiriazit, pasqyrohen rregulla për drejtshkrimin e fjalëve dhe rregulla të pikësimit. Ato jepen të integruara e të ndërthurura natyrshëm me njëra-tjetrën dhe e ndihmojnë nxënësin t'i kuptojë e t'i përdorë saktë ato në të folur e në të shkruar. P.sh. *Përdorni letër të madhe (shkronjën e madhe) për nisje të çdo fjalimi, për ç'do radhë vjershe... - Përkujdesuni, gjith kështu, të përdorni presje (,) pas ç'do lodhje të vogël. (f. II).*

⁹ Dako, Q. S. *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare*, Manastir, Shtypëshkronja "Tregëtare Ndërkombëtare", 1912, f. 28-29.

¹⁰ Konceptet dhe termat gjuhësorë e didaktikë konsiderueshëm janë marrë e ruajtur nga *Gramatika* e Samiut. Ato janë origjinale dhe dëshmojnë qëndrimin e autores për t'i përdorur shqip. Ky qëndrim mbështetet edhe nga fakti se vetë rilindësit ishin puritanë jo vetëm për fjalët me kuptim të përgjithshëm, por kryesisht për termat e formuara nga brumi i shqipes.

gramatikore në përputhje me veçantitë strukturore të shqipes.

P.sh. Të *Përhapurit dhe Të Analizuarit e Miemëravet*.¹¹ Apo Të përhapurit e Përemëravet.¹²

Ilustrimet me shembuj konkretë gjuhësorë (leksikorë a sintaksorë etj.) vijnë e bëhen edhe më kompleksë e të zgjeruar si për nga struktura ndërtimore, ashtu dhe nga përmbajtja gjuhësore. Përshkallëzimi, rimarrja dhe zgjerimi i njohurive bëhet në përputhje edhe me veçoritë e të menduarit dhe arsyetuarit, të gjykimit të moshave të ndryshme shkollore, duke përbushur në mënyrë intuitive dhe një parim tjetër, atë **psikolinguistik**. Ky parim mbështet edhe nga procesi i zhvillimit mendor të kësaj moshe, kalimi nga të menduarit konkret në atë abstrakt.

Mënyra e parashtrimit të njohurive gramatikore dhe asaj gjuhësore në përgjithësi, na duket se i jep dorë të lirë mësuesit në klasë. Kështu, kjo lëndë propozon përdorim metodash, teknikash e strategjish mësimore të cilat janë në funksion të përvetësimit të njohurive gjuhësore. P.sh., në parashtrimin dhe shpjegimin e koncepteve dhe termave gjuhësore, kategorive leksiko-gramatikore vihen në shërbim (përmenden) metoda të tilla si ato deduktive dhe induktive. Këto metoda hera-herës ndërkallen me njëra-tjetrën, në shtjellimin e lëndës gjuhësore sipas kombinimit: përkufizim-shembull apo shembull-përkufizim, kërkesa-ushtime. Ato shoqërohen me teknika mësimore, të tilla si: harta e koncepteve, brainstorming etj.

Zbatime të metodës deduktive dhe induktive.

- **Përkufizim.** Veta. *Ndë të folurit vëmë rë tri anë, të cilat quhen veta: folësi, dëgjonjësi edhe kafsha për të cilën flasimë.*

Ilustrimi dhe shpjegimi: Kështu, *Vasili po shkruan*. Unë që tregom se ç'bën *Vasili* jam *folësi*; *ti*, që dëgjon atë që thom për *Vasilin*, je *dënjosi*; edhe *Vasili*, është kafsha për të cilin flas; d.m.th. vet' e parë tregon *folësin*, vet' e dytë tregon *dënjosin*; dhe vet' e tretë *kafshën* për të cilën flasimë.¹³

Ose Të Përdorurit e Rrënjëvet. Renja *quanjëto* përdoret gjithnjë si një subjekt i një fjalimi. Shëmb. **Lulja është e veniturë.**

- Të Përhapurit ose Të analizuarit e Miemëravet

Shembëllë. Le të përhapet miemëri, që pushton fjalimi: Çup' e mirë dëgjon përrindërit.

Fjala *e mirë* është një *miemërë* sepse tregon çfarjen e emrit *çupë*.¹⁴

¹¹ Dako, Q. S. *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare*, Manastir, Shtypëshkronja "Tregëtare Ndërkombëtare", 1912, f. 49.

¹² Po aty, f. 55.

¹³ Po aty, f. 16

¹⁴ Dako, Q. S. *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare*, Manastir, Shtypëshkronja

Këto metoda, strategji dhe teknika mësimore janë të larmishme. Përvoja e S. Qiriazit, kryesisht si mësimdhënëse, e bën të qëllimshëm përdorimin e tyre, jo thjesht në aspektin didaktik, si këshillime për mësuesin e kohës. Njohuritë e marra nga ky tekst shkollor u japin nxënësve jo vetëm dije për një fushë të caktuar të shkencës së gjuhësisë por, fakt i njohur tashmë, u mësojnë realisht gjuhën shqipe si mjete i rëndësishëm i komunikimit, si mjete që mundëson të shprehurit qartë e bukur shqip si në të folur e në të shkruar.

b. Sa i përket *parimit gjuhësor*, ai ka të bëjë me përshtatjen e gjuhës së tekstit me moshën e nxënësve për të cilët është shkruar teksti shkollor. Në këtë gramatikë, ky parim gjen shprehje në mënyrën sesi autorja zgjedh fjalë e shprehje më afër ligjërimit të fëmijës, për t'ia sjellë me qartë e më të kuptueshëm lëndën gjuhësore (f.v. leksikore e gramatikore). Kjo vlen jo vetëm për shtjellimin teorik të kësaj lënde, por edhe atë praktik (zbatues). Kështu, shembujt ilustrues përzgjidhen nga ligjërimi i folur, mjedisi gjuhësor i fëmijëve, dhe bartin e përçojnë edhe vlera pragmatike.

Me pak fjalë, përkufizimet dhe ilustrimet i shkojnë për shtat fjalorit dhe gramatikës jo vetëm të shqipes, por edhe të vetë fëmijës. Janë të thjeshta, nxisin intuitën dhe kureshtjen e tyre gjuhësore, dhe përmbushin qëllimin didaktik të këtij teksti.

P.sh.: *Fjalët, që përdorim për të treguarë një mejtim të plotë bëjnë një fjalim*¹⁵.

Parja (parafjalët) janë ca fjalë, të cilat vihenë përpara emëravet për të ngjiturë këto me foljet¹⁶.

Thirrja është një fjalë a një zë, që rrëfen gas, helm, çudi, etj.¹⁷

Teksti të krijon idenë e një loje gjuhësore, gjë që e shpëton fëmijën nga ngërçi i abstraktimit për përkufizimin e koncepteve dhe termave gjuhësorë duke ia sjellë qartë e thjeshtë, pa e bjerrë vlerën shkencore të tyre.

P.sh., **Nyjet** janë ca fjalë të vogëla të cilat përdoren bashkë me emërat, miemërat edhe përemërat, për t'i çquarë këto.¹⁸

Ose, **Rrokje** quhet një a më shumë shkronja, të cilat i rrëmben gjuha edhe i flet përnjëherësh.¹⁹

“Tregëtare Ndërkombëtare”, 1912, f. 49.

¹⁵ Dako, Q. S. *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare*, Manastir, Shtypëshkronja “Tregëtare Ndërkombëtare”, 1912, f. 10.

¹⁶ Po aty, f. 24.

¹⁷ Po aty, f. 24.

¹⁸ Po aty, f. 41.

¹⁹ Po aty, f. 22.

Shembujt ilustrues merren edhe nga situata konkrete ligjërimore, si: p.sh., *Tregoni përemërat në këto fjalime: Ay ka ardhurë. Unë jam ay që kërkoni; Ata do të kthenënë në shtëpi; Ku është ajo?; Unë do të vete në shtëpi; Syt' e tu janë të mavi.*²⁰ Në këtë kontekst veç funksionit metagjuhësor, përmbushet edhe funksioni pragmagjuhësor.

Edhe kërkesat/ushtimet (stërviçet) janë formuluar qartë gjuhësisht. Ato ndërtohen me anë të fjalive të shkurtra, me qëllime udhëzuese, orientuese, zbatuese etj. Foljet kyç që mbizotëron në to janë *tregoj dhe shkruaj*. Përdorimi i tyre nuk bart vetëm qëllimin didaktik, por edhe qëllimin pragmatik, pra, të formojë e zhvillojë edhe shprehi gjuhësore e komunikuese.

P.sh.: *Tregoni cilat janë miemërat në këto fjalime.*²¹

Ose: *Shkruani pesë fjalime thënëse, pesë urdhëronjëse, pesë pyetëse dhe pesë çuditëse.*²²

c. Lidhur me *parimin shkencor*, vërehet një përpjekje për t'u kujdesur në përkufizimin e saktë shkencor të koncepteve dhe termave gjuhësorë, kategorive leksikore e gramatikore, funksioneve të tyre sintaksore. Edhe shembujt ilustrues ku gjejnë zbatim ato, reflektojnë këtë përkujdesje.

Në një tekst prej 100 faqesh përkufizohen rreth 243 koncepte e terma gjuhësorë. Përmendim disa syresh: *fjalë, fjalim* (fjali), *farët e fjalësë* (pjesët e ligjëratës), *të klasifikuarit e fjalimeve, fjalim thënës, pyetës, çuditës, urdhëronjës, emëri, gjindja* (gjinia), *formë e çquarë dhe e paçquarë* (trajta e shquar dhe e pashquar), *subjekt* (kryefjalë), *nyja, mifolja* (ndajfolja), *folja, predikat* (kallëzues), *foljet ngasëse dhe mosngasëse* (kalimtare dhe jokalimtare), *etimologjia* (morfologjia), *zërat* (tingujt/fonemat), *rrënjë* (rasa), *llojet e rrënjëve* (*quanjëto* /*nominativ/emërore, pjellto* /*gjenitiv/gjinore, dhënëto* /*dativ/dhanore* etj.), *përthesa* (lakimi dhe zgjedhimi), *përemërat gjëtregonjës* (pronorë), *përemri përmendës* (lidhor), *mot* (koha e foljes), *parjetë* (parafjalët), *lidhjetë* (lidhëzat), *thirrjetë* (pasthirrat) etj.

Këto koncepte e terma ajo nuk i krijon vetë, por një pjesë të konsiderueshme të tyre i merr të gatshme prej Gramatikës së Samiut²³ dhe i përdor lirshëm, dhe kryesisht në funksion të qëllimit didaktik të veprës, më shumë sesa të atij studimor. Kjo tregon se Gramatika shkollore e saj është në vazhden e punës së kryer më parë nga rilindës shkencëtarë dhe

²⁰ Dako, Q. S. *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare*, Manastir, Shtypëshkronja "Tregëtare Ndërkombëtare", 1912, f. 14.

²¹ Po aty, f. 13.

²² Po aty, f. 11.

²³ Frashëri, S. *Shkronjëto e gjuhësë shqip*, 1886.

specialistë të kësaj fushe: të tekstologjisë dhe të gramatologjisë.

Duke i qëndruar besnike objektivit kryesor të tekstit shkollor, S. Qiriazit lë “t’i shpëtojë” edhe ndonjë ngërç përkufizues që hahet në terminologjinë e përdorur, pavarësisht orientimit shumëplanësh mbi gjedhet e gramatikës së S. Frashërit dhe ndonjë tjetër në po këtë hulli.

Ky parim gjen zbatim edhe në ruajtjen e një farë koherence gjatë përkufizimit dhe shtjellimit të këtyre koncepteve e termave gjuhësorë, rimarrjes hera-herës, integritit dhe shtjellimi më të gjerë të tyre, ilustrimit të tyre me shembuj. Në këtë mënyrë ruhet jo vetëm një linjë konceptore, por edhe përftohen fusha konceptore.

Kjo ndihet si në aspektin shkencor, por edhe në atë didaktik e gjuhësor përgjatë gjithë tekstit.

P.sh.: *Subjekti i një fjalimi është fjala, që tregon kafshën, për të cilën bëjmë fjalë.* Kështu, në fjalimin: **Përingdi duhetë të nderonetë**; fjala **përingdi**, është subjekt’i fjalimit, sepse tregon, atë, për të cilën flasëmë.

Predikati i një fjalimi tregon atë, që flitet për subjektin. Kështu, në fjalimin: *Pemëtë janë të tharta*; fjalëtë, **janë të tharta**, është predikati i fjalimit t’onë, sepse tregon atë, që flitet për subjektin **pemëtë**.²⁴(f.12)

Saktësia dhe qartësia, vërehet edhe te shpjegimi i ndërrimit të kategorisë leksiko-gramatikore. Ato përlligjen edhe prej shembujve ilustrues. P.sh, dallimet midis mbiemrit dhe ndajfoljes jepen saktë e qartë si në përkufizim, edhe në përdorim. *Miemërat bëhenë nga mifolje qyshje, duke marë nyjen në krye edhe shkronjën ë në fund. Mifolje (urtë) – Miemëra (i-urtë).*²⁵

Në përfundim të kësaj analize mund të thuhet pa mëdyshje se arritja e qëllimit didaktik, i jep vlerë të veçantë kësaj gramatike, si një prej gramatikave të para shkollore të kohës. Për fëmijët e kësaj moshe shkollore do të vijonte të hartoheshin e gramatika të tjera të këtij lloji, që patën si model edhe tekstin shkollor të S. Qiriazit.

Gramatika e Qiriazit meriton të përmendet edhe për shërbimin patriotik që kreu në periudhën në të cilën u hartua, për ndihmesën që u solli shqipfolësve për ta ruajtur e trashëguar gjuhën shqipe, si të vetmen armë ndaj rrezikut të asimilimit dhe të ruajtjes së identitetit kombëtar.

²⁴ Dako, Q. S. *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare*, Manastir, Shtypëshkronja “Tregëtare Ndërkombëtare”, 1912, f. 12.

²⁵ Po aty, f. 48.

LITERATURA:

1. Dako, Q. S. *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare*, Manastir, Shtypëshkronja "Tregëtare Ndërkombëtare", 1912
2. Frashëri, S. *Shkronjëtorë e gjuhësë shqip*, 1886.
3. Qiriazi, S. *Jeta ime. Jetëshkrimi i pabotuar i "Mësueses së popullit" Sevasti Qiriazi Dako*. Botim i Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante. Paperback – October 23, 2016.

On of some distinguishing features of the textbooks of S. Qiriazi**ABSTRACT**

Sevasti Qiriazi, besides being a patriot dedicated to national issues during the Independence period, is a well-known name in the field of Albanian education and the compilation of school books. She taught for 19 years as a teacher of girls' school in Korça and attended the "Congress of Manastir" (1909), as a member of the commission for reviewing the textbooks of the association "Përparimi".

In the field of grammar and especially school-based grammar, Sevasti Qiriazi is mentioned as one of the first authors with the text *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare* (Elementary Grammar for Primary Schools)" (1912). This text was designed mainly based on the grammar of S. Frashëri, *Shkronjëtorë e gjuhësë shqip* (The Albanian Language Letter) (1886), as well as having didactic and scientific models even other previous texts since the early Renaissance. We can mention some of them: *Gramatika e gjuhës shqipe* of K. Kristoforidhi (1882); *Shkronjëtorja e gramatika shqip* of Sh. Kolonja (1903); *Gramatika e gjuhës shqipe* of Gj. Pekmezi (1908); *Gramatika shqyp* of A.Xanoni (1909); *Gramatikë e shkurtër e gjuhës shqipe* of A. Buzeti (1910) etc.

The main **aim** of our article is to review of a *distinctive feature of texts compiled by Sevasti Qiriazi: Qartësia* (Clarity). For this we have focused more on Elementary Grammar. This feature, as well as other or distinctive features, were addressed in regard of the application of the various principles of drafting a textbook, such as didactic, linguistic and scientific.

The followed **methodology** is: collection, analysis and interpretation of the language subject. *Elementary Grammar* of S. Qiriazi performed a precious service at the time, not only for learning Albanian in elementary schools but also for preserving and spreading it from all Albanians.

Key words: school grammar, school age, distinctive feature, principles of drafting textbooks.

Matilda ÇOLLAKU

DISKURSI I LUIGJ GURAKUQIT – DËSHMI E ÇMUAR E VLERAVE TË KOMISISË LETRARE

Hyrje

Në fokusin e kësaj trajtесе është vendosur studimi i ligjëritimit parlamentar të deputetit Luigj Gurakuqi për periudhën kur ai ka qenë përfaqësues i popullit të Shkodrës në Këshillin Kombëtar (Parlamentin) gjatë viteve 1920-1924. Korpusi i studiuar përfshin vëllimet e Bisedimeve parlamentare të botuara me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, duke ruajtur formën origjinale të tyre në Këshillin Kombëtar të asaj periudhe. Ky këndvështrim u shtohet vlerave të tij tashmë të njohura si iniciator, bashkëpunëtor, nxitës dhe drejtues i Komisionit Letrar Shqipe.

Nuk ka qenë e rastësishme pjesëmarrja e Luigj Gurakuqit në këtë tubim, ndonëse nuk ishte në nivelin e Kongresit si ai para tij (i Manastirit më 1908), e as si ata pasues (i Lushnjës 1920, i Drejtshkrimit 1972 etj.).

Ai vinte në këtë Komision nga një angazhim i së njëjtës natyrë në Kongresin e Manastirit, para organizimit të të cilit ai kishte shprehur shqetësimin për mosarritjen e marrëveshjes për alfabetin: “... ende nuk po merremi vesh për t`u bashkuar në mënyrë të shkrimit”¹ (të cilën e ka shkruar me alfabetin e shoqërisë “Agimi”, ndërkohë që ndër dy alfabetet e tjerë ai zgjodhi të përdorte në veprat dhe në letërkëmbimet e veta atë të Stambollit dhe jo atë të shoqërisë “Bashkimi”) me të njëjtin synim, atë të zgjedhjes e përdorimit të një mjeti të përbashkët komunikimi, më parë alfabetit e tashmë të vetë gjuhës së “përbashkme”.

Në kuadër të 100-vjetorit të këtij Komisioni, rregullat e të cilit hodhën bazat e gjuhës së njësuar, kush më mirë se vetë universiteti që mban emrin e drejtuesit² të Komisionit Letrar do ta ngrinte në lartësinë që i takon, siç ka vepruar edhe me rastin e 80-vjetorit të saj (tetor 1996).

Por, për pozicionin e tij si deputet, si mbrojtës i interesave të popullit në sallën e diskutimeve e debateve për çështje që lidhen drejtpërdrejt me të dhe me impaktin më të rëndësishëm për publikun të cilit

¹ Cituar sipas T. Osmanit, në *Histori e alfabetit të gjuhës shqipe*.

² L. Gurakuqi u zgjodh drejtues i Komisionit pas Gj. Pekmezit.

i drejtohet, nuk është folur.

Me anë të risjelljes këtu të disave prej pjesëve nga ligjërimet e tij të asaj periudhe do të kemi mundësi të njohim, jo vetëm mënyrën e paraqitjes grafike të tekstit me të cilin ai u është drejtuar kolegëve në sallë, e nëpërmjet tyre të gjithë lexuesve, të atëhershëm e të sotshëm të këtyre ligjëratave, por edhe këndvështrimin e tij social e politik për fatin e vendit në një periudhë aq të rëndësishme për të.

Vlerat e Komissisë Letrare dhe roli i L. Gurakuqit

Duket se qëllimet që Komisia i vuri vetes, siç ishin “*aratimi i gjuhës shqipe e zhdrivillimi i letraturës së sajë*”, “*të ndrequn t`drejtë e t`arsyeshëm t`orthografisë e për sa mundet, për të dy gojë të shqiptare*”; “*të bâmit e një gjuhe të përbashkme të administratës*”, i ka arritur duke mbajtur parasysh edhe propozimet e bëra për arritjen e tyre nga Gj. Pekmezi, Gj. Fishta dhe duke zbatuar sidomos atë të L. Gurakuqit: “*Tue qenë se djalekti i Elbasanit edhe ndën pikëpamjen e formavet, por sidomos ndën pikëpamjen e sintaksës âsht si një urë në mes të toskërnishtes e të gegënishtes, duhet të zgjidhet si gjuhëshkrimi me ato rregulla orthografike qi të na duken të drejta e t`arsyeshme.*”³

Vlerat e Komissisë Letrare shqipe janë vënë në dukje në mënyrë të veçantë në monografinë e T. Osmanit⁴, por edhe në konferenca shkencore të organizuara në përvejtore të themelimit të saj, si edhe nga autorë të tjerë siç është Fadil Raka⁵, i cili, pasi kujton se në përbërjen e Komissisë ishin vetëm S. Peci nga Korça dhe A. Xhuvani nga Elbasani dhe pjesëmarrësit e tjerë ishin shkodranë, nxjerr në pah faktorin gjuhësor (rolin e elbasanishtes si e folme që i bashkon dy dialektet) që iu shtua atij gjeografik.

Ndërthurja e parimeve fonetike me ato morfologjike dhe respektimi i etimologjisë së fjalëve që vinin nga secili prej dialekteve (kryesisht atij tosk) ngritën në normë të gjuhës së shkruar vlerat më të mira të secilës prej formave të folura të dialekteve, mbi të cilat u mbështetën këto norma dhe hartuesit e miratuesit e tyre.

Pavarësisht kundërshtimeve në të cilat hasi propozimi për zgjedhjen e të folmes së Elbasanit si bazë për drejtshkrimin e gjuhës shqipe, së bashku me përmirësimet që iu bënë ajo arriti të qëndronte normë e të

³ Cituar sipas B. Becit në *Historia e standardizimit të shqipes, politika dhe planifikimi gjuhësor në shkollë*, SHBLSH e re, Tiranë, 2010, f. 48.

⁴ *Komisia Letrare shqipe në Shkodër (1916-1918)*, Shkodër, 2004.

⁵ F. Raka, *Rreth teorive për mundësinë e formimit të gjuhës së njësuar letrare shqipe*, në *Filologji*, nr. 8, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2000, f. 44.

zbatohet si gjuhë e standardizuar, me gjithë përdorimin paralel të varianteve të toskërishtes dhe shkodranishtes.

Përparësia e Luigj Gurakuqit qëndronte pikërisht në faktin që të folmen e Elbasanit që u propozua të ishte në bazën e ortografisë që do të ndihmonte afrimin e dy dialekteve, që pavarësisht se mund të mos ketë qenë më e mira, së paku ka qenë zgjidhje praktike dhe me vlerë për kohën, e njëjtte më mirë se anëtarët e tjerë të Komisionit, falë mësimdhënies së tij në këtë qytet dhe pozitës administrative në drejtim të një institucioni arsimor aq të rëndësishëm për kohën siç ishte Normalja e Elbasanit.

Por, këtij *habitydi* të të folurit (në të dyja variantet e njohura prej tij) i shtohet fatmirësisht gatishmëria për të ruajtur të paprekur formën e shkruar të shkodranishtes së ngulitur tashmë, nga veprat e veta dhe të bashkëkohësve të vet e shkrimtarëve shkodranë më prodhimtarë, duke u “hapur derën” përmirësimeve kryesisht në aspektin fonetik, që propozoheshin nga Komisioni Letraro.

Pikërisht ky fakt theksohet edhe në pasazhin e mëposhtëm, të shkëputur nga korpusi i marrë në shqyrtim nga vëllimet e Bisedimeve: “... gjithçila mbretënië tue ditë qi bashkimi i gjuhës kombtare rrjedh vetëm prej shkollës e kanë vue mâ të madhen fuqië shkollave. Tue u pasë ndodhë Elbasani në kërthizë të Shqipnisë dhe tue u pas pranue dialekti i atij vendi në gjuhë zyrtare, se parandej tue rrëfyë se kjo shërben edhe atyne qi nuk e kanë vahtin me i çue fomit ndër shkolla t`Europës, më një anë tjetër edhe të përnjisuemit të dialektit qi asht pranue për gjuhën zyrtare.”⁶

Për figurën shumëdimensionale të L. Gurakuqit janë dhënë vlerësime edhe nga N. Gokaj⁷, i cili vë në dukje sidomos përpjekjet e tij të pareshtura për njësimin e gjuhës shqipe, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive, me mendime, diskutime, propozime e këshilla në të gjitha takimet e rëndësishme që u organizuan për këtë qëllim deri në vitin 1925: “Gjuha e përbashkët, për të cilën duem me punue, do të rrjedh prej dialekteve ma të mëdhenj të Shqipërisë e nuk do të jetë tjetër veç të afriturit e të derdhurit e tyre në një.”⁸

⁶ Bisedimet e Këshillit Kombtar, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1920, f. 133, botuar sipas origjinalit në Bisedime Parlamentare, Tiranë, 2012.

⁷ N. Gokaj, Luigj Gurakuqi – lëvrues dhe studiues i shquar i gjuhës shqipe (1879-1925), në *Gjuha Jonë*, 1984/2, f. 97: “Njësimi i gjuhës vështrohet si njësim i kombit ose, siç do të shprehet Gurakuqi “Gjuha asht batori ma i madh i kombësisë, dëftuesi ma i lartë e skaji ma i qartë i njësisë e i bashkimit të një populli [...] të ndihemi vetëm shqiptarë, as toskë, as gegë.”

⁸ Po ai, po aty, f. 100.

B. Beci⁹e ka veçuar L. Gurakuqin ndër pjesëmarrësit e Komissisë që propozoi zgjedhjen dhe ruajtjen e një dialekti duke shprehur, në emër edhe të anëtarëve të tjerë edhe mendjehaptësinë ndaj përmirësimeve dhe neutralizimit të ndryshimeve mes dy dialekteve.

Në Fjalorin Enciklopedik shqiptar¹⁰, L. Gurakuqi paraqitet si lëvruer i poezisë lirike dhe prozës së shkurtër, si publicist, luftëtar e udhëheqës, drejtues institucionesh arsimore dhe arsimdashës si rrallëkush.

S. Riza, pavarësisht keqardhjes që letërsia e Shkodrës dhe Toskërisë nuk kanë përbërë një sistem dy enësh “komunikante”, por dy sisteme të veçanta pa lidhje me njëri-tjetrin, i jep vlerat që meriton dhe që janë theksuar tashmë edhe nga jo vetëm gjuhëtarë, Luigj Gurakuqit dhe përpjekjes së tij për njësimin e gjuhës shqipe.

“Paradoksalisht mund të thuhet madje se në krye shkrimtarët Toskë t’Italisë do të kenë qënë ata që në botën e veçume të vilajetit të Shkodrës do të kenë zgjuar ndonjë interesim për letërsinë popullore dhe dijtunore të Toskëve të Shqipnisë. Këtu është prandej për t’u kujtue me një adhurim të përvujtë, me një miradijeje të gjunjëzue fushata afërimitare midis Toskënisë dhe Shkodrës e ndërmarrun prej të ndjerit Luigj Gurakuqit, i pari Shkodran i madh që merr përsipër mundimin jo të vogël me mësue mirë toskërishten dhe me njoftë sakt Toskëninë dhe që gjatë një jete mendim-këthielltë dhe punë-mbrodhtë u dëshmue si në lëmën e kulturës tosکو-gegë dhe të gatitjes së shqipes së bashktë ashtu edhe në lëmën e politikës së jashtme t’irredentismës Shqiptare dhe të mbrendëshme të vllazënimit interkonfesional, kryeapostull i panshqiptarismës.”¹¹

Luigj Gurakuqi ligjërues në Parlament

Gjatë periudhës që L. Gurakuqi ka qenë deputet i Shkodrës në Këshillin Kombëtar¹² 1920-1924, që është konsideruar si periudha e fillimit të demokracisë parlamentare, thelbi i së cilës qëndron në realizimin e vullnetit të shumicës së qytetarëve nëpërmjet institucioneve dhe trupave

⁹ *Historia e standardizimit të shqipes, politika dhe planifikimi gjuhësor në shkollë*, SHBLSH e re, Tiranë, 2010, f. 49 - 50.

¹⁰ Fjalori Enciklopedik shqiptar 1, ASHSH, Tiranë, 2008, f. 798.

¹¹ S. Riza, *Vepra të zgjedhura*, ASHSH, QSA, Shtypshkronja “Kristalina KH”, Tiranë, 2009, f. 152.

¹² *Organi më i lartë i pushtetit legjislativ i zgjedhur nga Kongresi i Lushnjës në vitin 1920 që përbëhej në fillim nga 37 anëtarë dhe kryente funksionet e parlamentit. Pas zgjedhjeve të para Këshilli Kombëtar i rifilloi punimet me 78 deputetë, më 21 prill 1921 dhe u shpërnda më 30 shtator 1923, pas të cilave u emërtua Asamble Kushtetuese. Shih FESH, ASHSH, Tiranë, 2008, f. 1165-1166.*

përfaqësuese dhe që është forma dominuese e qeverisjes sot¹³, vendi ynë ndodhej ende nën ndikimin e ngjarjeve të rëndësishme historike, siç ishte shpallja e Pavarësisë dhe situata e krijuar në vend pas ndarjes së kufijve etj., dhe atyre gjuhësore, Kongresi i Manastirit, Komisia Letrare, Kongresi i Lushnjës, në të cilat L. Gurakuqi ka qenë pjesëmarrës aktiv si drejtues institucionesh dhe propozues zgjidhjesh të argumentuara.

Edhe pse formimi i L. Gurakuqit nuk ishte për gjuhësi a për letërsi, vetë dëshira për të ndihmuar në ngulitjen e përdorimin e një gjuhe sa më të pastër e njësuar, dëshira që vendi i tij të përparonte në rrugën e dijes dhe njohuritë rreth gjuhës frënge e motivuan të shkruante, përveç shkrimeve letrare apo artikujve e letërkëmbimeve, edhe një alfabet¹⁴ dhe një fjalor¹⁵ ku do ta rendiste gjuhën shqipe krahas me atë frënge, nga e cila përktente herë pas here edhe ndonjë material zyrtar për parlamentin.

Pozicionet zyrtare dhe administrative që kishte mbajtur në periudha të ndryshme si drejtues i Normales së Elbasanit dhe si ministër i arsimit (dy herë në qeveri të ndryshme) e kanë ndihmuar t'i orientonte përpjekjet e tij të qarta dhe konkrete në funksion të ngritjes së shkollave shqipe dhe të hartimit të teksteve.

Ndër diskutimet në seancat plenare ku ai e ka marrë fjalën shumë shpesh, por sidomos për çështje të arsimit¹⁶, qoftë si diskutant, qoftë si oponent, i kanë dhënë diskursit të tij më shumë forcë ndikuese dhe e kanë bërë më ndërveprues. Kjo vihet re në referimin që u bëhen diskutimeve të tij, jo vetëm nga ministrat që thirren në interpelancë për çështje të përcaktuara që në seancat e mëparshme, por gjithashtu edhe në diskutimet për buxhetin etj.

Karakteri i orientuar i diskursit të tij del qartë nga natyra informuese dhe këshilluese që u jep diskutimeve jo të shkurtra: *“Nji njeri qi flet përpara nji shumice populli, a të jetë ndë nji sallë universiteti a në krye të nji meetingu apo mbrenda në dhomë të parlamentit, mund t'i caktojë vetes së vet tri qëllime. Njeriu mund të flasë pra, ase për të nxjerrë në shesh vetëm e vetëm të vërtetën; ase për t'u mbushun mendjen ndëgjuesvet mbi*

¹³ Y. Bufi, Tempulli i demokracisë, Ombra GVG, Tiranë, 2010, f. 152.

¹⁴ L. Gurakuqi, E Cremonesi, *Tufë lulesh*, Napoli, mars 1901.

¹⁵ L. Gurakuqi, *Fjalorth shqyp-frângisht e frângisht -shqyp i fjalëve të reja*, Napoli, 1906.

¹⁶ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1922/1, f. 108-109: *“Në pakë fjalë them se nuk jena të zottë t'i bajmë ballë analfabetizmit nga mungesa e mësuevet t'afte e ndërtesavet shkollore, [...], se ... kemi 392 mësues të cilët kan krye vetëm shkollat fillore të vjetra në gjithfarë gjuhësh e 192 mësues të tjerë që kanë mbarue nji shkollë qytetse, pse, për këtë degë (arsimin) nuk duhet me kursye kurr gja, e duhet të përdorim gjith fuqit t'ona për zhvillimin e saj”*.

parimet e së vërtetës qi u nxuer në shesh; ase në fund, për të bindun të tjerët e për t'i këthym në mendje të vet tue i tërhekun qi të ndjekin parimet e vullnetin e tij."¹⁷ Të paraqitura si formulime teorike se çfarë nënkupton, sipas tij një ligjëratë para auditorit të disallojshëm, këta rreshta ngjallin kureshtjen e dëgjuesit dhe lexuesit për atë çka vjen më pas dhe i japin një ton të veçantë përmbajtjes së formuluar mbi bazën e një logjike komunikimi, vijimi i së cilës përmban një informacion edhe më të rëndësishëm në lidhje me çështjen në diskutim: "*Sa për vete, po e thom që tashi se nuk kam as një shpresë qi të mund t` arrij qëllimin e tretë; [...] Në bisedën t`ime do të përpiqem qi të jem sa ma tepër i paanshëm; do të mirrem me punë e jo me persona, ashtu si i ka hije një kundërshtari të drejtë e të haptë.*"¹⁸

Në një këndvështrim më të gjerë ligjërimi parlamentar, si një formë e veçantë e ligjërimit politik është një fjalë publike e kontekstualizuar, e mbajtur në një mjedis publik, për nga numri i dëgjuesve, si edhe më i gjerë akoma për publikun të cilit i drejtohet nga ai auditor. Dhe pikërisht këto e bëjnë më aktual ligjërimin e L. Gurakuqit, që na vjen nëpërmjet këtyre vëllimeve të Bisedimeve Parlamentare nga Këshilli Kombëtar i periudhës që ai ka qenë deputet.

Si njohës dhe përdorues mjaft i mirë i të dy dialekteve, pra i formës së folur të gjuhës dhe zbatues korrekt dhe pa rezistencë i rregullave të Komisionit Letrare, ai ka arritur të transmetojë, te publiku i synuar të cilit i drejtohet, jo vetëm anën shoqërore të ligjërimit të vet, por edhe njohuritë e tij gjuhësore, për formën e shkruar të të cilave, ai ka marrë pjesë aktivisht për të përzgjedhur si më të përshtatshmin për kohën, variantin e dialektit të Elbasanit me përmirësime, me të cilin më pas ranë dakord pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në Komisi.

Duhet theksuar që, për shkak të transkriptimit dhe zbardhjes që u është bërë ligjëratave të asaj periudhe, është e kuptueshme humbja e ndonjë theksi në të shkruar apo ndonjë gabim në ortografi që mund t'i ketë "*shpëtuar*" syrit të administratës, pavarësisht detyrimit ligjor për t'i zbatuar rregullat e Komisionit.

Vlerat gjuhësore të ligjërimit të L. Gurakuqit

"Nëse lexon një libër të vjetër, është njëlloj sikur të lexosh gjithë kohën, që prej ditës kur libri është shkruar." (L. Borbes) Këtë ndjesi na

¹⁷ *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*, shtypshkronja "Nikaj", Tiranë, 1922/1, f. 514.

¹⁸ *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*, shtypshkronja "Nikaj", Tiranë, 1922/1, f. 514.

japin ligjërimet e L. Gurakuqit që në vitin 1920 (të riprodhuara në mënyrë të përpiktë nga materialet origjinale të asaj periudhe) teksa i lexojmë sot, me qëllimin e njohjes së anës gjuhësore të tyre. *Më ngarkoi t'ju baj me dijtë se lipset të...; la lerë të lirë të vijë në kontakt me...* 1922/1, f. 79.

Për Komisinë Letrare në këto diskutime lexojmë të trajtuar një nga çështjet që kishte ajo qëllim, hartimin e teksteve “*Ministrit e përparshme për t'a plotsue kët nevojë patën përtrimuun Komisinë Letrare qi pat kenë ngreh qysh në kohë të pushtimit austr. magjar. Kjo komisi fillon prap veprimin e vet në fillim të motit qi kalon e veç punve tjera qi janë caktue mas një program qi ju dha e kemi sot të botuem një abetare për shkollat e Shqipnisë jugore; libri i dytë i këndimit gjithnji për ato shkolla gjindet në Vlonë nën shtyp: libri i tretë është gati. Për shkollat e Veriut e të Jugut gjinden gati për t'u shtypun libri i II, i III, i IV, e i V.*”¹⁹

Po bâhen dy herë qi z. Vinjau foli mbi mjeshtërin e fjalve të mija tue karakterizue si një sfrytim mbi santimentin patriotik për të kthyer opinionin publik. 1921, f. 596

Përdorimi i emrave si tipar karakteristik i stilit libror, gjendet natyrshëm në ligjërimin e L. Gurakuqit. Ndër ta, janë shumë të shpeshtë emrat prejfoljorë, sidomos ata të formuar me prapashtesën *-im*. Kështu gjejmë brenda të njëjtit paragraf: *kuptim, peshim e gjykim, sharje e qortim, bisedim, veprim.*²⁰, të cilat pavarësisht se e bëjnë paksa të rënduar fjalinë, nxjerrin në pah karakterin e diskutimit.

Karakterin formal i tekstit shfaqet nëpërmjet përdorimit të fjalive të ndërlikuara, shpesh mjaft të gjata dhe me një rend të anasjellë, ndonjëherë, çuditërisht, shprehës. Zbërthimet e grupeve emërore janë karakteristike për gjuhën e folur të tij duke sajuar herë pas here një ndërthurje mes stilit libror dhe atij administrativo-shtetëror: “*Kur në muej të shkurtit të kaluem, Ministri i arësimit na kishte bamun një parashtrësë të gjatë mbi gjendjen e shkollavet t`ona e mbi masat qi kishte ndër mend me marrë për përmirsimin e tyne, unë pata rasë me i çmuem si duhej qëllimet e tija dhe mprojta me nxehtësi masat qi ai propozonte.*”²¹

Tiparet e veçanta të gjuhës së ligjëratave parlamentare të L. Gurakuqit, të ndikuara jo pak herë nga fryma e letrarit Gurakuqi: “*S`mund të shkoqiten veç e veç dhe duhet të bisedohet mâ parë e ama, jo e bija*”²² “*Komisia, mbas bës së bame, mbet në dyshim dhe la këtë çashtje pa*

¹⁹ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1922/1, f. 100.

²⁰ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1922/1, f. 514.

²¹ Po aty, f. 524.

²² *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1922/1, f. 429.

e vendue (pa marrë vendim për të)”²³ *I jap besën qi nuk jam kundra tij, po vetem due të nxjeri një të drejtë në shesh.*²⁴ *Ma e para detyrë e atyne q`i thonë vetes përfaqësues të popullit, pjesëtarë e mprojtës të fuqisë ligjvuese asht t`i shtrohen dhe t`a respektojnë ligjin.*²⁵ Siç tregojnë edhe shembujt e sjellë më sipër, gjuha e ligjëratave parlamentare të L. Gurakuqit është dëshmi e qartë e besnikërisë së tij ndaj vendimeve të Komisionit Letrare dhe e ndërthurjes së tipareve të të dy dialekteve dhe me ruajtjen e theksave e të zanoreve hundore, ruajtjen e bashkzânorevet **mb, nd e ngj** e dyzânoreve **ie, ue, ye**, me ruajtjen e –ë–së në mes e në fund të fjalës a me ndërtime tipike të formave foljore të gegërishtes veriperëndimore “Ky paragraf **të rrinë** ashtu si asht”²⁶ Mbi ket mund të nap spjegime un, tue kanë se...”²⁷ “... *Nuk e shof orportun qi të bisedohet kjo punë për deri sa ato mos të kenë arth në shkallë qi të kërkojnë të drejtën e tyne vet.*”²⁸

Tipike janë formulat e fillimit të fjalimeve/diskutimeve:

Kurrë na një herë s`kam qenë kaq i gëzuem se si sot se (Parlamenti shqiptar ka arie të marrë në konsideration për me nxjerrë në shesh fajet` e trathëtinat, pse deri tash sa faje që janë ba, kurrë na një her nuk ka marrë na një masë.)²⁹

S`kam kundreshtim për proponimin e z. S. Vinjaut qi (t`i ngarkohet përfaqësonjësit në Stamboll e sjellmja e dokymentave të tokave të shtëpijave t`atyne viseve qi kan mujt me j`u humbun pse tue qenë se nuk gjinden keto dokymenta, mund te dalin trazime. ... Asht e vertet se mund të dalin abyze për mungesë dokymentash, por kam frike se mund të dalin edhe prej pasjes së tyne.)³⁰

Tue marrë parasysh gjendjen; kemi qënë e jemi t`mendimit qi; Por qeveri e fortë është vetem ajo qi mund mbështetet nde nja shumicë të madhe të Parlamentit; kemi ç`faqun idhën qi; ashtu qi mund të permblëdhete në vete cilsit e ...; Për sa kemi mundin, vepres s`onë i kemi dhanë kët drejtim³¹

²³ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1924/1, f. 97.

²⁴ Po aty, f. 216.

²⁵ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1921, f. 630.

²⁶ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1923/2, f. 107.

²⁷ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1921, f. 179.

²⁸ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1921, f. 631.

²⁹ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1921, f. 672.

³⁰ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1921, f. 351.

³¹ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1921, f. 164.

Nuk shoh kundreshtim në; ... në kjoft se puna ngjet;³² Mue m`intereson qi; nuk due me hi n`bisedë me; e vërteta asht qi; unë kishe me thanë qi:³³ Tue u bazue mbi fjalët qi thaçë mâ parë³⁴ Më bje ndër mend mirë qi³⁵; Nuk do të kishe marrë fjalën as pak, po të kishte qenë e mundun të shkote këjo shkresë me një here; Ndofta fjala nuk jua ka shqyptuem mirë mendimin po dje keni thanë kështu, edhe po të doni, mund të këndojmë procesverbalin³⁶.

Është e dukshme që, në pjesën më të madhe të rasteve përdoret përemri vector në vetën e parë dhe, nëpërmjet tij ai tregon ndërmarrjen për një komunikim personal, shqyrtimin në thellësi të çështjeve për të cilat diskuton dhe jep mendime, opinione, sugjerime e këshilla personale, por, kur flet në emër të komisëve, ku merr pjesë, sepse në këtë rast u drejtohet dëgjuesve dhe nëpërmjet formës së shkruar lexuesve, zgjedh përdorimit e përemrit vector ose në vetën e parë shumës, ose në vetën e tretë njëjës: “Komisija sot, me anën t`ëme, do të paraqesë gojisht një raport të shkurtë mbi veprimet e veta deri sot.”³⁷

Të pranishme në ligjërimet e tij janë edhe ndërtimet e fjalive me emra asnjans: *Të ndjekunit e tij të bahet me urdhën ordinare³⁸; ... janë porositur atëherë kur ka shpallë qeverrija qarkon për të hjekunit e taksës së drithit, tue mos dijë qi nënë emnin...³⁹; ... ku thohet se Këshilli i Naltë ri në fuqi e me t`ardhmen e Mbrtetit quhet vetiu i rrëzuem.⁴⁰*

Pyetjet retorike që bëhen pjesë e diskutimeve dhe fjalimeve për çështje të caktuara të L. Gurakuqit, jo vetëm që ngjallin interes për dëgjuesit, megjithëse janë fakte të njohura që nuk do të marrin përgjigje të atypëratyshme, por edhe orientojnë strukturën e ligjërimet që do të vijojë, sidomos mbylljen e tij, me një këshillë për një zgjedhje, sipas këndvështrimit të folësit/diskutantit.

Deri kur do të shkojmë me këto sisteme? Deri kur do të përdoret në vendin tonë tortura? A beson Qeverrija se me rrahje do të shtojë dashunin e popullit? A beson se me shpërdorime do t`a bajë kët popull të butë? Nji popull qi rrahjet, pret ditën për me çue kryët, punë këtaj qi kishte me na

³² *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1921, f. 204.

³³ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1921, f. 223.

³⁴ Po aty, f. 375.

³⁵ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1923/2, f. 26.

³⁶ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1922/1, f. 523.

³⁷ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1924/1, f. 58.

³⁸ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1921, f. 428.

³⁹ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1923/2, f. 81.

⁴⁰ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1922/1, f. 481.

përtri ngatrrresa të pa-dishërueshme.⁴¹ ... duhet të bëjmë therorí ja ndë njenën, ja në tjetrën, ja të parapëlqejnë deputatsín, ja të marrin nepunsí tue hekun dorë nga deputatsija.⁴²

Përemrat pronorë në ligjërimet e Gurakuqit i kemi gjetur të shkruar me apostrof apo edhe të nyjzuar:

... nuk mund t`influencohet per damin t`onë⁴³; shtetit t`onë, Qeverrija e jonë⁴⁴; Mâ përpara edykasjoni i shkollavet t`ona ka qenë austrijak⁴⁵; Nofta nuk e shpjegova mirë mendimin t`em ... Por edhe mendimi i jem asht vetëm të hedhim një sy në organizimin e gjykatorevet t`ona në vendin t`onë.⁴⁶

Të gjitha këto veçori gjuhësore që e bëjnë ligjërimin e L. Gurakuqit më të pasur, më të kuptueshëm, tipik për t`iu referuar edhe në ditët e sotme, nuk mund të mishëroheshin dot kaq pastër veçse në gojën e një njohësi dhe zotëruesi aq të mirë të gjuhës së njësuar, (*me pak "anim të peshores gjuhësore" drejt shkodranishtes së tij të zemrës*) dhe një zbatuesi korrekt të rregullave të Komisisë, të propozuara nga vetë ai.

Një shprehje e njohur thotë që "*Jeta është i vetmi libër, fletët e të cilit nuk mund t`i kthesh mbrapa*", por, në rastin e L. Gurakuqit, përmes fletëve të librit të jetës së tij të shkurtër, themi me bindje se parlamentarë si ai, vështirë se do të kemi mundësi të njohim e të dëgjojmë në sallën e parlamentit shqiptar në ditët e sotme.

⁴¹ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja "Nikaj", Tiranë, 1923/2, f. 17.

⁴² *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja "Nikaj", Tiranë, 1922/1, f. 473.

⁴³ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja "Nikaj", Tiranë, 1921, f. 155.

⁴⁴ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja "Nikaj", Tiranë, 1922/1, f. 479.

⁴⁵ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja "Nikaj", Tiranë, 1922/1, f. 500.

⁴⁶ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, shtypshkronja "Nikaj", Tiranë, 1922/1, f. 457.

BIBLIOGRAFI:

- Beci, B., *Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre*, Sh. B. “Dituria”, Tiranë, 2002.
Historia e standardizimit të shqipes, politika dhe planifikimi gjuhësor në shkollë, SHBLSH e re, Tiranë, 2010.
- Bisedimet e Këshillit Kombtar, shtypshkronja “Nikaj”, Tiranë, 1920-1925, botuar sipas origjinalit, në kuadër të 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë nga Kuvendi i Shqipërisë, në Bisedime Parlamentare, Tiranë, 2012.
- ASHSH Fjalor Enciklopedik shqiptar, 1, 2, botim i ri, Tiranë, 2008.
- Gokaj, N., *Luigj Gurakuqi – lëvrues dhe studiues i shquar i gjuhës shqipe (1879-1925)*, në Gjuha Jonë, 1984/2.
- Ismajli, R., *Drejtshkrimet e shqipes*, ASHAK, Prishtinë, 2005.
- Plangarica, T., *Gramatika shkollore, gramatika e tekstit/diskursit dhe disa dukuri gjuhësore/ligjëimore që mund të studiohen veçse në tekst/diskurs*, në Seminari XXX Ndërkombëtar për gjuhën, Letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, gusht, 2011.
- Riza, S., *Vepra të zgjedhura*, ASHSH, QSA, Shtypshkronja “Kristalina KH”, Tiranë, 2009.
- Osmani, T., *Histori e alfabetit të gjuhës shqipe*, SHBLSH, Instituti i Studimeve Pedagogjike, shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1987.
Komisia Letrare shqipe në Shkodër (1916-1918), Shkodër, 2004.
- Raka, F., *Rreth teorive për mundësinë e formimit të gjuhës së njësuar letrare shqipe*, në Filologji, nr. 8, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2000.

Luigj Gurakuqi Discourse – Valuable Testimony to the Values of Literary Nationality**ABSTRACT**

The focus of this paper is the study of the parliamentary discourse used by Luigj Gurakuqi as a Member of the Parliament for the period when he was the representative of Shkodra people in the National Council (Parliament) during 1920-1924. The corpus studied includes volumes of Parliamentary Talks published on the occasion of the 100th anniversary of Albania's proclamation of independence, preserving their original form in the National Council of that period. This point of view is added to his values already known as an initiator, contributor, promoter and leader of the Albanian Literary Commission.

By recollecting some of the passages from his discourses of that period we will be able to know, not only the manner in which the text was graphically presented to his colleagues in the hall, and through them to all readers of these speeches of that time and today, but also his social and political view of the destiny of the country at such an important period for him.

Eliana LAÇEJ

A SHKRUAJMË SIÇ FLASIM? RASTI I RRJETEVE SOCIALE

Të shumtë janë ata që nuk e kanë falur Umberto Eco-n, i cili gjatë fjalës së tij me rastin e marrjes së diplomës *honoris causa* nga Universiteti i Torinos në vitin 2015, u hodh në sulm kundër teknologjive të reja të komunikimit dixhital me një akuzë që do të bëjë histori: *“Rrjetet sociale po u japin të drejtën e fjalës legjioneve me budallenj të cilët më përpara flisnin vetëm në lokale pasi e kishin pirë një gotë verë, pa i bërë dëm komunitetit. Ua mbyllnin gojën menjëherë, ndërsa tani kanë të njëjtën të drejtë fjale njësoj si ai që ka fituar Çmimin Nobel. Është koha e pushtimit prej budallenjve.”* – Burimi “Ansa”.

E megjithëse kjo akuzë hapi tek rrjetet sociale jo pak polemika, kemi të bëjmë me një vizion profetik të disa dinamikave tipike të këtyre mjediseve dixhitale.

Revolucioni dixhital nuk është vetëm një revolucion Teknik, por edhe mendor, e pse të mos themi edhe antropologjik. Lindja e internetit ka transformuar në mënyrë rrënjësore mënyrën se si njerëzit kalojnë kohën e lirë dhe ndërveprojnë mes tyre, ka ndryshuar kanalet përmes të cilave ngjarjet mbërrijnë tek lexuesi, ka ndryshuar marrëdhënien me gjuhën e shkruar.

Revolucioni dixhital ka bërë që në përdorimin e gjuhës të përfshihen dy risi të cilat, nëse nuk administrohen siç duhet mund të ndikojnë në ekulibrin e saj natyral. Risia e parë ka të bëjë me shfrytëzimin intensiv që gjuha, e sidomos gjuha e shkruar, pëson. Risia e dytë lidhet me një mekanizim të proceseve gjithnjë e më të përhapura të të shkruarit. Sot shkruhet masivisht, pa asnjë filtër, shkruhet siç flitet, shkruhet dhe lexohet pa u menduar, bile më mirë të themi duke menduar paralelisht edhe për gjëra të tjera. Rimë me orë të tëra në rrjetet sociale të ngujuar prej shkrimeve të miqve dhe miqve të tyre, në gatishmëri të plotë për të reaguar në momentin më të parë. Kohëzgjatja e vëmendjes që i kushtojmë dukurive për të cilat diskutojmë është bërë mikroskopike dhe të lexuarit e korpusit të pafund ndaj të cilit jemi të ekspozuar çdo ditë bëhet gjithnjë e më sipërfaqësor. Po aq në mënyrë të sipërfaqshme dhe të vrullshme pozicionohemi në debatet e rrjeteve sociale, pa u menduar shumë për atë çfarë shkruajmë dhe sidomos pa i peshuar fjalët, bile duke i zgjedhur mes

numrit të paktë të fjalëve që disponojmë vetëm në atë moment. Fatkeqësisht nuk arrijmë të kuptojmë se nga ky përdorim i rastësishëm, i pamenduar dhe spontan i gjuhës do të mbetet një gjurmë e shkruar e cila do të ushqejë korpuset e teksteve të lexuesve tanë e si rrjedhojë do të bëhet në njëfarë mënyre pikë referimi për gjuhën e shkruar dhe rezultati, vetëkuptohet, do të jetë tejet i rëndë. Pasoja shumë të rënda në planin tekstual paraqet për më tepër mungesa e rileximit të asaj çfarë shkruhet: teksteve të rrjeteve sociale i rihidhet shumë rrallë një sy para ripublikimit. Sa më shumë që të jetë i gjatë një tekst aq më i rëndësishëm bëhet rileximi i tij para publikimit; në mungesë të këtij veprimi, teksti mund të rezultojë i paqartë e i pakuptueshëm, duke minuar në këtë mënyrë qëllimin e tij komunikues.

Nëse do të ndaleshim shkurtimisht në një trajtim jo të hollësishëm teorik, do të arrinim në përfundimin se afërsia e të shkruarit me të folurën varet nga qëllimet e komunikimit, nga marrëdhënia mes bashkëbiseduesve dhe nga natyra joformale e mjetit. Gjithashtu varet edhe nga ngjashmëria mes gjuhës së shkruar dhe asaj të folur duke iu referuar në këtë rast repertorit tonë gjuhësor ku përfshihet edhe dialekti, dendësia e përdorimit të të cilit në rrjete dhe në mesazhe nxit drejt reflektimit për rolin e tij shoqëror. Ndërkohë, teknologjitë e reja pohojnë që raporti mes të shkruarit dhe të folurit nuk është një vijë e pastër ndarëse, por një vazhdimësi e kristalizuar.

Konceptet e të shkruarit dhe të folurit, e ligjërimit dhe shkrimit janë të dykuptimta, pasi mund t'i referohen si produktit ashtu edhe proceseve konjitive ose karakteristikave gjuhësore-tekstuale jo detyrimisht të lidhura me kanalin fonetik-akustik apo atë grafik. Për të kapërcyer një dykuptimshmëri të tillë Peter Koch dhe Wulf Oesterreicher, që në fillimet e viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar, propozuan një model që ndan qartazi kodet grafike dhe fonetike nga parametrat konceptuale që identifikojnë njëkohshmëri (gjuhë e folur) dhe distancë në komunikim (gjuhë e shkruar). Sipas tyre, në analizën e dallimeve mes të shkruarit dhe të folurit përballemi me një organizim konceptual; me fjalë të tjera një tekst, pavarësisht nga kanali që përdor, nga ana konceptuale mund të jetë larg karakteristikave pragmatike tipike të ligjërimit dhe të të shkruarit. Vlerat që ndikojnë në formën e komunikimit të bashkëbiseduesve duhet të lidhen me situatën dhe kontekstin, pra të pavarur nga trajta e shkruar apo ajo e folur e mesazhit. Dy polet e njëkohshmërisë dhe të distancës përcaktohen nga një e përbashkët që i referohet karakterit publik apo privat të komunikimit, kontekstit jashtëgjuhësor, qëllimeve të bashkëbiseduesve, shkallës së emotivitetit të shkëmbimit, siç paraqitet në tabelën që vijon:

Gjuhë e folur	Gjuhë e shkruar
1. komunikim privat	1. komunikim publik
2. bashkëbisedues i njohur	2. bashkëbisedues i panjohur
3. emocionalitet i fortë	3. emocionalitet i dobët
4. afërsi në hapësirë dhe kohë	4. distancë në hapësirë dhe kohë
5. bashkëveprim komunikues intensiv	5. bashkëveprim komunikues minimal
6. dialog	6. monolog
7. komunikim spontan	7. komunikim i përgatitur
8. tematikë e lirë	8. tematikë e përcaktuar

Koha e kufizuar për planifikimin e mesazhit dhe natyra joformale e komunikimit ndikojnë tek koherenca duke favorizuar përdorimin e shpeshtë të fjalive me strukturë foljore, tipike të leksikut bisedor. Tashmë është mëse e qartë se gjurmët e të folurit në tekstet elektronike janë rezultat i kombinimit të shumë faktorëve, disa prej tyre të tipit gjuhësor-tekstual, të tjerë të tipit kulturor dhe disa të tjerë tipikë të mjeteve të komunikimit masiv. Duke e shndërruar shkrimin në dialogues, teknologjitë e reja po mundësojnë shkëmbimin e roleve mes dërguesit dhe marrësit si dhe po ofrojnë një *feedback* gati - gati sinkron. Pra, nëse do të jepnim një shembull, platformat e komunikimit pothuajse sinkrone të tipit WhatsApp, përdorin një kanal për më tepër grafik për të realizuar një komunikim shumë të ngjashëm me ligjërimin duke mbetur në kuadrin e simulimit të komunikimit bisedor primar, pasi mungon një karakteristikë thelbësore: afërsia fizike e bashkëbiseduesve, e cila mundëson komunikimin jo vetëm me fjalë, por edhe tonin e zërit, gjestet, shprehjet e fytyrës etj. Simulimi, në këtë këndvështrim, mund të bëhet gjithnjë e më real, por simulim mbetet: p.sh., në WhatsApp, programi na informon kur bashkëbiseduesi ynë po shkruan një përgjigje të mesazhit tonë për të shmangur mbivendosjen e turneve, ose përdorimi i fytyrzave (*emoji*) zëvendëson pamundësinë për të perceptuar ballë për ballë qëndrimin ndaj përmbajtjes së mesazhit.

Cardona në 1990 (Prada, 1996: 31) përcaktonte me emërtimin “komunikim i përditshëm (i zakonshëm)” një lloj komunikimi që karakterizohet nga një kohë e shkurtër ideimi, pothuajse “i njëkohshëm me mendimin”, pa “një planifikim paraprak”, duke e dalluar nga gjuha e formalizuar e cila, në të kundërt, ofron “një organizim linear të tekstit, një planifikim të pjesëve të tij, një përdorim të kufizuar ose të munguar të mjeteve të tjera, joverbale”.

Sot jemi të gjithë më tolerantë për sa i përket gjuhës: e folura, përmes elasticitetit dhe formës së saj relaksuese bëhet gjithnjë e më shumë pushtuese pikërisht, sepse teknologjitë e reja po imitojnë dialogun përmes të shkruarit; siç e përmenda edhe më sipër, vetë gjuha e shkruar nuk është më vetëm alfabetike, por përfshin simbole dhe elemente ikonike, si p.sh.,

rasti i fytyrzave (*emoji*) që shfaqen tashmë në fund të çdo turni të fjalës dhe zëvendësojnë pikën duke shprehur ironi, pakënaqësi, mëdyshje, habi nga ana e bashkëbiseduesit. Sipas një studimi të bërë nga Oxford University Press e Swiftkey, 😄 është shpallur fjala e vitit 2015 (edhe pse menjëherë lind dyshimi nëse mund të quhet apo jo fjalë, por meqenëse Fjalori i Oksfordit e ka quajtur të tillë, një arsye duhet të ketë). Faktikisht është zgjedhur si e tillë, pasi më shumë se çdo fjalë tjetër, pasqyron ndjesi, duke arritur në këtë mënyrë kuotën prej 8.000 miliardë përdorimesh për një vit. Një bisedë në WhatsApp mes miqsh, por pa përdorur fytyrëzat (*emoji*), është aq e paimagjinueshme saqë në kushte normale mungesa e tyre ka kuptimin "...a je akoma i/e zemëruar?", apo "si është puna?". Këto dukuri paraqesin shumë elemente karakteristike të dialogut gojor, si p.sh., mungesën e projektimit të mendimit, kohezionin e mangët, sintaksën e thjeshtuar, praninë e shenjave bisedore në të shumtën e rasteve përmes trajtës ikonike, riprodhimin e disa dukurive prozodike, si p.sh. zgjatjen e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve "mooj, mooos, çfaaaarë etj.", përdorimin ekspresiv të shenjave të pikësimit, onomatopetë e shumë të tjera.

Meqenëse tashmë interneti nuk i përket më vetëm pak njerëzve, por është shndërruar në një dukuri masive ku të qëndruarit online merr gjithnjë e më shumë rëndësi. Duhet të dimë të flasim në rrjetet sociale, por mbi të gjitha të dimë si duhet të flasim dhe me kë të flasim.

Të qëndruarit në rrjetet sociale nuk është aq i lidhur me faktin se sa arrihet të fitohen apo të ushtrohen aftësitë teknike, por mbi të gjitha është komunikim, dhe në qendër të komunikimit janë të vendosura fjalët. Edhe në një shoqëri të mbingarkuar me imazhe, pamje dhe kontekste që stimulojnë dhe përfshijnë pesë shqisat, janë përsëri ato, fjalët, që i japin kuptim gjithçkaje. E megjithatë shpesh i përdorim duke nxituar pa vlerësuar pasojat.

Sigurisht gjuha e internetit ka anët e veta pozitive dhe negative. Në fund të fundit përfaqëson përshtatjen e gjuhës me një mjet specifik. Për Akademinë e Kruskës "*rrjetet sociale nuk janë as toka e premtuar e gjuhës së shkruar, as shenja e dekadencës kulturore të të rinjve*". Janë një nga anët e shumta të komunikimit, e cila nuk duhet të stigmatizohet, por të jetë një nga regjistrat e shumtë në dispozicion të njerëzve e cila merr kuptim dhe vlefshmëri kur përdoret në kontekstin e duhur. "*Është fjala për një mjedis komunikimi ku sigurisht të shkruarit ka një rol shumë të rëndësishëm dhe është një formë të shkruarit e veçantë që kërkon shpejtësi, gatishmëri dhe aftësi sintetike. Pastaj ekzistojnë mijëra situata të tjera ku duhet të dimë të shkruajmë ndryshe*". Në fakt, kompetenca e komunikimit

përmban në vetvete jo vetëm aftësinë gjuhësore, me fjalë të tjera, atë gramatikore, sa të domosdoshme aq edhe të pamjaftueshme, por edhe një seri aftësish sociolinguistike, bisedore dhe strategjike që folësi vë në jetë në momentin e komunikimit. Studiuesit e krahasojnë komunikimin me ndërtimin e urave: për t'i ndërtuar ato nevojiten si materialet (pra, gramatika), ashtu edhe mjetet e tjera që i bëjnë këto materiale realisht të shfrytëzueshme.

Pra, ajo që dua të nënvizoj përmes këtij shkrimi, është qëndrimi që duhet mbajtur në çështjen e përkujdesjes ndaj gjuhës nga ana e të gjithë komunitetit.

Një pjesë e konsiderueshme e studentëve që hyjnë në universitet trashëgon një nivel të ulët të zotërimit të gjuhës së shkruar (standardit) dhe një kulturë të cekët gjuhësore përmes mosnjohjes së rregullave të drejtshkrimit dhe atyre të pikësimit, mangësive në zotërimin e strukturave sintaksore, leksikut të varfër, vështirësisë në gjetjen e fjalëve të duhura dhe organizimit të mendimit, vështirësive të mëdha në kalimin nga një regjistër komunikimi në një tjetër, përdorimit të gabuar të fjalëve të huaja, përdorimit të strukturave sintaksore të ndikuara prej modeleve të gjuhëve të huaja etj. Prandaj edhe alarmi për ekzistencën e “analfabetizmit funksional”, e atyre individëve që, edhe pse e kanë të zhvilluar aftësinë e të lexuarit dhe të shkruarit, nuk janë në gjendje të hynë në brendësinë e mesazhit të tekstit dhe, aq më pak, të përdorin gjuhën e shkruar për t'u kuptuar nga lexuesit, tashmë ka rënë prej kohësh.

Natyrshëm, secilit prej nesh, mund t'i lindë pyetja: Po cilat janë arsyet e kësaj gjendjeje? Në mendimin tim personal arsyeja madhore është niveli i përgjithshëm kulturor që zotëron sot shoqëria shqiptare dhe emancipimi i saj në drejtim të rëndësisë që paraqet zotërimi i gjuhës standarde, niveli jo i kënaqshëm i mësimdhënies së gjuhës shqipe në shkolla, modelet që ofrojnë media e shkruar dhe ajo e folur, të lexuarit e pakët, faktorët psikologjikë etj.

Impakti që këto aftësi jo të mira gjuhësore kanë në mënyrën se si e mësojmë gjuhën duhet të jetë në qendër të studimeve të specialistëve: në asnjë mënyrë nuk mund të përjashtohet në këtë rast fakti që nëse studentët lexojnë dhe shkruajnë pa u thelluar, dhe kanë gjithashtu prirjen për të harruar atë çfarë mësojnë, përgjegjësia duhet të bie edhe mbi revolucionin antropologjik që po jetojmë. Gjithashtu duhet të studiohen edhe ndikimi që ato kanë tek gjuha, sidomos tek gjuha e shkruar, edhe pse një vlerësim teorik arritëm ta bëjmë.

Më në fund gramatika u rikthye në shkollën e mesme përmes lëndës së gjuhës shqipe, por ama duhet të synohet drejt mësimdhënies së një

gramatike me drejtim nga të reflektuarit ndaj gjuhës. Kjo për tri arsye bazike: nuk mund të jemi të ndërgjegjshëm në përdorimin e saj, sidomos të gjuhës së shkruar, pa ditur funksionimin e saj analitik. Një njohje e tillë do të na ndihmonte që të mësonim edhe gjuhët e tjera. Përveç kësaj, analiza e gjuhës është një sondazh i proceseve tona mendore, i marrëdhënieve tona shoqërore dhe i historisë sonë kulturore.

Si konkluzion, nëse gjuha është një e mirë e përbashkët kemi të gjithë dy përgjegjësi: të vazhdojmë të luftojmë në mënyrë që të gjithë folësit të kenë akses në të gjitha variantet e repertorit, dhe së dyti të gjithë të përkujdesemi për gjuhën tonë. Përkujdesja kërkon kohë, prandaj duhet të marrim kohën që na duhet për ta përdorur gjuhën ashtu siç duhet. Është detyrë e jona, e përditshme, që ta mbajmë efiçente, të fuqishme, të pastër, të shumëllojshme dhe të gjallë. Prandaj një ftesë për të gjithë lexuesit: të dhurojmë mendimet tona në mënyrë që të gjejmë mënyrat për ta mbrojtur, ushqyer e pasuruar këtë gjuhë. Në mendimin tim personal, universiteti përmes departamenteve të gjuhës e letërsisë shqipe, departamenteve të gjuhëve të huaja e të tjerave në përgjithësi, duhet të gjejë pika bashkëpunimi me shkollat e sistemit parauniversitar duke hartuar projekte të përbashkëta dhe efikase për këtë qëllim duke mos mbetur në nivelin e nismave të përkohshme, të cilat nuk vlejné asgjë.

BIBLIOGRAFIA:

- D'ACHILLE, P., (2017), *I social network e la lingua italiana, tra neologismi e anglicismi*, në <http://www.accademiadellacrusca.it/>.
- GHENO, V., (2014) *A proposito di virale e meme*, në <http://www.accademiadellacrusca.it>
- GHENO, V. & MASTROIANNI, B., (2018) *Tienilo acceso. Posta, commenta, condividi senza spegnere il cervello*. Longanesi & C. F , Gruppo editoriale Mauri Spagnol, Milano.
- GRICE P., (1993), *Logica e conversazione*, Il Mulino, Bologna.
- MARASCHIO N. (2011), "Le nuove fonti della lingua: radio e televisione", in V. Coletti (a cura di), *L'italiano dalla nazione allo Stato*, Le Lettere, Firenze, pp. 161-171, e disponueshme on line në adresën: <http://www.viv-it.org/sites/default/files/u80/Maraschio.pdf>.
- PISTOLESI, E.,(2004) *Il parlar spedito: L'italiano di chat, email e SMS.*, Esedra, Padova.
- PISTOLESI, E. (2014), "Scritture digitali", in G. Antonelli, M. Motolese, L. Tomasin (a cura di), *Storia dell'italiano scritto.*, 3 voll., III. Italiano dell'uso, Carocci, Roma, pp. 349-375
- PRADA, M., (2016) *Scritto e parlato, il parlato nello scritto. Per una didattica della consapevolezza diamesica.*, Italiano LinguaDue, n. 2.
- SORNICOLA, R., (1981) *Sul parlato*, Il Mulino, Bologna.

Do we write as we speak? The case of social networks***ABSTRACT***

It is undeniable that social networks have transformed the way we interact with others. The technological revolution is not just a technical revolution, but should also be considered as mental revolution or, if we may call it an anthropological revolution, as it has radically transformed the way people spend their free time by interacting with one another. It has also changed channels through which events reach the reader and the subject matter of the digital text: short sentences, use of acronyms, emotion, etc. We have all become maniacs of communication speed. Always ready! The person on line should not wait. In this context, a question naturally arises: "Is the relationship with language changing?" By means of this paper, we will try to answer this question through theoretical treatment and concrete examples. Yes, perhaps language is changing for the very fact that it is in a constant evolution, and as a result, we cannot admit that the language of social networks does not find its impact on how we use it every day and what the consequences are on our way of communication especially in written language. We write whatever and however. We write as we speak without caring about selection and the result speaks for itself: the situation is often unacceptable and intolerable. What we really need to fear is that, despite the lexical and cultural richness that on line language has brought, it may not be the only type of Albanian language that people should know and use.

Key words: language, communication, social networks

Lindita KAZAZI

NDIKIME TË NDËRSJELLA MES GJUHËVE - RASTI I HUAZIMEVE ITALIANE NË SHQIP

Sektori i gjuhësisë që merret me studimin e kushteve në të cilat përcaktohet kontakti mes gjuhëve dhe pasojat që rrjedhin prej tij (të nënkuptuara si ndikime, qofshin të njëanshme apo të dyanshme) njihet me termin *interlinguistica - ndërëgjuhësi*. Ky përkufizim nxjerr në pah dy këndvështrime të ndryshme nga të cilat mund të shqyrtohet fenomeni. Nga njëra anë kontakti, që ka të bëjë edhe me përmasat ‘virtuale’ të takimit mes dy varietetesh apo e thënë ndryshe ‘të praktikuarit alternativ i gjuhëve’ dhe nga ana tjetër ndërndikimi, që ka të bëjë me konkretizimin në një strukturë gjuhësore konkrete në akte komunikimi. Termi *interlinguistikë - ndërëgjuhësi* përdoret së pari në Kongresin IV Ndërkombëtar në Paris më 1949, duke nënkuptuar studimin e gjuhëve artificiale, siç mund të ishte gjuha *esperanto*.¹ Më pas ajo filloi të nënkuptonte kalimet dhe ndryshimet mes gjuhëve. Ky koncept u bashkua me atë të kontaktit mes gjuhëve, duke konsideruar të domosdoshëm aktin e komunikimit në mënyrë që kontakti të realizohej.

Nga ana tjetër, kemi atë që quhet *ndërndikim* (interferencë), që e ndeshim në kompetencën individuale të individit, që konkretizohet në vetë mesazhin që ai formulon dhe paraqet. Kështu folësi dygjuhësh, duke folur njëren gjuhë mund të përdorë elemente të gjuhës tjetër, duke i thyer normat e gjuhës së vet. Ndërndikimi mund të jetë leksikor apo terminologjik; semantik a kuptimor dhe gramatikor². Sigurisht më të rëndit janë ndërndikimet gramatikore. Ndërndikimi i ka rrënjët në vetë aftësitë gjuhësore të asimiluara nga individi, përmes marrëdhënieve të vendosura në grupin shoqëror ku jeton. Rreth kontaktit mes gjuhëve janë bërë studime që kanë përfshirë edhe sferën sociokulturore. Kështu dy ose më shumë gjuhë, quhen gjuhë në kontakt, nëse përdoren në mënyrë alternative nga të njëjtët persona. Përdorim termin ndërndikim për të shënuar shembujt e shmangies nga normat e një gjuhe apo një tjetre, të cilat vërehen në aktet

¹ Roberto Gusmani, *Interlinguistica*, në ‘Linguistica storica’, ed. R. Lazzeroni, Roma, 1989, f. 87-114.

² Gjovalin Shkurtaj, *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006.

komunikuese të vetë folësve, si rezultat ky i kontaktit gjuhësor³. Një gjuhë e caktuar mund të ushtrojë ndikim në një tjetër për shkaqe të ndryshme: - falë vështirësive natyrore artikuluese të vetë gjuhës, - falë dembelisë, - falë tendencave të imitimit.⁴

Dëshirojmë të ndalemi në dy raste tipike:

- Kur një i huaj i çfarëdo kombësie qoftë, mëson gjuhën shqipe dhe gjatë komunikimit në gjuhën tonë nuk arrin të mos transportojë fjalë, shprehje apo thekse e intonacion të gjuhës së vet, kjo tingullon e pranueshme dhe nuk shkakton shqetësim, pasi kuptohet që këto kalime bëhen ‘nga halli’.

- Në rastin e dytë, kur këto kalime a thyerje të normës së gjuhës shqipe bëhen nga një shqiptar, i cili natyrisht e di shumë mirë gjuhën e vet (L1), situata bëhet më e ndërlikuar. Kështu këta folës që përdorin fjalë të huaja të panevojshme, mund të imitohen nga të tjerë që ‘infektohen’ me dëshirën që t’i ngjajnë atij, duke i konsideruar këto përdorime si risi, me pasojën që pak nga pak fjalë të tilla mund të nguliten në sistem.

Vendi ku ndodh kontakti janë vetë personat që i përdorin gjuhët. Kështu, folësit dygjuhësh bëhen vetë qendra e ndërveprimit dhe e mbivendosjes së dy kodeve të ndryshme gjuhësore. Vetë parregullsitë në përdorimin e gjuhës përbëjnë fenomenin e ndërveprimit, ku ndërveprimi që mund të pësojnë kodet e ndryshme gjuhësore janë të formave të ndryshme. Dihet që gjithmonë është prirja për të njëzuar gjuhën e re që po studiohet me gjuhën mëmë. Kështu kemi ndërveprim mes gjuhës a kodit gjuhësor të mësuar përpara dhe gjuhës a kodit gjuhësor që mësohet në një moment të dytë, duke realizuar bashkëjetesën në një individ të caktuar të gjuhës mëmë apo gjuhës së parë dhe gjuhës së huaj, gjuhës së dytë. Rreth këtyre koncepteve mund të gjenden emërtime të ndryshme (gjuhë e nisjes/lingua di partenza – gjuhë e mbërritjes/lingua di arrivo; gjuhë model/lingua modello – gjuhë përgjegjëse/lingua replica). Ndeshemi me fenomenin e ndërveprimit edhe mes gjuhës a kodit gjuhësor që zotërohet më mirë dhe atij që zotërohet më pak; apo mes kodit gjuhësor që gëzon një prestigj më të madh sociokulturor dhe atij që ka më pak peshë. Ferguson i lidhje me këtë ka propozuar terminologjinë variant i lartë/varietà alta dhe variant i ulët/varietà bassa o inferiore. Këto raste paraqiten më së shumti në shoqëri ku ka më shumë se një komunitet të vetëm gjuhësor dhe social, shoqëri që janë pra të karakterizuara nga një shumësi gjuhësore a kulturore, në të cilat kontaktet mes gjuhësh e kulturash janë të vazhdueshme dhe çojnë në krijimin e fenomeneve dinamike.

³ Ulrich Weinreich, *Languages in contact. Findings and problems*, New York, 1953, p. 3.

⁴ Paola Cotticelli, *Interferenza* në Dispense di Linguistica storica 2011/2012.

Nëse pyesim se pse ndodh ndërndikimi gjuhësor apo se pse huazohen elemente gjuhësore. Si përgjigje të përgjithshme mund të marrim se huazimet në përgjithësi shërbejnë për plotësuar mungesa të caktuara të një gjuhe marrëse me material gjuhësor të një gjuhe dhënëse. Në momentin kur një popull shpik a zbulon diçka të vlefshme, kjo mund të jetë e dobishme edhe për popuj të tjerë të cilët e marrin prodhimin apo idenë e re. Në një situatë të tillë nëse në gjuhën e tyre nuk ka një term të posaçëm për të shënjuar objektin apo idenë atëherë ajo hyn në gjuhë së bashku me emërtimin e tij në gjuhën dhënëse. Pra, gjërat e reja zakonisht vijnë me emra të rinj. Huazimi bën pjesë në risinë leksikore që përftohet nga nevojat për të emërtuar objektet apo idetë e reja. Shpesh ndeshemi me ato që quhen ndërkombëtarizma, fjalë që gjenden nëpër fjalorë të pothuajse të gjitha gjuhëve, që do të thotë se në momente të caktuara shpikjet e fundit janë përhapur në shumë popuj duke marrë me vete edhe emërtimin e tyre.

Nga ana tjetër është më e thjeshtë të huazohet një term së bashku me objektin që shënjon, sesa të krijohet një term me material të vetë gjuhës. Kjo vihet re si prirje edhe në të folmet e shumë gazetarëve, politikanëve, personaliteteve nga fusha të ndryshme apo edhe në mënyrën e të shkruarit e të përkthyerit të shumë përkthyesve. Shpesh, ata, duke qenë njohës e folës të gjuhëve të huaja e kanë më të lehtë t'i marrin fjalët drejtpërdrejt nga gjuhët e huaja, pa u lodhur të gjejnë gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe. Në raste të tilla ata mjaftohen vetëm me një përshtatje nga ana fonetike e morfologjike të fjalëve të huaja.

Kështu na ndodh që gjatë emisioneve të drejtpërdrejta televizive, në kanale prestigjioze si Top Channel dhe Tv Klan dëgjojmë: “...të hyjë e të penetrojë në mediat e përditshme..., ...të krijohet një qeveri e re që të ketë prerogativa..., ... një pjesë e kësaj partie kontestoi...” Opinion, TV Klan; “Jam dakord edhe me disa sensibilitete të përmendura këtu..., ... ka qytete që kanë fraxhilitetin e tyre..., ... nivelin e humanitetit të figurës..., ... nuk mendoj se do të ketë reaksion kushedi se çfarë..., ... meqë na e antiçipoi...” Top Show, Top channel; ose “... po ta vëmë aplausometrin...” Top Show, Top Channel dhe “... ka vetëm një festival ku debutohet live, ... ne shpresojmë të koeperojmë..., ... nuk është dominant...”, Zonë e lirë, Tv Klan. Kohët e fundit, duke dëgjuar në njërin nga kanalet tona televizive informacionin rreth një vizite jashtë vendit, një nga politikanët tanë shprehet se kthehej “...me impresione të jashtëzakonshme nga negociatat bilaterale dhe multilaterale me impreditorët dhe donatorët...”. Shtrojmë pyetjen: sa përçind e popullsisë arrin të kuptojë sidomos fjalinë e fundit, pjesa më e madhe e fjalëve të së cilës janë të huaja? Në vijim sjellim një sërë fjalësh të tjera të cilat dëgjohen zakonisht në emisionet televizive të

kanaleve të ndryshme: *eksperiencë, ambient, evitohet, dedikohet, presion, rekomandohet, ekspresiv, ekspresivitet, iniciativë, interdipendencë, kurioz-e, kuriozitet, distancë, distancoj, aktivitet, kontribut, prezent-e, kartë identiteti, publikohet, komunikohet, komunikatë, likuidohet, likuidim, abuzohet, abuzim, tentativë, prezencë, okazion, ofensivë, suprem, nacional-e, internacional-e, direkt-e, deciziv-e*. Problemi i gjuhës shqipe dhe i ruajtjes së saj u ndeshën nën një këndvështrim tjetër gjatë Rilindjes Shqiptare. Pat shumë përpjekje për të ruajtur gjuhën tonë dhe sigurisht kjo që “...arsyeja e mbijetesës së gjuhës shqipe dhe e zhvillimit të fizionomisë së saj”⁵.

Sigurisht shtimi i përdorimit të fjalëve të huaja, lidhet edhe me intensitetin e lëvizshmërisë së popujve, shtimin e udhëtimeve në vende të huaja, studimi dhe punësimi jashtë vendit, por edhe sjellja nga këto vende të materialeve të shkruara që nga libra artistikë, tekste që kanë të bëjnë me sektorin e punësimit të secilit apo edhe thjesht gazeta të përditshme. Në ditët e sotme, në epokën e internetit, ku çdo informacion përcillet në kohë reale, është shumë e thjeshtë të kemi qarkullim informacioni në të gjitha gjuhët që na interesojnë. Ky realitet na bën të jemi në kontakt me të gjithë informacionin që na intereson dhe sidomos në gjuhën që na intereson. Për pasojë ndeshemi me dy prirje të kundërta të cilat përfaqësojnë dy grupime njerëzish. Nga njëra anë ndeshemi me të gjithë ata që lëvizin shpesh, studiojnë a punojnë në vende të ndryshme të cilët përdorin si pa të keq fjalë me prejardhje të huaj, pa u shqetësuar për ruajtjen e mbrojtjen e gjuhës shqipe. Shpesh kjo tendencë të foluri perceptohet si shenjë modernizmi. Nga ana tjetër kemi të gjithë ata që bëjnë kujdes për strukturën e shqipes, duke u munduar të mos përdorin fjalë të huaja që e kanë përgjegjësen në gjuhën tonë. Sigurisht në epokën e internetit është e tepruar dhe e pakuptimtë të flasim për lëvizje puriste, porse heqja nga përdorimi i fjalëve të huaja që e kanë përgjegjësen në gjuhën tonë është një detyrë dhe respekt ndaj vetes. Sigurisht, ndërkombëtarizmat nuk bëjnë pjesë në lëmin e fjalëve për zëvendësim. Kjo sigurisht kërkon një formim gjuhësor dhe ndjeshmëri më të madhe ndaj gjuhës.

Prof. Eqrem Çabej në studimin e tij shumë të njohur, biles thelbësor në këtë fushë, “*Për pastërtinë e gjuhës*”⁶, bën një paraqitje të shkurtër të punës së bërë, prej shekujsh, në pastrimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe, punë që fillon që me autorët e parë shqiptarë e vazhdon deri

⁵ Emil Lafe, *Pastërtia e gjuhës në kohën tonë si detyrë gjuhësore dhe kombëtare*, në ‘Gjuha jonë’, Viti XII, Nr. 3-4/ 1992, f. 48-53.

⁶ Ky studim është botuar fillimisht në gazetën “Mësuesi”, më 28. 03 dhe 04. 04. 1079. Në kemi konsultuar ribotimin e tij në revistën “Gjuha jonë”, viti I, Nr. 1, 1981, f. 36- 47.

tek ata të Rilindjes Kombëtare, shkrimtarët e periudhës së Pavarësisë e deri në ditët tona.

Gjuhëtari i njohur thekson se “Një ndër detyrat kryesore të gjuhësisë shqiptare, krahas kërkimeve teorike, është dhe mbetet pasurimi i gjuhës me elemente të gurrave vetjake dhe spastrimi i saj prej masës së fjalëve të huaja, që kanë vërshuar së jashtmi dhe po vazhdojnë edhe në ditët tona. Kanë depërtuar dhe depërtojnë në shkrimet shkencore dhe letrare, në shtyp, në radio, në televizion, në bisedën e përditshme”⁷.

Më pas ai numëron fushat në të cilat ndjehet ndikimi (sisteme e nënsisteme të gjuhës ku ndikimi është i ndjeshëm), dhe nënvizon në mënyrë të veçantë ndikimin e italishtes duke dhënë edhe mundësi zgjidhjesh të problemit. Në këtë studim është paraqitur edhe një listë fjalësh që mund të mënjanohen dhe të zëvendësohen lehtësisht me fjalë të gjuhës sonë. Me veprimtarinë e shumanshme shkencore e me nivel të lartë, prof. Eqrem Çabej ndriçoi shumë probleme të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, duke argumentuar lashtësinë dhe origjinën ilire të saj, vitalitetin e saj ndër shekuj dhe marrëdhëniet me gjuhët dhe kulturat e popujve të tjerë.

Është shumë me interes të shihet që pak a shumë e njëjta gjë ka ndodhur edhe në Itali. Duket, në fakt, se shtypi i kushton një vëmendje të vazhdueshme problemeve të gjuhës dhe studimeve gjuhësore. Pikërisht për këto probleme, Felitta Carrafiello, ka përgatitur temën e tij të diplomës, me titull, “*Questioni linguistiche nella stampa quotidiana italiana*”, ku ka paraqitur një bibliografi mjaft të gjerë të shkrimeve të botuara në vitet 1962-63 dhe 1972-73 në shtatë të përditshme të rëndësishme: “La Stampa”, “Corriere della Sera”, “Il Giorno” në veri; “La Nazione”, “Paese Sera”, “L’Unità” në qendër e “Il Mattino” në jug.

Në këto botime, paraqitet situata që sigurisht është shqetësuese për gjuhëtarët, të cilët kundërshtojnë përdorimin e disa fjalëve në gjuhë të huaja apo latine. Bile në disa raste përdorimi i tyre gjykohet si i gabuar dhe i pasaktë – “*Përdoret latinishtja shpesh me dëshirën për t’u ndjerë i rëndësishëm*”, La Stampa, 1962 – (f. 3)⁸. Duket se një problem i madh është edhe ai i përdorimit të fjalëve të marra nga gjuha angleze, “*Week-end e fine settimana*”, “Il Corriere della Sera”, 1963 – (f. 3) ose përshtatja e tyre morfologjike në gjuhën italiane, “*Il Week-end o l’Week-end?*”, “Corriere della Sera”, 1963 – (f. 5)⁹. Ky fakt na lë të kuptojmë se rrjedha e gjuhëve

⁷ Eqrem Çabej, *Për pastërtinë e gjuhës*, në ‘Gjuha Jonë’, nr. 1, 1981, f. 37.

⁸ Felitta Carrafiello, *Questioni linguistiche nella stampa quotidiana italiana*, në ‘Aspetti sociolinguistici nell’Italia contemporanea’, Bulzoni, Roma, 1977, f. 594.

⁹ Felitta Carrafiello, *Questioni linguistiche nella stampa quotidiana italiana*, në ‘Aspetti sociolinguistici nell’Italia contemporanea’, Bulzoni, Roma, 1977, f. 598.

është pak a shumë e njëjtë: gjithmonë ekziston një gjuhë më me prestigj që ndikon në të tjerat.

Në fondin e vet leksikor, gjuha shqipe përmban një numër të konsiderueshëm italianizmash, numër i cili ka ardhur gjithnjë e në rritje. Aktualisht, nga kontaktet e shumëfishta, po vërejmë një shtim të numrit dhe të përdorimit të fjalëve me prejardhje nga italishtja. Këto fjalë tek kalojnë në gjuhën tonë pësojnë ndryshime të shumta. Gjuhëtarët kanë nxjerrë në pah dhe shqyrtuar dy korpusë leksikore me prejardhje funksionale të ndryshme: a) korpusi i parë, është një listë me 2000 fjalë, i përgatitur nga një grup gjuhëtarësh italianë, b) korpusi i dytë, në të cilin përfshihen huazimet që studiuesit i konsiderojnë italianizma.¹⁰

Mund të themi pra, që vërshimi i fjalëve të huaja është edhe një formë mode e diktuar nga gjuhët e mëdha dhe nga prestigji që ato gëzojnë, jo vetëm ndër ne, por edhe në vende a kultura të krahasueshme me tonën. Pra, krahas huazimeve që hyjnë në gjuhën marrëse si rezultat i një nevoje a kërkese të momentit, kemi edhe një sërë fjalësh që hyjnë, falë një tendence a mode në përdorim. Përmendim këtu format përshëndetëse me prejardhje nga italiashtja, ‘*ciao*’ e cila shpeshherë përdoren përkrah formës shqipe ‘*pashim*’, ‘*paçim*’. Kjo formë është bërë kaq e zakonshme, saqë shpesh e dëgjojmë në gojën edhe të njerëzve të cilët nuk dinë të flasin e komunikojnë në gjuhën italiane. Duket deri diku edhe qesharake ta dëgjojmë nga goja e gjyshërve tanë. Sjellim në vijim disa shembuj që ilustrojnë përdorimin të mbivendosur të fjalës shqipe dhe përgjegjëses së saj në gjuhë të huaj, në rastin tonë gjuhës italiane. Kështu vazhdojnë të përdoren *influencon* e *influcë* (ndikoj, ndikim), *uniform* (i njëtrajtshëm), *dimensione* (përmasa), *eksperiencë* (përvojë), *inspirohem* (frymëzohem), *evidentohet* (vihet në dukje), *mentalitet* (mendësi), *superioritet* (epërsi), *kurioz* (kureshtar), *distancë* (largësi), *aktivitet* (veprimtari) etj. etj.

Prof. dr. Gjovalin Shkurtaç, thekson, se kemi të bëjmë me një rikthim të fjalëve të huaja, pasi ato ishin zëvendësuar me fjalë amtare apo të krijuara, sipas gjedheve me brumin e shqipes. Kjo, përbën një dëm të jashtëzakonshëm dhe një tregues të qëndrimit të papërgjegjshëm të shtetit dhe të shoqërisë shqiptare ndaj gjuhës.¹¹ Këtu duhet theksuar edhe diçka tjetër. Shpesh, ngaqë nuk njihet mirë kuptimi i fjalëve të huaja dhe duke

¹⁰ Artan Fida, *Disa interferenca leksikore gjatë nxënies së huazimeve italiane*, në ‘Rreth huazimeve në shqipen standarde’, Akte të sem. të 3-të, Pegi, Tiranë, 2004, f. 106.

¹¹ Gjovalin Shkurtaç, *Trysnia e huaj dhe qëndresa e shqipes*, në ‘Rreth huazimeve në shqipen standarde’, Akte të seminarit të 3-të, Pegi, Tiranë, 2004, f. 22.

pasur fjalë që janë të ngjashme fonetikisht me njëra- tjetrën, mund të përdoren gabimisht në vendin e anasjelltë. P. sh. *adaptoj* – *adoptoj*; *konfirmoj* – *komfirmoj*.¹²

Ne shqiptarët, përveç se jemi përtacë të fortë, mbajmë edhe kokën lart. E shohim nevojën e të mësuarit të rregullave të një gjuhe vetëm kur dëshirojmë të mësojmë një gjuhë të huaj, porse kur flitet për rregullat e gramatikën e gjuhës sonë, askush nuk i përvishet punës dhe askush nuk pohon se ka nevojë t'i mësojë, duke pretenduar se tashmë i di mirë¹³.

¹² Miço Samara, *Norma leksikore, pastrimi e pasurimi i leksikut të gjuhës së sotme dhe letrare shqipe*, në 'Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë', nr. 7 – ShBLSh, Tiranë, 1981, f. 43.

¹³ Iris, (Justin Rrota), *Rreth problemit të gjuhës letrare*, në 'Hylli i Dritës', 1931/VII, Nr. 3, f. 126.

BIBLIOGRAFI:

1. Roberto Gusmani, *Interlinguistica*, në 'Linguistica storica', ed. R. Lazzeroni, Roma, 1989.
2. Gjovalin Shkurtaj, *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006.
3. Ulrich Weinreich, *Languages in contact. Findings and problems*, New York, 1953.
4. Paola Cotticelli, *Interferenza në Dispense di Linguistica storica 2011/2012*.
5. Emil Lafe, *Pastërtia e gjuhës në kohën tonë si detyrë gjuhësore dhe kombëtare*, në 'Gjuha jonë', Viti XII, Nr. 3-4/ 1992.
6. Eqrem Çabej, *Për pastërtinë e gjuhës*, në 'Gjuha Jonë', nr. 1, 1981.
7. Felitta Carrafiello, *Questioni linguistiche nella stampa quotidiana italiana*, në 'Aspetti sociolinguistici nell'Italia contemporanea', Bulzoni, Roma, 1977.
8. Artan Fida, *Disa interferenca leksikore gjatë nxënies së huazimeve italiane*, në 'Rreth huazimeve në shqipen standarde', Akte të sem. të 3-të, Pegi, Tiranë, 2004.
9. Gjovalin Shkurtaj, *Trysnia e huaj dhe qëndresa e shqipes*, në 'Rreth huazimeve në shqipen standarde', Akte të seminarit të 3-të, Pegi, Tiranë, 2004.
10. Miço Samara, *Norma leksikore, pastrimi e pasurimi i leksikut të gjuhës së sotme dhe letrare shqipe*, në 'Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë', nr. 7 – ShBLSh, Tiranë, 1981.
11. Iris, (Justin Rrota), *Rreth problemit të gjuhës letrare*, në 'Hylli i Dritës', 1931/VII, Nr. 3.

**Mutual influence between languages - Italian borrowings
in albanian language**

ABSTRACT

Albania and Italy are two countries in permanent contact with each other, since the time of Latin-Roman influence. The density of the exchanges has certainly brought about influences in Albanian, spoken and written. Borrowings in Albanian language are often seen positively, but Albanian speakers at certain times have raised concerns about the lack of foreign words, as a substitute for the existing words in our language.

Jonida CUNGU

SHPREHËSIA LEKSIKORE E POEZISË SË ILIRJANA SULKUQIT

Nga jeta dhe vepra e Ilirjana Sulkuqit

Duke dëgjuar Ilirianën, të bën përshtypje energjia e saj, e cila shprehet në çdo tingull zëri, mbi pasionin për poezinë dhe mallin për vendlindjen. Me vitet mbi shpinë, duket se mbart kujtimet më të ëmbla nga ky vend, të cilat i reflekton në bisedat e saj.

Ilirjana Sulkuqi e nisi karrierën e saj profesionale si oficere e ushtrisë shqiptare, por që sot njihet jo më si nënkolonele, por si një poeteshë e suksesshme. E lindur në vitin 1951 në qytetin e Elbasanit, përfaqëson atë plejadë autorësh, të cilët e shfaqën krijmtarinë si një pasion të kahershëm dhe të përhershëm, pavarësisht profesionit të tyre.

E edukuar fillimisht në shkollat e qytetit të Elbasanit, studimet e mëvonshme i kryen në Akademinë Ushtarake të Forcave Tokësore në Tiranë. Disa vite më vonë do të konkretizojë studimet në drejtim të pasionit të saj, letërsisë, si dhe do të angazhohet me Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, në të cilën ka lënë gjurmët e thella si krijuese letrare.

Krijmtaria e saj ka filluar që në fëmijërinë e hershme dhe do të përsosej nga njëri vit në tjetrin e nga një krijim në tjetrin. Fituese e disa çmimeve kombëtare në Shqipëri e jashtë saj, Ilirjana Sulkuqi ka prezantuar dhe prezanton denjësisht penën artistike të krijuesve të Elbasanit. Titujt e botuar prej saj arrijnë në disa (afro 17 vepra të botuara), duke realizuar kornizën e plotë të krijimeve letraro-artistike, kryesisht me poezi.

“Jeta shëtiti nëpër ëndrra”

Vëllimi i fundit me poezi “Jeta shëtiti nëpër ëndrra”, botuar në 2016, vjen i organizuar me katër krerë: “Para dha pasthënie”, “Jam ju. Tani, shamëni!”, “Hymni i mallit” dhe “Mall nga ‘sirtari’ i Malli-t”. Në afro 200 poezi të shkruara jepet një botë me mendime e emocione të thella për njerëzit, natyrën, dashurinë, fëmijët e lulet, vendlindjen e gjithçka që e rrethon në jetën e saj në mes të dy dashurive të mëdha. Përmbledhjet poetike janë kryesisht të një karakteri meditativ, të mbushura me ndjenja,

mendime e kujtime të autores, që shfaqen herë me forcën e mallit dhe herë me forcën e dëshirës. Motivët tematike të tipit: dashuri, kohë, jetë, vdekje, mall, lot etj., nxjerrin në pah karakterin unik të fjalës së shkruar të Sulkuqit, e cila edhe pse është e thjeshtë, gërshetohet në zinxhirin e harmonisë figurative.

Mozaiku poetik në veprën e Ilirjana Sulkuqit, përcjell forcën poetike të ndjenjës së dashurisë dhe mallit. Çdo fjalë në poezitë e saj është e zakonshme, por e skalitur me mjeshtëri modeste. Në një vështrim të përgjithshëm, tematikat e poezive janë mbi ndjeshmërinë shpirtërore të autores, mbi dhembjet dhe gërvishtjet shpirtërore për atdheun, mbi familjen, shokët, miqtë, të afërmit dhe mbi të gjitha, për mallin.

Mbi pasurinë leksikore dhe semantike në poezinë e Sulkuqit

Në poezinë e saj vërehet një ndërthurje e zbrazëtisë leksikore me fuqinë e ngarkesës maksimale poetike. Pak vargje, pak fjalë, por të vendosura në funksion të plotë të përsosmërisë poetike të vargut. Këtë gjë autorja e arrin nëpërmjet përzgjedhjes dhe shfrytëzimit me origjinalitet të leksikut potencial, i cili përfshin leksikun dialektor që mund të përfshihet në sistemin e gjuhës letrare, rigjallërimin e leksikut të vjetëruar apo mundësinë e gjuhës për hartimin e njësive të reja leksikore¹.

“Më mjafton/ dheu i varrit,/ mbi Dashuri/ baltë, mos më hidhni.”

“Nga heshnja e fjalës,/ m’u trishtua nata.../ dhe iku.”

“M’u lëmushk muzgu,/ i shpresës/ dhe në ardhsha e rilindur,/ përkundmëni me/ djep tjetër!”

Edhe pse me fjalë të kursyera, shprehësia leksikore jepet e pasur dhe e plotë, për shkak të përzgjedhjes së kujdesshme të leksemave, të cilat krijojnë shumanshmëri lidhjesh kuptimore. Në të gjejmë përpjekjen për të sjellë gjedhe të reja fjalëformuese, të cilat tregojnë dinamikën e gjuhës të përdorur në vargjet e poezive, si p.sh.:

“Në pragnatë të pres”; “... dhe mbeti dritëzbrazur”; “... në udhëshpirti”; “...syliku nxiu”; “pasqyra-vajzëri”; “rrobat-gjyshe”; “dhe mbeti dritëzbrazur”; “... ti ëndrrakëngë” etj.

Si burim shprehësie janë përdorur dhe një kategori neologjizmesh, të cilat janë ndërtuar me ndajshesa, si: *bukurisht*, *përditërisht*, *verdharakja*, *djallushkë*, “Na *ermoni* një aromë”; “M’u lëmushk² muzgu”, etj. Ato kanë

¹ J.Thomai, “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, fq.188-189.

² Shënim: Në “Fjalor i gjuhës shqipe” 2006, njësia leksikore “lëmushk” jepet si emër, ndërsa në poezi e gjejmë të përdorur si folje.

jo vetëm funksion artistik për t'i dhënë shprehësi poetike vargut, por shihen edhe si burime të vyera për pasurimin e leksikut të shqipes.

Një nga burimet e shprehësisë leksikore në poezitë e Sulkuqit është dhe larmia stilistikore e fjalëve, të cilat pasqyrojnë dhe ndikimin e faktorëve psikologjikë. Mjetet gjuhësore që përdor autorja janë zgjedhur me kujdes nga thesari i shqipes, si nga shprehësia ashtu dhe nga tingëllimi, për të na shërbyer artistikisht përmbajtjen. Dhimbja, loti, malli, dashuria, erotika janë referime të qëndrimeve emocionale të autores. Emocionaliteti i vargut dallohet në zgjerimin fushës semantike të njësive të përdorura, të cilat i ka shprehur nëpërmjet krijimit të neologjizmave. Si burim për pasurimin e shprehësisë leksikore në vargje, poetja është mbështetur në krijimin dhe përdorimin e kompozitave, të cilat janë ndërtuar mbi njësimin e së vjetrës me të renë, ose si fjalë të përbëra me gjymtyrë të barasvlershme që përcaktojnë njësoj njëra-tjetrën³. Këto të fundit janë dhe lloji më prodhimtar në poezinë e Sulkuqit, si:

“...me prangëdhimbjet që ju gjeta...”/ “Nëse më zgjon sot e pasmot/me heshtje-dhimbje, dashuri...”/ “...nga rrotull-boshëzat e tua”/ “Nga mushti i shpirtit, ngjyrëshpirti mbeti...”/ “Që thu ti pranverëz-njomë”/ “Dë fëmijë i linda, nga pakditët-grua”/ “Njeri harkdrejt vdekjes”/ “Flurudhë me shkronjësi...”/ “...po pij burim-burimburuar...”.

Pjesa e parë e librit do të fillojë me kreun **“Para dhe pasthënie”**, e cila ka 73 poezi. Tipar i burimit të shprehësisë në kreun e parë, janë opozicionet dhe antonimia kuptimore, të cilat vërehen që në titullin e zgjedhur. Fjalë dhe mendime të shkurtra, të cilat japin një emocion të vrullshëm, ka qenë përzgjedhja e poetes për të shprehur më fuqishëm ligjërimin me anë të antonimeve konteksture .

“Një ditë botës/ mendja do t’i vijë.../ dhe do të qeshë duke qarë...”

“Dielli u dogj brenda vetes.../ hëna m’u ftoh nëpër duar.../ U putha a s’u putha...”

“Tepër shpejt më erdhi mbrëmja.../tepër vonë të shkrijë çka ngriu...”

“Lakuriqësisë/ i veshja rrobat e lakuriqit,/ ...dhe mbylla dritaret e natës.”

Por, ka edhe poezi të tjera (kreu “Jam ju, tani, shamëni...”), të cilat janë në kufijtë e kundërvënieve kuptimore të antonimeve, duke treguar se njeriu mund të gjendet në dy anët e jetës i sfiduar dhe i mundur nga pikëpyetja e madhe, se në cilën anë duhet të drejtohet. Efekti shprehës i antitezave, e bashkon më tepër lexuesin me poezinë, në të cilat e gjen veten në mënyrë të përsëritur si personazh të saj.

³ J.Thomai, “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, Tiranë, 2011, f.183.

“Ik,/ duhet të ikësh.../ Eja,/ duhet të vish.../ Ik, s’mund të rrish më tepër.../ Mos ik, pa ty s’mund të rri!/ Ik.../ Eja.../ Eja.../ Ik.../ As natë.../ as zgjim... “Se të vjen dimër në behar...”/ “Për hir tingujsh/ qava, qesha...”

Çdo poezi në këtë kre karakterizohet nga një unikalitet i veçantë shprehësie leksikore dhe semantike, në të cilat opozicionet dhe antonimet kuptimore shërbejnë për të treguar karakterin sfidues të jetës njerëzore ndaj çdo qenieje. Mjetet leksikore të shfrytëzuara dhe të krijuara shërbejnë për të treguar jo vetëm karakterin individual poetik të autores, por edhe për të rrëzuar poshtë anormalitetin që ekziston brenda karakterit e mendësisë shoqërore, që në thelb është indiferente ndaj paradokseve jetësore, ku aktorët dhe viktimat janë qeniet njerëzore.

Poezia e Ilirjanës është një poezi e metaforës, e cila ndjehet në çdo varg të saj. Lëvizjet kuptimore të realizuara kanë rritur aftësinë shënuese të fjalës dhe e sjellin atë të realizuar në disa trope gjuhësore. Përpos metaforës, në poezitë e kreut të parë zë një vend të rëndësishëm simboli. Ato paraqiten sipas natyrave të ndryshme, por kryesisht simboli ka natyrë universale: galaktika, Zoti, bota, hapësira, koha, yllësi etj. Çdo efekt figuracioni arrihet vetëm nëpërmjet përzgjedhjes së leksemave. Ashtu siç shprehet dhe F.Terziu “Dhe kjo vjen në pak vargje që prodhon Iliriana Sulkuqi. Në pak vargje që vijnë nga një arsye. Në pak vargje që shpërthejnë fjalën. Fjala, e gjitha në një gjuhë. Në gjuhën moderne të filozofisë poetike”⁴.

Nga pikëpamja morfostilistikore të bie në sy përdorimi i foljes me larmi të gjerë stilistikore. Në disa vargje, realizimi i vetës së parë të lë shijen e një monologu në poezi, duke rritur dramacitetin e shprehësisë, e cila vjen si klithma dhembjesh. Por me interes është përdorimi i foljes në mënyrën habitore, dëshirore, si dhe i trajtës pësore të foljes, të cilat e dërgojnë poeten në një udhëtim sfidues për të njohur veten, për t’u rishfaqur në një tjetër formë për veten dhe për lexuesin.

“...gjakosa dhimbjen...”; “veç mos ardh të dita ime...”; “prit më...t’i marr leje vetes...”; “dielli u dogj brenda vetes.../hëna m’u ftoh nëpër duar”; m’u lëmyshk muzgu i shpresës”; “m’u trishtua nata”; “të vdiskam – tri jetë m’u dashkan”; “toka s’më mbaka...”;

Kreu i dytë fillon me gjuhë të fortë, me fjalë dënuese, të cilat me modesti ia drejton vetes e më pas të tjerëve. E shfaqur modeste dhe e drejtpërdrejtë në vargje, Ilirjana grisht brengat e dhembjes për faktin se duhej të ishte grua, nënë dhe femër mbi rrugën e gabimeve. Ndjenja e altruizmit

⁴ Fatmir Terziu, “Kritika ndryshe. Vëzhgim në brendësi të prozës e poezisë shqiptare”, 2010, fq.283.

përshkruan vargjet e saj, për të na treguar se përsosmëria nuk është virtyt njerëzor, e për rrjedhojë, çdokush mund ta gjykojë me doza ashpërsie të pamatshme, pasi edhe Ilirjana është një nga ne. Stilistikisht është realizuar me përdorimin e foljeve në mënyrën urdhërore, që kanë në trup të tyre trajtat e shkurtra të përemrit vetor, me qëllim që ashpërsia e gjykimit njerëzor të fillojë nga vetë poetja.

“Mbi rrugën e gabimeve të mia/ bëra gruan/ bëra nënën/ trajtëzova femrën”.

“Jam Ju./ Tani, shamëni...”; “Gënjemë me fjalëza përralle...”.

Poezitë e përmbledhura në kreun e dytë janë meditative, të shtruara, me ndjenja dhe mendime të forta poetike. Harmonia mes fjalës dhe mendimit është në një shkallë më të lartë, pasi shprehësia poetike gërshetohet me karakterin meditativ dhe tematikën e trajtuar. Ajo zgjedh një mënyrë poetike për të bashkëjetuar me fenomenet që e frymëzojnë gjithnjë. Dashuria, si ndjenja më sublimë e universale, do të zerë një vend të rëndësishëm. Mënyra se si trajtohet ndjenja e dashurisë është unike, ndaj dhe poetja dallon në unitetin poetik të pasqyruar në çdo varg të saj. Dashuria dashurohet, bëhet e bukur, vjen, kritikohet, dhemb, urrëhet, jeton te autorja që nga vajzëria e hershme dhe deri tash që nuk dëshiron të veshë rrobat-gjyshe. Botëkuptimi për dashurinë jepet në të dy anët e jetës: ndërgjegjja e njeriut të jetë dashuri dhe prologu i jetës të rrëshqasë në dashuri. Edhe pse vitet ndihen në vargjet e Ilirjanës, të cilat i përmend shpesh në poezi të tilla si: *“Rrobat e vajzërisë/ s’më bëjnë më./ Fustanin e nusërisë, s’e prek dot.../ Rrobat-gjyshe./ nuk dua t’i vesh!”*, bashkërendon poezinë dhe jetën në tri dimensione poetike, ku thelbi i secilit dimension është dashuria.

Ngjyrat e jetës ndjehen vrullshëm, edhe pse vitet nuk i takojnë më vajzërisë. Por frymëzimi poetik vazhdon të jetë i fuqishëm dhe më i përsosur se vitet e zjarra të vajzërisë. Pothuajse e gjithë poezia e poeteshës Ilirjana Sulkuqi, është ngjyra e gjuhës së të folurit me jetën, monolog që ecën rrugëve të jetës të mbushura me mall e dashuri, për të gjetur se ku e ka fundin. Dhe fundi i çdo gjëje dhe gjithkujt është “falja”. E kujdesshme aq sa i lejon vrulli poetik, autorja lejon ngjyrat shpirtërore për të mos ndëshkuar asnjë, as ato që kanë qenë shkaktarë të dhimbjes së saj, por të falë çdokënd, si vlefshmëri të dy dimensioneve jetike që kemi, botës së tanishme dhe botës së përtejme.

“Si femër/ do të më shani,/ për ç’ka s’ju dhashë të bukur.../

Si grua, burri im/ ka “të drejtë” të më qortojë.../

Si nënë,/ as fijen e rënë të flokut, s’ju lejoj!/

Si shoqe/ e le në dorën tuaj,/ më gjykoni...

...Dhe/ Ju/ Fal.”

Kreu i tretë “Hymni i mallit” është një grup poezish të dedikuara për vendin, për të dashurit, njerëzit e afërm, miqtë, idhujt e Ilirjanës. Simbolika e këtyre poezive është Malli. Kjo ndjenjë shfaqet në krijimet e poeteshës me natyrë universale. Ashtu si shkruan dhe Robert Goro⁵: “Një numër autorësh janë emra të njohur që në Shqipëri, të tjerë e “kanë shtruar” muzën e tyre në mëgrim. Kategoria tjetër, e konsideron të marrët me vjershërimin, si një lloj psikoterapie për të harruar vështirësitë e stërmundimet e mbijetesës në ditët tona”. Në këto marrëdhënie ne takojmë edhe krijuesen e kësaj lënde poetike, të druajtur, të mallëngjyer, shpresëthyer, por edhe kurajoze dhe të virtytshme në raste të tjera, ku gjen forcën dhe guximin për të përballuar të gjitha sfidat e vështirësitë.

“Malli qenka dhe i bukur.../ edhe pse të than si eshkë.../ Jeta vetë na qenka – mall/ Ndaj syhapur çdokush vdes.”

Karakteristikat stilistikore janë nën vijën e krerëve paraardhës, duke përdorur mënyrën habitore të foljes, kryesisht në vetën e parë njëjës, foljet në mënyrën urdhërore që kanë në trup të tyre trajtat e shkurtra të përemrit vetor, apo dhe përdorimin e neologjizmave, të tilla si: *portëmadhe-hapur; parathirorre; qingj-urtuar; këngëdhimbja* etj.

Gjatë kreut të tretë vërejmë se poezitë i kushtohen dikujt të afërt me të. Aty gjejmë vargje për nënën, fëmijët, nipërit, gjyshen, për qytetin e lindjes, apo për copëza të jetës që gjithnjë do t’i kujtojnë vendlindjen, si: Krasta, kalaja etj. Për poeten fjala “atdhe” konsiderohet intime, duke dashur të tregojë për lidhjen e ngushtë që ka njeriu me vendin e tij. Ajo shprehet se “Pra, Atdheu është si Atomi në një Molekulë-jete. Edhe krijimtaria aty nis dhe... aty mbaron.”⁶

“Vetëm nëna ma lexoi/ mallin në sy. Me shpirtin e saj-/ Fshij lotët e mi.”

“Vendlindja ime,/ jepmë pak ujë/ të laj sytë e lotëzuar.../ Një grysh dritë nga cdo shtëpi./ të ndricoj varret e harruar!...”

“Në heshtje varri-shoku im i rrallë/ Në frymë jete më bëhet përrallë.”

Në këto poezi e vargje ndjejmë entuziazmin dhe përkujdesjen e autores që ka guximin të niset si zogu në qiellin e kaltër për të shijuar ajrin, tokën, diellin dhe gjithë gëzimin e atdheut, ngrohtësinë atërore dhe ëmbëlsinë e lirisë shpirtërore. Larmia e këtitllë e temave që shtjellon poetesha në tokën e largët, krijon një imazh të jetës së tyre të përditshme, me mallin ndrydhur në shpirt, me dëshirat dhe ëndrrat e pashuara për vendlindjen, duke gjetur

⁵ “Antologjia”.

⁶ Intervistë e autores I.Sulkuqi për editor Tribon.

ngushëllimin te ditët e ardhshme të lumturisë së imagjinuar në vargun e tyre. Një shkëndi mbijetese ushqen në shpirtin e saj Ilirjana, që përkundër vështirësive dhe sakrificave të jetës në një botë të huaj, gjithmonë ka gjetur arsye për të mbushur shpirtin e saj të kapluar nga malli, duke thurur vargje e poezi, të cilat janë dekoruar me leksema të përzgjedhura nga fondi leksikor i shqipes.

Në kreun e katërt Ilirjana Sulkuqi do të përcjellë për lexuesin poezitë e përmbledhura nën titullin “**Mall nga “sirtari” i Malli-t...**”, me krijmtari të viteve ‘70-‘80. Poezia vjen e i bashkohet më tepër tradicionales, se sa kujtimeve të kohës për të treguar nostalgjinë e saj. Ajo është e organizuar në strofa të rregullta dhe vërejmë dhe përdorimin e rimës, e cila nuk është karakteristike e poezisë së saj. Ndërmjet, gjenden dhe disa krijime të Ilirjanës të realizuara në Greqi, vend në të cilin kaloi një pjesë të jetës. Ndaj dhe tematikat janë të larmishme, por që në thelb kanë ndjenjën e mallit.

Si përfundim: Poezia e Ilirjana Sulkuqit është një poezi meditative, ku në thelb të çdo vargu qëndrojnë figurat letrare të metaforës dhe simbolit. Shprehësia leksikore jepet e pasur dhe e plotë, për shkak të përzgjedhjes së kujdeshme të leksemave, të cilat krijojnë shumanshmëri lidhjesh kuptimore. Si burim shprehësie janë përdorur dhe një kategori neologjizmesh, të cilat janë ndërtuar si kompozita, ose si fjalë të formuara me ndajshesa.

Tipare të burimit të shprehësisë leksikore dhe semantike në vëllimin me poezi, janë opozicionet dhe antonimia kuptimore, që janë zgjedhur nga poetja për të shprehur më fuqishëm ligjërimin me anë të antonimeve konteksture. Nga pikëpamja morfostilistikore të bie në sy përdorimi i foljes me larmi të gjerë stilistikore, e cila më së shumti përdoret në mënyrën habitore, dëshirore dhe në mënyrën urdhërore që kanë në trup të tyre trajtat e shkurtra të përemrit vetor.

E shtruar, e menduar dhe me fjalë të zgjedhura, përshkon ndjenja të thella që janë në kufijtë e njerëzores. Poezia e Ilirjanës është në hapësirat mes asaj tradicionales dhe bashkëkohores, si për të ndarë edhe dy botët në të cilat ajo jeton. Qartësia ideore dhe realizimet kuptimore brenda vargjeve, shpeshherë janë të pakapshme nga lexuesi, duke bërë që mendja njerëzore të thellohet në domethënien e tyre. Metaforat dhe tematikat e trajtuara në formën e simbolit, kërkojnë një lexues të përgatitur e të sprovuar me vargun.

Struktura poetike e larmishme, është arritur të ruhet me mjeshtëri nga poetesha, duke ruajtur raporte të ekuilibruara ndërmjet tradicionales dhe bashkëkohores. Poezia e Ilirjanës rend pas emocioneve sikur vrapon

dashuria, dashuria e një gruaje fisnike, që vrapon pas ngjyrave të jetës të gjejë të humburën e njerëzores, për ta kthyer mes njerëzve, që bota të duket ndryshe. Ligjërimi poetik është i vullshëm dhe i larmishëm, edhe pse me fjalë e vargje të kursyera, mbart forcën poetike të një uni lirik të veçantë.

BIBLIOGRAFIA:

- **Androkli Kostallari**, “Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe”, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë 1972.
- **Anton Çefa**, “Poezia e Iliriana Sulkuqit dhe disa konsiderata për poezinë erotike në letërsinë tonë të traditës”, <http://www.zemrashqiptare.net>.
- Intervistë e autores Iliriana Sulkuqi per editor Tribon <http://iliriana-sulkuqi.blogspot.com/>
- **Jani Thomai**, “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, Tiranë 2011. “Fjalor i gjuhës shqipe” 2006
- **Fatmir Terziu**, “ KRITIKA NDRYSHE: -Vëzhgim në brendësi të prozës e poezisë shqiptare”.
- **Fatmir Terziu**, “Poezia. Haraçi tjetër për kohërat”.
- **Robert Goro**, “Antologjia”.
- **Xhevat Lloshi**, “Stilistika dhe pragmatika”.

Lexical expression of the poetry of Ilirjana Sulkuqi

ABSTRACT

This paper will draw on the description and interpretation of the lexical and semantic expression of Ilirjana Sulkuqi's poetry. Being one of the poets who has contributed a lot in the field of creativity in Elbasan city, this paper, aims to explore and observe the lexical and semantic expression of the work with the collection of poems "Life Rolls through Dreams", "Jeta shëtit nëpër ëndrra".

Sulkuqi's poetic momentum will appear in her poems, where her spared words carry a heavy weight and constitute the poet's lyrical self. The diverse poetic structure has been skillfully preserved, maintaining balanced relations between the traditional and the contemporary. The creation of lexical and semantic expression is reflected in the use of the (ordinary) dialectical lexicon, which is poetized by the use of linguistic elements selected by the author.

The sources of the lexical and semantic expression of Sulkuq's poetry rely on the use of contextual antonymy, synonymy, as well as the figure of metaphor and symbol. They are realized through the flow of neologisms and the creation of compositions, giving poems with an abundantly rich lexicon.

Key words: lexemes, antonyms, neologisms, meditative, traditional.

Alfred ÇAPALIKU

PËRKTHIMET E KOLË THAÇIT

“Ushqye me vepra autorësh klasikë, Kolë Thaçi diji e i mbrijti me perdorë me shum mjeshtri, nder perkëthime e vepra origjinale, trajta fort të vshtira qi dukeshin të papërshtatshme për giuhën t’ onë.”

Revista “Kumbona e së Diellës”

Studiuesja Miaser Dibra, më 1996, në Shkodër, tek një libër me artikuj shkencorë dhe me ese kushtuar vlerave të qëndrueshme poetike shprehur tek autorët më në zë të viteve ’20 - ’30, analizon funksionimin e rrjetit kulturor përmes marrëdhënieve letrare në fillim të shekullit XX tek ne: *“Edhe në fushën e përkthimeve Shkodra u shqua në dy aspekte: së pari përkthyes të talentuar, njohës të mirë të gjuhëve të huaja botuan dhjetëra romane, drama, vepra historike dhe së dyti spikati aftësia e tyre për të zgjedhë nga letërsia botërore vepra me vlera që ndihmonin zgjerimin e horizontit të lexuesve dhe përparimin e shoqërisë shqiptare të kohës. Gjergj Fishta përkthen nga Moliere, Rondino, Manzoni, Homeri; Hilë Mosi nga Shileri, Goldoni, Kornei; Lazër Shantoja nga Shileri, Gianini, Gëte; Kolë Thaçi nga Metastazi; Vinçenc Prennushi nga Rolando, Wiseman, Silvio Pellico, Petrarka; Karl Gurakuqi nga Edmond De Amiçis, Barcata e përkthime me karakter historik.”* (1)

“SH’ EUSTAKI O FAMILJA E MARTIRVE”

Kjo tragjedi e shkruar nga ipeshkvi italian Filippo Allegro i Albengës, që ngërthen pesë akte, në dyzet e tetë skena veprimi, u përkthye në vargje 11 rrokjesh nga Kolë Thaçi, kur ai ishte mësues në Kolegjin e Sh’ Françesk Saverit. Vepra qe botuar nga Imzot Filippo Allegro në tipografinë Cravioto të Albengës, Itali, më 1877. Ngjarjet zhvillohen në Romë në shekullin e dytë, kur perandori pagan Trajan mbante si krah të djathtë fisnikun Placidus, fitimtar betejash. Por kur ai u pagëzua me emrin Eustak, u ndesh me mërinë e Trajanit, që e dëboi në malet e Velturinit, larg bijve: Agapitit dhe Teopistit. Gruaja e tij besnike, përqafuese e fesë së re, Teopista martirizohet, por Eustaki i internuar tepër larg nuk di gjë për këtë sakrifikim. Vetminë në rrëpirën izoluese ai e duron bashkë me shërbëtorin e

familjes, Faustin. Rreziku i madh i sulmit të Romës nga barbarët e furishëm e bën Trajanin të përulet dhe, përmes një lajmëtari, e thërret Eustakin si komandant ushtrie. Ai rivjen në pallat, e pranon detyrën, por jo kushtin e mohimit të Zotit. Pavarësisht këshillave të bujarit dhe mikut të tij Prisku, ai këmbëngul me dinjitet, gjer në përballjen me dënimin kapital të perandorit. Ekzekutimi kryhet nga rivali intrigant i Eustakit, Gjani që nuk kursen as dy djemtë e vegjël dhe as shërbëtorin plak. Kështu e gjithë familja derdh pa droje gjakun e saj, si farë martirësh në themelet e fesë.

Sapo libri i përkthyer nga Kolë Thaçi (Shkodër, 2 dhjetor 1886 – Tiranë, 14 korrik 1941) doli në qarkullim publik në fillim të prillit 1909 në Shkodër, revista “Elçija e Zemërs J. Krishtit” i bëri atij këtë vlerësim pozitiv:

“Per çka diim na, s’ka pas kurr deri tash von giuha e jonë as drama as komedii as tragedii. Komediiin e paar (Besa) e shtypshkruenë Toskt, n’v. 1901 (është tragjedi, shënimi im); tragediiin e paar, Sh’ Eustakin, e çiti tash Vepra Pijore... Si per sende t’nalta qi çfaq kio tragedii si edhe per giuh t’bukur me t’cillen à çitun kena rrugë me thanë se à njimend pun’e madhe per letratyrë t’onë. I lumt Zotn. Kol Thaçit i cilli neper vshtiriina shum ja mrrini me e perkthye aq mirë!” (2)

Por edhe më 1915 revista “Perparimi” do ta vazhdonte jehonën e kësaj ngjarjeje kulturore- teatrore të paharrueshme:

“Per tragediiin e Eustakit është ankue ndokush per dy arsyena: e para, prej fjalve t’reja teprii qi perkthyesi ka kllasë mrënde, e dyta, prej t’dredhunit t’fjalve. E na ja dim per ndeer perkthyesit, qi kaa diit me i gjue nder libra ato fjalë t’bukura t’tana shqyp, e na i ka qitë n’ dritë... Por qe nomi si me i marshtrve fjalët e njimdhetrrroksit. Pik s’parit vëhet subjekti, mandej verbi, ne e mram predikati, se e cilla pjesë e propozicionit me perkryesa t’veta, b. f. :

*Eustaki: ... E krahit
Edhe e hershme fuqia s’është e fikun
Prej t’tretunit. Per jetë e dekë nuk leva
Un’t prujta. M’a ndiin zemra. O i bardhë kù fati
Ësht o nder t’forta vepera, gjallimin
Do t’bàj, o se do t’mes.”* Faqe 11. (3)

Ndërsa në vitet ’50, në Romë, shkrimtari dhe studiuesi Ernest Koliqi zbuloi vlerat artistike të përkthimit mjeshëtor ku:

“Thaçi del në vargje të papritura të një bukurije të rrallë e mahnitëse:

Trajani: Hiret e mija o mnin?

Eustaki: Per n'kjoft' se hiret

Me i ble sot duhet veç pervars t'u ba.

Hiret s'ti due.

Trajani: Po mnin qi m'vlon e hujin Ti n'droj s'i paske?

Eustaki: Fort ma i rrebt se i yti

I qiells idhnimi mue m'shiron.” Faqe 93. (4)

Më 2007, në Hamburg, albanologu gjerman Markus W. E. Peters, vlerat tipike gjuhësore të sjelljes në shqip të kësaj vepre melodramatike i trajton edhe si kulturë personale e Thaçit:

“Merita e veçantë e përkthyesit qëndron në faktin që ai e ka shfrytëzuar mirë lirinë e përkthyesit dhe nëpërmjet fjalorit “të rizbuluar” nga ai i shqipes së vjetër dhe të gjuhës moderne shqipe ka hapur dhe ka bërë të përdorshëm një thesar të ri fjalësh.” (5)

Nga 80 fjalët e zorshme (apo të vështira pikërisht se janë të rralla), që shpjegohen në fund të librit, 28 prej tyre nuk gjenden tek “Fialuer i Rii i Schypès” i 9 janarit 1908 i botuar nga shoqëria “Bashkimi” në Shkodër. Ato janë pronë e thesariusit aktiv personal të Kolë Thaçit, që ai i vë në shërbim të përdorimit masiv popullor:

1. Ahmarrje - t' marrunit e gjakut e t' uhàs.
2. Aht - t' hjekun, fshamë.
3. Brue - kerkues.
4. Burrojë - balcue.
5. Dermue (m' u) - m' u ulë.
6. Dermore - hov.
7. Dindë (me) - me çue peshë.
8. Ferfelitë (me) - me shndritë.
9. Galdim - gzim i math.
10. Gnjye (me) - me trathtue.
11. Gorromisë (me) - me pshtjellë.
12. Harè - shénd.
13. Lartsue (me) - me neltue.
14. Lipsì - dhimë.

15. Ngallnim - çelëng, lumni.
16. Nojmë - diftim.
17. Perbindsh - mahlukat.
18. Pervarsë - fëlshues.
19. Polem - popull.
20. Sodak - kurban.
21. Strokull - shpellë.
22. Shkerbàe - përbindsh.
23. Shkerbaltë - shmije. (Shmije – shemti, shën. im).
24. Terrtim - idhnim.
25. Tranditë (me) - m' u tundë, m' u trand.
26. Tutundzë - t' rrahunit e zëmres.
27. Vezullue (me) - me shndritë.
28. Vrenue (me) - me caktue.

“ZEFI I NJOFTUN”

Brenda vitit 1909 Kolë Thaçi, “Shok i Rrethit Sh’Jozefit”, iu paraqit artdashësve edhe me përkthimin në vargje njëmbëdhjetërokëshe të pjesës dramatike të poetit italian Pietro Metastasio (1698 – 1782). Melodrama, e publikur më 1736 nga autori iluminist, u dha si premierë në Venecia më 1742, me muzikë të kompozitorit Paolo Scalabrini. Subjekti merret nga “Besëlidhja e Vjetër. Libri i Zanafillës”. Autori e përshkruan Jozefin 17 vjeçar, birin e Jakobit dhe Raketës, të drejtë, të urtë, të zgjuar dhe zemërbutë. Këto cilësi zgjojnë smirën e vëllezërve thjeshtë, Judës e Simeonit, bijve të Jakobit dhe të Lisë, të cilët e shesin tek tregtarët ismaelitë. Pas shumë peripecive Jozefi arrin të bëhet më i besuari i faraonit. Por ai s’ hakmerret dot ndaj të dy vëllezërve nga babai:

*“Zefi: - Do t’ jeem si nanë e dashtun
 Qi t’ kandshmit fmii i kercnohet,
 E e ban paa prà me drashtun
 Por kurr nuk e ndeshkon.
 Me raa me theer çon doren,
 por nuk e sbritë fuqija;
 pse doren vaar dashtnija
 gati me theer kuur don.”* Faqet 36 – 37.

Zefi i ndihmon ata në mjerim, duke u kërkuar që të sjellin në pallat Beniaminin, vëllain e tij të vogël. Ky takim e zbut përfundimisht zemrën e

Zefit. Ai zbulohet para dy të penduarve, Judës dhe Simeonit, duke gëzuar pa masë edhe babain Jakob. Të katër vëllezërit hedhin së bashku një valle që e mbyll krejt veprimin skenik:

*“I marrë kush ngrehë mëndimin
Kundra kshilleve t’Naltit. Vetë nder gropa
Qi çilë per dam t’ saa tjerve,
Ma i urti bjen, hutohet mrendë e mytet.
Veç me drejtsii virtytet
Çohen si palma t’nalta
Me sa fuqii, kur i dermon shkerbalta.”* Faqe 52.

Ngjarjet plot ulje - ngritje zhvillohen në Menf, në praninë e Asenetës, gruas së Zefit dhe të Tanetit, shërbëtorit të tij.

Më 1934, në Shkodër në një tekst mësimor për shkollat e mesme, studiuesi Justin Rrota e ka përcaktuar me ilustrim autori llojin e melodramës, si një:

“... hartim dramatik, qi perciellet krejt a pjesërisht me muzikë; d.m.th. se është një dram muzikuer, qi sod e thirrin librec. Nen ketë pikpamje janë të permenduna dramet e Metastasisit.” (6)

Më 1942, në Shkodër, studiuesi Kolë Ashta e ka pikëzuar venën artistike të Kolë Thaçit në kulminacionet e procesit përkthimor binar:

“Personaliteti letrar i Thaçit paraqitet kryesisht lirik... Thaçi ndien një afërsi shpirtnore me veprat e Melodramaturgut të vlerë. Metastasio, sikur se Thaçi, gjindet po në të njëjtën kohë kalimi dhe është aj njeri qi paraqet gjendjen e kalimit në mes një letërsije të vjetër kah një letërsi e rë.” (7)

Më 2009, në Romë, studiuesja Alma Hafizi, e ka theksuar teknikën specifike gjuhësore të Thaçit gjatë shqipërimit të saktë, model:

“U dallua në përkthimin e “Zefit të njoftun” duke sjellë me origjinalitet në shqip skema strofike me perfeksion të lartë metrik, mjeshtëri vjershërimi, frymëmarrje të madhe frazash. Stili poetik i rafinuar dhe i përpunuar i veprave të Metastasio në variantin shqip ka krijuar, pa dyshim, terrenin e favorshëm për sjelljen e veprave të mëdha klasike, ka dëshmuar ekzistencën e një gjuhe të aftë për të tejkaluar çdo

provë artistike.” (8)

Vënia në skenë, në Shkodër, në vitin 1909, e dy pjesëve teatrore të autorëve italianë Filippo Alegro dhe Pietro Metastasio, që mbanin vulën e dallueshme përkthimore të Kolë Thaçit, shënuan dy ngjarje të rëndësishme kulturore. Të dy spektaklet u mbajtën mend gjatë dhe u diskutuan shpesh. Salloni i parë teatror në historinë e Shqipërisë qe ngritur në Kolegjin Saverian qysh më 1890. Palku e ndryshonte pamjen nga akti në akt, në sajë të skenografisë portative të punuar mjeshtërisht nga piktori Kolë Idromeno. Në atë dekor plot ritëm, aktrimi mashkullor bëhej i besueshëm edhe prej kostumografisë që u përshtatej roleve të aktorëve të rinj. Interpretimin amator, shoqëruar me elemente makiazhi e me mjete parukerie, e mbikëqyrte me kujdes regjisori Fratel Gjon Pantalija S. J.. Fondali ndriçohej me kandila vajguri. Nganjëherë ndër shfaqje realizoheshin efekte skenike, kryesisht imitime të fenomeneve të natyrës dhe konkretizime zhurmash tipike mjedisi. Pjesët shoqëroheshin me këngë e me valle. Kuintat e paravendosura që hapeshin e mbylleshin në fillim e në fund të çdo pjese, ishin të vizatuara artistikisht me dy shtylla të lidhura mes tyre me kordonë të artë. Arsimtari erudit Kolë Thaçi, me vënie në skenë të tragjedisë së Filippo Allegros dhe të melodramës së Pietro Metastasio, e përdori teatrin si një mjet pedagogjik, që i shërbente formimit të nxënësve, si një mjet artistik që i shërbente kulturimit të prindërve të tyre dhe si një mjet moralistik që i shërbente edukimit të spektatorëve të Shkodrës në sallën 450 vendesh të mbushur përherë plot e përplot. Dy pjesët që panë dritën e skenës u përzgjedhën me këto tri kritere nga përkthyesi Kolë Thaçi. Ato spektakle artistike paraprinë zhvillimin e dramaturgjisë shqipe në prag të Pavarësisë. Të dyja pjesët dramatike sjellë në shqip nga Thaçi hynë me dinjitet në traditën e përkthimit, si modele të ndërthurura bukur të monologut me dialogun.

Pas viteve 1909 – 1911, njohësi i mirë i italishtes, i frëngjishtes, i gjermanishtes Kolë Thaçi u largua nga fusha e përkthimeve teatrore të dramës. Ai nisi të lëvrojë publicistikën në vitet 1914, 1915 dhe 1916. Më pas iu përkushtua poezisë, posaçërisht poemës, gjatë viteve 1916, 1917, 1918, 1921, 1936, 1937. Ndërkohë njohësi i mirë edhe i turqishtes Kolë Thaçi u përpoq mjaft në rrafshin krahasues mes gjuhës turke dhe asaj shqipe gjatë përkthimit, kur hartoi librin zyrtar “*Kanun’ i doganës josë administrimi doganuer në Shqipënië, i shvilluem mbas ligjëve e rregulloreve të doganave otomane të perparëshme*”. Ai qe një kod sa i nevojshëm aq edhe i domosdoshëm për tregtinë e shtetit të ri shqiptar. Vepra u botua në Shkodër në vitin 1920 dhe u përhap menjëherë atje ku kishte pika doganore, në atdhe.

REFERENCA:

1. Miaser Dibra: "Zhvillimi i letërsisë në Shkodër në vitet '20 - '30". Vlerat poetike të viteve '20 - '30. Shkodër, 1996, f. 6.
2. Pa autor: "Sh' Eustaki". Rev. "Elçija e Zemrës J. Krishtit". Shkodër, prill 1909. Nr. 4, f. 64.
3. Pa autor: "Pika letratyret. Tragedia e Eustakit". Rev. "Perparimi". Shkodër, 1915. Nr. 9, f. 160.
4. Ernest Koliqi: "Kolë Thaçi". Kritikë dhe estetikë. Tiranë, 1999, f. 189.
5. Markus W. E. Peters: "Jetëshkrimet e shenjtërve". Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare arsimimin dhe kulturën. Tipografia e Zojës së Paperlyeme në Shkodër (1870 - 1945). Tiranë, 2016, f. 125.
6. Justin Rrota: Letratyra shqype. Libri I. Parime letratyret. Shkodër, 1934, f. 269.
7. Kolë Ashta: "Nji vegim i veprimtaris letrare të nji shkrintari shqiptar. Kolë Thaçi". Rev. "Kumbona e së Diellës". Shkodër, 1942. Nr. 35, f. 443.
8. Alma Hafizi: "La geografia delle traduzioni e le scuole scutarine del novecento". Albanie. Traduzione tradizione. Roma, 2009. Nr. 1, p. 164.

Translations of Kolë Thaçi***ABSTRACT***

Neoclassical writer Kolë Thaçi (Shkodër 1886 - Tirana 1941) debuted in literature with the publication of two books with translations from Italian dramaturgy (Shkodër 1909). Two years later (1911), two plays were staged by amateurs of Shkodra Saverian College, M.S Filippo Allegro tragedy "Sh' Eustaki o Familja e martirve" and Pietro Metastasio melodrama "Zefi i njoftun". He has translated both sentimental and romantic works into Albanian. In 1914 Kolë Thaçi debuted in publicity, in the magazine "Përparimi" of Shkodra. His collaboration with the magazines and newspapers there, in that city of culture, continued until 1920. In 1917, he published in Shkodra the original book "Tu Tempulli i Mariës ..." and in 1928 published there too, in book form, the poem "28 Nanduer". Meanwhile in the Shkodra press, until 1939, he also published three other poems, as well as some poetry poems. In 1920 Kolë Thaçi published in Shkodra the legal-economic work "Kanun' i doganës " ... ". From 1921 to 1939, the well-known writer K. Thaci was a deputy of the Albanian Parliament in Tirana and five times he was appointed as a Finance Minister by the State Government.

Alma HAFIZI

MES DY DETESH DHE SHUMË KULTURASH. REFLEKSIONE MBI VEPRËN E KARMINE ABATES

Letërsia si dëshmi historike

E ardhmja merr kuptim vetëm nëse programojmë veprime praktike për të realizuar ose shprehim dëshira dhe shpresojmë në një moment të së tashmes që çast pas çasti i përket së shkuarës. Një e ardhme ndërtohet nga e shkuara, nga traditat, nga sistemi i vlerave të një kombi.

Edhe pse mund të mos ndryshojë botën, letërsia është tregues i drejtimit nga shkojmë. Një shembull tipik se si të projektohet e ardhmja kur i përkasim shumë kulturave dhe shumë vendeve është vepra e Karmine Abates, një ndër personalitetet kulturore më përfaqësuese të botës arbëreshe, shkrimtari që nuk është italisht-folës, por që ka zgjedhur italishten si mjetin shprehës letrar dhe Italinë si vendqëndrimin e tij. Vepra e Abates është e dyvlershme, tipar karakterizues i të ashtëquajturës letërsi e emigrimit¹. Vepra e shkrimtarit mbledh përvojën e emigracionit me të gjitha problematikat që krijon, të cilën e ka sjellë me një thjeshtësi artistike në poezinë “Lojëra gjuhësh”², ku Abate përmes një loje gjuhësh, shqipe, italiane dhe gjermane, përmbledh identitetin e tij shumëkombësh.

Në të gjitha veprat e tij, Abate nuk resht përpjekjet për ta përfshirë arbërishten kalabreze në botën e globalizmit, duke nxjerrë në dritë përfitimet që emigranti ka nga kontaktet me qytetërimin në tërësi, me diversitetin. Njëkohësisht, ai lufton për të mbrojtur identitetin kulturor të arbëreshit kalabrez ndaj përmasave kolosale të metropolit perëndimor, ku përjeton fatin e tij të njëjtë me atë të emigrantëve në mbarë botën, të cilësuar përjetësisht si *i ndryshëm, i huaj*.

Në këtë punim do të përqendrohemi në romanin e Abates *Mes dy deteve*,³ në të cilin autori e sheh realitetin e shoqërive moderne globale nga një këndvështrim i dyfishtë; nga ai i individit që vendos të largohet nga toka e origjinës dhe i trashigimtarëve të tij, por edhe nga perspektiva e atij

¹ Gnisci, A., *Il rovescio del gioco*, Roma, Carocci, 1992.

² Abate, C., *Terre di andata* (poesie), Argro 1996, “Giochi di lingue”:

³ Abate, K., *Mes dy detesh*, Toena 2007, përktheu nga origjinali Spëtim Çuçka.

që këmbëngul të jetojë fatin e vet, të bëjë përpara në tokën e tij. Për herë të parë Abate trajton problematikën e një komuniteti tërësisht kalabrez, jo vetëm arbëresh, sepse fati i kalabrezëve ka, pa dyshim, pika të shpeshta takimi me atë të arbëreshëve, por edhe me atë të shqiptarëve. Këto komunitete kanë njohur valë të ndryshme emigrimi përgjatë historisë, shqiptarët drejt Italisë, Greqisë e pas rënies së diktaturës kanë emigruar kudo nëpër botë, ndërsa kalabrezët drejt “Merikës”, Amerikës së pari, më pas Francës e Gjermanisë, Veriut të Italisë, në kërkim të punës e të kushteve më të mira të jetesës.

Mes dy deteve është një roman i shestuar nga një rrjetë e dendur udhëtimesh të realizuara në kohë dhe hapësirë. Udhëtimi në vetvete është një zbulim i dyfishtë i identitetit dhe i diversitetit. Përmes një vështrimi në retrospektivë, një burrë i fortë dhe krenar, protagonistin Xhorxh Belushi dhe një djalosh, që në mënyrë progresive pasuron identitetin e tij me elemente të rinj, takohen në dëshirën dhe vullnetin për të realizuar një ëndërr të vjetër familjare. Floriani është nipi i Xhorxh Belushit, i lindur nga martesja e përzier e vajzës së tij Rozana dhe e Klaus Hojman, gjerman nga Hamburgu, djali i një tjetër personazhi të denjë, i fotografit Hans Hojman, artist me famë botërore. Hans e Xhorxho njihen që prej viteve pesëdhjetë, dhe miqësia e tyre forcohet akoma më shumë nga shiriti i dashurisë, të cilin e ushqejnë Floriani dhe i vëllai Marko.

Xhorxho Belushi ka një ëndërr të vjetër, madhore, akoma e parea realizuar, që shndërrohet në motivin e jetës së tij: të ngrejë nga gjermadhat të famshmen “Bujtina e Fikut”, bujtinën ku kishte ndaluar i madhi Aleksandër Dymai gjatë *tour* të tij italian me 1835 dhe shumë udhëtarë të tjerë të huaj e të shquar për kujtesën e njerëzimit. Jeta kriminale lokale fillon të gjallërohet me qëllim përfitimet e pamerituara. Mishtari kalabrez var taksambledhësin mafioz në një çengel mishi, për të cilin vuan dënimin me tetë vite burg. Janë vitet kur nipi Florian, që kalon pushimet verore në Rokalba, ndërjegjësohet për afërsinë e gjakut me një njeri jo fort të këshillueshëm, por që nuk mund të mohohet. Mënyra sesi afrohen shpirtërisht gjyshi sërish i lirë dhe nipi, që tashmë ka filluar të ndjejë brenda vetes thirrjen e të parëve, ëndrrën e tyre si pjesën më të çmuar të trashëgimisë, i ngjan një riti fillestar. Floriani qëndron në Rokalba gjatë vitit të pritjes për t’u regjistruar në universitet me dëshirën për të qenë pjesë në realizimin e ëndrrës së gjyshit të rigjetur, por njëkohësisht ai gjen dashurinë e një vajze të hijshme kalabreze, Martinës. Historia e ëndrrës së Xhorxho Belushit, bashkudhëtare me të, përfundon në një osmozë shpresash dhe trishtimi, lindjesh dhe humbjesh njerëzore, por jeta vazhdon, ashtu sikundër edhe ëndrrat, që duket se kanë gjetur strehën e ngrohtë në

subkoshiençwn e Florianit.

Dyvlershmeria e romanit

Dyvlershmeria është filli përshkues i të gjithë romanit. Epiqendra e të gjitha veprimeve dhe shpërthimeve ndjesore është “Bujtina e Fikut”, që në thelb përbën identitetin e dinastisë Belushi, e ndërtuar nga stërgjyshi i Xhorxhos, Xhoakino Belushi. Për Xhorxhon nuk ekziston e kaluara për aq kohë sa nuk do të ringrihet Bujtina. Për këtë arsye atij i ngjan se jeton në një të tashme pezull, sepse duket se ka lindur nga hiçi dhe nuk shikon nga e ardhmja. Ja përse ai ndjehet i motivuar të çojë përpara dhe të realizojë ambicien e tij, të rifitojë kohën e humbur, jetën që nuk i përket vetëm atij. E bija Rozana, jeta e së cilës ndahet mes Hamburgut dhe Rokalbës, zëvendëson figurën e babait të munguar gjatë viteve të burgimit të Xhorxhos me atë të bujtinës së vjetër, tashmë me përmasa thuajse njerëzore, personifikim i më të parit të gjakut Belushi. Ajo dhe i ati ngërthejnë të njëjtën ëndërr aq sa punimin e diplomës ia kishte kushtuar udhëtarëve të huaj që në shekullin XVIII kishin ndaluar në Bujtinën e Fikut: “[...] ajo kishte lexuar të gjithë librat që bënin fjalë për Bujtinën e Fikut. Dhe në qoftë se nuk donin t’i zinin besë [...] atëherë ime më jepte një tjetër provë të dokumentuar e të padiskutueshme; një studim të Vito Tetit të titulluar “Bujtina e Fikut” dhe që për të ishte si një bibël.”⁴ Dyvlershmeria e bujtinës është e dukshme duke filluar që nga pozicioni i saj gjeografik, “shtrihet si një patkua sipër një kodre që ndodhet mes dy detesh, Jonit dhe Tirrenit”.⁵ Përfaqëson metaforikisht identitetin fragmentar të personazheve, si: Rozana, Floriani dhe Marko. Nga lindja shtrihet deti Jon që lag brigjet e Shqipërisë, vend prej nga mërguan komunitetet arbëreshe, pjesë e të cilit është vetë autori Abate. Nga perëndimi i gadishullit shtrihet Tirreni, simbol i një tjetër aspekti identitar të të gjitha personazheve më sipër, ai italian.

Bujtina është epiqendër nga ku nis dhe kthehet gjithçka, por edhe pikë monumentale në të njëjtën kohë. Në vitin e largët 1835 aty kishte ndaluar Dymai, babai i “Tre muskotierëve”, i shoqëruar nga piktori Zhadën gjatë udhëtimit të tyre në Itali, ku kishte harruar bllokun e shënimeve të udhëtimit dhe, i konsideruar si një nga reliket më të çmuara, ishte ruajtur me shenjtëri brez pas brezi nga familja Belushi. Këtu ndaluan edhe poeti anglez i shekullit XVIII Suinbërn, e të tjerë shkrimtarë të huaj, si: Lënorman, Galanti, Këpel Kraven, konti gjerman Shtolberg, që nuk ishte një personalitet i njohur, por ishte meritë e tij që kishte shkruar përshtypjet

⁴ *Mes dy detesh*, vepër e cituar, fq.34.

⁵ Po aty, fq.12.

e udhëtimit nëpër Itali në fund të shekullit, në formë epistolare, akoma më heret se Gëte ta bënte një gjë të tillë. Më 22 maj 1792, ndryshe nga Gëte, ai u ndal të pushonte në bujtinë, arsyeja se përse Rozana i kishte kushtuar punimin e diplomës, ndryshe nga rekomandimet e profesorit që i jepte përparësi të parit: Ja se ç'emër të denjë ka Bujtina e Fikut, nga ku Ciceroni i shkroi letra një farë njeriu me emrin Atik, që kanë arritur deri në ditët tona. Bujtina vishet me një shkëlqim të veçantë duke qenë vend i takimit të kulturave, që zë vend në kujtesën e udhëtarëve që u bënë pjesë e *Gran Tour*.

Bujtina shndërrohet edhe në një vend të kujtesës historike. Ushtarët e Mbretit të Italisë i kishin vënë zjarrin bujtinës, pas tridhjetë viteve jetë, me pretendimin për të zënë rob apo vrrarë kaçakët që e frekuentonin atë. Xhoakino Belushi, i përfshirë fillimisht me vullnetin e tij në ushtrinë e Një Mijëve në fshatin Kuringë, shumë shpejt zbulon anën tjetër të medaljes së shtetit të bashkuar, që nga bujtina, simbol i ekzistencës dhe lavdisë familjare, kishte kursyer vetëm një mur të shkrumbuar, që për sytë e Florianit prej fëmije ishte “figura e qartë dhe e stërmadhe e një dinosauri”.⁶ Rrënojat e bujtinës janë dëshmitare historike të zhgënjimit që pësuan italianët e jugut pas bashkimit kombëtar.

Një *personazh i dyvlershëm* është Floriani, zëri rrëfimtar i romanit, i cili që në krye të herës lë të kuptojë thyerjen që e karakterizon përbrenda: një fëmijëri e ndarë mes dy gjuhëve, dy kulturave, dy vendeve.

Përtej “Bujtinës së Fikut”, nga ana e detit, syri nuk të sheh tjetër veçse kodra argjili, pyje hilqesh dhe kone të mbushura me ferra.[...] Rruga që ngjitet drejt fshatit të sime mëje duket sikur të ishte masakruar nga një bombardim ajror: kudo shihje gropa të thella, të përndara zigzag përgjatë një xhadeje gjarpëruese të mbushur me plasa.

[...]Nga Hamburgu e deri në dalje të autostradës, për plot 2581 km të mundimshme e të mërzitshme, kisha duruar si ajo bleta brenda një gote të vënë përmbys duke ndjekur [...] atë vargun e pafund të landrave të lulëzuar, por kjo pjesë e fundit ishte më e pështira, në kuptimin që hera herë më vinte për të vjellë.

Po vija për të kaluar pushimet e mëdha dhe pa mbërritur mirë doja të kthehesha.⁷

Nuk është i mërguar në Gjermani, është gjysmë gjerman dhe jeton në një raport kënaqësie, të qetë, gati gati shpirtëror me Hamburgun. Por gjysma e

⁶ *Mes dy detesh*, vepër e cituar, fq.52.

⁷ Po aty, fq.12-13.

tij është kalabreze, edhe pse akoma nuk është ndërgjegjësuar për identitetin e përzier që mbart. Kjo ndodh, sepse ai akoma nuk e ka zbuluar, studiuar limfën e përzier jetësore. Figurat emblematike të së shkuarës janë gjyshërit, pak të pranishëm në jetën e tij, e për pasojë pak të njohura edhe rrënjët e të parëve të tij.

Gjyshi nga babai, një fotograf i njohur nëpër botë, është gjithnjë larg familjes për shkak të narcizmit që e karakterizon, të indiferencës, më tepër se për shkak të punës, shfaq ndjenja të ftohta gjatë vizitave kalimthi në Hamburg dhe gjithmonë cinik e mospërfillës ndaj birit të vet. Një paaftësi për të hyrë në raporte njerëzore që pjesërisht e kishte trashëguar edhe i ati Klaus, sipas gjykimit të Rozanës me mentalitet kalabrez. Hans është një qytetar i mbarë botës, njeri i metropoleve të mëdha, i kujdesshëm ndaj çdo gjëje njerëzore që ndesh, i vëmendshëm të përjetësojë në një shkrepje të aparatit fotografik atë që në Hamburg e në qytetet e mëdha ka humbur. Ai ishte gjyshi i Florianit, “ata sy të pafytyrë dhe ajo gjuhë e helmatisur ishin të mbushur me të njëjtin gjak”⁸ si gjaku i tij. Vështirë ta besonte.

Gjyshi nga nëna, i moshuari tjetër, të cilit mezi i kujtonte tiparet fizike, nuk është i pranishëm në adoleshencën e tij për shkak të vuajtjes së dënimit me burg, por është i lidhur me kujtimin e tij përmes rrëfimeve të mamasë Rozanës mbi udhëtimet dhe bujtinën antike. Pavarësisht dhembshurisë pa kufij që transmeton Rozana përmes historive në kujtim të Xhorxhos, si figura e babait gjithnjë mikpritës gjatë pushimeve në Rokalba, autoritar dhe i dashur njëherësh, ai nuk është shumë i ndryshëm nga gjyshi Hans, sipas mendimit të Florianit. “Ç’prejardhje të shëmtuar kisha, ç’përzierje e helmatisur gjaku më rridhte në damarë!”⁹ - mendonte Floriani, ndërsa prindërit e tij shihnin vetëm anën e jashtme dhe krenoheshin që kishin dy fëmijë të veçantë, pikërisht sepse rridhnin nga një çift i përzier.

Vështirësitë për të përfutur një amalgamë mes dy kulturave janë të pranishme gjatë gjithë romanit, por më të theksuara shfaqen në adoleshencën e Florianit: “[...] unë i kisha zili miqtë e mi më të shtrenjtë, që kishin prejardhje si të thuash normale: ishin thjesht fëmijë prindërisht gjermanë. Ndërsa unë, sikur të kërkoja gjurmët e prejardhjes sime, do të humbisja si ai uji i rrëkesë në mes të shkretëtirës. Për më tepër uji im ishte një ujë i fëlliqur.”¹⁰ Ato sikur zbuten falë rastësisë që mbledh së bashku fragmentet identitare dhe të shkuarën e tij, kur takohen sërish të dy

⁸ *Mes dy detesh*, vepër e cituar, fq.70.

⁹ Po aty, fq.71.

¹⁰ Po aty, fq.72.

gjyshërit, si dikur për herë të parë në Bari. Xhorxho Belushi po emigronte nga provincat e Kalabrisë drejt Barit, në kërkim të së dashurës, ndërsa takon një djaloshi të ri fotograf, gjerman, francez, anglez, Hans Hojman që po udhëtonte për aventurë. Kishin bërë menjëherë shoqëri. Hansi kishte udhëtuar përgjatë gjithë Jugut të gadishullit në shoqërinë e Xhorxhos, me të cilin kishte vizituar, pa dyshim, edhe rrënojat tek Bujtina e Fikut, vend mitik për historinë që mbart dhe peizazhin që Hans e kishte përjetësuar në celuloid. Fotografia kishte marrë dhenë kudo nëpër botë, Xhorxho goxha djalë, përpara rrënojave të bujtinës, dhe Milordi poshtë tek këmbët e tij. Milord ishte qeni që shoqëronte Dymanë, pas së cilit Xhorxho, asokohe 12 vjeçar, ishte marrosur. Kujtimi i tij i sillte ndërmend bujtinën. Duke mos mundur ta ringrinte, Xhorxho kishte marrë një qen për ta rritur dhe pa me të voglën mëdyshje e quajti Milord. Besnikëria ndaj Milordit është metaforë e besnikërisë ndaj ëndrrës së Belushëve. Fotografia u pëlqye shumë, i dha emër të mirë Hansit kudo nëpër botë, deri atëherë i panjohur për artin e fotografisë. Në përshkrimin artistikisht elegant të Abates, mund të dallohet diversiteti mes dy burrave, mes dy kulturave:

Dhe ndërkohë që Hans Hojmani fotografonte fshatarët, tek ktheheshin nga fushat të mbështjellë si kaçakë në pelerinat e tyre të zeza, kopetë e dheneve të mbështjella nga një dritë verbuese, gratë e ulura varg mbi avllitë e shtëpive ose duke futur bukën në furrë, fëmijët e zbatuar me fytyra prej të rrituri, Xhorxho Belushi pa vise që nuk i kishte parë kurrë, fshatra të ngritura buzë greminash të frikshme, gurin në malin e Aspromontes ku dikur ishte plagosur Garibaldi, një kështjellë të rrethuar nga uji i detit, një shtyllë mermeri të vetmuar, male të mbuluara me pisha, ndër to edhe pishën më të vjetër të Europës, e cila kishte kohë që i kishte mbushur të një mijë vjetët.¹¹

Ritakimi i dy gjyshërve shërben si çels interpretimi për të kaluarën e Hansit. I mbetur jetim nga babai në moshë të porsalindur, e ëma ishte kthyer në Zvicër, vendlindjen e saj, së bashku me foshnjën. Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, Hansi njëzet e dy vjeçar ishte kthyer në Gjermani, ndryshe nga e ëma që nuk mund të shihte as edhe një gjerman me sy, si kujtim i keq i fashizmit. Hansi, i rritur pa praninë e babait, nuk kishte një model se si të ndërtonte raportin atëror me të birin, duke mos e përjetuar një eksperiencë të tillë. Hetimi në të shkuarën e tij i sqaron disa

¹¹ *Mes dy detesh*, vepër e cituar, fq.24.

mënyra të sjelluri të pazakonta. Brenda tij nuk qëndron gjithnjë ai karakteri i pamposhtur, di edhe të jepet i tëri pas ndjenjave, edhe të përkëdhelë nipërit. Zbulimi më i madh i Florianit është pendimi që sheh tek Hansi, teksa e bren përbrenda, për ashpërsinë me të cilën e ka trajtuar birin e tij Klaus. Gjyshi nga babai rrëfëhet, duke ngushtuar kësisoj hendekun mes tyre, tanimë ai është një bashkëbisedues që lejon të depërtohet në botën dhe zemrën e tij. Dhe, aty ku ka dialog ka edhe komunikim, mes Hansit dhe Florianit, mes dy brezave, mes dy kohëve, e tashme dhe e shkuar, mes traditës dhe së ardhmes.

Rozana, Florianit dhe Marko i vogël nisen nga Hamburgu drejt Rokalbës për Krishtlindje, tetë vjet pas “nisjes”, e përshkruar në fillim të romanit. Rokalba nuk është më ai vendi që “provokon të vjella”, jo më “fshati i sime mëje”. Ai vend që tani gëzon një emër të përveçëm në rrëfimet e tij, duket se i përket edhe Florianit, sepse e paraqet si vendbanimin e të afërmëve të tij, gjyshe Patricia, teta Elsa dhe xha Brunoja, kushërira Tereza, miqtë që shkojnë atje për pushime. Në këtë segment kohor të adoleshencës historia mes tij dhe Martinës fillon të japë shenjat e një dashurie, ç’ka shton ndjesinë e përkatësisë ndaj tokës kalabreze. Kthimi në Rokalba në prag krishtlindje i gjermano kalbrezëve Hojman përkon me atmosferën që kishte krijuar kthimi i shumëpritur i Xhorxho Belushit. Bashkëvendasit e konsiderojnë Xhorxhon një hero, dhe kaq mjafton që nipi ta dëshirojë takimin me gjyshin, figurën e të cilit e kujton turbullt, pasi me gjithë tregimet sipas varianteve femërore të mamasë, gjyshes, tetës, nuk ka mundur ta plotësojë imazhin e tij. Më pas Xhorxho Belushi udhëton drejt Hamburgut për disa kontrole mjekësore, por qëndron më gjatë nga sa e mendonte për shkak të një infarkti.

Nëse në Rokalba ishte ngjizur një marrëdhënie mes Florianit dhe gjyshit, falë kërshërisë së të parit dhe dashurisë së të dytës për historinë legjendare të “Bujtina e Fikut” që kundërmonte aromë bergamote, në Hamburg forcohet e mishërohet kjo lidhje, gjatë zbulimit të natyrës njerëzore, të brishtë e të fortë njëherësh të gjyshit, por edhe të ëndrrës së përbashkët që do të jetë motiv i ekzistencës së tyre. Dhe pse pikërisht në Hamburg? Sepse këtu përthihet në mënyrë metaforike origjina e tij e dyzuar, kultura, shfaqje të karakterit, kur dy gjyshërit janë miq në shtëpinë e tij. Takimi mes tyre është moment kyç në kërkim të identitetit për Florianin. Bazuar në një metodë krahasuese, ai arrin të dallojë të përbashkëtat dhe diversitetet e tyre, që tek nipi jo vetëm janë trashëguar përmes AND-së, por edhe janë ndërthurur aq në harmoni duke i dhënë jetë një identiteti shumëngjyrësh, të shëndoshë e të qëndrueshëm, siç është ai i tij.

Pema identitare e Florianit i ka rrënjët e thella, të lëshuara në dy tokë të largëta. Është saktësisht kjo karakteristikë që i jep asaj madhështi, që i jep fuqinë për të rezistuar ndaj forcave shkatërrimtare të natyrës dhe të shoqërisë. Bujtina u shkatërrua nga shteti i ndërtuar mbi të keqen, ashtu sikundër edhe ringritja e saj duhet të përballet me një tjetër formë të pushtetit në konkurrencë me Shtetin, “*ndragetën*”, mafian. Xhorxho kërkon të jetë i drejtë, çfarë i vihet kundër duke i kushtuar heqjen e lirisë për tetë vjet. Kalabrezi kokëfortë nuk braktis ëndrrën e tij edhe pas vuajtjes së dënimit, i vetëdijshëm për kanosjen e rreziqeve:

Bujtina e Fikut ishte ngritur tanimë dhe vazhdonte të ngrihej si një bimë e marrë, nga ato që vazhdojnë të jetojnë edhe mes gurëve të mureve, mjaft që të gjejnë një pikë ujë dhe dy kokërriza dhe, duke u bërë më të bukurat e tërë bimëve. Rëndësi kishte të mos u shkulje rrënjët, thoshte i ati, të tjerat rregullohen me kalimin e kohës, bima u rritet, u bënë ballë edhe tërmeteje të jetës, nëse rrënjët janë të gjalla e plot gjak sit e rrëzoret.¹²

Floriani e ka përvetësuar vetiu filozofinë e stërgjyshërve që është shtresuar në kohë e breza të ndryshëm. Ai e di tashmë ku janë rrënjët e tij, pikënisjen për të ndërtuar e pasuruar identitetin. Falë ëndrrës së bujtinës, gjysh e nip arrijnë të kenë një marrëdhënie të fortë, shenjë e vazhdimësisë dhe e kujtesës.

Është edhe romani i një ëndrre, ëndrre të madhe, që është e gjyshit, por për realizimin e së cilës jepet shumë nipi. Ja pra, edhe kjo është një nga idetë e mia të ngulëta: marrëdhënia mes brezave. Sepse të rinjtë sot kanë nevojë për ëndrra, dhe përmes kësaj ëndrre ndodh takimi mes të dyve, që shënon fundja kalimin e stafetës.¹³

Floriani ka epërsi ndaj gjyshit për shkak të pasurisë shpirtërore dhe identitare që trashëgon. Nga Xhorxho ka trashëguar ëndrrën, nga Hansi ka trashëguar famën botërore të tij si fotograf dhe shpesh i pëlqen të prezantohet si nipi i tij, ndërsa paratë për ndërtimin e “Bujtina e Fikut” nga ankandi i kujtimit historik e kulturor të saj, blloku i shënimeve të udhëtimit të Dymasë.

Gjysh Belushi e bën krenar Florianin mes të rinjve të Rokalbës, të cilët e rrethojnë Xhorxhon mbrëmjeve në bar sikur të duan t’ia përpijnë

¹² *Mes dy detesh*, vepër e cituar, fq.80.

¹³ Carmine Abate, l’intervista a l’autore su “Fahrenheit, un libro al giorno” (Radiotre), 11 marzo 2005 (online in WWW.carmineabate.net)

fjalët pa dalë akoma nga goja. Floriani ka krijuar tashmë bindjen e tij mbi Xhorxhon, njeri me shpirt, i gojës, që tregon histori me një stil të bukur bustrofedik¹⁴, nga e shkuara tek e ardhmja e anasjelltas, më bukur nga ç' do të bënte një film. Ai është një personazh amalgamë, kalabrez me mbiemër tipik arbëresh. Ai mishëron energji të pashpjegueshme shpirtërore që sjellin zhvillim, po ato që kanë vënë në lëvizje prej shekujsh komunitetin arbëresh, duke trashëguar djalë pas djali thesarin historik, kulturor e psikologjik, të lidhur me figurën e heroit legjendar Skënderbeut, me gjuhën, folklorin, traditat dhe qëndresën. Nuk mund të mungonte në veprën e Abates peizazhi i qytezave arbëreshe si Vena, ku piktori Zhadën mrekullohet me ngjyrat e veshjeve popullore të qëndisura me fije ari, ku Dymai magjepset nga gjuha e çuditshme që dëgjon të flitet dhe ku Xhorxho takon gruan e jetës së tij, Lizabetën.

Xhorxh Belushi e Hans Hojman kanë vënë në duart e Florianit jetën e tyre, për t'i mpleksur me të tijën që më pas do të jetë zëri i së shkuarës. Ata largohen nga kjo botë në rrethana dramatike. Duke udhëtuar drejt Jugut për të rikujtuar aventurën e rinisë së tyre, një motoçikletë i ndjek nga pas dhe qëllon mbi Xhorxho Belushin.

Në përmbyllje mund të themi se Floriani është provë dhe dëshmi e përvojës së emigrimit, të faktit se ajo nuk është vetëm "gjaku ynë i shprishur", por edhe pasuri. Floriani ndjehet gjerman, kalabrez e arbëresh kudo që të ndodhet. Territoret nuk ndahen më nga kufij të shënuar për tokë, nga trarë e flamuj, por janë të përbashkuar nga natyra gjeografike dhe kulturore. Floriani provon thujse në mënyrë aksiomatike se është e pashmangshme të mos ndjehemi të ndarë mes shumë botëve, se mund të jetohet me vetëdije "*per addizione*"¹⁵, që do të thotë të jetosh identitetin si pasuri, pa patur nevojë të zgjedhësh gjuhën e zemrës ndaj asaj të bukës, veriun ndaj jugut, të jetosh mes pasurisë së dy a më shumë kulturash.

Katër muaj i kaloj në shtëpinë tjetër, në Hamburg, ku edhe kam lindur. Kam nevojë për këtë se nuk dua të humbas pjesë nga e kaluara dhe, ku ta dish, edhe nga e ardhmja ime. Duke jetuar në këto dy vende, që ndryshojnë mes tyre siç ndryshon dielli me hënën, e gënjej veten sikur jetoj dysfish, sepse në secilin prej tyre që të shkoj, i hyj jetës deri në thellësi.¹⁶

¹⁴ Stil ose shkrim bustrofedik quhet ai në të cilin nuk ka një drejtim të caktuar, por ndryshon nga radha në radhë, nga e majta në të djathtë, pastaj nga e djathta në të majtë, e kështu në vazhdim, si gjurma e qeve kur lërojnë tokën.

¹⁵ Term i përdorur nga Abate.

¹⁶ *Mes dy deteve*, vep.cit., fq.217.

BIBLIOGRAFIA:

1. Abate, C., *In due mondi*, incontro con Carmine Abate (online in WWW.digilander.libero.it)
2. Abate, C., l'intervista a l'autore su "Fahrenheit, un libro al giorno" (Radiotre), 11 marzo 2005 (online in WWW.carmineabate.net)
3. Abate, C., *Tra due mari*, Milano, Mondadori, 2002.
4. Abate, K., *Mes dy detesh*, Toena 2007, përktheu nga origjinali Spëtim Çuçka.
5. Abate, C., *Terre di andata* (poesie), Argro 1996, "Giochi di lingue".
6. Eco, U., *Costruire il nemico e altri scritti*, Saggi Bompiani, 2011.
7. Gnisci, A., *Il rovescio del gioco*, Roma, Carocci, 1992.
8. Kadare, I., "Populli ynë po ribëhet europian", *Panorama*, 29 tetor 2011.

**Between two seas and more cultures. Reflections on the work
of Carmine Abate**

ABSTRACT

"Between two seas and many cultures. Reflections on the Carmine Abate's work" is an analysis based on Abate's novel "Between two Seas". This contribution seeks to bring to light a very tangible reality in the life experience of a migrant, the feeling of living twice, being spiritually and culturally rich. The paper transmits this idea through the ambivalent element that reveals some characters and places that are dressed in human and historical dimensions. The paper focuses on the ambivalence of the Guest House, as the starting point and the mechanism that moves all kinds of characters. It has created the identity of a home community, arbëresh. The guesthouse is also transformed into a place of historical memory, sparkled with a special glamor, being a meeting place of cultures, occupying the memory of world-renowned travelers who became part of the *Gran Tour* during the 18th century. The emigration experience is an amalgam of memory, identity and transformation.

Rrok GJOLAJ

**VËSHTRIM PËR PËRMBLEDHJEN ME POEZI
“DËGJOHET NJË POEZI, NË SUFERINË...”
TË ANTON GOJÇAJT**

*Hyrje***Veprimtaria letrare**

Anton Gojçaj është figura qendrore e krijimtarisë letrare të shqiptarëve që jetojnë në Mal të Zi dhe njëra nga figurat e spikatura të letërsisë shqipe në rrafshin mbarëkombëtar. Ai u lind në Tuz, ku dhe jeton. Studimet universitare dhe pasuniversitare i ka përfunduar në Prishtinë. Me krijimtari letrare ka filluar të merret në moshë shumë të re; botoi në shtypin e kohës në Podgoricë, Kosovë etj. Shkruan poezi, tregime, romane e studime letrare. Deri tani ka botuar dy përmbledhje me poezi: “Poezi” (2001) dhe “Dëgjohet një violinë, në suferinë” (2011). Në prozë ka botuar përmbledhjet me tregime “Qengji i harruar vetëm në mal” (2003) e “Ndërmjet kapakëve”(2010) dhe romanin “Passio”(2004). Studimi “Proza letrare e Anton Harapit” titullohet “Fakticiteti në letërsi” (2007), esetë janë përmbledhur në librin me titull “Tema e heroit nacional” (2004), kurse vështrimet dhe recensionet në librin me titullin “Shija e librit” (2009).

Vlerat e përmbledhjes “Dëgjohet një violinë, në suferinë...”

Përmbledhja e dytë me poezi, “Dëgjohet një violinë, në suferinë...” e poetit Anton Gojçaj, qysh nga vetë titulli afron vlera poetike dhe estetike që përshkojnë gjithë veprën si krijim i një strukture të veçantë ligjërimore.

Harku qendror i kësaj përmbledhjeje poetike mbështetet tek substanca refleksive dhe disponimi lirik. Uni poetik vjen në këto poezi edhe si artikulum emotiv e tërësi artistike, pa mbetur asnjëherë në rrafsh përgjithësues. Zëri i unit lirik, sfidat e këtij uni mbruhën duke u bërë përcaktim i saj dhe përqendrim i brendshëm i poezisë. Vetë titulli i veprës nxirret nga një poezi e veçantë e kësaj përmbledhjeje: “Dëgjohet një violinë, fryn një suferinë”. Ky është një ndërtim poetik befasues origjinal që ofron dendësi konotacionesh e kuptimesh semantike

me vlera të larta estetike.

Poeti dhe studiuesi i talentuar Anton Berishaj për poezinë e këtij autori shprehet: “*Poezinë e Anton Gojçajt e karakterizon një dinamikë e veçantë tekstore, një tekstualitet i gjallë, i pazakonshëm, origjinal. Autori e arrin këtë me një shumësi procedimesh dhe teknikash kompozicionale e strategjish retorike*”¹.

Në disa poezi kemi një lirizëm filozofik që vjen tek lexuesi si bisedë qiejsh dhe bashkëbisedim me hyjnitë (*Kambanat para dritës, Dëgjohet një violinë, Fryn një suferinë, Gjysma e botës, Energjia e poezisë*).

Dhimbja e poezisë nxit mendime zhbiruese në kërkim të kuptimësisë.

Kahjet e poezisë si sajim i iluzionit të imazhit konkret dhe lëvizje e brendshme e metaforave, për të zbuluar të padukshmen japin së bashku reflekset e një gjendjeje të caktuar shpirtërore, duke na sjellë përjetimin. Tek Gojçaj, poezia nuk lexohet, ajo përjetohet (*Vajza ecën me ombrellë në borë, Trëndafil i kuq në borë, Askush s’e kupton dhelpren*).

Në një pjesë të madhe të lirikave, vargu ngarkohet me reflekse kategorie vitale, si ekzistencë, e cila shpesh lidhet me tërësinë e universit. Në poezitë ku është e pranishme substanca filozofike, shpesh dilemat mbesin të pazgjydhshme (*24 orë, Lirikë heroike, Një mace kozmosi, Diç për matanë, Mrekullia e ekzistencës, Shpejtësi e rrezikshme*).

- 1) Anton Berishaj, *Poezia si jopërsosmëri e përsosur...* botuar si recension te libri Anton Gjoçaj “Poezi”, Tuz, 2001, fq. 77

“*Poezinë e Anton Gojçajt prore e ka karakterizuar njomësia dhe freskia e vargut poetik, ndërsa autorin, guximi për t’i thyer konvencat dhe durimi për ta latuar vargun deri në përsosmëri*”, shkruan gazeta “Zëri” i Prishtinës në vitin 2001 dhe është botuar në kopertinën e këtij libri “Dëgjohet një poezi, në suferinë...” (Lezhë, 2011).

Karakteristika të lirikës intime

Zëri lirik i autorit është shumë i fuqishëm në këtë përmbledhje me poezi. Shpesh ndihet dëshpërimi poetik, zhgënjimi nga jeta dhe njerëzit, po fundi i poezisë gjallon besim.

Poezitë përshkruhen nga idetë e natyrës metaforike, të cilat shpesh artikuloohen si përvoja personale. Kemi në këto poezi dendësi mendimi dhe tendosje emocionale. Në disa poezi gjejmë poetikën e mungesës. Mungon vazhdimësia e dashurisë, duke u kthyer në mungesë të botës së përsosur

reale. Mungesa si kudo sjell mall e vuajtje; vuajtja është e përballueshme, nuk ka stuhi ndjenjash, të duket se gjithçka përballohet me urti.

Karakteristikat gjuhësore të kësaj poezie janë foljet të cilat më së shumti përdoren në të shkuarën: në të shkuarën gëzimi e tash mungesa (“Lamtumirë nuk mund të them”, “Botët paralele”, “Olimpiada e pritjes”, “Largimi është veç fillim i kthimit”, 403, “Regëtin”, “Njeriu i mirë”).

Në poezitë intime të Goçajit, uni lirik është i çliruar nga vetjet e tjera; ajo është e brendshme dhe vizaton dritëhijet e veta shpirtërore. Shpesh autori përdor gjuhën ezopike, si te poezitë: “Askush s’e kupton dhelpren”, “Një mace kosmosi”.

Të pranishme në lirikat e këtij libri janë edhe gjeneza, gjuha e rrënjët shqiptare (“Nëna ime shqype kryebardhë”, “Traboinshe”, “Dhjetë ndoshta pse Çun Mula”, “Gjuha shqipe është e bukur”, “Rrëfëhem”).

Ironia në poezitë e Goçajit kthehet në substancë të ngarkesës emocionale, kurse tharmi ironik shtrihet që nga vargje të veçanta e deri në gjithë poezinë.

Struktura dhe gjuha e veprës

Artikulimi gjuhësor të tërheq si çelës për leximin e poezisë. Poezitë në këtë përmbledhje kanë lehtësi komunikimi, harmoni ritmike e tingëllore e vargu poetik ndërtohet duke synuar përsosmërinë. Teknikën si formë e komunikimit poetik e karakterizon mungesa e shenjave të pikësimit dhe mospërdorimi i shkronjës së madhe. Kjo është një shenjë dalluese që lidhet me teknikën e tij të veçantë dhe përvojën e thurjes së vargut. Poezia herë lexohet si strofikë e organizuar e herë si varg i lirë. Disa poezi janë të kornizuara, duket sikur kanë dyer nga ku hyhet dhe dilet (“Vrapo e dashura ime”, “Buzëqeshje e gjelbër”). Në këtë përmbledhje, shkapërcimi i kufijve formalë të poezisë sjell elegancë ritmi dhe efekte stilistike. Poezitë kanë figurshmëri të pasur e metaforat përkundin njëra-tjetrën në djepe vargjesh.

LITERATURA :

1. Gojçaj, Anton, “Dëgjohet një poezi, në suferinë...”, Lezhë, 2011.
2. WELLEK, Rene, WARREN, Austin., “Teoria e letërsisë”, Një studim themelor mbi natyrën dhe funksionimin e letërsisë në gjithë kontekstet e saj, përktheu: Abdurrahman Myftiu, Shtëpia Botuese “Onufri”. Tiranë, 2007.
3. SINANI, Shaban, Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të. Studime. Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtëpia Botuese “Naimi”, Tiranë 2010.
4. Vinca, Agim, Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe, Prishtinë, 1985.

**A glimpse at poetry collection of Anton Gojçaj under the title
“Dëgjohet një poezi në suferinë ...”**

ABSTRACT

Anton Gjocaj's work of art in poetry puts in front of the reader, his authorial poetic being in a pure state. The lyrics evolves not only by defining substantially his poems but mostly by becoming its inner essence. Gjocaj's poetry built up around his reflexive working and also the enriched lyrical sensibility.

One of the greatest achievements of his works is that they can't be simply read: they demand to be felt profoundly. (Just to name a few: The girl with the snow umbrella, Red rose, Nobody gets the fox). Technically, his poetic messages flow through the illusion of concrete and real images and moving metaphors.

The result: Gjocaj's lyricism leads to unveil the unseen dimensions of reality and human emotions.

The philosophy beyond his works comes across the reader as if it was a sort of dialogue between skies and Gods of distant parts of the emotional cosmos. In some of his works, different philosophical questions remain yet unresolved, just to mention a few: "24 hours "; "Heroic lyrics"; "A cat from cosmos"; “Something about outerspace”.

Existence is the main concept of all above poems, becoming in each of them a central part of metaphysical consideration during the author's creative process.

Key words: reflection, special discourse, lyrical, musicality, philosophical lyricism.

Anelmo SPAHIJA

DIVERSITETI FETAR NË ARBËRINË MESJETARE DHE POLITIKA PËRBASHKUESE E SKËNDERBEUT

Pozicioni gjeografik i Arbërisë mesjetare, të vendosur mes tri zonave të influencës, asaj latine-perëndimore, bizantine-lindore e së fundi asaj sllave nga veriu, e shndërronte këtë të fundit në një “fushëbetejë” të përplasjes jo vetëm politike e ushtarake, por edhe kulturore e fetare, pasi siç dihet, sidomos në këtë periudhë, këto elemente ishin të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Prandaj paraqitja e situatës kishtarë në këtë periudhë lidhet me faktorët që përmendëm më sipër.

Në mesin e krizës ikonoklaste, për shkak të përplasjeve me Papatin ikonofil, perandori bizantin Leoni III, në vitin 732 vendos shkëputjen e Epirit të ri dhe Prevalit nga juridiksioni i Kishës së Romës për t'i kaluar nën juridiksionin kanonik të Patriarkanës së Kostandinopolit, e cila do të ruante autoritetin absolut mbi ipeshkvitë e këtyre provincave (që më tej do të përfshihen në themën e Durrësit, dhe nën autoritetin e Kishës Metropolitane të Durrësit) për një periudhë rreth pesëshekullore, duke përjashtuar këtu sundimin e shkurtër të Kishës bullgare të Ohrit në gjysmën e parë të shekullit X, si pasojë e shtrirjes së sundimit të Perandorisë Bullgare¹. Pikërisht në vitin 879 përmendet për herë të parë edhe peshkopata e Krujës me përfaqësuesin e saj, Davidi Krutan, pjesëmarrës në koncilin fotin të Kostandinopojës². Duke filluar që nga gjysma e dytë e shek. XI, krizat politike e shoqërore që pëson Perandoria Bizantine dhe copëtimi i mëtejshëm politik i territoreve perëndimore të saj, krijon kushtet për depërtimin e ndikimit të Kishës Katolike Romane, të arqipeshkvive e të manastireve të saj, fillimisht në qytetet bregdetare, për të depërtuar pastaj dhe në territoret e brendshme të Arbërisë Veriore. Në aspektin politik, ky depërtim bëhet i mundur përmes shfrytëzimit të dy faktorëve politikë të rëndësishëm: a) Krijimit të formacioneve të reja shtetërore apo princërore (Dioklea, Mbretëria e Rashës e së fundi Principata e Arbrit në Ballkanin perëndimor). Në çastet e dobësimit të Perandorisë Bizantine e sidomos me

¹ Milan Shuflaj, Situata e Kishës në Shqipërinë paraturke, Botime Françeskane, Shkodër, 2013, f. 35 - 37.

² Kristo Frashëri, “Skënderbeu, jeta dhe vepra”, Toena, Tiranë, 2002, f. 235.

rënien e përkohshme të Kostandinopojës në duart e kryqtarëve (1204-1261), këto formacione të reja shtetërore feudale kërkojnë dhe gjejnë menjëherë mbështetjen e Romës³. Kështu në fundin e shek. XI, një rol qendror në këtë proces merr Ipeshkvia e Tivarit (pjesë e mbetërisë së Dioklesë), nën administrimin e së cilës u vendosën edhe provincat e Shqipërisë Veriore, Ulqini, Shasi, Shkodra, Drishti dhe Pulti⁴. Ndërkohë, përparimi i influencës së Kishës së Romës në Arbërinë qendrore, pra në peshkopatat e Krujës, Stefaniakës etj., fillon të zgjerohet në sajë të afrimit politik me Principatën e Arbërisë, të sunduar nga Dhimitri. b) Shtrirjes së sundimit të shteteve italice (Republika e Venedikut, Mbretëria e Sicilisë/Napolit). Kjo shtrirje u bë e mundur sidomos pas Kryqëzatës IV, që përfundoi me copëzimin e Perandorisë Bizantine, mes strukturave feudale të formuara nga “latinët” dhe Republikës së Venedikut, e cila ndër të tjera arriti të vendoste për një periudhë të shkurtër (1204-1213) nën kontroll Durrësin, gjë që mundësoi vendosjen e arqipeshkopatës katolike në këtë qytet, dhe largimin e peshkopit ortodoks⁵. Një kthesë të rëndësishme në depërtimin e influencës së Kurisë Romane në trevat e brendshme të Arbërisë qendrore, shënon përparimi i anzhuinëve dhe themelimi i së ashtuquajturës Mbretëri e Arbërisë nën sovranitetin e Karlit Anzhu. Kjo mundësoi rivendosjen e ipeshkvijve katolikë në Durrës e në Vlorë, si dhe vendosjen e lidhjeve për një periudhë të shkurtër me ipeshkvijtë e Krujës. Për herë të fundit kjo peshkopatë përmendet si pjesë e kishave të vendosura nën juridiksionin e Kostandinopojës në vitin 1282 në Taktikonin e Mihail Paleologut, ndërsa katër vjet më vonë, Romanin peshkopin e Krujës e gjejmë në varësi të Selisë së Shenjtë, por duke mos e ndryshuar as ritin as liturgjinë bizantine. Në vitin 1319, përmendet ipeshkvi i Krujës, Andreas që me mbështetjen e papatit nxit një kryengritje që nga Dioklea deri në Muzaki kundër mbretit serb Uroshit II. Pas Koncilit të Firences, që synonte unifikimin e dy kishave dhe fillimet e asaj lëvizjeje që njihet me emrin uniatizëm merr përhapje fenomeni i mësipërm edhe për arqipeshkvitë e tjera të Arbanonit klasik si ato të Stefaniakës, Lisit, Pulheriopolit, Akrokeraunit etj⁶. Së fundi, krijimi i së ashtuquajturës “Arbëri Venedike” (1392-1479), që përfshinte pothuajse gjithë zonën bregdetare nga Durrësi në Tivar, e përcaktoi përfundimisht pozitën e Arbërisë si zonë e ndërthurjes së dy traditave kishtare.

³ Dimitri Obolenski, “Il Comonwealth Bizantino”, Laterza, 1974, f. 315-136.

⁴ Milan Shuflaj, Serbët dhe Shqiptarët, f. 40-43.

⁵ Milan Shuflaj, vep. e cit., f. 51-52.

⁶ Po aty, f. 54-58.

Kështu, kur në vitin 1443 u shpalos flamuri i kryengritjes antiosmane, gjeografia kishtare në Shqipëri paraqitej e shumëngjyrshme: në viset veriore e veriperëndimore mbisundonte kisha katolike me manastiret dhe peshkopatat e saj, për shkak të faktorëve që përmendëm më sipër. Ndërkohë këto vise, që gjeografikisht njiheshin me emrin Zeta (nga gryka e Kotorrit deri në derdhjen e Drinit), si pasojë e sundimit filo-ortodoks të Stefan Dushanit kishin pësuar një depërtim jo të papërfillshëm të ortodoksisë në pjesën veriore e perëndimore të liqenit të Shkodrës. Peshkopatat jugore e juglindore si pasojë e ruajtjes së sundimit bizantin-epirot deri në mesin e shek. XIV (deri me pushtimin serb) vazhdonin të ruanin lidhjet organizative e liturgjike me Kostandinopojën, përmes Arqipeshkvisë së Ohrit. Ndërkohë në viset midis tyre, në territoret e Arbanonit klasik (mes Drinit dhe Shkumbinit; më vonë Drinit dhe Vjosës) kishte një ndërthurje të influencave kishtare, ku ndryshe nga veriu ku ortodoksia u shfaq si element i ri, për shkak të depërtimit anzhuin këtu siç e shpjegojmë më sipër, duke filluar nga fundi i shek. XIII, kemi shfaqjen e peshkopatave e manastireve “latine”, të cilat i mbivendosen atyre ortodokse (peshkopata e Lisit, Stefaniakës, manastiri i Shën Aleksandrit në Mat, manastiri benediktin e Shën Mërisë në Ndërfandinë etj).

Rritja e ndikimit të fuqive perëndimore në fundin e shek. XIII bëri të mundur gjithashtu edhe ndryshimin e qëndrimit të fisnikërisë arbëre. Kjo fisnikëri e cila vinte nga lidhjet e gjata shekullore me dinastitë bizantine e sllave⁷, pa tek lidhjet me anzhuinët (Karli I dhe Filipi i Tarenti) dhe Kisha Katolike (për shkak të rëndësisë politike që ajo përfaqësonte në këtë periudhë) mundësinë për të forcuar më tej pozitat e saj politike, për t'i dhënë atyre trajta të mëtejshme autonome e independente. Kështu, familje, si: Dukagjinët (duka Gjin Tanushi), Matrangët, Blinishtët (Kalojan Blinishti, me titullin “comes” merr pjesë në kryengritjen e vitit 1319), Jonimajt (Vladislav Jonima, zhupan i Dukles dhe Arbërisë bregdetare), por edhe përfaqësues të Muzakajve si Andrea I që më 1319 mbante titullin e mareshalit të Arbërisë (ndërkohë që kushëri i tij Johannes, do të mbahej peng në Durrës nga anzhuinët, që e konsideruan si tradhëtar) u shfaqën si mbështetës të Karlit Anzhu dhe të birit Filipit në krijimin e Mbretërisë “anzhuine” të Arbërisë⁸. Në dekretet papale të 1319 drejtuar fisnikëve nga

⁷ “Dyert fisnike arbëre ne traditën bizantine-serbe” në: Oliver J. Schmitt, “Arbëria Venedike (1392-1479)”, Fjala, Tiranë, 2014, f. 171-177, dhe “Fermenti i bujarëve shqiptaro-serb”, në: Milan Shuflaj, Serbët dhe Shqiptarët, Toena, Tiranë, 2004, f. 156-174.

⁸ Milan Shuflaj, Serbët..., f. 158-160.

Buna deri në Vlorë për të mundësuar një kryengritje kundër sundimit serb, këto të fundit konsiderohen si “njerëzit tanë besnikë”, “vir cattolici”⁹. Me rënien e perandorisë serbe të Stefan Dushanit, dhe shfaqjen e principatave shqiptare si faktorë realë pushteti të pavarur, del më tepër ky qëndrim amfib i fisnikërisë arbëre, sidomos tek pricipata e Balshajve e të Topiajve. Karl Topia, megjithëse përmendet në burimet venedikase si “catholicus princeps Albanie” dhe me lidhje farefisnore me anzuinët e Napolit, bën të mundur rindërtimin nga themelet të kishës së manastirit ortodoks të Shën Gjon Vladimirit, ku emërohet me tituj që i shkonin për shtat princërve të besimit Kristjan lindor. Ndërkohë që Balsha II pranon konvertimin në ritin roman në vitin 1379, nipi i tij, Balsha III së bashku me të ëmën Helenën, në luftërat e fillimshekullit XV kundër Venedikut shfaqen si mbrojtës të manastireve dhe peshkopatave ortodokse¹⁰. Në territoret arbëre do të gjente shprehje edhe konflikti mes papëve të Avinjonit e të Romës, të parët të lidhur me Topiajt ndërsa të dytët me familjen e Balshajve¹¹. Përsa i përket familjes së Kastriotëve, mund të themi se Gjon Kastrioti shfaqet si i lidhur me ortodoksinë me dhurimin e bërë së bashku me bijtë e tij manastirit të Hilandarit (1426), por gjithashtu mban kontakte përmes përfaqësuesve të tij me Selinë e Shenjtë¹². Në territoret e zotëruara prej tij gjendeshin madje edhe mjaft manastire benediktine. Këto qëndrime të lëkundura të fisnikërisë ndaj përkatësisë religjionare ishin të lidhura së pari me trajtën plastike që kishte marrë gjeografia kishtarë në Arbëri gjatë shek. XIII-XV dhe së dyti, me rëndësinë politike që përfaqësonte kjo gjeografi kishtarë, të cilën e theksuam më sipër.

Në një situatë të tillë do ta gjente Arbërinë mesjetare pushtimi otoman e më pas lufta kryengritëse e Gjergj Kastriotit. Me rënien e fuqive të vjetra ballkanike, Perandorisë Bizantine dhe asaj Serbe, u bë e qartë se interesat e luftës e bënë të domosdoshme lidhjen me Perëndimin, që përfaqësohej nga tre fuqi, dy nga të cilat italice (Republika e Venedikut dhe Mbretëria e Napolit) dhe fuqinë me karakter ekumenik e universal që përfaqësonte Kisha e Romës. Për pjesën më të madhe të epopesë skënderbegiane (1443-1468), Venediku do të mbante një qëndrim të rezervuar në kundërvënien me Perandorinë Osmane, qoftë për të ruajtur zotërimet e saj në Mesdheun Lindor, por edhe për të mbrojtur interesat e saj

⁹ Milan Shuflaj, *Serbët...*, f. 51-52.

¹⁰ Oliver J. Schmitt, vep. e cit., f. 239 - 240.

¹¹ Stavro Skëndi, “Il complesso ambiente dell’ attività di Skanderbeg”, në: V Convegno di studi albanesi (1968), Palermo, 1969, f. 85.

¹² Kristo Frashëri, vep. e cit., f. 86 - 89.

tregtare. Ndërkohë, Mbretëria e Napolit, e lidhur me shtëpinë mbretërore të Aragonës përfaqësonte një fuqi mesdhetare në ngritje, ku ambiciet ekspansioniste drejt lindjes të Alfonsit I, e bënë gjithnjë e më tepër të interesuar për një konfrontim me otomanët, e po kështu mund të luante rolin e një kundërbalancë ndaj ndikimit të Serenisimas në Arbëri¹³. Papatë si fuqi universaliste, që përfaqësonte një pushtet jo vetëm religjioz dhe moral në Evropën e shek XV, por edhe politik e financiar, të akumuluar e ndërtuar që nga shek. VIII, shikohej si një faktor me rëndësi në qëndresën antiosmane. Në fakt, edhe përpara kryengritjes arbëre, papati kishte mbështetur dhe nxitur tri fushata antiosmane (1396, 1443, 1444) që synuan pa sukses të rikthenin atmosferën e kryqëzatave të shek. XI-XIII, si dhe përmes Koncilit të Firences, ishin bërë përpjekje për unifikimin e faktorit Kristjan përballë mësymjes otomane¹⁴. Kështu mund të kuptohet arsyeja se pse Skënderbeu, që vinte nga një familje e lidhur në njëfarë mënyre me ortodoksinë, që në dokumentet venedikase gjatë kohës që shërbente në ushtrinë dhe administratën osmane përmendet si muhamedan¹⁵, së bashku me mjaft fisnikë të tjerë të Besëlidhjes së Lezhës në luftërat antiosmane në aspektin religjionar do të shfaqej si mbështetës i Kishës së Romës. Prandaj, sidomos në veprimtarinë diplomatike të strukturës shtetërore arbëre që Skënderbeu ka pasur, një rol të rëndësishëm do të luanin personalitete të shquara shqiptare që vinin nga kleri katolik. Përmes tyre, Gjergj Kastrioti, siguronte lidhjen dhe vazhdimësinë e marrëdhënieve me fuqitë që përmendëm më lart. Nga nga tjetër, duke qenë se kishin pasur më të lehtë kontaktin me kulturën humaniste që zhvillohej në botën e qyteteve të Italisë Veriore, paraqiteshin si mjaft të aftë për realizimin e detyrave politike e diplomatike. Gjergj Pellini, abat i manastirit të Rotezos në afërsi të Tivarit, do të luante një rol të rëndësishëm në përfaqësimin e arbërve në Venedik, negociatat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes Skënderbeut dhe Venedikut etj. Pal dhe Gjon Gazulli gjithashtu u caktuan si ambasadorë të Skënderbeut në Raguzë, nga ku siguroheshin edhe lidhjet diplomatike me Hungarinë, për shkak të zyrtarëve të saj, që ishin prezentë në Republikën e Shën Vlashit. Për mbajtjen e lidhjeve me Papatin funksionin kryesor do ta

¹³ Harry Hodkinson, *The Adriatic Sea*, Alden Press, Oxford, 1955, f. 103.

¹⁴ “Mbi marrëdhëniet e Papatit me Gjergj Kastriotin Skënderbeun” në: USHT, IHGJ, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike (12-18 janar 1468), Stabilimenti i Botimeve Arsimore, Tiranë, 1969, f. 53-54.

¹⁵ Në letrën e dërguar Senatit venedikas të 17 gushtit 1428, Gjon Kastrioti kërkon që t’i jepet mundësia që në rast të depërtimit të osmanëve në tokat e tij të ketë mundësinë që të strehohet në territoret veneciane, e ndër të tjera kërkon që të mos mbahet përgjegjës për të birin “që është bërë turk e mysliman”.

luante Pal Engjëlli, peshkop i Shasit, i Drishtit, e më 1456 i emëruar peshkop i Durrësit. Marrëdhëniet e tij të mira më Selinë e Shenjtë (ndryshe nga Pellini, i cili në konfliktin mes papatit dhe Venedikut përkrahte këtë të fundit) do të ndikonin në rritjen e vëmendjes së papatit ndaj luftës çlirimtare të arbërve. Pas vdekjes së Pellinit, Pal Engjëlli filloi të kryente edhe rolin e ambasadorit pranë Republikës së Venedikut.

Megjithatë, Skënderbeu duke kuptuar interesat e luftës antiosmane kishte si synim primar bashkimin e të gjithë faktorëve politikë të kohës, pra të të gjithë princave dhe strukturave religjionare që vepronin në Arbërinë e mesit të shek.XV. Prandaj, pavarësisht lidhjeve të ngushta me Romën, udhëheqësi arbër u tregua i gatshëm të përfshinte në veprimtarinë e tij elementë qoftë klerikë apo princa, të lidhur me të dyja strukturat kishtarë që gjendeshin në vendin tonë. Kështu, në Besëlidhjen e Lezhës, ai arriti të përfshinte pjesën më të madhe të fisnikërisë që nga Zeta e Epërme deri në territoret në jug të Shkumbinit, Mokër etj., me përfaqësues të familjeve që dy shekujt e fundit ishin shfaqur si të lidhura me Romën (Gjergj Arianiti, Andrea Topia, Nikollë Dukagjini etj.) e po ashtu edhe princat ortodoksë, si: Zaharijajt, Balsha, Crnojeviçët, Muzakajt etj. Kjo bëhej e mundur edhe në sajë të karakterit amfib, te fluiditeti që karakterizonte qëndrimin që princat arbër mbanin ndaj çështjeve religjionare për arsye të renditëm më sipër.

Njoftimet nga aktet kancelareske dhe burimet tregimtare, sado që nuk flasin haptaz, na japin të drejtë të pohojmë se Skënderbeu pavarësisht preferencave që pati për Selinë e Shenjtë romane, mbajti vazhdimisht një qëndrim të tillë. Ai pati në radhët e bashkëpunëtorëve të tij komandantë ushtarakë, si: Tanush Topia (i kishës katolike të Durrësit), Zaharia Topia (i kishës ortodokse të Ohrit) Pal Gropa (në zotërimet e të cilit ndodhej peshkopata uniate e Stefaniakës) etj.

Një dëshmi mbi qëndrimin e barabartë dhe integrues që mbante Gjergj Kastrioti ndaj përfaqësuesve të dy kishave vjen në shkrimin hagiografik mbi jetën dhe veprimtarinë e Nifonit të Moresë, që në fund të shek. XV do të emërohej patrik në Kostandinopojë. Në mesin e shek. XV, së bashku me Zaharinë, murgu Nifon do të vizitonte Arbërinë e Mesme:

“Që këtej ata u ngjitën në qytetin e Krujës, i cili është gjashtë milje nga Durrësi. Dhe vanë te Gjergji, prijësi i Arbërisë i cili quhej Skënderbe. Ai i pranoi me gëzim të madh dhe me dashuri, sepse ky edhe më përpara kishte dëgjuar për jetën e tyre dhe ta kishte at shpirtëror dhe mësues dhe edukator për të gjithë banorët dhe organizator të shpëtimit të të gjithëve, ndërsa Nifonin, me bekimin e kryepriiftit të Krujës e bëri igumen duke e

dorëzuar, si dhe vetë arhiereun, tek i lumturi patrik Nikolla”¹⁶.

Së fundi përsa i përket ritit që praktikohet nga banorët e kështjellës së Krujës në mesin e shek. XV, përfundimin mund ta nxjerrim nga një letër që i dërgohet Alfonsit të Aragonës nga komanda e trupave spanjolle që ndodhet në Krujë, ku i kërkohet që të dërgojë një klerik katolik për të celebruar meshën, sipas ritit roman për ushtarët në kështjellë, pasi aty mungonte një i tillë¹⁷. Nga kjo mund të kuptohet se në qytetin-kështjellë të Krujës praktikohet riti lindor ortodoks. Megjithatë në radhët e diplomatëve të Skënderbeut pati edhe peshkop ortodoks, si Stefani, i cili përmendet si një ndër dy nënshkruesit e traktatit të Gaetës¹⁸.

Një element me rëndësi të veçantë për të siguruar njësimin e ideologjisë kombëtare dhe bazat mbi të cilat ajo mbështetet, është pikërisht historicizmi. Evokimi i epokës së Skënderbeut, pasqyrimi i gjerë i saj në letërsinë e Rilindjes, propagandimi i luftës 25-vjeçare kundër perandorisë së fuqishme osmane kryen një funksion shumë të rëndësishëm politik dhe ideologjik. Me këtë rilindasit synonin jo vetëm të nxisnin krenarinë kombëtare duke evokuar një të kaluar të lavdishme, por edhe të ngjallnin optimizmin e besimin për një të ardhme më të mirë me synim realizimin e platformës ideologjike të Rilindjes Kombëtare. Kjo platformë nuk mund të zhvillohet e të realizohet përveçse në përplasje të drejtpërdrejta me pasojat ideologjike e strukturore të krijuar nga shekujt e sundimit osman, krahinarizmin feudal e patriarkal dhe identitetet e ngritura mbi to, e së fundi premiset për përçarje fetare të bazuara në sistemin e superuar tashmë historikisht të mileteve, të bazuar në komunitarizmin konfesional. Uniteti konfesional që ishte një element themelor në lëvizjet kombëtare të vendeve fqinje, në vendin tonë për një varg arsyesh nuk ekzistonte. Për këtë arsye, rilindasit tanë, duke marrë për bazë parimet filozofike të iluminizmit e të racionalizmit, por edhe të romantizmit liberal-demokratik e ngritën ideologjinë kombëtare mbi idenë themelore të mbivendosjes së identitetit kombëtar ndaj identiteteve të tjera religjionare të korracuara deri në atë moment nga sistemi i miletit. Ky identitet i ri, përmes të cilit do të njësohet dhe të materializohet “komuniteti imagjinar”, duhet të bazohet tek ideja e një historie, gjuhe dhe kulture të përbashkët, duke tejkaluar kështu

¹⁶ “Viata di trauil S. Nifon, patriarchal Costandinopolitalului”, Bukaresti, 1937, cituar në “Kristo Frasheri, Skenderbeu...”, f. 188.

¹⁷ Kristo Frashëri, vep. e cit... , f. 247.

¹⁸ “Mbi marrëdhëniet e Papatit me Gjergj Kastriotin Skënderbeun” në: USHT, IHGJ, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike (12-18 janar 1468), Stabilimenti i Botimeve Arsimore, Tiranë, 1969, f. 55.

identitetet e vjetra fetare e krahinore, të cilat shpeshherë shndërroheshin në mjete politike në duart e Portës së Lartë dhe të shteteve fqinje. Dhe pikërisht epoka e Skënderbeut do të shërbente si një shembull i shkëlqyer i këtij bashkimi, si një imperativ i imponuar nga rrethanat historike e politike.

BIBLIOGRAFIA:

- Milan Shuflaj, *Situata e Kishës në Shqipërinë paraturke*, Botime Françeskane, Shkodër, 2013.
- Milan Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët*, Toena, Tiranë, 2004.
- Kristo Frashëri, “Skënderbeu, jeta dhe vepra”, Toena, Tiranë.
- Dimitri Obolenski, “Il Comonwealth Bizantino”, Laterza, 1974.
- USHT, IHGJ, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike (12-18 janar 1468), Stabilimenti i Botimeve Arsimore, Tiranë, 1969.
- V Convegno di studi albanesi (1968), Palermo, 1969.
- Harry Hodkinson, *The Adriatic Sea*, Alden Press, Oxford, 1955.
- Oliver J. Schmitt, “Arbëria Venedike (1392-1479)”, Fjala, Tiranë, 2014.

Religious diversity in medieval Albania and the unifying politics of Gjergj Kastrioti Skanderbeg

ABSTRACT

This paper aims to clarify the political and cultural factors that make possible the emergence of religious diversity in medieval Albania, the catholic penetration starting from the XI century and later the Orthodox one from the north in the first half of the 14th century, as well as the impact that this geopolitical and cultural clash of the West and the East had in the amphibious and pragmatic character of the local nobility. This nobility, which, as Schmitt points out, came from the Byzantine-Serbian bonds, beginning in the second half of the XIII century with the anjouin penetration in the country, and after 1355 with the fall of the Serbian Empire in feudal anarchy, was able to rise using the political connections with the Papacy (getting involved enen in the crisis between the Anjouing Papacy and the Roman Papacy), the maneuvers between Venice and Ragusa or Anzhiun and Byzantium, and thus attaching these political movements to a religious vest. Consequently, reflecting such a plastic environment in the sense of the plurality of religious and provincial identities, we can appreciate further the politics and diplomacy that Gjergj Kastrioti Skanderbeu pursued as part of the unification of the country in the anti-Ottoman resistance.

Sokol AXHEMI

EVOLUCIONI I FAKTORËVE DHE I FORMAVE TË MIGRIMIT NË VENDIN TONË (1945-2019). EFEKTE DHE RISI

Hyrje

Në tërësinë e elementeve që karakterizojnë zhvillimin e popullsisë në hapësira të ndryshme sociogjeografike, kudo në botë, migrimi shfaqet ndër më ndikuesit ndër to. Një rol i tillë është mjaft i shprehur në disa drejtime dhe aspekte të ndryshme të popullsisë përkatëse të këtyre hapësirave sociogjeografike. Mjaft evident ky ndikim është në kuadrin e numrit dhe dinamikës së popullsisë, shtesës natyrore dhe ecurisë së saj, strukturave të ndryshme të popullsisë, dinamikës së vendbanimeve në vendet e origjinës dhe destinacionit etj. Njëkohësisht këto lëvizje migrative shfaqin efekte nga më të larmishmet jo vetëm në zhvillimet përkatëse të popullsisë së këtyre hapësirave sociogjeografike, por edhe në tërësinë e zhvillimeve rurale dhe urbane të tyre, zhvillimeve strukturore ekonomike, raporteve me natyrën dhe mjedisin e këtyre hapësirave etj.

Një tematikë e tillë ka qenë gjithmonë e pranishme në fokusin studimor analitik të shkollave të ndryshme gjeografike dhe gjeografëve të shumtë. Në mjaft artikuj shkencorë, tekste mësimore universitare, monografi apo libra të ndryshëm, çështje të tilla janë të pranishme. Mjafton të përmendim shkollat gjeografike evropiane (sidomos ato franceze, gjermane, britanike, italiane etj.), shkollën amerikane me analiza të ndryshme mbi migrimet dhe tiparet e tyre etj. Analiza të tilla kanë qenë prezente në evente të ndryshme shkencore ndërkombëtare, ku janë shfaqur debate nga më të larmishmet, si për rolin dhe kontributin e migrimeve, ashtu edhe për efektet bashkëshoqëruese të tyre në mjaft hapësira të larmishme sociogjeografike.

Shkolla shqiptare gjeografike ka qenë përgjithësisht e kufizuar dhe joanalitike gjatë gjithë historisë së zhvillimit të saj në drejtim të çështjeve që lidhen me migrimin. Mesa duket një gjë e tillë është ndikuar edhe nga një dominim i terminologjisë shkencore, në kuadrin e asaj që është njohur si lëvizja mekanike e popullsisë (kryesisht të fokusuar në lëvizjet e brendshme të popullsisë), mungesës së qartësisimit dhe mundësisë për të siguruar një analizë shkencore jashtë kuadrit politik, të migrimit të jashtëm

sporadik të pranishëm në Shqipërinë e 1945-1990, shkallës së kufizimit të specializimeve në gjeografi në përgjithësi dhe tematikave humane në veçanti, mungesës së literaturës së fokusuar në këto çështje etj. Një qasje më të zgjeruar dhe të shprehur, trajtesat migrative shkencore gjeografike morën pas viteve 1990, ku disa gjeografë u orientuan në studimet migrative në këndvështrimin gjeografik. Ndërkaq mjaft gjeografë të tjerë të fushës humane në trajtesat e tyre, si në mënyrë direkte ashtu edhe interdisiplinare bënë pjesë të analizës së tyre shkencore optikën migrative dhe analizën mbi çështje të ndryshme që lidhen me të.

Në këtë artikull shkencor kemi bërë përpjekje për të evidentuar disa tipare dhe risi të lëvizjeve migrative të popullsisë shqiptare në këto 70 vitet e fundit. Evidentimi i tyre është menduar nga ana jonë që të paraqitet në disa drejtime. Së pari, në kuadrin e faktorëve që kanë ndikuar dhe evoluimin e dinamikën e tyre. Së dyti, në tiparet që kanë shfaqur lëvizjet migrative në periudha të ndryshme, lidhur ngusht me format dhe mënyrat e realizimit të këtyre lëvizjeve migrative. Së treti, në efektet dhe disa risi, që jepen në brendësi të vetë nënçështjeve të shtjelluara nga ana jonë, me të cilat këto lëvizje migrative të popullsisë janë shoqëruar gjatë ecurisë së tyre. Vlerësojmë se një tematikë e tillë e përzgjedhur nga ana jonë është e përgjithshme dhe jo e detajuar ndikuar nga destinacioni i llojit të punimit shkencor, që në këtë rast është artikulli shkencor. E evidentojmë një gjë të tillë për faktin se çështje dhe tematika të tilla kanë nevojë për analiza të përmasave më të thelluara dhe më të zgjeruara shkencore, të cilat janë pjesë e punës sonë në të ardhmen. Në fund të punimit në një kuadër të përmbledhur kemi paraqitur disa konkluzione mbi këto lëvizje migrative të popullsisë së vendit tonë gjatë periudhës 1945 -2019.

Evolucioni dhe dinamika e faktorëve ndikues në lëvizjet migruese 1945-1990

Lëvizjet migrative në tërësinë e kësaj periudhe kohore kanë njohur veçori dhe karakteristika të larmishme. Vlerësojmë se ato janë të shprehura në mjaft prej elementeve përbërës të tyre, por spikasin faktorët ndikues dhe roli i tyre, tipet dhe llojet e migrimit, ecuria dhe drejtimet e shfaqjes, larmia dhe diversiteti i efekteve bashkëshoqërues të tyre, fizionomia e hapësirave sociogjeografike si të origjinës ashtu edhe të destinacionit të lëvizjeve të popullsisë etj. Analiza jonë në këtë nënçështje, i është referuar në mënyrë të veçantë rolit të faktorëve ndikues në lindjen dhe zhvillimin e lëvizjeve migrative në Shqipërinë e periudhës 1945 -2019. Nën këtë këndvështrim dhe optikë studimore në kuadrin e literaturës së shfletuar dhe hulumtimeve të realizuara evidentojmë faktin e një larmie të konsiderueshme të faktorëve

ndikues, të cilët shfaqin tipare interesante dhe kanë luajtur rol të rëndësishëm në lëvizjet e larmishme të popullsisë shqiptare gjatë periudhës së marrë në studim.

Tipari më interesant është ai që lidhet me karakterin dinamik të faktorëve ndikues në lëvizjet migrative. Argumentet në shërbim të evidentimit të një tipari të tillë specifik, janë të lidhura ngusht me vetë ecurinë e lëvizjeve migruese gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore. Në tërësinë e saj faktorët ndikues nuk kanë qenë të njëjtë e të qëndrueshëm në përmbajtjen e tyre motivuese apo suportuese në drejtim të ndikimit që kanë luajtur në lëvizjet e popullsisë. Përkundrazi ato kanë ndryshuar nga njëra periudhë në tjetrën, duke shfaqur në këtë mënyrë një karakteristikë apo tipar interesant që lidhet me dinamikën e evolucionit të tyre. Vlen të theksojmë ndryshimet që shfaqen në faktorët ndikues të periudhës së migrimit të jashtëm 1945-1990, me ato të periudhës së migrimit 1990 - 1992, me ato të 1997, apo migrimet e shfaqura së fundi në periudhën 2014-2019. Një dinamikë e tillë kemi mendimin se ka qenë e ndikuar nga kushtet konkrete të periudhave të veçanta kohore në të cilat ato janë shfaqur, ndonëse dinamika më intensive është ajo që paraqitet me faktorët ndikues pas viteve 1990.

Njëkohësisht një dinamikë e tillë paraqitet mjaft e spikatur edhe në kuadrin e evolucionit të faktorëve ndikues në lëvizjet migrative të brendshme gjatë tërësisë së periudhave të paraqitura më sipër, në të cilat shfaqeshin zhvendosjet e popullsisë nga një hapësirë e caktuar sociogjeografike në tjetrën. Theksojmë se dinamika e faktorëve ndikues në rastin e pranisë së migrimit të brendshëm ka njohur një intensitet më të lartë ndikuar edhe nga zhvillimet ekonomike sociale që pësoi vendi ynë në tërësinë kohore të periudhës së marrë në studim nga ana jonë, përkatësisht 1945 - 2019. Zhvillimet ekonomike, industriale e bujqësore gjatë periudhës 1945 - 1990, transformimi i njësive të ndryshme administrative urbane dhe rurale, lindja dhe zhvillimi i mjaft qyteteve të reja, hapja e mjaft qendrave dhe objekteve të reja ekonomike, në fushën e industrisë, minierave, energjitikës, sektorëve të pyjeve, ndërmarrjes së iniciativave të ndryshme nga grupe të veçanta sociale të shoqërisë shqiptare gjatë kësaj periudhe, shërbejnë si argumente të rëndësishme të potencialit dinamik të faktorëve ndikues në zhvillimet migrative të brendshme të popullsisë shqiptare. Nga ana tjetër dinamika paraqitet mjaft intensive edhe pas viteve 1990 deri më sot, ku zhvillime të tjera mjaft serioze prekën Shqipërinë e periudhës së tranzicionit duke ndikuar si në mënyrë direkte, ashtu edhe indirekte në lëvizjet migrative të popullsisë shqiptare si nga zonat rurale drejt atyre urbane, nga zonat rurale të vogla në ato të mëdha, e nga qytetet e vogla në

drejtim të qyteteve kryesore të vendit.

Larmia e faktorëve ndikues në lëvizjet migrative të popullsisë shqiptare gjatë periudhës 1945-1990, është një tjetër tipar karakteristik që duhet evidentuar. Një gjë e tillë arsyetohet nga fakti se gjatë gjithë kësaj periudhe ndeshen prania e tipeve të ndryshme faktorësh, të cilët kanë ndryshuar nga njëra periudhë në tjetrën. Larmia e tyre është e lidhur ngusht me drejtimet e ndikimit që ato patën në lëvizjet e popullsisë. Ndër faktorët kryesorë duhen përmendur sidomos ato politikë, ekonomikë, socialë etj. Një larmi e tillë kemi mendimin se ndryshon në kuadrin e llojeve të ndryshme të lëvizjeve migruese të popullsisë shqiptare të periudhës 1945-2019, si dhe vetë periudhave të migrimit. Gjatë periudhës 1945-1990 ndikim të dukshëm në kuadrin e migrimit të jashtëm shfaqet faktori politik, i cili bëri të mundur lindjen dhe zhvillimin e një migrimi ndonëse sporadik e të kufizuar, por ekzistues dhe të pranishëm në zhvillimet e popullsisë shqiptare. Ndërsa në periudhat e tjera të zhvillimeve të lëvizjeve migruese pas vitit 1990 faktori politik shprehet i shoqëruar me faktorët e tjerë, kryesisht ekonomikë e socialë. Një gjë e tillë është evidente jo vetëm gjatë periudhës së parë të valëve migrative të popullsisë shqiptare pas tranzicionit në 1990, por edhe më pas në 1997, apo në 2014 - 2019.

Gjatë periudhës 1945 -1990 në kuadrin e migrimit të jashtëm vlerësojmë se faktori themelor ndikues mbetet ai politik. Ndonëse në kuadrin tërësor të zhvillimit të tij ky migrim shfaqet sporadik, grupet sociale të migrantëve ishin kryesisht përfaqësues të grupeve sociale, që ishin të pakënaqur me politikën e aplikuar në Shqipëri në asaj kohe, duke i bërë rezistencë të hapur apo të fshehtë sistemit politik që u instalua në vendin tonë. Në fillimet e migrimit të periudhës së tranzicionit në Shqipëri vlerësojmë se faktori politik mbetet primar për fillimet e viteve 1990, lidhur ngusht me një politikë izoluese ndjekur nga sistemi komunist mbi popullsinë shqiptare 1945-1990. Ndonëse me kalimin e viteve deri në 1997 krahas këtij faktori, rritet intensiteti dhe roli i faktorit ekonomik në zhvillimet e migrimit të jashtëm të popullsisë shqiptare. Gjendja ekonomike në të cilat ndodheshin familjet shqiptare me fillimin e periudhës së tranzicionit, mbyllja e ndërmarrjeve të shumta dhe mjaft objekteve ekonomike industriale pas 1990, krijoi një papunësi dhe varfëri të konsiderueshme në popullsinë shqiptare të kohës. Lidhur ngusht me një situatë të tillë, faktori ekonomik ndikoi dukshëm në lëvizjen dhe migrimin e popullsisë shqiptare drejt vendeve evropiane dhe me gjerë.

Periudha e vështirë me të cilën u përball vendi ynë gjatë ngjarjeve problematike të vitit 1997 luajti një rol të rëndësishëm, që krahas faktorëve politikë dhe ekonomikë, të qartësohej edhe përfshirja e faktorit social në

motivimin e lëvizjeve migruese të jashtme. Vlerësojmë se në mënyrë jo masive një faktor i tillë ishte prezent në migrimin e mjaft intelektualëve gjatë periudhës 1990-1996. Një migrim i tillë u shfaq qartazi në institucionet universitare, si dhe në sferën e artit, kulturës dhe sportit. Mjaft studiues të qendrave të ndryshme kërkimore shkencore, pedagoge universitetesh, artistë të skenës, sportistë të llojeve të ndryshme të sportit, u bënë pjesa themelore kryesore e një migrimi të tillë. Ndjekja dhe qasja ndaj zhvillimeve më të mira e pozitive për karrierat e tyre profesionale dhe mirëqenien e tyre, janë elemente të rëndësishme që qartësojnë edhe rolin dhe kontributin e faktorit social në këto zhvillime migrative. Por jemi të mendimit që ngjarjet që ndodhen në Shqipërinë e 1997, referuar problemeve të shfaqura kryesisht me shkatërrimin e institucioneve shtetërore në veçanti e rënies së rolit të shtetit në përgjithësi, shtoi pasigurinë e mjaft familjeve shqiptare, të cilat evidentuan dhe përcaktuan si mundësi të vetme, migrimin drejt vendeve të tjera evropiane dhe më gjerë. Një situatë e tillë zgjeroi së tepërmi edhe kontributin e faktorit social, si motivuesi kryesor i këtyre grupeve, shtresave dhe kategorive sociale, që të zhvendoseshin drejt destinacioneve të tjera, në kuadrin e migrimit të jashtëm.

Migracioni i jashtëm, i cili u shfaq në mënyrë më të theksuar nga 2014-2019, kemi mendimin se dallon nga një bashkëpunim dhe ndikim kompleks i faktorëve ekonomikë, politikë e socialë. Ndjenja e pritshmërisë së lartë ndaj rrotacionit politik në Shqipëri pas 2013, zhgënjimet e pësuar nga efektet e reformave të ndërmarra në sektorë të ndryshëm të jetës së vendit, mungesa e hapjes së vendeve të reja të punës dhe produktivitetit të funksionimit të ekonomisë aktuale, si në aspektin industrial e bujqësor, problematikat e shfaqura në anën fiskale etj., bënë të mundur lindjen dhe zhvillimin e një migracioni intensiv, që ka prekur thuajse tërësinë e hapësirës sociogjeografike të vendit tonë.

Kjo larmi e faktorëve ndikues në zhvillimin e lëvizjeve migruese të jashtme të popullsisë shqiptare vihet re edhe në kuadrin e lëvizjeve të brendshme të popullsisë shqiptare gjatë periudhës 1945 - 2019. Ndonëse vlerësojmë se rol dhe kontribut më të drejtpërdrejtë kanë luajtur faktorët ekonomikë e socialë, veçanërisht gjatë migrimit të brendshëm në periudhën e tranzicionit. Migrimi i brendshëm gjatë periudhës 1945-1990 ka shfaqur si tipar specifik lëvizjen e kontrolluar të tij, edhe pse është evidentuar larmi në faktorët apo motivet e lëvizjeve të popullsisë. Një larmi e tillë shpjegohet me faktin se zhvendosjet e popullsisë lidheshin ngusht me hapjen e mjaft qendrave apo objekteve të reja ekonomike në fushën e industrisë (punishte, ndërmarrje, fabrika, uzina kombinate, miniera apo

bujqësisë (ndërmarrje bujqësore, sektorë pyjesh) etj. Raste tilla i kemi prezente kudo në Shqipëri, si në rastin e Elbasanit, Laçit, Kuçovës (ish - Qyteti Stalin, Rubikut, Memaliajt, Martaneshit, sharrave të Pukës etj. Inicativat e ndryshme nga grupe sociale apo kategori të veçanta të popullsisë, si: rinia, arsimi, kultura, shëndetësia, institucionet e ndryshme shtetërore, bënë të mundur lëvizje të shumta migrative të brendshme drejt zonave rurale apo njësive të vogla administrative urbane. Raste të tilla janë të shumta dhe të shumëllojshme pothuajse kudo në Shqipërinë e viteve 1945-1990.

Larmia e faktorëve migrativë ndikues në migrimin e brendshëm të popullsisë shqiptare 1990-2019 ndjek më së shumti evidentimin e faktorëve ekonomikë dhe socialë. Ndjenja e lirisë së lëvizjes, përfshirja në aktivitete të ndryshme, nevoja për mundësi të një jete sociale e mirëqeniejeje më të mirë, ndikuan dukshëm në lëvizjet e brendshme të popullsisë shqiptare. Nën efektin e këtyre faktorëve ekonomikë e socialë një pjesë e konsiderueshme e popullsisë shqiptare kanë tashmë destinacione të tjera banimi në raport me njësitë e tyre administrative të origjinës. Situata të tilla prezente i kemi jo vetëm në qendrat e mëdha urbane, si: Tirana, Durrësi, Fieri, Shkodra, Elbasani, Vlora etj., por edhe në ato më të vogla. Njëkohësisht trendi i kësaj lëvizjeje migrative ka prekur edhe njësi të tjera administrative më të vogla si urbane apo rurale të mëdha.

Format dhe mënyrat e migrimit. Dinamika dhe evolucioni i tyre

Krahas evolucionit dhe dinamikës së faktorëve ndikues në lëvizjet migrative të tipeve të ndryshme të migrimit të popullsisë shqiptare gjatë viteve 1945-2019, vlerësojmë se nga analiza jonë janë evidentuar edhe disa tipare dhe karakteristika të tjera të tyre. Në mënyrë të veçantë këto tipare janë të lidhura ngusht me vetë elementet themelore që karakterizojnë në kuptimin dhe përmbajtjen themelore procesin migrativ. Ndër to mund t'u referohemi kryesisht tipeve dhe llojeve të migrimit, formave të migrimit, origjinës dhe destinacionit të lëvizjeve të popullsisë, rolit që ka luajtur në zhvillimet ekonomike e sociale, larmisë statistikore, efekteve bashkëshoqëruese etj.

Një ndër tiparet specifike të lëvizjeve migrative të popullsisë shqiptare gjatë periudhës 1945-2019 ka qenë e lidhur ngusht me praninë e një larmie të tyre. Një larmi e tillë paraqitet mjaft evidente në kuadrin e pranisë së tipeve të ndryshme të migrimit. Gjatë gjithë tërësisë kohore të kësaj periudhe në studim vihet re qartësisht një larmi e tillë, ndonëse duhet të nënvizojmë se ajo nuk është aktive në njëtrajtshmërinë e shfaqjes dhe vazhdimit kohor. Në mënyrë të veçantë njëtrajtshmëria dhe aktiviteti si

proces njih kufizimet e veta në kuadrin e migrimit të jashtëm 1945-2019, ku siç e kemi theksuar edhe në nënçështjen e parë, migrimi i jashtëm ishte sporadik. Ndër më të spikaturit janë migrimet më të njohura si ato të jashtme dhe të brendshme. Rastisjet e tipeve të tjera të migrimit janë të lidhura ngusht me atë spontan apo të organizuar, familjar apo individual, të përkohshëm dhe të përhershëm etj.

Një dinamikë interesante dhe karakteristike e rëndësishme që duhet paraqitur është edhe ajo e varietetit dhe ndryshimit të formave të migrimit, të mënyrës se si grupet e ndryshme migratore shqiptare kanë bërë të mundur zhvendosjen e tyre. Interesant është fakti, se një karakteristikë e tillë është në mënyrë të veçantë gjatë migrimeve të jashtme 1945-1990 dhe pas viteve 1990. Theksojme se secila nga këto periudha të migrimit të popullsisë shqiptare ka veçoritë dhe specifikat e veta në kuadrin e formave të aplikuara për të realizuar migrimin. Hulumtimet e realizuara nga ana jonë, dokumentet e ndryshme mediatike, të shkruara apo filmike, tregojnë një dimension të jashtëzakonshëm mënyrash, peripecish e formash të organizimit të lëvizjeve migrative individuale apo familjare të migrimit të jashtëm 1945-1990. Këto forma variojnë që nga arratisjet e dikurshme nëpër shtigje malore në zona ndërkufitare, me varka e objekte rrethore nëpërmjet liqenit të Shkodrës dhe atij të Ohrit, detit Jon, e deri në rastin e largimeve të vullnetshme nga grupe të veçanta sociale, si rezultat i pranisë së tyre në delegacione, ekipe sportive, apo udhëtime zyrtare kulturore, artistike apo sportive.

Format e mënyrat e migrimit ndryshojnë, transformohen e përsosen pas viteve 1990. Tashmë këto forma dhe mënyra nuk paraqiten më vetëm në raporte individuale apo familjare, përkundrazi shfaqen në përmasa më masive. Si të tilla mund të përmendim rastet e fillimit të viteve 1990, siç ishin lëvizjet e popullsisë me anije drejt Italisë, Greqisë e vendeve të tjera. Rrugët tokësore kryesisht drejt Greqisë, por edhe drejt vendeve fqinj, siç ishin Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, përfaqësonin forma të tjera migrative të popullsisë. Më pas, format migrative të realizimit të migrimit të popullsisë ndërmorën një mënyrë tjetër, siç ishin ato të rrugës detare me gomone nga Vlora drejt Italisë. Sistemi i realizimit të mënyrës dhe formave të realizimit të migrimit tenton krijimin e një forme më “legale” nëpërmjet sporteve të misioneve diplomatike të huaja ku tregtia e vizave fillon e rritet në mënyrë intensive duke ndikuar në rritjen dhe formësimin e një migrimi “ideal” për shumë individë e familje të ndryshme shqiptare. Situatë e tillë kaotike në forma, mënyra e llojshmëri të realizimit të lëvizjeve migrative të popullsisë shqiptare kemi prezente në Shqipërinë e 1994-2009.

Një etapë tjetër e rëndësishme e avancimit të formave të migrimit të popullsisë shqiptare në kuadrin e migrimit të jashtëm shënon postperiudha 2009. Liberalizimi i vizave dhe përfitimet nga marrëveshja Shengen, që u realizua në vitin 2009 nga ana e qeverisë shqiptare me vendet e tjera të Bashkimit Evropian, duket sikur ndikoi sadopak në eliminimin e rrugëve apo formave të paligjshme të migracionit ilegal apo klandestin të Shqipërisë së tranzicionit. Tashmë në kuadrin e realizimit të formave migrative filluan që të aplikohen forma të reja të migrimit. Ndër to mund të vlerësojmë kontratat e ndryshme ndërshtetërore nga marrëveshjet e ndryshme dypalëshe (kryesisht me Italinë), kontratat individuale të personave të ndryshëm që gjenin mundësi punësimi në vendet e ndryshme të BE-së (shumë e përhapur pas 2016), realizimi i martesave me shtetas të huaja rezidente në vende të ndryshme evropiane me qëllim sigurimin e dokumenteve legale për t'u vendosur në shtetin përkatës të BE etj. Krahas këtyre formave agjenci të ndryshme punësimi më qëllim ndëmjetësimin në kuadrin e ofertave për në vende të ndryshme të BE-së janë përfshirë në faza të ndryshme rekrutimi profesionesh të ndryshme. Po kështu vlen të përmendet roli i agjencive të ndryshme turistike, të cilat filluan që të marrin në konsideratë dhe realizojnë udhëtime të shtetasve shqiptarë në vende të ndryshme të BE-së me qëllim final migrimin e tyre në kuadrin e kërkesave për azil etj. Mjaft prezente një situatë e tillë ishte gjatë periudhës 2014-2015.

Janë realizuar edhe hulumtime në literaturën e kohës dhe anketime të ndryshme gjatë periudhës pas 1990 për të evidentuar edhe format e migrimit të popullsisë shqiptare në kuadrin e migrimit të brendshëm. Vlerësojmë se gjatë periudhës 1945 -1990 një migrim i tillë, lidhur ngusht me tiparin themelor të tij, që ishte i kontrolluar nuk u dallua për ndonjë varietet apo larmi formash e mënyrash zhvendosjesh së popullsisë. Ndonëse spikasin disa raste lëvizjesh masive ndikuar nga veprat e ndryshme ekonomike të cilat ndërtoheshin në hapësira të veçanta sociogjeografike. Rast tipik paraqitet ndërtimi i qytetit të ri të Kukësit etj. Format kryesore të migrimit realizoheshin nën orientimet e strukturave të pushtetit lokal apo atij qendror, ku njerëzit në mënyrë individuale apo kolektive vendoseshin në destinacionin përkatës. Periudha e pas 1990 e deri sot dallohet për një natyrë tjetër formash e mënyrash të zhvendosjeve të popullsisë, suportuar nga liria e lëvizjes së tyre. Nën këtë fokus kemi format e mënyrat e lëvizjes së popullsisë drejt destinacioneve të tyre.

KONKLUZIONE

Efektet dhe risitë e evolucionit dhe dinamikës së shfaqur në kuadrin e faktorëve ndikues në lëvizjet migruese të popullsisë shqiptare 1945 -2019 bartin në vetvete një rëndësi të veçantë në aspektin shkencor. Rëndësia është e lidhur ngusht me faktin e rolit që ato luajtën në vetë zhvillimet e popullsisë në përgjithësi, të popullsisë së hapësirave të veçanta sociogjeografike si të origjinës, ashtu edhe të destinacionit. Nën ndikimin e këtyre faktorëve, larmisë dhe dinamikës së tyre në periudha të ndryshme kohore, qartësohen dukshëm jo vetëm motivet e lëvizjes së popullsisë shqiptare, por edhe format dhe mënyrat e realizimit të tyre.

Analiza e faktorëve ndikues dhe e formave se si realizohen lëvizjet migruese luajnë rol evident në këndvështrimin teorik të studimeve mbi popullsinë në përgjithësi dhe popullsinë e vendit tonë në veçanti. Tematika e paraqitur dhe analiza referuar këtyre dy çështjeve të rëndësishme të lëvizjeve migrative të popullsisë (ndonëse e kufizuar në përmbajtje, diktuar nga fakti i llojit të punimit shkencor në gjeografi, që në këtë rast është artikulli shkencor), pasurojnë mendimin teorik mbi çështje të tilla, duke ndikuar drejtpërsëdrejti edhe në zgjerimin kontributiv të gjeografisë së popullsisë së Shqipërisë, e cila e ka jo vetëm të nevojshme, por edhe të domosdoshme një gjë të tillë.

Jemi të mendimit se efektet studimore të çështjeve të tilla sinjifikative për hapësirat sociogjeografike dhe dinamikën e tyre, ndikojnë dhe shërbejnë edhe në aspektin praktik. Aspekti praktik në këtë rast shfaqet në kuadrin e evidentimit të faktit se sa interesante dhe kontribuese paraqiten faktorët e migrimit dhe format e lëvizjes së popullsisë në zhvillimet shoqëruese të vetë jetës sociale që një hapësirë e caktuar sociogjeografike, njësi administrative urbane apo rurale, një shtet i caktuar kalon në periudha të ndryshme. Në këtë sens paraprin dhe nxit format e planifikimit social nga ana e institucioneve të ndryshme lokale e qendrore për marrjen në konsideratë të politikave të ndryshme për popullsinë në përgjithësi, e migrimin në veçanti. E në këtë rast situata aktuale e zhvillimeve të popullsisë në vendin tonë dhe sidomos çështjeve që lidhen me migrimin gjatë periudhës aktuale ndjen një domosdoshmëri të tillë.

Në këtë drejtim risi që duhet evidentuar është fakti që krahas disiplinave të tjera shkencore edhe gjeografia është përfshirë në studime të shumta dhe të shumëllojshme për migrimin dhe tematikat që lidhen me të. Organizimi i konferencave të ndryshme shkencore, botimet e shumta si në rastin e artikujve shkencorë apo monografive shkencore, pjesëmarrja në evente të shumta shkencore brenda e jashtë vendit, po ndikojnë në pasurimin në vazhdimësi të studimeve mbi çështje të tilla në gjeografinë e

vendit tonë. Njëkohësisht mjaft studiues gjeografë me projekte të ndryshme dhe punimet e tyre shkencore, po japin një ndihmesë të konsiderueshme për analiza të shumta e të detajuara në lidhje me zhvillimet që kanë të bëjnë me lëvizjet migrative të popullsisë shqiptare.

LITERATURA:

- Axhemi, Sokol: *Disa konsiderata mbi efektet socio-ekonomike të lëvizjeve migrative në Shqipëri në periudhën 1990 – 2011*. Buletini i Shkencave Shoqërore, 2012, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- Axhemi, Sokol: *Migrimi në kuadrin e politikave mbi popullsinë. Roli i popullsisë në evolucionin e politikave mbi migrimin në Evropë dhe Shqipëri*. Buletini i Shkencave Shoqërore, 2013, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- Axhemi, Sokol: *Efekte të lëvizjeve migrative të popullsisë drejt zonave bregdetare në Shqipëri 1990 - 2014*. Studime Albanologjike Nr.4, Tiranë, 2014.
- Axhemi, Sokol: *Migracioni shqiptar i vitit 2015. Faktorët, karakteristikat dhe tendencat e tij*. Buletini i Shkencave Shoqërore, 2016, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- Grup autorësh: *Identifikimi i zonave më të prekura nga emigracioni dhe migracioni i kthimit në Shqipëri. Profili i migrantëve të kthyer*. Botim i IOM Shqipëri, dhjetor 2008.
- INSTAT Migracioni në Shqipëri. Botim, maj, 2014.
- Hackaj, Ardian & Shehaj, Esmeralda & Zeneli, Neshat: *Të kuptojmë migrimin shqiptar në Gjermani gjatë periudhës 2014-2016* Dokument Pune “Seritë e procesit të Berlinit”, Migrimi/2/2016, dhjetor, 2016.
- Shehaj, Esmeralda: *Faktorët ndikues në shtysën për emigrim të studentëve shqiptarë*. Studim 2013, Ekon.al.Fuqia e incentivave, 18 shtator 2013.

Evolution of factors and forms of migration in our country (1945-2019). Effects and innovation.

ABSTRACT

This article attempts to present the evolution of the factors and forms of migration during the period 1945-1990. The dynamics of changing factors affecting the migration movements of the Albanian population during this period has also had an impact on the forms of migration and its types. At the same time migration has been associated with many effects in several directions, mainly on the social and economic aspects of the migrant social groups. The full scope of these issues is presented analytically in the article. The material is divided into two fundamental issues, namely: the evolution and dynamics of the factors influencing migration movements from 1945 to 1990 and the forms and forms of migration that appear in conjunction with their dynamics and evolution. At the same time the material contains introduction, conclusions of the paper and reference literature.

**Flora GJONI,
Nertila DILAVERI**

**OPORTUNITETET E PRIRJEVE GLOBALE TË
SHKËMBIMEVE TREGTARE, KUSHT PËR RITJEN
EKONOMIKE. KONTEKSTI I RASTIT TË
BASHKËPUNIMEVE NDËRKUFITARE MIDIS
SHKODRËS DHE MALIT TË ZI**

**Relacionet tregtare dhe impaktet në bashkëpunimet
ndërajonale e ndërkufitare, sfida e zhvillimeve të sotme ekonomike**

Doktrina e zhvillimeve ekonomike të sotme në kuadër të globalizimit ekonomik, ka vënë degën e tregtisë në pararojë të këtij procesi mbarëbotëror, duke superuar shoqëritë autokratike, ku prodhohet e konsumohet vetëm brenda kufijve të një shteti. Ndikimi që tregtia ka mbi ritjen ekonomike është një nga pyetjet më të rëndësishme, më të debatuar, dhe më të hulumtuara për ekonomistët në qarqet akademike, por edhe për politikëbërësit¹. Vendet e zhvilluara, përdorin të gjitha avantazhet konkurruese në interes të zhvillimit të ekonomive të tyre, shembull i cili duhet të konsiderohet edhe nga vendet në zhvillim. Rruga për arritjen e këtij qëllimi, janë bashkëpunimet ndërajonale, nëpërmjet forcimit dhe heqjes së barrierave tregtare.

Bashkëpunimet ndërajonale realizohen nëpërmjet bashkëpunimeve ndërkufitare. Kontrastet që ekzistojnë ndërmjet zonave ndërkufitare në shumë aspekte, qofshin ato ekonomike, kulturore e deri mjedisore, duhet të zbuten, në mënyrë që në rezultante të kemi zhvillim të qëndrueshëm të këtyre hapësirave. Kjo realizohet nëpërmjet vlerësimit të potencialeve natyrore dhe përdorimit të këtyre avantazheve në funksion të zhvillimit të këtyre hapësirave dhe më gjerë të vendeve respektive.

Dinamizmi i zhvillimeve tregtare aktualisht ka ndikuar në forcimin e marrëveshjeve tregtare ndërmjet vendeve, sidomos me vendet kufitare dhe më gjerë atyre rajonale. Në këto relacione ndikojnë shumë faktorë, si të

¹ Banka e Shqipërisë 2013, Ndikimi që tregtia ka mbi ritjen ekonomike është një nga pyetjet më të rëndësishme, më të debatuar, dhe më të hulumtuara për ekonomistët në qarqet akademike, por edhe për politikëbërësit. Faqe 6

spekterit fizik-natyror, ashtu edhe të atyre historikë, ekonomikë e kulturorë. Një nga format e këtyre relacioneve ndërajonale e ndërkufitare është krijimi i zonave të lira ekonomike, procese këto të përfaquara nga shumë vende të botës dhe ku leverditë ekonomike mes tyre janë në epiqendër, ndryshe nga autokratizmi e teoritë proteksioniste.

Krijimi i zonave të Tregtisë së Lirë presupozon heqjen e çdo barriere në këtë fushë të palëve nënshkruese me përfitime të ndërsjella, duke çuar në nxitjen e atyre sektorëve të ekonomisë me avantazhe konkurruese midis vendeve, apo edhe më gjerë në kuadër rajonal. Intensifikimi i relacioneve tregtare midis dy vendeve, ndikon pozitivisht në orientimin e burimeve natyrore e humane drejt përdorimit racional të tyre, por edhe efikasitet të sigurtë. Lidhja midis tregtisë dhe zhvillimit është teori tashmë e parë në proceset e zhvillimeve aktuale, ashtu sikurse nga ana tjetër, tregtia nxit edhe mirëqenien e popullsisë. Në fund të fundit ky është edhe qëllimi i tërë proceseve të zhvillimit ekonomik të çdo vendi.

Tranzicionet e ndodhura në vendet e rajonit të Ballkanit kanë qenë të vrullshme, por edhe të egra në një kuptim. Vendet e rajonit përfaqësojnë një grup partnerësh tregtarë, të rëndësishëm për tregtinë e jashtme të Shqipërisë, për shkak të afërsisë gjeografike dhe qëndrueshmërisë së tregtisë me këto vende.

Vendet e Evropës Juglindore, kanë institucionalizuar angazhimin për t'u bërë pjesë e Zonës së Tregtisë së Lirë. Midis tyre ato kanë nënshkruar marrëveshjet e Tregtisë së Lirë, që do të thotë lëvizje e lirë e mallrave, njerëzve, shërbimeve, ideve dhe informacionit.

Lind pyetja: *Cilët janë përfitimet ekonomike institucionale dhe mjedisore që vijnë nga hapja tregtare?*

Vendet nënshkruese kanë përfitime të shumta, ku mund të diferencojmë disa prej tyre:

- *Përfitime në produktivitet ekonomik;*
- *Efekte dinamike në zbutjen e papunësisë;*
- *Përmirësime teknologjike me implementim të të gjitha risive në këtë fushë;*
- *Çmime më të ulëta të mallrave nga eliminimi i tarifave doganore;*
- *Kontroll i inflacionit;*
- *Rritje më efiçente e ekonomisë dhe shpërndarje e drejtë e burimeve natyrore e humane etj.;*
- *Eliminim i procedurave burokratike në bashkëpunimet dypalëshe;*
- *Zbutje të korrupsionit;*
- *Shtim i sigurisë në këto procese bashkëpunuese;*

- *Institucionalizim i problematikave që lidhen me ruajtjen e mjedisit;*
- *Integrim social midis vendeve nënshkruese.*
Këto marrëveshje, krahas avantazheve të karakterit pozitiv, janë shoqëruar edhe me impakte negative, të lidhura me:
- *Konkurrencën e mallrave mes palëve nënshkruese, që është e shoqëruar me rënie të prodhimit vendas;*
- *Heqjen e tarifave doganore, e cila ka ndikuar në aspekt negativ në buxhetin e shtetit;*
- *Aktivizim i dukurive negative të lidhura me kontrabandën etj.*

Pavarësisht këtyre, rezultatja e hapjes tregtare të një vendi, ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike të vendeve pjesë e këtyre proceseve, ku sfida kryesore është sa organet qeverisëse arrijnë t'i menaxhojnë e shfrytëzojnë në maksimum këto opurtunitete.


Shqipëria është pjesë e shumë proceseve që kanë ndodhur në rajon. Ajo ka nënshkruar me vendet e Rajonit marrëveshjet e Tregtisë së Lirë, si pjesë e kërkesave të formalizuara të Paktit të Stabilitetit të vendeve të EJT. Liberalizimi i tregtisë me këto vende, është parë si e vetmja rrugë në favor të rritjes ekonomike dhe përmirësimit në përgjithësi të treguesve të saj, në mënyrë që, Shqipëria shpejt të jetë pjesë e familjes evropiane.

Bashkëpunimet ndërkufitare Shkodër-Mal i Zi dhe përfitimet prej tyre

Përfitimi i komuniteteve lokale nga relacionet mes tyre duhet të sjellin përfitime për komunitetet apo njerëzit që jetojnë në këto hapësira, ku burimet natyrore e humane të shfrytëzohen në interes të tyre, duke ndikuar në rritjen e nivelit të jetesës.


Në kushtet e ndryshimeve të shpejta të tregut dhe të proceseve globalizuese, partneritetet në nivele ndërkombëtare janë më se të nevojshme. Ky lloj bashkëpunimi ka për synim kryesor, të qenit konkurrues në këto relacione, por edhe me përfitime për të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë në to. Meqenëse Shkodra bashkëndan kufij tokësorë, detarë e liqenorë me Malin e Zi, është krejt e kuptueshme që mes tyre të ketë bashkëpunime ndërkufitare në shumë aspekte, veçanërisht intensifikim relacionesh tregtare. Ky partneritet midis Shkodrës dhe Malit të Zi është i hershëm. Një nga faktorët më të rëndësishëm në këto relacione është fakti që territoret kufitare me rajonin e Shkodrës janë të gjitha treva të shkëputura që në 1881, pas vendimeve të Kongresit të Berlinit. Intensifikimi i hapjes tregtare me këtë shtet është shtuar shumë në ditët e sotme, kur partneriteti ndërkufitar është shndërruar në strategji zhvillimore të domosdoshme, që synojnë qëndrueshmëri zhvillimi të zonave

ndërkufitare të dy shteteve. Ky partneritet i forcuar ndërkufitar është i lidhur me një sërë faktorësh, si:



- ❖ Historiku pothuajse i njëjtë i të dy vendeve, të cilat vijnë nga të njëjtat sisteme;
- ❖ Afërsia gjeografike dhe fqinjësia historike midis tyre, të cilat shihen si faktorë favorizues në relacionet tregtare, por edhe ato të sektorëve të tjerë të ekonomisë;
- ❖ Resurset natyrore specifike të vendit tonë e veçanërisht të rajonit të Shkodrës, dhe mundësitë për një specializim funksional të tij, e gjithë kjo në kuadër të ekonomisë globale;
- ❖ Perspektiva e përbashkët e dy vendeve për të aderuar dhe bërë pjesë e BE-së, por edhe të gjitha organizmave evropianë e ndërkombëtarë¹etj..


Të jemi realistë, relacionet tregtare të Shqipërisë me Malin e Zi, nuk e justifikojnë plotësisht historikun e zhvillimeve të tyre në shekuj. Këtë na e tregon edhe grafiku i mëposhtëm, ku në eksportet e vendit tonë me Malin e Zi, zënë vendin e tretë :



Ndërkohë që volumi i eksport –importeve me këtë shtet ka pasur dinamikën e vet të zhvillimit gjatë 5 viteve të fundit, me uljet e ngritjet e veta. Bazuar në të dhënat e INSTAT-it vëmë re se eksportet ndaj këtij shteti janë më të mëdha se importet, pra me një bilanc pozitiv, me përfitime direkte të rajonit të Shkodrës.

Këtë bilanc na e evidenton qartë edhe grafiku i mëposhtëm:

2



Përfitimet e Shkodrës nga zbatimi prej gati 13 vitesh i kësaj Marrëveshjeje është për disa aktorë: konsumatorët, biznesin si dhe investitorët shkodranë e malazezë. Është e kuptueshme që përfitimet janë edhe shtetërore. Konsumatorët shkodranë nga ky qarkullim tregtar kanë mundësi më të madhe përzgjedhjeje mallrash. Krahas kësaj konsumatori shkodran ka edhe përfitime në çmime, pasi vetë hapja tregtare krijon ulje të çmimeve të mallrave dhe rritje të konkurrencës.

Në këto procese edhe biznesi shkodran ka pasur përfitimet e veta. Konkretisht po rendis disa prej tyre:

- Tregti më e lehtësuar me këtë shtet;
- Janë hapur tregje të reja;
- Për mallrat e eksportuara, ashtu edhe të importuara janë ulur çmimet;
- Rritje e kapaciteteve prodhuese për ato biznese që kanë gjetur treg në Mal të Zi, të cilat janë pakta etj.

Një aktor i rëndësishëm në këtë partneritet dhe liberalizim tregtar janë edhe investitorët e huaj dhe vendas, që domosdoshmërisht kanë pasur përfitimet e tyre nga Marrëveshja me Malin e Zi. Konkretisht:

² InstatTregtia e Jashtme 2012-2016.

- Akses për investime të kapitalit malazez në rajon;
- Akses për aplikim të risive teknologjike;
- Krijimin e një mjedisi atraktiv për këto investime;
- Rritjen e aspekteve cilësore, krahas sasisë në prodhimin e tregtinë e mallrave.

Megjithatë tregtia ndërkuftare e Shkodrës me Malin e Zi është në nivele tepër të ulëta, e cila edhe në këtë degë ka mbetur prapa, duke mosshfrytëzuar të gjitha potencialet e saj. Kjo është e lidhur me dallimet që vërehen në strukturën ekonomike të rajoneve. Shkodra ka një strukturë ekonomike ku mbizotëron bujqësia, shërbimet, tregjet me shumicë dhe pakicë, në rajonet malazeze shfaqet një industri më e zhvilluar, si dhe nivel të lartë të zhvillimit të turizmit³.

Dega e bujqësisë mbetet një nga degët më të rëndësishme për të dyja rajonet kuftare. Pavarësisht nga kjo sfidë në këtë partneritet, ajo që konstatohet janë nivelet e ulëta të prodhimit në këtë fushë, e lidhur kjo me mosshfrytëzimin e risive teknologjike në këtë degë, duke mospërballuar kërkesat e tregut me produkte të cilësisë së lartë. Një faktor tjetër, në shkëmbimet e ulëta të produkteve bujqësore e blegtorale ndërmjet hapësirave ndërkuftare, është edhe fragmentizimi i lartë i ekonomive rurale, sidomos në pjesën e rajonit të Shkodrës.

Njësitë e vogla të prodhimit bujqësor e kanë të vështirë përballimin e nevojave të tregut për shkak të konkurrencës së ulët me mallrat e huaja. Kjo ka sjellë konkurrentshmëri të ulët të fermerëve midis dy hapësirave ndërkuftare, duke plotësuar nevojat e tregut me produkte të ndryshme bujqësore nga rajonet, apo edhe shtete të tjera. Rritja e efikasitetit në degën e bujqësisë do të sjellë rritje të konkurrencës së fermerëve në të dy anët e kufirit, duke ju shtuar një tjetër burim shtesë komuniteteve banuese në këto hapësira, krahas degëve të tjera.

Pavarësisht nga këto zhvillime të kohëve të fundit, produktet potenciale autoktone që Shkodra dhe kryesisht zonat kuftare me Malin e Zi mund të eksportojnë janë: qumësht, fruta e perime të freskëta e të konservuara, duhan, peshk i freskët, vezë, pije alkoolike, mjaltë natyral, mish i freskët, bimë mjekësore e erëza, prodhime konfeksionesh e tekstilësh, prodhime xunkth-kashte, prodhime të argjendarisë, si dhe

³ FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, 2016, nr. 48, faqe 11.

prodhime artistike të ndryshme.

KONKLUZIONE E REKOMANDIME

Nga kjo analizë e shkurtër e relacioneve ndërkufitare midis Shkodrës dhe Malit të Zi konstatojmë se bashkëpunimet tregtare midis vendeve partnere janë një element mjaft i rëndësishëm që ndikon në përmirësimin e jetës së popullsisë respektive. Strukturat ekonomike të të dy hapësirave, tregojnë tendenca të ngjashme.

Struktura e ekonomisë është e ndryshme në të dyja anët e kufirit. Ndërsa rajonet shqiptare mbështeten në bujqësi, shërbime, tregje shumice dhe pakice, rajonet malazeze shfaqin industri më të zhvilluar dhe një nivel shumë më të zhvilluar të turizmit. Përgjithësisht, bujqësia është e rëndësishme për të dyja palët.

Ajo çka konstatohet nga analiza e zhvillimeve të relacioneve tregtare midis këtyre vendeve partnere është konkurrenca e ulët. Kjo lidhet me strukturën e dobët të mallrave që eksportohen e importohen. Një produktivitet më i lartë bazuar në risitë teknologjike të inovacionit, përbën një parakusht për t'u bërë më konkurrues si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Pavarësisht nga këto zhvillime aktuale midis këtyre dy hapësirave, mendoj se ato përmbajnë potenciale, të cilat mund të bëhen tërheqëse për investitorët e huaj.

Në mënyrë që të konkretizohen këto investime është e nevojshme që në të dy vendet ndërkufitare të bëhen përmirësime infrastrukture.

Bujqësia mbetet një potencial i madh ekonomik për hapësirat ndërkufitare, por që momentalisht përdoret pak. Ka prodhime të shumëllojta, por që për fermerët është plotësuese e më pak konkurruese në tregjet ndërmjet vendeve, aq më pak më gjerë në tregun rajonal.

Një akses i përmirësuar në tregun vendas, specializimi funksional në disa produkte dhe identifikimi i disa produkteve të veçanta, duke dalë nga fragmentarizimi i njësive të prodhimit bujqësor, është rruga e vetme për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë.

LITERATURA:

- Banka e Shqipërisë “Ndikimi i tregtisë MBI rritjen ekonomike: Një model i bazuar në instrumentet e gravitetit për Evropën postkomuniste”.
- Banka e Shqipërisë 2013, Ndikimi që tregtia ka mbi rritjen ekonomike është një nga pyetjet më të rëndësishme, më të debatuar, dhe më të hulumtuara për ekonomistët në qarqet akademike, por edhe për politikëbërësit. Faqe 6.

- Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, 2016, nr. 48, faqe 11.
- INSTAT, Tregtia e Jashtme 2012-2016.

The opportunities of global openness of trade opening, a condition for economic growth. The context of cross-border cooperation between Shkodra and Montenegro

ABSTRACT

In the economic development processes the liberalization processes in the trade branch have become the key to the cooperation between the countries in the framework of regional cooperation. The positive relations that emerge between the liberalization processes in the commercial and economic growth field are debatable in today's economic analyzes. The defenders of this thesis are those who agree to economic liberalization in many respects, while protectors are more skeptical of these processes.

The free market economy creates spaces for cooperation and agreements between businesses in different countries, reinforcing inter-regional cooperation between countries.

Our country's memberships in various international organizations are an expression of being part of these globalizing and integrating processes. Albania, like other Southeast European countries, has institutionalized its commitment to becoming part of the Free Trade Zone in the Region. The signing of Free Trade Agreements with the countries of the region, and more broadly, means the free movement of goods, people, services, ideas and information. On the multidimensional developments of our country, the Free Trade Agreement with Montenegro in December 2006 also affected positively, especially on the the strengthening of the relations of this country with the region of Shkodra as cross-border areas.

From this agreement, Shkodra's region has great direct and indirect advantages, making Shkodra's business well known and competitive not only in Montenegro but also in some regional and European markets.

Key words: Free Trade Agreement, trade relations, globalization processes, liberalization.

Dritan RRUSTJA**INFRASTRUKTURA SI FAKTOR ZHVILLIMI AKTUAL
DHE PERSPEKTIVA NË NJËSINË ADMINISTRATIVE
RRETHINAT - SHKODËR****I. Hyrje**

Infrastruktura me të gjitha degët dhe elementët e saj përbërës është një faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi. Shqipëria ka trashëguar nga e kaluara e saj një infrastrukturë të pazhvilluar dhe të papërshtatshme për nevojat që kërkon një ekonomi e tregut të lirë. Prandaj, vitet e demokracisë janë karakterizuar nga një numër i madh investimesh, sidomos në infrastrukturën rrugore, por jo vetëm. Ashtu sikundër i gjithë vendi, edhe qarku i Shkodrës, ka njohur zhvillime të rëndësishme në këtë drejtim, të mbështetura me plane konkrete, për një zhvillim të qëndrueshëm të rajonit, ndërkohë që ka edhe plot gjëra për t'u përmirësuar. Gjithsesi, në këtë artikull, jemi përqendruar kryesisht në tiparet aktuale të zhvillimit të infrastrukturës në njësinë administrative Rrethinat, por duke e parë atë në kuadër të zhvillimit rajonal e më gjerë.


II. Rasti studimor

Njësia administrative (NJA) Rrethinat, me ndarjen e re administrativo-territoriale të Shqipërisë, miratuar me 31 korrik 2014, sipas ligjit 115/2014, është pjesë e bashkisë së re Shkodër dhe qarkut me të njëjtin emër¹. Kjo bashki e re përbëhet nga këto njësi administrative: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Gur i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë. Sipas të dhënave të Censusit 2011, kjo bashki e re ka një popullsi prej 135 600 banorësh; ndërsa sipërfaqja e saj është 872 km² (INSTAT 2012). Më përpara kjo njësi administrative njihej me emrin

¹ Ligji nr.115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

komuna Rrethinat, krijuar në v. 1992, dhe ishte pjesë e qarkut Shkodër (Rustja, 2009).

Fig.1. Pozita gjeografike e njësisë administrative Rrethinat në qarkun dhe bashkinë (e re) Shkodër.



Sipërfaqja e kësaj NJ.A është 47 km², ndërsa popullsia e saj - 22 000 banorë (INSTAT 2012). Ajo përbëhet nga 10 vendbanime (fshatra): 1.Bardhaj, 2.Bleran, 3.Dobraç, 4.Golem, 5.Guci e Re, 6.Grudë e Re, 7.Hot i Ri, 8.Shtoj i Ri, 9.Shtoj i Vjetër, 10.Zues.

III. Gjendja aktuale e infrastrukturës

a) Transporti

Për vetë pozicionin gjeografik që ka, NJ.A Rrethinat ka avantazhin të përshkohet nga rruga automobilistike kombëtare dhe ndërkombëtare që lidh Tiranën me pikat kufitare të Hanit të Hotit dhe Muriqanit (ose Shqipërinë me Malin e Zi). Gjithashtu në të kalon hekurudha e vetme ndërkombëtare e Shqipërisë, që e lidh atë me Malin e Zi dhe rrjetin hekurudhor evropian.

Janë këto përparësi që kjo njësi i zotëron dhe që në një të ardhme të afërt, lidhur ngusht me zhvillimin e përgjithshëm rajonal dhe perspektivën e integritimit në BE, mund t’i krijojnë asaj kushte shumë të përshtatshme komunikimi dhe zhvillimi.

- Transporti automobilistik.

Në tërësi, në hapësirën e Rrethinave gjenden 27.7 km rrugë urbane, nga të cilat rreth 18.15 km janë të asfaltuara dhe rreth 9.55 km të pashtuara. Kurse rrugë të brendshme janë gjithsej 35 km, nga të cilat 9 km janë komunale (ZUKRR, 2015). Gjendja ekzistuese e rrugëve automobilistike paraqet mangësi, edhe pse ka pasur gjithsesi një përmirësim të dukshëm në këtë drejtim, sidomos pas v. 1990. Kështu, sipas të dhënave në dispozicion, janë asfaltuar pjesa më e madhe e rrugëve kryesore të fshatrave të komunës deri tek qendra e tyre, ose deri tek shkollat (ZZHQSH, 2013). Vlen për t’u përmendur së fundi ndërtimi i rrugës kombëtare Shkodër–Han i Hotit, e cila kalon në një pjesë të konsiderueshme në territorin e NJ.A Rrethinat.

Më problematike paraqitet gjendja e rrugëve të brendshme të fshatrave, apo edhe e atyre që i lidhin ata me njëri- tjerin. Shumica e tyre janë në gjendje të papërshtatshme dhe kanë nevojë për rikonstruksion ose rregullim tërësor. Përveç pamjaftueshmërisë së rrjetit aktual vihen re edhe mungesa në standarde, si p.sh.: në ndriçim, sinjalistikë, korsi për transport alternativ (biçikleta), trotuare për këmbësorët, si dhe infrastrukturë nëntokësore (elektrike apo hidraulike).




Fig.2. Pozicioni strategjik rajonal i NJ.A Rrethinat në rrugët e komunikimit dhe rrjeti kryesor i transportit të saj.

Gjithashtu pritet që të kenë një ndikim të rëndësishëm në infrastrukturën dhe rrjetin rrugor të zonës edhe ndërtimi i bypassit që bashkohet pranë fshatit Dobraq me rrugën kombëtare Shkodër-Koplik (nëse do të përfundojë). Një vend të veçantë në rrjetin e transportit për HPUSH, për vetë rolin strategjik të tyre zënë edhe *urat*. Dallojmë në këtë drejtim sidomos dy prej tyre:

- *Urën e Bardhajve*, e cila kalon mbi lumin Kir dhe shërben për të lidhur fshatrat Bardhaj dhe Bleran me fshatrat e tjerë të komunës dhe vetë qytetin e Shkodrës. Kjo urë e ndërtuar pas viteve '90, është shumë e rëndësishme për banorët e këtyre fshatrave, megjithatë, edhe pse e ndërtuar relativisht vonë, gjendja e sotme e saj është mjaft e rënduar dhe jashtë kushteve teknike, duke shtruar nevojën për ndërhyrje të menjëhershme për rikonstrukcion.
- *Urën e Vrakës*, e cila ia vlen për t'u përmendur gjithashtu, pasi është pjesë e rrugës nacionale kombëtare Shkodër-Han i Hotit, dhe një pikë e rëndësishme lidhëse e zonës me Gruemirën, bashkinë Malësi e Madhe e më gjerë.

Së fundi përmendim Urën e Bunës, që e lidh këtë njësi administrative me qytetin e Shkodrës dhe Malin e Zi.



Foto 1. Rrugë të asfaltuara dhe të paasfaltuara në NJ.A Rrethinat (D.Rustja).

Foto 2. Ura e Bardhajve (a), dhe hekurudha Tiranë-Hani i Hotit (b) në NJ.A Rrethinat (D.Rustja).



a)



b)

- Transporti hekurudhor.

Siç e përmendëm, në territorin NJ.A Rrethinat kalon hekurudha kombëtare dhe ndërkombëtare Tiranë - Han i Hotit, e cila e lidh vendin tonë me Malin e Zi dhe vetë zonën me kryeqytetin. Duhet thënë se gjendja e kësaj hekurudhe paraqitet e rënduar, për shkak të lënies në harresë dhe mosmirëmbajtjes të saj.

Aktualisht ajo përdoret kryesisht për transportin e mallrave me Malin e Zi, por në një të ardhme të afërt mund të përbëjë një vlerë të shtuar shumë të rëndësishme për lidhjet rajonale dhe zhvillimin ekonomik të zonës.

b) Furnizimi me ujë dhe energji elektrike

- *Furnizimi me ujë* përbën problemin më të rëndësishëm dhe akoma të pazgjidhur për banorët e NJ.A Rrethinat. Aktualisht, vetëm fshati Dobraq dhe pjesërisht fshati Golem, furnizohen me ujë nëpërmjet ujësjellësit të qytetit të Shkodrës: po ashtu edhe një pjesë e Hotit të Ri dhe Zuesit.

Ndërsa fshatrat e tjerë janë pothuajse pa ujë. Furnizimi i tyre me këtë burim jetik duhet të kryhet nga ujësjellësi i Mbishkodrës, i ndërtuar në

vitet 1976-1979; mirëpo me ndarjen administrative të Koplikut nga qyteti i Shkodrës, ai pothuajse doli jashtë funksionit (NUFSH, 2015).

Duke i shtuar kësaj, edhe ndërhyrjet e pakontrolluara në tubacionet kryesore pas v. 1990, si dhe rritjen e kërkesës për ujë për shkak të rritjes demografike, situata degradoi aty ku është sot: ku mbi 70 % të banorëve të zonës nuk u sigurohet nga strukturat shtetërore, një nevojë bazike dhe e drejtë njerëzore si uji.

- Bashkë me furnizimin me ujë, furnizimi i popullsisë së NJ.A Rrethinat *me energji elektrike*, përbën një problem tjetër të rëndësishëm për banorët e zonës. Në ditët tona, furnizimi me energji i kësaj njësie realizohet kryesisht nga nënstacioni Shkodra 1 dhe nga 3 fidra të ndryshëm me kapacitet 6-kilovatësh të tij; ku burimi parësor i energjisë është HC i Vaut të Dejës².

Në tërësi në të gjithë njësinë ka rreth 5000 abonentë (familjarë dhe biznese), dhe niveli i pagesës së energjisë së konsumuar është rreth 50%. (v. 2014). Po ashtu, vlen për t'u theksuar fakti se gjendja e rrjetit elektrik në NJ.A Rrethinat paraqitet mjaft e amortizuar për shkak të mungesës së investimeve në këtë drejtim; kabinat elektrike dhe i gjithë rrjeti në tërësi, nuk mirëmbahen.

Një gjë e tillë lidhet me faktin se, ndërkohë që numri i popullsisë se zonës është dyfishuar gjatë 20 viteve të fundit, rrjeti dhe kapaciteti mbajtës i tij ka mbetur thuajse i njëjti si më përpara.

c) Menaxhimi i ujërave të përdorura dhe mbetjeve urbane

Menaxhimi i *ujërave të zeza* është një element i infrastrukturës që akoma nuk ka filluar të vlerësohet në këtë zonë. Kanalizimet e tyre mungojnë në të gjithë fshatrat, dukë bërë që mënyra e vetme për sistemin e ujërave të zeza në fshatra është ajo me gropa septike individuale³.

Përqendrimi gjithnjë e më i madh i popullsisë në këtë zonë, me fshatra që i kalojnë 5000 banorë, ka bërë që ajo të ndotet shumë nga *mbetjet urbane*, prej hedhjes së pakontrolluar të tyre. Këto mbetje, por sidomos mbetjet e ngurta urbane përbëjnë një shqetësim për Rrethinat. Nuk ekziston një vend depozitimi, grumbullimi, përpunimi apo shërbim me rrjet kazanesh për hedhjen e tyre. Kjo zonë ka probleme të konsiderueshme edhe

² Të dhënat mbi furnizimin me energji elektrike në HPUSH janë marrë nga dega Shkodër e CEZ Shpërndarje dhe KESH (Korporata Energjitike Shqiptare), si dhe nga burime në terren.

³ D.Rustja; të dhëna të marra në terren, tetor 2015 .

me shërbimin e mbledhjes dhe të trajtimit të tyre.

Thuajse kudo, anës rrugëve, në kanalet kulluese dhe vaditës, gjenden grumbuj mbeturinash, që hidhen kryesisht nga familjarët dhe bizneset private, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në NJ.A Rrethinat. Kjo situatë është më alarmante përgjatë lumit Kir, veçanërisht në zonën Bardhaj-Bleran; por edhe në fushën e aviacionit, që gjendet mes fshatrave Grudë e Re dhe Hot i Ri. Këtu hidhen jo vetëm mbetjet e kësaj komune, por edhe ato të zonave fqinje, në disa raste. Kuptohet qartë se një ndër prioritetet kryesore të kësaj njësie në të ardhmen është marrja e masave për menaxhimin dhe trajtimin e këtyre mbetjeve.



Foto.3. Mbetjet urbane në Nj.A Rrethinat (D.Rustja).

d) Infrastruktura arsimore dhe shëndetësore

Aktualisht në të gjithë vendbanimet e NJ.A Rrethinat ka shkolla të ciklit 9-vjeçar. Gjendja e godinave të shkollave është relativisht e mirë, pasi pjesa më e madhe e tyre është rikonstruktuar vitet e fundit apo është ndërtuar krejtësisht e re (ZSDRASH, 2015).

Edhe infrastruktura e brendshme e tyre është përmirësuar nëpërmjet pajisjes me kompjutera, mjete të reja mësimore etj., megjithëse në këtë drejtim mbetet akoma shumë për t'u bërë. Megjithatë, të gjithë objektet shkollore kanë nevojë për shtim të ambienteve, përmirësim të kushteve dhe në disa raste ka nevojë edhe për objekte të reja, ndërkohë që paraqitet i domosdoshëm ndërtimi i një shkolle të mesme që mungon në këtë njësi.

Me përjashtim të Zuesit, në të gjithë fshatrat e Rrethinave ekzistojnë ambulancat me personelin shëndetësor përkatës; një pjesë e mirë e tyre janë ndërtuar gjatë viteve të fundit dhe në përgjithësi janë funksionale dhe në shërbim të banorëve të zonës (DRSHPSH, 2015).

Gjithsesi, edhe sektori i shëndetësisë nuk i plotëson siç duhet nevojat e komunitetit dhe ka nevojë për përmirësime të shumta në sasi dhe cilësi dhe shtim të kapaciteteve në ambiente.

e) *Infrastruktura social – kulturore*

Jeta socialkulturore e banorëve të zonës është e zbehtë dhe ofron pak mundësi për mbushjen e kohës së lirë me veprimtari të dobishme qoftë në nivel individual, qoftë në nivel komuniteti. Mungojnë qendrat kulturore, bibliotekat, parqet, lulishtet apo këndet e lojërave.

Vihet re qartë mungesa e vëmendjes së strukturave të qeverisjes lokale në këtë drejtim, ku pothuajse nuk është realizuar asnjë investim me karakter publik. Sado që afërsia me qytetin e Shkodrës krijon më shumë mundësi për të kaluar kohën e lirë dhe për t'u argëtuar për banorët e zonës, kjo nuk do të thotë se këto veprimtari dhe mundësi duhet të mungojnë në vetë fshatrat e saj. Përveç të tjerave ato do shërbenin edhe për socializimin dhe risocializimin e popullsisë, në një zonë të prekur dukshëm nga lëvizjet demografike dhe heterogjeniteti social, pas viteve '90 (Kroni, 2011).




Fig.3. Hartë e shpërndarjes së infrastrukturës arsimore dhe shëndetësore në NJA Rrethinat.

IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Nga analizimi i gjendjes aktuale të infratrakturës në NJ.A Rrethinat, mendojmë që zhvillimi i infrastrukturës së saj në të ardhmen, duhet të përqendrohet në këto drejtime kryesore, në:

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe transportit,
- Përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe energji elektrike,
- Rregullimin dhe përmirësimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza,
- Menaxhimin e mbetjeve urbane.

Më konkretisht, bazuar edhe në ndarjen e re administrative, rekomandohet për:

- integrimin e rrjetit rrugor të NJA Rrethinat me njësitë administrative fqinje; përmirësimin, asfaltimin dhe sistemimin e rrugëve problematike;
- rivitalizimin e hekurudhës Tiranë-Shkodër-Han i Hotit;
- lidhjen e fshatrave të zonës me rrjetin ujësjellës të qytetit ose ndërtimin e një ujësjellësi të ri;
- shtimin e kabinave të reja elektrike dhe transformatorëve në çdo fshat, kompletimin dhe rehabilitimin e atyre ekzistuese;
- ngritjen e një sistemi të kanalizimit të ujërave të zeza; hartimin e një plani për menaxhimin e mbetjeve urbane;
- krijimin e një sistemi zyrtar të adresave;
- *Përmirësimin e cilësisë së arsimit:* ndërtimin e një shkolle të mesme (pse jo me profil bujqësor) që aktualisht mungon në këtë zonë, zgjerimin e ambienteve dhe klasave në shkollat që e kanë të nevojshme, si dhe ngritjen e laboratorëve mësimorë dhe ambienteve sportive;
- *Përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore* - përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së shërbimit në qendrat e ngritura shëndetësore, si dhe ndërtimin e objekteve *socialkulturore*
- *Mirëqeverisjen:* në kuadër të reformës së re administrative dhe decentralizimit të pushtetit vendor, disa kompetenca të rëndësishme mbi administrimin e ujësjellësve, kanalizimeve, rrugëve rurale apo menaxhimit të mbetjeve urbane, do t'u kalojnë bashkive të reja. Po ashtu do të hartohen planet territoriale vendore për çdo bashki, që do jenë në harmoni me planin rajonal dhe atë kombëtar. Ndikimi i të gjitha këtyre ndryshimeve pritet të jetë pozitiv në aspektin e zhvillimit të infrastrukturës në tërësi, për këtë zonë e më gjerë, megjithëse mbetet për t'u parë më mirë në të ardhmen.

Burimet e shfrytëzuara

1. DRSHPSH; Drejtoria Rajonale e Shërbimit Parësor Shkodër, tetor 2015.
2. FSHZH - Fondi Shqiptar i Zhvillimit, *Plani Rajonal Shkodër - Lezhë* (2005 - 2020), Eptisa, Shkodër, 2006.
3. INSTAT; *Të dhënat paraprake të Censurit 2011*, Tiranë, 2012.
4. Kroni, Mehdi; *Vështirësi dhe sfida të integritetit të banorëve të ardhur pas vitit 1990 në qytetin e Shkodrës*; Lente sociologjike, Vëllimi I, nr. 1 – 2011.
5. NUFSSH; Informacionet dhe të dhëna të marra nga Ndërmarrja e Ujësjetësimit Fshat – Shkodër, tetor 2015.
6. Rustja, Dritan; *Transformimi i hapësirës periurbane të Shkodrës pas v. 1990 – sfidat drejt zhvillimit*; Studime Albanologjike nr. 4, Tiranë, 2009.
7. ZUKRR; Të dhëna të marra në Zyrën e Urbanistikës të komunës Rrethinat, qershor, 2015.
8. ZSDRASH; Të dhëna të marra nga Zyra e Statistikave të Drejtorisë Rajonale Arsimore - Shkodër , tetor 2015.
9. ZZHQSH (Zyra e Zhvillimit e Qarkut Shkodër); *Investime në komunën Rrethinat për periudhën 2005-2012*, tetor 2013.

The infrastructure as a factor of actual and perspective development in the administrative unit rrethinat - Shkodër

ABSTRACT

This paper analyses the current state of infrastructure development in the administrative unit "Rrethinat", of the new municipality of Shkodra, and its role as a factor of integration and territorial development in perspective for this area and beyond. This administrative unit with peri-urban patterns of development has undergone many changes in demographic, socio-economic and land use terms over the past 25 years, changes that have had a direct impact on the level of development of its infrastructure in general.

So initially, it is analyzed the current state of the physical infrastructure (roads, water supply, sewerage, waste treatment, power supply) and then, that of the social infrastructure (educational, health and socio-cultural facilities). Also, it is examined the role of the former local government in this context and the impact that will have the new administrative reform.

The paper concludes that the infrastructure in this area presents many deficiencies in its current state of development and needs to be completed and modernized, related closely with the changes that it has undergone after the 90's, so that it can serve better to its present and future residents by improving their quality of life; and to also, be better integrated with the neighboring administrative units and beyond. In this regard, specific and concrete recommendations are given.

**E. KRYMBI & A. HASAJ & O. HASRAMA
& I. SOKOLI**

**INSTRUMENTI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR.
RASTI I RAJONIT SHKODËR-PODGORICË DHE
ZONAT PËRRETH LIQENIT TË SHKODRËS**

Hyrje

Ky punim në lidhje me rajonin Shkodër-Podgoricë jep një qasje të përdorimit më eficient të Instrumentit të Bashkëpunimit Ndërkufitar në mënyrë që projektet të cilat zhvillohen në kuadër të këtij instrumenti të kenë një impakt më të madh rajonal. Duke dalluar që kemi vështirësi të bashkëpunimit institucional ndërmjet dy palëve të kufirit, mungesë të iniciativës, funksionimit të rajonit në mënyrë “informale” si dhe një impakt të zbehtë nga projektet të cilat zhvillohen nga ky instrument, atëherë ky punim kërkon të analizojë se si me anë të hartimit të vizioneve rajonale mund të përmirësohet situata. Ky rajon ashtu si edhe pjesa tjetër e Ballkanit ka një diferencë të madhe, përse i përket zhvillimit me rajonet e tjera të Evropës. Gjithmonë standardet e jetesës dhe mirëqenia sociale në Ballkan kanë qenë shumë herë më të ulëta sesa në Evropë, kjo për faktorë të ndryshëm që e karakterizojnë Ballkanin. Duke qenë se si Mali i Zi ashtu edhe Shqipëria duan të integrohen në Bashkimin Evropian, bashkëpunimi ndërkufitar është një instrument me anë të të cilit BE mbështet dhe kërkon të përshpejtojë këtë integrim të dy shteteve. Megjithëse ky rajon është në zhvillim e sipër, në të kaluarën e tij si pasojë e politikës nuk ka pasur asnjë lloj komunikimi ndërmjet shteteve, dhe kjo gjë sillte një pengesë serioze për zhvillimin e këtyre zonave. Ky rajon për momentin është në zhvillim e sipër dhe zhvillimi vjen si pasojë e disa faktorëve që janë specifikë dhe i japin përparësi në dallim me rajonet e tjera. Ekonomia është në rritje dhe ka resurse dhe potenciale të mëdha për zhvillim të mëtejshëm. Hartimi i një vizioni për rajonin Shkodër-Podgoricë do t'i japë një drejtim strategjik zhvillimit rajonal, do të intesifikojë marrëdhëniet institucionale, do të koordinojë politikën, si dhe do të sjellë një impakt më të madh në rajon nga përdorimi më eficient i fondeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar.

Vlerësimi i bashkëpunimit ndërkufitar i fushave të ndryshme në rajon

Bashkëpunimi ndërkufitar midis Shkodrës dhe zonave kufitare të Malit të Zi ka kaluar nëpërmjet një rrjedhe të pazakontë zhvillimi në pesëmbëdhjetëvjeçarin e fundit. Për shkak të kushteve historike, Shkodra u privua nga kursi i vazhdimit të marrëdhënieve me Malin e Zi, ndërkohë që ishte vendosur edhe në periferi të zhvillimit socialekonomik kombëtar. Për pasojë, progresi në rajonin verior mbeti pas hapave të rimëkëmbjes së ekonomisë malazeze në periudhën pas vitit 2000, që nënkupton edhe një hendek më të madh zhvillimi midis dy zonave dhe një pozitë më të pafavorizuar të Shkodrës ndërkohë që “kërkonte” mundësi bashkëpunimi me Malin e Zi.

Megjithëse takimet e nivelit të lartë midis autoriteteve të të dy vendeve janë zgjeruar më tej në vitet e fundit, mbështetja e bashkëpunimit ndërkufitar në këtë rajon është ende poshtë pritshmërive. Autoritetet qendrore shqiptare e malazeze kanë qenë të suksesshme në trajtimin e kërkesave të caktuara të vendasve që do të ndihmonin operatorët privatë nga të dyja anët e kufirit, të tilla si pikat e reja kufitare të kalimit, përmirësimi i rrjetit të rrugëve dhe hekurudhave kombëtare.

Bashkëpunimi në fushën e Biznesit

Pesëmbëdhjetë vitet e fundit të tranzicionit treguan se rikrijimi i lidhjeve “natyrore” të biznesit të Shkodrës me partnerët e tij rajonalë dhe rigjallërimi i tij si një zonë e rëndësishme ekonomike do të kërkonin më shumë se sa vetëm stimujt e tregut. Tranzicioni në Shqipëri madje e thelloi hendekun e zhvillimit me rajonet kufitare malazeze, ashtu si edhe në lidhje me ekonominë kombëtare, në veçanti, me pjesën qendrore dhe perëndimore të vendit. Kapacitetet e bashkësisë së biznesit vendas deri tani nuk kanë arritur të shkojnë përtej caqeve të tregtisë së vogël, duke lënë të pashfrytëzuar bashkëpunimin ekonomik në shkallë të gjerë. Aktorët lokalë dhe ekspertët e vendit në mënyrë të vazhdueshme kanë tërhequr vëmendjen në fushat e tjera me interes reciprok për bashkëpunimin kufitar me Malin e Zi, të cilat kanë mundësi të mëdha për sukses dhe rezultate, madje edhe brenda një periudhe kohe relativisht të shkurtër.

Ka edhe dy faktorë të tjerë që e kufizojnë zgjerimin e sipërmarrjes në veprimtaritë e tjera të biznesit (prodhim, industri, turizëm). Së pari, konkurrenca e bashkësisë së biznesit të Malit të Zi dhe pozita e tij e mirëvendosur në tregun rajonal dhe së dyti, mungesa e mbështetjes nga qeveria në drejtim të investimeve publike në infrastrukturë (sidomos në

qytetin e Shkodrës dhe zonat rurale të rrethit), i linjave të kreditit dhe projekteve të zhvillimit.

Bashkësitë vendore nga të dyja anët e kufirit kanë një traditë të gjatë në zejтари dhe prodhimet e artizanatit. Ndërsa zejjet malazeze të lehtësuara nga zhvillimi i turizmit tanimë kanë siguruar mbështetjen e hapësirën e nevojshme në tregun kombëtar dhe më gjerë, kjo nuk ka ndodhur me Shkodrën. Megjithatë, interesi i shprehur në disa veprimtari për nxitjen e mjeshtërive tregon se ‘tradita është akoma gjallë.’ Mungesa e burimeve financiare ka kufizuar jo vetëm zhvillimin e këtij sektori, por edhe organizimin e panairëve tregtare që do të kontribuonin në të vërtetë për nxitjen e këtij sektori përtej kufijve shtetërorë.

Të dhënat statistikore nga Dhoma e Tregtisë Shkodër mbi strukturën e ndërmarrjeve private dhe veprimtarive respektive të biznesit konfirmojnë dobësinë e këtij sektori që patjetër përfiton shtypa të reja duke zhvilluar ndërmarrje të përbashkëta dhe duke thelluar më tej bashkëpunimin me homologët e tyre malazezë. Përvoja e deritanishme tregon se veprimtaria e biznesit ndërkufitar mbetet brenda kuadrit të tregtisë së vogël, ndërkohë që ndaj sektorëve të tjerë është treguar një vëmendje e vogël. Një strategji zhvillimi afatgjatë duhet të përfshijë dhe të harmonizojë nismat e tanishme në sektorë të ndryshëm ekonomikë (industri e drurit, bakri, tekstilet, agrokultura etj.) duke iu drejtuar rritjes së mëtejshme të komponentit të bashkëpunimit ndërkufitar.

Bashkëpunimi në fushën e Turizmit.

Edhe sektori i turizmit në Shkodër e sheh veten në pozitë shumë të dobët krahasuar me atë të Malit të Zi. Rajoni i Shkodrës dhe fqinji verior, kanë karakteristika të ngjashme në sektorin e turizmit për shkak të burimeve të tyre të përbashkëta natyrore, duke përfshirë liqenin (liqeni i Shkodrës), lumin (Buna), detin (deti Adriatik) si dhe një zonë malore (Bjeshkët e Namuna). Kjo zonë, për pasojë, i ka të gjitha parakushtet e nevojshme për zhvillimin e katër degëve të turizmit: bregdetar (liqeni dhe deti), dimëror (malet), kulturor (qendrat kulturore, historike dhe arkeologjike) dhe agroturizmin. Megjithëse afërsia gjeografike e këtyre burimeve (brenda një rrezeje prej 30 km) përbën një avantazh mjaft tërheqës, krahasuar me Malin e Zi, sektori i turizmit në zonën e Shkodrës nuk i ka shfrytëzuar madje edhe mundësitë minimale të rajonit. Gjithsesi, përpjekjet në këtë sektor, nuk duhet patjetër të përqendrohen në garën me përvojën e gjatë të fqinjit tonë në turizëm – në konkurrencën vendore. Ato deri diku duhet të përqendrohen në veprimet e përbashkëta dhe të bashkërenduara nga të dyja anët e kufirit me qëllim që të tërheqin një

numër më të madh turistësh nga mbarë bota dhe të sigurojnë një përdorim më të mirë të burimeve natyrore për zhvillimin e sektorit të turizmit.

Bashkëpunimi ndërkufitar në këtë zonë duhet të përqendrohet në shfrytëzimin e progresit të turizmit malazez për ta bërë Shkodrën si pjesë të zonës turistike malazeze. Ky mesazh duhet përcjellë te homologët malazezë të cilët mund ta konceptojnë Shkodrën si një konkurrent shumë të mirë në të ardhmen në sektorin e turizmit. Ndërsa bashkësia vendore e biznesit dhe aktorë të tjerë qytetarë në rajonin e Shkodrës mund të zënë një pozicion më aktiv për të ushtruar presion mbi organet e qeverisjes vendore dhe autoritetet në qendër, aktorët publikë duhet të shfaqin angazhim për t'iu përgjigjur siç duhet këtij presioni. Mjedisi i biznesit dhe mungesa e investimeve të huaja të drejtpërdrejta ende përbëjnë pengesat kryesore për zhvillimin e ardhshëm të Shkodrës dhe në këtë kuptim, autoritetet qendrore duhet të tregojnë se ato mund të bëjnë më shumë se sa mbështetja e këtij procesi vetëm me deklaratat.

Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes së mjedisit

Bashkëpunimi ndërkufitar për çështjet e mjedisit në rajonin e Shkodrës na jep shembullin më të mirë të lidhjeve të frytshme midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. Në fakt, ky është sektori që kohët e fundit është karakterizuar nga një kurs i harmonizuar veprimesh dhe bashkëpunimi midis organizmave përgjegjëse publike dhe civile të përfshira nga të dyja anët e kufirit. Një tipar i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërkufitar mbi problemet e mjedisit është niveli i lartë i përfshirjes së aktorëve kryesorë nga sektori publik (autoritetet qendrore dhe vendore), sektori civil (organizatat ndërkombëtare dhe vendore, bashkësia akademike etj.) dhe në një shkallë më të vogël operatorët ekonomikë. Vendosja e këtyre lidhjeve midis aktorëve në fushën e mjedisit ka përcaktuar dhe ka trajtuar efektivisht jo vetëm nevojat dhe interesat, por edhe rolin e vërtetë që është në gjendje të luajë secili aktor. Përveç interesit të aktorëve vendorë, në drejtim të progresit të kohëve të fundit në këtë fushë kanë ndikuar edhe dy faktorë të tjerë:

- Angazhimi efektiv dhe i vendosur i bashkësisë së donatorëve;
- Interesi i madh i autoriteteve qendrore shqiptare dhe malazeze në lidhje me burimet e përbashkëta natyrore të të dy vendeve;
- Aktoret vendorë - shoqëria civile, bashkësia akademike, autoritete vendore – dhe organizmat përkatëse i kanë përdorur maksimalisht këta dy faktorë në disa nisma mjedisore ndërkufitare.

Megjithatë, përfshirja e aktorëve të shoqërisë civile dhe e bashkësisë donatore nuk mund ta përmirësojë gjendjen e mjedisit në rajon vetvetiu pa

një qasje akoma më aktive dhe e orientuar nga zgjidhja e problemeve nga sektori publik-pushteti vendor dhe ai qendror. Nismat ndërkufitare në fushën e mjedisit duhen parë nga aktorët qeveritarë si një instrument i rëndësishëm ndihme dhe jo si një mjet i fundit rezervë që mban gjallë bashkëpunimin ndërkufitar midis dy vendeve. Ndërsa bashkëpunimi ndërkufitar në çështjet e mjedisit deri tani me të drejtë ka arritur pozitën e ‘një prej lidhjeve të zhvilluara më mirë’ midis Shkodrës dhe zonave kufitare malazeze, shtypa e duhur nga autoritetet shtetërore ka mundësinë e rritjes së efektivitetit të bashkëpunimit dhe e pajis atë me statusin e ‘bashkëpunimit më të suksesshëm dhe më efektiv’.

Bashkëpunimin në fushën e Kulturës

Bashkëpunimi ndërkufitar në kulturë është ndoshta një nga më problematikët për rajonin verior shqiptar, kryesisht për shkak të vëmendjes së pakët që i është kushtuar deri tani dhe për shkak të shpresave të pakta që ka për mbështetje. Veprimtari të përbashkëta kulturore janë organizuar që në fillim të viteve 1990, nga shumë shoqata vendase dhe individë që herë pas here janë mbështetur edhe nga bashkitë e Shkodrës dhe të Podgoricës. Gjithsesi, bashkëpunimi intensiv ndërkufitar midis të dy bashkësive kufitare nuk do të bëhet realitet vetëm me veprimtaritë kulturore anësore që zhvillohen si pjesë e veprimtarive të tjera si panairët apo veprimtari të tjera reklamuese. Vëmendje e madhe duhet t’i kushtohet një bashkëpunimi më të qëndrueshëm midis institucioneve kulturore në fusha, të tilla si: arkeologjia, muzetë, historia, teatrot etj.


Përpyekja e parë serioze për të dalë jashtë caqeve është Strategjia për Zhvillimin Ekonomik 2005-2015 (Bashkia Shkodër) i cili në veçanti përfshin edhe komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar në këtë fushë. Ky dokument ka përcaktuar qartë dhe masat e domosdoshme që do të sigurojë ky sektor me një pozitë më të favorizuar për të kontribuar në zhvillimin socialekonomik të rajonit kryesisht në fushën e turizmit, duke shtuar përpjekjet e aktorëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë brenda një kuadri mjaft të konsoliduar, të harmonizuar dhe me veprimtaritë në fusha të tjera: zhvillimin ekonomik, bashkëpunimin ndërkufitar në fushën e turizmit etj.

Përveç strategjisë, aktorët vendorë tani duhet të përqendrohen dhe në nxitjen e aktorëve kombëtarë për veprime më kompakte. Ndërkohë që autoritetet qendrore duhet të jenë sigurisht fokusi kryesor i këtyre përpjekjeve, institucionet publike dhe aktorët e tjerë në sektorin e kulturës duhet ‘të nxitin’ përfshirjen dhe mbështetjen e organizmave aktive në procesin e bashkëpunimit ndërkufitar duke forcuar më tej lidhjet tashmë të krijuara me Malin e Zi.

Problematika e projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar

Le të kalojmë në një vlerësim të projekteve të cilët janë zbatuar në rajon dhe kanë përfituar fonde nga Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri - Mal i zi.

Na duhet të themi se për nga pikëpamja organizative dhe menaxhuese programi ka ecur me ritme të kënaqshme. Janë kryer tri thirrje dhe në total janë përzgjedhur për financim 24 projekte me një fond prej 5 246 104 euro. Në kuadër të thirrjes së 1-rë për propozime janë aprovuar 6 projekte me një fond prej 793 163 euro. Në kuadër të thirrjes së 2- të për propozime janë aprovuar 11 projekte me një fond prej 2 083 495 euro. Në kuadër të thirrjes së 3-të për propozime janë aprovuar 7 projekte me një fond prej 2 369 446 euro.




Në këtë figurë janë paraqitur projektet sipas prioriteteve të programit. Dallohet qartë se projektet tentojnë të alokohen në të njëjtat zona duke mos pasur një mbulim neutral të të gjithë rajonit me projekte. Në këtë mënyrë kemi krijimin e një mosbarazie në rajon përse i përket shpërndarjes së financimeve në rajon gjithashtu promovimit dhe zhvillimit. Në rajon ka mjaft zona të cilat kanë potenciale dhe resurse në të cilat nuk janë propozuar në projekte.

Nga intervistat e zhvilluara dalin në pah problematikat kryesore që janë vështirësia e bashkëpunimit institucional si dhe mungesa e një bashkëpunimi efektiv për zhvillimin e rajonit. Nga kjo mungesë impaktet e projekteve të cilat aplikohen në rajon janë më të vogla dhe nuk japin zhvillimin e duhur. Gjithashtu kuptohet se rajoni funksionon vetëm në mënyrë informale nga marrëdhëniet e krijuara rishtaz dhe jo duke pasur një iniciativë të organizuar nga të dy palët.

Në këtë pikë shfaqet mungesa e një vizioni rajonal që të shërbejë si platformë për projektet që do të financohen në mënyrë që të ketë një drejtim të përbashkët strategjik të projekteve si dhe për intesifikimin e marrëdhënieve dhe koordinimin institucional për zhvillimin rajonal. Në këtë mënyrë projektet mund të kontribuojnë me njëri-tjetrin në përmbushjen e objektivave më madhore të cilat mund të përcaktohen nga ky vizion rajonal. Duke pasur një eksperiencë të mirë organizative të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, atëherë me arritjen e marrëveshjes dhe krijimin e iniciativës çdo gjë mund të jetë më e lehtë, sepse praktika na tregon se marrëdhënie të tilla mund të funksionojnë shumë mirë dhe mund të japin impaktin e duhur.

Analiza rajonale e Shqipërisë Veriore

Duke u fokusuar në zonën veriore të Shqipërisë (shih hartën 1 në porterin 5) do të kuptojmë marrëdhënien e rajonit Shkodër-Podgoricë me rajonin e diamantit të Kosovës dhe rajonit të Alpeve. Këto dy rajone (rajoni Shkodër - Podgoricë dhe rajoni i diamantit të Kosovës) kanë pasur një lidhje shumë të fortë historike, sepse këto dy rajone kanë pasur shkëmbime tregtare të mëdha. Korridori kryesor që për momentin lidh në mënyrë më të shpejtë dy rajonet ekonomike është rruga e Kombit, por ka edhe korridore të tjera alternative të cilat bëjnë lidhjen e dy rajoneve. Korridori tjetër është rruga që lidh Pejën me Podgoricën në pjesën veriore të alpeve. Ka edhe rrugë të tjera të cilat shkojnë direkt në rajonin malor, por nuk kanë lidhje me rajonin tjetër (rruga e Thethit, rruga e Vermoshit dhe rruga e vjetër e Kosovës) nga kjo pikëpamje mund të themi se rajonin Shkodër-Podgoricë dhe rajoni i diamantit të Kosovës nuk kanë një lidhje aq të fortë. Një lidhje të re mund të krijohej me anë të një rruge mjedisore që kalon nga Shkodra në Theth në Valbonë e në Gjakovë. Kjo rrugë do t'i jepte një zhvillim të ri rajonit malor dhe gjithashtu do t'i jepte një fluks të ri zhvillimi dhe dy rajoneve të tjerë.



Analiza territoriale e rajonit

Rajoni Shkodër-Podgoricë ndodhet në bregun e detit Adriatik dhe në qendër të tij ka liqenin e Shkodrës. Në pjesën lindore të rajonit ndodhen zonat malore të alpeve kurse në pjesët jugperëndimore dhe veriore ndodhen zonat fushore. Qytetet më të mëdha në rajon janë Shkodra dhe Podgorica të cilat luajnë rol kyç në zhvillimin e rajonit.

Arsyet e funksionimit të rajonit

Në fillim do të fokusehemi në shkaqet e funksionimit të këtij rajoni i cili është një rajon ndërkufitar (shih skemën 1 në posterin 6).

Së pari, vitet e fudit vihet re një rritje e shkëmbimeve tregtare dhe njerëzore dhe këtë gjë e tregon më së miri grafiku i lëvizjes së automjeteve. Kjo gjë tregon se dy anët e kufirit kanë tendencë për të bashkëpunuar më shumë që të kenë përfitime më të mëdha.

Së dyti, është faktori i arritjes së marrëveshjeve mbi përmbytjet. Ky faktor megjithëse është një faktor negativ në rajon ka çuar në arritjen e disa

bashkëpunimeve të përbashkëta për zgjidhjen e këtij problemi. Në këtë mënyrë ky faktor mund të merret si një faktor pozitiv që e bën rajonin të funksionojë si një i vetëm.

Së treti, është faktori historik. Si në periudhën e para pushtimit osman dhe në periudhën e osmanëve ky rajon ka funksionuar si një i vetëm dhe ka qenë mjaft i zhvilluar për kohën. Në periudhat e mëparshme Shkodra ka luajtur rol kryesor në këtë rajon si dhe ka pasur një lidhje të fortë me rajonin e Kosovës. Një zhvillim të lartë ka pasur dhe infrastruktura portuale dhe liqeni i Shkodrës ka shërbyer për zhvillimin e tregtisë. Ky faktor ndikon pozitivisht sepse në fillim ky rajon ka ekzistuar dhe ka funksionuar shumë mirë, kjo do të thotë që me krijimin e një strategjie ky rajon mund të zhvillohet përsëri.

Së katërti, një faktor për funksionimin e këtij rajoni është vetë ekzistenca e liqenit të Shkodrës, që është një pasuri dhe resurs i përbashkët i dy shteteve dhe kjo mund të përkthehet në potencial për zhvillim rajonal. Në këtë mënyrë duke qenë një liqen i përbashkët në një farë mënyre në këtë aspekt vendet janë të ndërvuar me njëri-tjetrin për të krijuar këtë zhvillim.


Së pesti, është ekzistenca e potencialeve dhe e resurseve të përbashkëta që janë një faktor tjetër pozitiv për zhvillimin e rajonit. Këto resurse janë në shumë sektorë, siç janë sektorët e turizmit bregdetar, liqenor, kulturor dhe mjedisor, por gjithashtu dhe resurset bujqësore dhe të zhvillimit të industrisë janë të njëjta në dy anët e kufirit. Kjo gjendje në dy anët e kufirit dhe ekzistenca e potencialeve të njëjta mund të jetë një faktor pozitiv që mund të shërbejë për hartimin dhe implementimin e strategjisë rajonale.

Analiza bujqësore, e zonave të mbrojtura, e zonave kulturore, e vendbanimeve dhe e infrastrukturave të rajonit

Në vijim do të fillojmë me analizimet kryesore rajonale me qëllim që të nxjerrim në pah potencialet që shërbejnë për hartimin e vizionit.

Në një analizë të tokave bujqësore në rajon dallohen zonat të cilat kanë potenciale për zhvillimin e bujqësisë. Ndër zonat kryesore janë zonat e Nënshkodrës, Fusha e Zadrimës dhe Fusha e Zetës. Zona e Zadrimës dhe e Nënshkodrës ka kryesisht prodhime bujqësore si drithëra dhe perime. Në zonën e Nënshkodrës një sasi e madhe e tokave janë të mbjella me pemë frutore si dhe ullishte të cilat ndodhen edhe në tokat fushore të bregut lindor të liqenit të Shkodrës. Vreshtat i gjejmë në zonën fushore midis qytetit të Podgoricës dhe liqenit si dhe në pjesën veriore të rajonit përgjatë rrugës për në Cetinjë. Gjithashtu, pjesa e Mbishkodrës, ka

prodhime bujqësore siç janë drithërat dhe perimet si dhe bimët medicinale që janë të veçanta dhe mund të sjellin përfitime.



Analiza e zonave të mbrojtura mjedisore është një analizë shumë e rëndësishme, sepse është me rëndësi të evidentohen këto zona të mbrojtura më qëllim që të kthehen në potenciale për zhvillimin e turizmit mjedisor në rajon. Në rajon kemi 2 parqe kombëtare siç është zona e liqenit të Shkodrës (pjesa e Malit të Zi) si dhe parku kombëtar i Maranajt që ndodhet në pjesën lindore të rajonit. Një zonë tjetër natyrore është parku rajonal i Rumisë që ndodhet midis bregut perëndimor të liqenit dhe bregut të detit. Rezervatet strikte natyrore kryesisht ndodhen në bregun e detit. Kemi grykëderdhjen e lumit Buna, Lagunën e Vilunit si dhe pjesën e Ranës së Hedhun. Ndërsa zonat e tjera mjedisore cilësohen si zona me biodiversitet të lartë që mund të jenë zonat ligatinore dhe zonat pyjore. Këto zona janë të përhapura në pjesën e Mbishkodrës aty ku terreni lartësohet në pjesën lindore të rajonit, por gjithashtu gjenden dhe në pjesën veriperëndimore të rajonit.

Një analizë tjetër e rëndësishme është dhe analiza e zonave kulturore (shih hartën 3 në posterin 6) të cilat mund të jenë potencial për zhvillimin e turizmit kulturor dhe për hartimin e guidave. Në këtë analizë dallohen kryesisht objektet e kultit kisha ose xhamia si dhe zonat muzeale,

zonat arkeologjike dhe kalatë historike. Objektet e kultit me vlera historike kanë një përqendrim të lartë në disa qytete kryesore që janë: Shkodra, Ulqini, Cetinja, Shasi dhe Shirqi. Gjithashtu pjesa më e madhe e këtyre objekteve të kultit ndodhen në bregun perëndimor të liqenit të Shkodrës. Zonat arkeologjike, muzeale dhe kalatë kryesore i gjejmë në qytetet, si: Shkodër, Lezhë, Ulqin, Bar, Podgoricë dhe Cenjie, si dhe në vendbanimet më të vogla siç janë: Mesi, Drishti Vranina dhe Ivanaj.

Analiza e qyteteve kryesore të rajonit


Në këtë pjesë të analizës do të analizojmë qytetet kryesore të Rajonit dhe do të tregojmë problemet të cilat kanë këto qytete.

Qyteti i parë që do të analizojmë është Podgorica (shih hartën 2 në posterin 7). Podgorica është qyteti më i madh i rajonit si dhe është kryeqyteti i Malit të Zi. Podgorica në afërsi të saj ka edhe qyteza të vogla që mund të shërbejnë si vendbanime satelit përreth saj. Si kryeqytet është motori i ekonomisë së Malit të Zi dhe këtë rol do ta luajë edhe në rajonin ndërkufitar. Ekonomia e saj kryesisht mbështetet nga shërbimet dhe facilitetet që janë zhvillimi i bizneseve dhe i njësive tregtare të mëdha dhe të mesme kryesisht të shpërndarjes së mallrave dhe të industrisë së lehtë. Një pikë tjetër e fortë është edhe sektori i bujqësisë që përbëhet kryesisht nga kultivimi i vreshtave dhe i prodhimeve bujqësore (drithëra, perime) si dhe blegtoria. Podgorica është qyteti më i madh në rajon më një popullsi prej rreth 185 000 banorësh.

Zona tjetër është zona urbanë Shkodër - Koplík (shih hartën 4 dhe 5 në posterin 7).

Qyteti i Shkodrës është qyteti i dytë më i madh i rajonit i cili ka një pozicion mjaft strategjik në rajon. Ky qytet kryesisht ka një profil ekonomik të bazuar në ekonominë e shërbimeve, të industrisë dhe të bujqësisë. Industria përbëhet nga njësitë industriale të industrisë së lehtë, shërbimet kryesisht janë njësitë e vogla dhe të mesme tregtare si dhe bujqësia nëpërmjet produkteve siç janë dithërat, agrumet dhe blegtoria. Zonat e fshatrave në drejtim të Koplíkut kryesisht kanë profil bujqësor dhe blegtoral. Koplíku është qyteti më verior i Shqipërisë i pozicionuar në aksin Shkodër-Podgoricë. Ka një profil ekonomik kryesisht të bazuar në shërbime dhe në bujqësi, sektor tjetër me rëndësi është dhe industria e lehtë. Në të gjithë aksin Shkodër-Koplík kemi një numër të lartë të papunësisë, si dhe rritje të lartë të dendësisë dhe numrit të banorëve. Nga ky problem lind nevoja që të ketë një strategji zhvillimi për punësimin dhe për rritjen e mirëqenies dhe cilësisë së jetesës, sepse është një zonë që ka potenciale për

zhvillim. Shkodra ka një popullsi prej 114 000 banorësh, kurse Kopliku ka një popullsi prej 11 300 banorësh.



Tivari (Bar) është porta kryesore hyrëse për në rajonin Shkodër-Podgoricë (shih hartën 3 në posterin 7). Ky qytet ka një rëndësi të madhe ekonomike për rajonin për vetë ekzistencën e portit të mallrave. Ekonomia lokale mbështetet nga sektorët e shërbimeve të turizmit dhe të bujqësisë. Shërbimet përbëjnë peshën kryesore të ekonomisë, sepse porti i mallrave jep shtysë drejt këtij sektori. Gjithashtu turizmi bregdetar është sektori sekondar i zhvillimit të ekonomisë. Tivari ka një popullsi prej 42 000 banorësh dhe një kapacitet turistik prej 20 000 shtretërisht i cili pritet të shkojë në 53 000 shtretër.


Ulqini është një qytet tjetër i rëndësishëm i rajonit Shkodër-Podgoricë (shih hartën 7 në posterin 7) ky qytet kryesisht mbështetet në sektorin e shërbimeve, të turizmit dhe atë bujqësor. Sektori i shërbimeve është i përbërë nga njësitë e vogla tregtare dhe komerciale si dhe shërbimet turistike. Turizmi është një sektor mjaft i zhvilluar, por ka potenciale në mënyrë që të zhvillohet më tej. Gjithashtu edhe bujqësia është një sektor dytësor që kontribuon në zhvillimin e ekonomisë lokale. Ulqini ka një popullsi prej 20 000 banorësh dhe një kapacitet turistik prej 21 000 shtretërisht, por në vitet në vazhdim ky kapacitet turistik pritet të shkojë në 52 000 shtretër.

Velipoja është ndër zonat më të rëndësishme turistike të rajonit (shih hartën 6 në posterin 7) e cila ka mjaft potenciale zhvillimi. Kryesisht ekonomia lokale mbështetet në sektorin bujqësor dhe atë të turizmit. Më pak të zhvilluar janë sektorët e shërbimeve dhe të peshkimit. Në Velipojë papunësia është në nivele mjaft të larta dhe kjo gjë e bën të nevojshme krijimin e një politike për rritjen ekonomike të zonës.

Velipoja ka një popullsi prej 8 700 banorësh dhe një kapacitet turistik prej 10 000 shtretërish.

Analiza përmbledhëse e rajonit

Analiza përfundimtare e rajonit na paraqet një panoramë të potencialeve për zhvillim që ka çdo qendër e banuar dhe rëndësinë që ka secili vendbanim në raport me të gjithë rajonin (shih hartën 8 në posterin 7). Nga kjo analizë del që qytetet të cilat kanë potenciale për zhvillimin e ekonomisë të bazuar mbi zhvillimin e bizneseve, të tregtisë dhe të industrisë janë të përqendruar në aksin Lezhë-Shkodër-Koplik-Bajzë-Podgoricë, ku Shkodra dhe Podgorica kanë rëndësinë kryesore të zhvillimit të këtyre sektorëve. Një rëndësi tjetër të madhe kanë qytetet që kanë përparësi zhvillimin e turizmit. Këto qytete kryesisht ndodhen në vijën bregdetare të rajonit Shkodër-Podgoricë ku rëndësinë kryesore e mban qyteti i Tivarit i cili përveç sektorit të turizmit ka mjaft të zhvilluar dhe sektorin e transportit të mallrave. Gjithashtu të rëndësishme janë dhe qytetet e tjera, si: Budva, Ulqini, Velipoja, Petrovaci dhe Shëngjini i cili pos zhvillimeve bujqësore ka tendeca për zhvillime ekonomike të mbështetura në transport, sepse është ndër portet kryesore në Shqipëri. Vendbanimet e tjera janë vendbanime të cilat mbështeten në sektorin e zhvillimit të bujqësisë. Këto vendbanime kryesisht janë fshatra të cilat ndodhen në pjesën jugore dhe jugperëndimore të rajonit Shkodër-Podgoricë. Këto fshatra janë: Kallmet, Gjadër, Blinisht, Dajç, Hajmel, Bushat, Mjedë, Gur i Zi, Bërdicë, Trush, Dajç i bregut të Bunës, Pentar dhe Shas, ku rëndësinë kryesore e kanë fshatrat Bërdicë, Bushat dhe Shas. Kategoria e fundit është kategoria e vendbanimeve që kanë potenciale në zhvillimin e agroturizmit dhe të turizmit kulturor e mjedisor. Këto vendbanime ndodhen përgjatë bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës që janë: Shiroka, Zogaj, Ostros, Boboviste, Moracnik, Muriq, Karanikici, Godinje, Virpazar dhe Vraninë. Qyteti i Cetinjës bën pjesë në këtë kategori, por ky qytet në dallim nga vendbanimet e tjera potencial ka turizmin kulturor dhe tradicional, sepse është një qytet historik.



KONKLUZIONE

Duke parë që rajoni Shkodër-Podgoricë ka mjaft potenciale zhvillimi dhe ka mungesë të një iniciative të përbashkët, si rrjedhojë e kësaj të fundit, fondet që akolokoheshin për projektet kishin një përdorim jo eficient.

Si rezultat i kësaj u hartua ky vizion që nëpërmjet tij synon të intensifikojë marrëdhëniet që kjojnë një iniciativë të përbashkët për zhvillim dhe si rrjedhojë e kësaj fondet që alokohen për projektet ndërkufitare të kenë impaktin e duhur.

Kjo u arrit duke bërë një analizë të hollësishme të problematikave dhe potencialeve në mënyrë që hartimi i vizionit të tregojë qartazi drejtimin e duhur strategjik.

Nga ky studim kuptohet se si mund të përdoret hartimi i një vizioni hapësinor rajonal në kuadër të përdorimit më eficient të fondeve në mënyrë që projektet të kenë impaktin e duhur në territor si dhe koordinimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit institucional në të dy anët e kufirit.

Në mënyrë që të kemi një përfitim dhe ndryshim të situatës duhet të krijohet një iniciativë e përbashkët e zhvillimit rajonal e cila të konkretizohet me zhvillimin e projekteve të përbashkëta

Në mënyrë që të kemi një impakt më të lartë të projekteve në territor duhet që aplikantët dhe institucionet që merren me organizimin e projekteve të mbështeten në studimet rajonale të cilët synojnë zhvillimin e tyre në disa drejtime të caktuara. Është e rëndësishme që të gjithë aktorët të kontribuojnë në zhvillimin dhe zbatimin e këtyre studimeve rajonale.

Duke kuptuar limitet e një teme diplome masteri që janë kushtëzimi në kohë dhe kushtëzimi në financime, rekomandohet që të zhvillohen studime të mëtejshme, se si mund të arrihet ky implementim i vizioneve rajonale, në funksion të përdorimit më eficient të fondeve të cilat alokohen për projektet ndërkufitare dhe të koordinimit institucional.

LITERATURA:

- Albrechts L, (2004): Strategic Spatial Planning, Lueven, Belgium.
- Drejtoria gjenerale për zgjerimin., (2011): Të kuptojmë zgjerimin. Luxemburg.
- Economic Commission for Europe (2008): Spatial Planning, Key Instrument for Development and Effective Governance.
- European Movement Albania, (2009): Broshurë informative mbi Programet e ndihmës së BE, Tiranë.
- European Union, (2007): Adriatic IPA Cross-border Co-operation Programme 2007-2013.
- Shutina D, Toto R (2012): Polikëbërës dhe politikëndjekës, Tiranë.
- Dosenrode S, (2006): Federalism Theory and Neo-Functionalism.

- Dühr S, Colomb C, Nadin V (2010) European Spatial Planning and Teritorial Cooperation. New York, Rutledge.
- Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, (2006): Bashkëpunimi ndërkufitar në Shkodër Euro-Rajon i ardhshëm apo një përpjekje e mbetur pezull?
- Këshilli European (2007): Udhëzues Praktik për Bashkëpunimin Ndërkufitar, Luksenburg.
- Meeting of Ministers for Spatial Planning and Cohesion (2006): Mapping Territorial Cohesion, Marsille.
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, (2007): Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rajonal të Shqipërisë, Tiranë.
- Ministry of European Integration of Albania., Secretariat of European Integration of Montenegro (2007): IPA CBC Albania-Montenegro, Tirana and Podgorica.
- Ministry of Economic Development of Montenegro (2007), Spatial Plan of Montenegro until 2020, Podgorica.
- Qarku Shkodër (2010): Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal të Qarkut të Shkodrës, Shkodër.
- Søren Dosenrode (2010): Federalism Theory and Neo-Functionalism: Elements for an analytical framework.

Instruments of cross-border cooperation. Case-studies: the region Shkoder-Podgorica and the areas around Shkoder lake

ABSTRACT

This paper in relation to the Shkoder-Podgorica region provides an approach to more efficient use of the Inter-Co-Operative Instrument so that the projects under this instrument have a greater regional impact. Noting that there are difficulties in institutional cooperation between the two sides of the border, lack of initiative, the functioning of the region in an informal manner and a pale impact on the projects developed by this instrument, this paper seeks to analyse how drawing on regional visions can improve the situation. This region, like the rest of the Balkans, has a large margin in terms of development with other regions of Europe. Always living standards and social welfare in the Balkans have been many times lower than in Europe, due to various factors that characterize the Balkans. As both Montenegro and Albania want to integrate into the European Union, cross-border cooperation is an instrument by which the EU supports and seeks to accelerate this integration of the two countries. Although this region is under development, in its past because of politics there has been no communication between states, and this caused a serious obstacle to the development of these areas. This region is currently under development and development comes because of certain factors that are specific and give priority in contrast to other regions. The economy is growing and has great

resources and potential for further development. Drafting a vision for the Shkoder-Podgorica region will give a strategic direction to regional development, intensify institutional relations will coordinate policies, and will bring greater impact to the region by more efficient use of Cross-Border cooperation funds.

RECENSION**ALFRED ÇAPALIKU: VELI STAFA (PLATONICUS)****JETA DHE VEPRA****(Monografi)**

Monografia “Veli Stafa” e prof. Alfred Çapalikut” është e shtata në radhë në opusin e tij studimor, kurse në pikëpamje të plotësimit të një konstelacioni poetësh, siç e quan vetë autori treshen Pali (1916-1942) - Mirdita (1900-1936) - Stafa (1915-1939), është e treta, mbas atyre për Gaspër Palin dhe Kolë Mirditën. Rrjedhimisht kjo është monografia përmbyllëse e konstelacionit. Këtë gjë ai e sqaron që në hyrje, kur i drejtohet me dy fjalë lexuesit, me të cilat tregon për plotësimin që ato mbartin në raport me njëra-tjetrën. Kjo lidhje përcaktohet nga personalitetet letrare të cilëve u kushtohen monografitë: të tre kanë jetuar në rreth 40 vitet e para të shekullit XX, të tre janë shkolluar në Shkodër (në kolegjin françeskan dhe në atë jezuit), të tre janë diplomuar jashtë shtetit (Firence, Grac, Bolonjë), të tre e kanë e dashuruar letërsinë, të tre kanë vdekur të rinj dhe paradoksalisht edhe nga e njëjta sëmundje.

Në çdo fillim kapitulli vendoset nga një citat, i cili parapërgatit apo sqaron me një këndshikim sintetizues atë që thuhet më pas. Kështu ndodh edhe te parathënia, ku përmes citimit “*Tradita letrare është një vijë kufitare që shtrihet midis letërsisë e historisë*” lexuesi kupton këndvështrimin e trajtimit të monografisë.

Kapitulli i parë është hallkë lidhëse në mes të hyrjes, prezantimit dhe vazhdimit të mëtejshëm, pasi gjurmon faktorët që ndikuan në rritjen dhe në formimin e Veli Stafës, duke i parë ato të krahasuara me dy bashkëkohësit e tjerë, me të përbashkëtat e të veçantat e tyre, gjë që e bën edhe më komplekse dhe më të plotë analizën. Kurse nga citimi i dytë, në hyrje të kapitullit të parë, me fjalët e vetë Platonius: “*Sa dola nga bankat e liceut, ndjeva veten të prirun kah vjershat*”, kuptohet edhe një detaj tjetër i metodologjisë së shkrimit të monografisë, që jeta e shkrimtarit do t’i shërbejë studiuesit për të gjetur ndjesi të brendshme, të cilat do t’i shërbejnë pastaj si ndriçuese për krijimtarinë. Kurse faktorët e jashtëm pozitivistë ai na i rrëfen me detajet më të holla të studiuesit dhe me këndshikimin e vëzhguesit të afërt të çdo efekti që ka lënë dëshmi Velin. Çdo detaj analizohet deri në ezaurim, duke u futur në familje, në profesionin e

prindërve, në shkollim, në mënyrën e jetesës, tek mësuesit e lëndëve të veçanta (ku nuk kishte si të mos përmendej Ndre Mjeda) e deri tek korigjimi i amzës së Kolegjit nga At Zef Valentini. Ndriçohen detaje të vlerësimit *mjaftueshëm, mirë, shumë mirë, shkëlqyeshëm*, me bojë të kuqe, ose me *lavd të posaçëm*, si dhe të përzgjedhjes në aktivitete apo në kujtesa nëpër studimet kushtuar Kolegjit Saverian. Gjurmimi i çdo detaji bëhet me skrupolozitet.

Autori mban një raport të hapur me ato që janë shkruar për Veliun dhe dy autorët e tjerë dhe, kur ndan të njëjtin mendim, citon studiuesit përkatës. Përgjithësisht të dhënat për Veliun i vë në raport me ato të Gaspër Palit dhe Kolë Mirditës, si bashkëkohës, për të përcaktuar veçantinë e secilit.

Studiuesi A. Çapaliku me stilin e vet të brendshëm poetik lë vend edhe për të pashpjegueshmen, edhe për misterin, duke e tejkaluar kështu këndshikimin pozitivist.

Titulli dhe citati i kapitullit të tretë janë sa lidhëse, po aq thellues të argumentit që vijon natyrshëm. Trashëgimia e Veli Stafës (Platonicusit), me devizën e tij “Thirrje zemre djaloshare” i lejon studiuesit të vërë në fokus të gjitha botimet dhe reagimin e nxitur në kritikën e viteve ’30; më pas edhe përfshirjen në librat dhe antologjitë e letërsisë; më pas ai nuk nguron edhe të vendosë kontributin vetiak të Stafës në sfondin e botimeve të dekadës së katërt, siç i quan ai. Në veçantinë që përmban ky kontribut brenda këtij sfondi, studiuesi përmend si faktor edhe *gegërishten normative* të Veli Stafës, gjë që do ta përmendë më vonë si argument për interesin e studiuesve të sotëm filologë.

Vlerësime të tilla, si: *asgjë amatore s’ka në këto shtigje poetike fillestare ... e parapëlqen simbolin ... jo për t’u fshehur, por për t’u shprehur, shtjella e poezisë gufon sentimentaliste, por rrjedh realiste ... realizon natyrshëm e pa sforcim ... më tepër pëshpëritet, sesa flitet, ndihet sesa preket, nënkuptohet sesa shihet drejtpërdrejt ... tregojnë cilësimet e poezisë së Veli Stafës nëpërmjet një shikimi analitik dhe më rrallë sintetizues.*

Nëse në vlerësimet e prozës bie në sy ballafaqimi i rrëfimit me rrëfenjën, fakticitetit me fictionin, prozës dokumentare me atë artistike, në veçantinë e publicistikës studiuesi vlerëson ditarizmin si tërheqje të Veli Stafës, gjithashtu dhe moshumbjen e letraritetit. Ai i sheh në marrëdhënie reciproke prozën dhe publicistikën e tij, duke vlerësuar se gazetaria i jep krijimit kontaktin me realitetin, kurse letrarësia i jep gazetarisë së tij sfumaturën njerëzore dhe e bën të lexueshme për një kohë të gjatë.

Në vlerësimin e poezisë, prof. Alfred Çapaliku, vë në dukje shtrirjen e vargjeve, llojet e tyre, strofat, metrat, cilëson rolin eufonik dhe, pavarësisht se nuk mohon qasjen sociale, përpiqet të gjejë realizimin e letrarësisë si thellësi shprehjeje dhe lojë fjale:

me tastet e zeza të pianos së shpirtit.

Ai është përpjekur të gjejë çdo gjë që ka lënë përshtypje të thellë tek Veli Stafa, për të gjurmuar pastaj përthyerjen e mbresës në krijim. Kjo duket edhe në komentin që bën për poezinë që shkroi Veliu, duke marrë shkas nga vdekja e një vajze të bukur shkodrane. Studiuesi ka rrëmuar në të dhëna të Shkodrës aq sa, nëse do bëhej një muze për Shkodrën letrare, kjo monografi do të shërbente me siguri për ndonjë kënd.

Duke analizuar karakteristika komplekse të poezisë e më tej, autori citon dhe ndan mendimet me Koliqin e të tjerë studiues për brezin e viteve '30, duke arritur në përfundimin se Veliu, për disa arsye më shumë anon drejt hermetizmit.

Studimi i elementeve metrikë si kapitull më vete, ndërtimi i një rimari poetik të Stafës, përpjekja për të depërtuar në pikëpamjet e tij mbi artin, që deri diku shprehen në citatin e kapitullit të V, sistemi i vetë rimarit: "*Guvë e ndjesive si rrahje çekiçash/ mendjen ma djeg me thërrmija xixash, Platonicus*", si dhe qasja me shkollën estetike të Mjedës, mendojmë se janë vlera të shtuara të monografisë.

Në analizën e prozës, në kapitullin VI, tërhiqet vëmendja për sintetizmin, detajet përshtypjelënëse, mikrofabelën, ritmin e të treguarit, lidhjen e subjekteve prozaike me ato poetike etj. Autori nuk ngurron të vlerësojë më të mirat e krijimtarisë, përveçse në poezi, edhe në prozë, vazhdon të cilësojë vlerësimet përbashkuese mbi letrarësinë me opinionet e personaliteteve të mëhershme, duke bërë që monografia ta shohë veten si vazhdimësi e komponenteve më të mira të kritikës së mëparshme. Edhe kur elementet e prozës së Veli Stafës bëhen propogandistike, apo deklarative, studiuesi i nxjerr në dritë, si ndjeshmëri dhe qasje kritike të Stafës ndaj çështjeve të femrës, papunësisë, apatisë, fëmijëve etj., por në këtë përmendje pasqyrimi i risive si raport i jashtëm (me shfaqjen e portretit a vizatimit), apo si raport i brendshëm (me parandjenjat, gjendjet e pashpjegueshme emocionale, ngjyrat gri, flunë, fatalitetin apo tingujt e hareshëm) nuk mungon. Bile, më vonë ai do të reagojë edhe për kritikën e mëparshme mbi Veliun, duke theksuar se e ka tepruar me shikimin dhe me interpretimin misionar të krijimtarisë. Kjo ka rrjedhur gradualisht, nisur edhe nga sinteza që Veliu thotë për vete dhe që studiuesi e vendos si citim në fillim të prozës: *... u bana mendues, ndjejshta nevojën e paradokseve... Platonicus.*

Objekti i kritikës letrare mbi qeniet e brishta në letërsi riobjektivizohet te prof. Alfred Çapaliku, duke u pasuruar me elemente të reja, kurse në kritikë ai shpesh përdor fjalët e vetë autorit si argument, kur e ndien se nuk mund të shijojë asgjë më shumë se një kulm letrar.

Pjesëmarrja në gazetari e Veli Stafës shihet në monografi si vokacion në emër të përparimit dhe si i tillë vlerësohet për vizionin, kulturalitetin, pa lënë mënjanë edhe ngjyrimet stilistike që sjell.

Edhe në kapitullin e “*Jhonës së shkrimtarit*” ku përmblihen gjithë shkrimet mbi Veli Stafën e krijimtarinë e tij deri në ditët e sotme, një vend të veçantë zë edhe botimi miscellanea, siç e quan studiuesi librin “*Veli Stafa*”, të shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, të vitit 1992. Duket se edhe te ky botim, përveç tjerash, mund të gjendet një shtytje për të shkruar monografinë, pasi, pavarësisht vlerësimit që ka për autorin e saj Andrea Varfin, Çapaliku vë re domosdoshmërinë e ritrajtimit të Veli Stafës në kohën e sotme, mbështetur mbi dokumente të reja që kanë dalë në dritë dhe sipas një këndshikimi të ri.

Monografia, është shprehje e një pasioni dhe e një pune serioze të njëmendtë. Çdokush që e lexon, mund të kuptojë që studiuesi e ka gjurmuar për një kohë të gjatë veprimtarinë e shkrimtarit e shumëçka që lidhet me jetën e tij. Nga ky gjurmim ka lindur një dashuri që është e admirueshme për një studiues, por edhe pedagog që vazhdon të flasë për Veli Stafën në auditore edhe sot e kësaj dite. Kjo gjë, besoj unë, e pasuron traditën dhe është shembull i mirë për vazhdimësinë e natyrshme të saj tek letërsia jonë e re.

Ermira Alija

JETA SHKENCORE**AKTIVITET SHKENCOR NDËRKOMBËTAR :
“Leonardo Maria Savoia: Linguisti dhe Albanologu”**

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në bashkëpunim me Fondacionin Universitar “Francesco Solano” (Itali) organizuan ditën e premtë, më datë **29 mars 2019**, në ambientet e Bibliotekës Shkencore Universitare, aktivitetin shkencor ndërkombëtar “Leonardo Maria Savoia: Linguisti dhe Albanologu”.

Në fjalën e hapjes dekania e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, prof. dr. Mimoza Priku, pasi përshëndeti pjesëmarrësit në këtë takim, paraqiti edhe arsyet e organizimit të kësaj veprimtarie, e cila në thelb kishte pasqyrimin e kontributit shkencor të prof. Savoia-s për shqipen, në përgjithësi, dhe arbërishten e gegërishten, në veçanti. Objekt i këtij aktiviteti mes të tjerash ishte edhe promovimi i monografisë “*Structuring Variation in Romance Linguistics and Beyond*”, të botuar në nderim të figurës së këtij gjuhëtari.

Nga Universiteti i Shkodrës kumtuan prof. dr. Artan Haxhi, drejtor i Qendrës së Studimeve Albanologjike – prof. dr. Mimoza Priku, pedagoge e departamentit të Gjuhësisë, të cilët ravijëzuan në mënyrë të përgjithshme figurën e prof. Savoia-s që me fillimin e karrierës së tij, kontributin e tij akademik në disa universitete të Italisë si dhe u ndalën më hollësisht në veprimtarinë e tij shkencore në fushë të gjuhësisë, e në veçanti në atë të Albanologjisë.

Profesor Mirko Grimaldi nga Universiteti i Salentos (Itali) foli për raportet personale me prof. Savoia-n si mentor i tij dhe u ndal më konkretisht në vëllimin “*Structuring Variation in Romance: Linguistics and Beyond*”, vëllim që u botua për nder të prof. Savoia-s, me rastin e 70 - vjetorit të lindjes së tij. Ai u përqendrua në kontributet konkrete të prof. Savoia-s në fushë të gjuhësisë.

Prof. as. dr. Eliana Laçej, përgjegjëse e departamentit të Italianistikës pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Shkodrës, foli për ndihmesën që prof. Leonardo Savoia kishte dhënë në dy drejtime: së pari, në ngritjen e forcimin e Italianistikës si një degë e re atëherë në Universitetin e Shkodrës; së dyti, në planin personal, si drejtues i saj në tezën e doktoratës, të mbrojtur në Universitetin e Firences, duke u ndalur në kontributin konkret të prof. Savoia-s si mbështetës kryesor në

finalizimin e punës së saj studimore.

Prof. dr. Matteo Mandalà, nga Universiteti i Palermos, pasi foli për figurën e prof. Savoia-s dhe përcolli përgëzimet e tij për të gjithë kontributin që ai ka dhënë gjatë gjithë këtyre viteve për Albanologjinë në Itali, theksoi se ai ka dhënë një ndihmesë të veçantë kryesisht në ruajtjen dhe inkurajimin e katedrave albanologjike në të gjithë Italinë.

Prof. dr. Francesco Altimari, nga Universiteti i Kalabrisë, nënvizoi rolin e prof. Savoia-s në lëmë të studimeve gjuhësore, duke analizuar disa prej punimeve themelore të tij, sidomos ato që i kushtohen arbërishtes. Më në veçanti ai u ndal në prezantimin e lidhjeve të prof. Savoia-s me Universitetin e Kalabrisë.

Në përmbyllje të aktivitetit, në formën e surprizës, Rektori i



Universitetit të Shkodrës dhe njëkohësisht Kryetari i Senatit akademik, prof. dr. Adem Bekteshi, i dorëzoi prof. dr. Leonardo Maria Savoia-s titullin “*Profesor Nderi*” i Universitetit të Shkodrës, të akorduar nga Senati Akademik i Universitetit të Shkodrës, me motivacionin:

“Për kontribut të shquar në vendosjen dhe mbarëvajtjen e marrëdhënieve midis Universitetit të Firences dhe Universitetit tonë, si dhe për

kontributin e tij të gjerë në fushën e studimeve albanologjike”.

Në fund e mori fjalën prof. dr. Leonardo Savoia, i cili mjaft i emocionuar, falënderoi Senatin akademik dhe rektorin për dhënien e këtij titulli, miqtë e kolegët e tij shqiptarë dhe italianë.

SESIONI SHKENCOR NDËRKOMBËTAR:

“Roli i shkrimtarit dhe i françeskanit arbëresh Frangjisk Andon Santori për Rilindjen Kulturore Kombëtare”

Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Qendra e Studimeve Albanologjike të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në

bashkëpunim me Fondacionin Universitar “*Francesco Solano*” (Itali) dhe me mbështetjen e Komunave të Cerzeto-s (Qanës) dhe Santa Caterina Albanese-s (Picilisë), Arqipeshkvisë Shkodër-Pult, Provincës Françeskane Shkodër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Tiranë, organizuan në Shkodër “*Ditët santoriane*”, duke hapur kështu siparin e manifestimeve që do të ketë gjatë gjithë këtij viti kushtuar figurës së arbëreshit të njohur Frangjisk Andon Santori.

Dita e shtunë, datë 30 mars 2019, filloi me hapjen e një ekspozite, ku u prezantuan para publikut dorëshkrimet e Santorit, të cilat gjenden në Arkivin e Shtetit. Ekspozita u prit me mjaft interes. Pjesë e rëndësishme e këtyre manifestimeve ishte sesioni shkencor ndërkombëtar me temë “*Roli i shkrimtarit dhe i françeskanit arbëresh Frangjisk Andon Santori për Rilindjen Kulturore Kombëtare*”, organizuar me rastin 200-vjetorit të lindjes së Frangjisk Andon Santorit (1819-2019). Në këtë aktivitet morën pjesë personalitete të larta shtetërore e fetare, studiues, miq e të ftuar nga Shqipëria, Italia dhe Kosova. Ky aktivitet u përshëndet nga Rektori i Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” prof. dr. Adem Bekteshi, i cili



pasi falënderoi të ftuarit për pjesëmarrjen e tyre dhe në veçanti dy albanologët e ardhur nga Italia, prof. dr. Francesco Altimari-n, (nga Universiteti i Kalabrisë) dhe prof. dr. Matteo Mandalà-në nga Universiteti i Palermos, i përgëzoi organizatorët e këtij aktiviteti dhe u ndal tek puna e grupit të studentëve, të cilët

vunë në skenë një pjesë nga drama e parë shqiptare “*Emira*”, realizuar nën kujdesin e dr. Gëzim Pukës dhe dr. Erzen Koperajt. *Kjo iniciativë dëshmon për punën e mirë që bëhet në këtë universitet për përfshirjen e studentëve në aktivitetet me karakter kulturor e shkencor, theksoi ndër të tjera rektori Bekteshi.*

Ndërsa kryetarja e Bashkisë së Shkodrës zj. Voltana Ademi në fjalën e saj përshëndeti të gjithë arbëreshët. “*Këto ditë do të zbukurojnë Shkodrën edhe grupet e ardhura nga komunat arbëreshe të Picilisë e Qanës çka dëshmon për një lidhje të fortë mes botës arbëreshe dhe qytetit tonë*”-

nënvizoi ajo në fjalën e saj.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Shkëlqësia e tij Imzot Angjelo Masafra, Arqipeshkvi i Shkodrës dhe i Pultit, i cili përgëzoi Universitetin për këtë bashkëpunim të frytshëm me vëllezërit përtej detit.

Don Elio Stamile, prifti arbëresh i deleguar nga Ipeshkvi i Dioqezës së Shën Markut Arxhentan, me fjalën e tij përshëndetëse ndër të tjera përcolli mesazhin se “*shpirti arbëresh rron*”.

Përshëndetën gjithashtu Roberto Lavallo, kryetar i Bashkisë Santa Caterina Albanese (Picilisë), ndërsa Stefano Vattimo, nënkryetar i Bashkisë Santa Caterina Albanese, përshëndeti në emër të kryetarit të Komunës së Cerzeto-s (Qanës) Giuseppe Rizzo-s. Ata i dhuruan Rektorit të Universitetit, kryetares së Bashkisë dhe Arqipeshkvit një mirënjohje nga bashkitë e tyre dhe në mënyrë simbolike “*Kalendarin e Santorit*”, me simbole nga vendi ku lindi dhe ku punoi arbëreshi Frangjisk Andon Santori. Në këtë sesion shkencor kumtuan: prof. dr. Mimoza Priku & prof. dr. Artan Haxhi me temën “*Personaliteti i Frangjisk Andon Santorit dhe pasuria gjuhësore në krijimtarinë e tij në prozë*”; prof. dr. Francesco Altimari “*Kontributi i katedrës së Albanologjisë të Universitetit të Kalabrisë për studimet dhe kërkimet santoriane*”; prof. dr. Tomor Osmani “*Variantet alfabetike të përdorura në veprën e Anton Santorit*”; prof. dr. Mateo Mandalà “*Për botimin e veprës letrare të Frangjisk Andon Santorit*”; prof. dr. Anton Berisha “*Frangjisk Andon Santori në dyqindvjetorin e lindjes së tij*”; prof. dr. Alfred Çapaliku “*Cikli rrezatues me vjersha të vëllimi “Këngëtorja arbërore” i Frangjisk Andon Santorit*”; prof. as. dr. Rrezarta Draçini “*Identifikimi i veçorive psiko-sociale përmes gjuhës së veprave të Santorit*”; dr. Erzen Koperaj “*Elemente të gegërishtes në veprën e Santorit*”; dr. Gëzim Puka “*Emira” e Santorit - një dramë për skenën shqiptare*”; dr. Ermira Aliaj “*Çështje të letrarësisë në “Këngëtorja arbërore” e Santorit nga arbërishtja në shqip*”; dr. Merita Hysa & dr. Rrezarta Murati: “*Tipare të antroponimisë dhe toponimisë në dramën e Santorit*”.

Gjatë këtij tubimi pati disa ndërhyrje me karakter kulturor që ia shtuan edhe më shumë emocionet këtij aktiviteti. Studentët e programeve të studimit Gjuhë shqipe - Letërsi dhe Gazetari – Komunikim, përcollën emocione të veçanta me interpretimin e një pjese nga drama “*Emira*” e Santorit. Me një lojë plot ndjenjë e pasion studentët i përmalluan të gjithë, por sidomos 100 arbëreshët e ardhur nga fshatrat e Kalabrisë.

Gjatë këtyre dy ditëve, më 30 dhe 31 mars, grupet arbëreshe: grupi etnomuzikor “*Shpirti arbëresh*”, Kori “*Picilia*” dhe kori arbëresh “*I Paradosis*”- *G.B.Rennis*” performuan këngë arbëreshe e me motive

santoriane që u ndoqën me interes dhe përcollën emocione tek të gjithë të pranishmit.

Ky bashkëpunim i frytshëm në mes të Universitetit të Shkodrës, studiuesve dhe vëllezërve arbëreshë dëshmoi edhe një herë për punën e mirë që bën ky institucion në fushë të kërkimit shkencor.

AKTIVITETE TË TJERA

Më datë **29 tetor 2018** në mjediset e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, prof. Antonino Scarelli matematicien, Universiteti i Tuscias, Itali, që ka studiuar në rrafsh ndërdisiplinor *Komedia Hyjnore* e shkrimtarit të madh italian Dante Aligieri, mbajti leksionin e hapur mbi misterin e sistemit numerik në kryeveprën danteske “*Misteri i një numri që vazhdon të ekzistojë që prej më shumë se katërmijë vitesh*”, me studentët e programit të studimit Gjuhë italiane, si edhe me praninë e studentëve të seksionit dygjuhësh të gjuhës italiane, pranë gjimnazit “*28 Nëntori*”. Ligjëruesi nxori në pah vlerën që akoma vazhdon të transmetojë kryevepra danteske, jo vetëm në rrafshin letrar, por edhe në atë shkencor. Interesimi i studentëve ishte i madh, çka u reflektua edhe në pyetjet e shumta drejtuar profesor Scarelli-t.

Në datat **5 dhe 8 nëntor 2018**, në mjediset e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës, Ambasada e Italisë në Tiranë në bashkëpunim me departamentin e Romanistikës, në kuadrin e veprimtarisë “*Ditë italiane në Universitetin e Shkodrës*” organizoi dy aktivitete të kushtuar kulturës dhe qytetërimit italian. Në ditën e parë studiueset, pedagogët dhe bashkëpunëtorët e ngushta të *Accademia della Crusca*, Firenze, Vera Gheno e Stefania Iannizzotto mbajtën referimin “*Krushka dhe rrjetet sociale*”, duke u ndalur në problematikat aktuale të njëjtësimit të gjuhës së shkruar me gjuhën e folur. Në ditën e dytë pedagogët e Universitetit të Firences, arkitektët Ferruccio Canali dhe Virgilio Galati, mbajtën kumtesën “*Në vendin e shqiptarëve. Udhëtarë dhe studiues italianë në Shqipëri mes tetëqindës e nëntëqindës. Peizazhe, qytete e monumente*”. Rrëfimi interesant i dy lektorëve krijoi një këndvështrim të ri, ndryshe, të marrëdhënieve italo-shqiptare ndër vite, gjithmonë nisur nga perceptimi i përhershëm i studiuesve italianë. Në syrin e udhëtarëve antropologë italianë, si Ojetti, Montanelli, Baldacci, qytetet shqiptare të fillimshekullit të kaluar paraqiten me fizionomi të ndryshme nga njëri - tjetri, çka provon më së miri kulturën tonë të orientuar nga dy kahe të ndryshme, Orienti dhe Perëndimi.

Më datë **22 nëntor 2018** dhe **4 prill 2019**, në mjediset e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës, departamenti i Romanistikës në bashkëpunim me departamentin e Gjermanistikës vijoi me fazën e tretë dhe të katërt të workshop-it prej katër fazash “*Udhëtim nëpër trashëgimi*”, me temat përkatëse “*Vend e kuvend*” dhe “*Vend që shkon, gatime që shijon*”. Zakonet, traditat dhe elementet ndërkulturore të vendeve, si: Italia, Franca, Austria dhe Gjermania u sollën përmes kumtimeve të pedagogëve të këtyre departamenteve L. Kazazi, A. Lika, D. Brahimi; I. Pirani, E. Bushati, A. Shllaku, K. Lazri, I. Tirana. Në trajtimet e kolegëve u përcoll qartë mesazhi se ajo çfarë ne dimë për trashëgiminë tonë kulturore, tashmë pasuri e UNESCO-s, është krahasuar fare pak me atë që realisht është grumbulluar më mijëvjeçarë qytetërim evropian. Kulturat kanë një komunikim të përsosur me njëra-tjetrën, një marrëdhënie dhe një dialog konstruktiv, aq sa shpeshherë kumtuesit u vunë në një “garë” e përballje për të fituar autorësinë e shumë aseteve kulturore evropiane, gjë që i dha karakter informativ, por edhe argëtues të gjithë veprimtarisë.

Në datat **29** dhe **30 nëntor 2018**, pranë Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Beogradit, Serbi, u zhvillua tryeza e rumbullakët e përfaqësuesve të departamenteve të Italianistikës dhe Romanistikës së Rajonit, me temë “*Italishtja jashtë Italisë: perspektivat e bashkëpunimit ndëruniversitar rajonal*”. Departamenti i Romanistikës u përfaqësua nga dekania e FGJH, prof.as. Alma Hafizi dhe drejtorja e departamentit prof. as. Eliana Laçej, të cilat paraqitën programet e studimit të niveleve BA dhe Master, aktivitetin shkencor e kulturor të pedagogëve dhe të studentëve të programit të studimit “*Gjuhë italiane*”, si dhe siguruan përfshirjen dhe kontributin e këtij departamenti në të gjithë veprimtarinë shkencore rajonale në vijim.

Më datë **6 dhjetor 2018**, departamenti i Romanistikës në bashkëpunim me Aleancën franceze, dega Shkodër, organizoi sallonin letrar “*Apoliner, një gjeni i paparashikueshëm*”, një homazh për të përkujtuar shkrimtarin e madh francez Apollinaire në 100 - vjetorin e vdekjes. Kombinimi i ligjërimeve të pedagogëve Dh. Hoxha e D. Brahimi dhe studentëve të programit të studimit “*Gjuhë frënge*” nënvizoi disa nga karakteristikat letrare dhe humane të këtij shkrimtari të angazhuar në Luftën e Parë Botërore, si dhe fakte nga korrespondenca me shkrimtarin tonë Faik Konica. Prof. dr. Alfred Çapaliku, si i ftuar special i aktivitetit, ndau me pjesëmarrësit përjetimet personale për

poezitë e këtij shkrimtari dhe veçanërisht për *kaligramet*. Në fund u ndanë çmimet për konkursin

“ *Kaligrami, si një tekst poetik në formën e një vizatimi, apo një mënyrë e veçantë për të shprehur botën shpirtërore*”. Spikati punimi i studentit E.Markaj, si shprehje e kësaj aventure poetike.

Më datë **12 mars 2019**, departamenti i Romanistikës organizoi veprimtarinë "*Ditë letrare me shkrimtarin Ridvan Dibra*" mbi romanin e përkthyer në frëngjisht "*Legjenda e vetmisë*". Biseda u përqendrua në idenë e subjektit, përzgjedhjes së librit për t'u përkthyer në gjuhën frënge, si dhe elemente të tjera të krijimtarisë së tij letrare. Studentët e programit të studimit "*Gjuhë frënge*" treguan interes, çfarë u reflektua nga pyetjet e shumta që i drejtuan shkrimtarit dhe pedagogut të letërsisë shqipe Ridvan Dibra, i cili nuk e fshehu ndjesinë e bukur që përjetoi, duke zbuluar se ishte më tepër i lexuar nga publiku nga sa e mendonte ai vetë. Biseda mori një rrjedhë shumë të këndshme mes dilemave se mos lexuesi shqiptar i zbulon vlerat e shkrimtarëve të tij, pasi përkthehen në gjuhë të huaj? Me këtë moment reflektimi u mbyll takimi, çka lë të kuptohet se së shpejti shkrimtari dhe pedagogu Dibra, do të jetë i ftuar mes studentëve të Romanistikës.

Më datë **27 mars 2019**, departamenti i Romanistikës në bashkëpunim me Aleancën franceze, dega Shkodër, organizoi veprimtarinë "*Nadarët dhe Marubët si legjenda të fotografisë*". Ky aktivitet u konceptua në formën e një përfaqëje mes rrugëtimit të pjesëtarëve të këtyre dinastive, teknikave të fotografimit dhe fondit jashtëzakonisht të pasur si trashëgimi e historisë botërore të fotografisë, por edhe si një dëshmi e lidhjeve të hershme midis Francës dhe Shqipërisë. Diskutimi mori shkas nga ekspozita fotografike e vëllezërve Nadar e vendosur në mjediset e muzeut të fotografisë MARUBI, nën kujdesin e Ministrisë së Kulturës dhe Ambasadës Franceze në Tiranë.

Në kuadrin e bashkëpunimeve ERASMUS të programit të studimit "*Gjuhë italiane*", në datat **8 prill - 11 prill 2019**, prof. Mauro Geraci i Universitetit të Mesinës, mbajti leksione të hapura mbi antropologjinë kulturore në drejtimin si gjuhësor, ashtu edhe letrar. U trajtuan në mënyrë të hollësishme probleme që lidhen me objektin dhe subjektin në kërkimet etnografike dhe në analizën antropologjike.

Me dëshmi që lidhen me ngjarjet njerëzore, letrare dhe intelektuale të Musine Kokalarit dhe Robert Priftit, si edhe të poetit nga Shkodra Fabian Çoba (i sjellë përmes dëshmimeve të drejtpërdrejta të së bijës Eliza) u analizua

roli thelbësor që fusha gjuhësore, rrëfimtare dhe letrare ka pasur në transformimet e thella politike të historisë bashkëkohore shqiptare, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XIX.

U trajtuan temat:

- Antropologjia kulturore: objekti i studimit; objektivat njohëse dhe metodat e punës kërkimore. Mbledhja e të dhënave, metoda historiko-krahasuese dhe çështja e burimeve të informacionit.
- Antropologjia kulturore: historiku i fushës dhe i shkollave të mendimit, (nga pozitivizmi antropologjik evropian tek dekonstruksionizmi amerikan).
- Studimi antropologjik i rrëfimeve dhe struktura gjuhësore, politike dhe letrare e Shqipërisë (nga shoqëria ideale tek shteti-komb). Perspektiva etnografike dhe përfshirja shoqërore në letërsinë shqipe : Musine Kokalari dhe Robert Prifti.
- Fragmente politike dhe letrare të Shqipërisë bashkëkohore: ligjërime, retorika, simbolika.
- Takim me Eliza Çobën: kujtimet dhe poezia e Fabian Çobës përmes rrëfimeve të së bijës.

Në datat **3, 6 dhe 7 maj 2019** në mjediset e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës, Ambasada e Italisë në Tiranë në bashkëpunim me departamentin e Romanistikës, organizoi për studentët kursin e formimit “*Qytetarët evropianë*” përmes leksioneve të mbajtura nga znj. Zamaida (Kastrati) Mozali. Kursi i formimit mëtonte të transmetonte informacion mbi vlerat evropiane, përparësitë e të qenit anëtarë të familjes së madhe evropiane, historikun e Bashkimit Evropian dhe ritmet e zgjerimit të tij. Studentët reagueshan me pyetje dhe kërkshëri ndaj argumenteve të trajtuara. Në përfundim të kursit studentët u pajisën me certifikatë pjesëmarrjeje.

Më **23 maj 2019**, me studentët e programit Master në Mësimdhënie të Gjuhës Angleze u zhvillua workshop-i me titull “*Is Seeing Believing? Teaching Critical Thinking through Visual Literacy in the EFL Class*”, organizuar nga Ambasada Amerikane në Shqipëri dhe Zyra Rajonale e Gjuhës Angleze me seli në Beograd, në bashkëpunim me departamentin e Gjuhës Angleze. Aktiviteti u drejtua nga trajnuesja me eksperiencë ndërkombëtare Jen Mac Arthur., e cila theksoi ndër të tjera se në epokën tonë, kur po bombardohemi gjithnjë e më shumë nga informacioni i përditshëm, është më e rëndësishme se kurrë që ne t'i ndihmojmë studentët tanë të zhvillojnë aftësi për të parë, përshkruar, analizuar dhe interpretuar informacionet - si me fjalë, ashtu edhe nëpërmjet imazheve. Kjo kërkon që

në bërthamën e kurrikulës sonë të kalohet nga përdorimi mjeteve vizuale ndihmëse në vendosjen e aftësive vizuale.

20 qershor 2019 - Në kuadrin e projektit *Guidë turistike për qytetin e Shkodrës* studentët e vitit të tretë të degës “Gjuhë angleze” kanë përgatitur një guidë turistike të qytetit të Shkodrës. Në përmbyllje të këtij projekti, më 20 qershor 2019, u organizua një aktivitet ku u bë paraqitja e punimeve të realizuara nga studentët. Objektivat e këtij projekti kanë qenë: përmirësimi i aftësive gjuhësore të studentëve nëpërmjet përkthimit; formimi kulturor i tyre, si pjesë e pashmangshme e formimit të përkthyesit; përmirësimi i aftësive prezantuese dhe i aftësive për kërkim shkencor; përmirësimi i aftësive kompjuterike; me qëllimin final përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Materiali i pëzgjedhur u përkthye e u ilustrua nga studentët, të cilët bënë prezantin e punimeve. Ato iu nënshtruan një gjykimi kritik nga studentët e tjerë dhe pedagogu përgjegjës Rajmonda Këçira. Materialet e përkthyer janë të disponueshme në departament në formë elektronike, të printuara dhe të afishuara në hollin e departamentit në *Këndin e Përkthimit*, duke plotësuar në këtë mënyrë objektivat e parashikuara dhe duke dhënë një shembull dinjitoz për studentët e tjerë të degës së gjuhës angleze dhe të fakultetit në përgjithësi.

26 qershor 2019 - Në ambientet e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës u zhvillua aktiviteti studentor i titulluar “*Let’s celebrate the bard*”, kushtuar 260- vjetorit të lindjes së shkrimtarit skocez Robert Bërns. Ai është një nga figurat më interesante të letërsisë britanike, që falë universalitetit të veprës së tij, i kalon kufijtë e vendlindjes dhe të epokës kur jetoi. Studentët, nën drejtimin e pedagoges Ilda Erkoçi, prezantuan fakte nga jeta dhe vepra e poetit, recituan në shqip e anglisht, si dhe kënduan këngë, vargjet e të cilave janë krijuar nga poeti në fjalë.

28 qershor 2019 - Në përmbyllje të kursit vjetor të Letërsisë angleze është zhvilluar aktiviteti me titull: “*A Flavour of Romanticism in English Literature*”. Ky aktivitet u zhvillua me studentët e vitit të dytë, të degës së “Gjuhës angleze”, nën mbikëqyrjen e lektores Dalila Karakaçi. Fokusi i aktivitetit ishte periudha e romantizmit anglez me tre autorët përfaqësues: Bërns, Bajron dhe Shelli. Në aktivitet morën pjesë 16 studentë. Ato, në grupe dyshe, përgatitën tema dhe prezantime, të cilat reflektojnë motivet, simbolikat dhe problematikat që pasqyrohen në këtë periudhë letrare, mbi të gjitha tek këto autorë kryesorë. Recitime të vargjeve, të shkëputura nga veprat e autorëve të lartpërmendur, kanë shoqëruar prezantimet e bëra

përpara auditorit. Në to janë përfshirë materiale fotografike, audio e video për të konkretizuar tematikat e trajtuara. Është për t'u vlerësuar pjesëmarrja e gjerë e studentëve, zhdërvjelltësia gjatë prezantimeve dhe komunikimi me audiencën, për të tërhequr vëmendjen ndaj çdo tematike të përzgjedhur.

TERENC TOÇI “RIKTHEHET” NË SHKODËR

Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Qendra e Studimeve Albanologjike, me nismën e gazetarit shqiptar me banim në Itali, z. Sokol Borshi, promovuan në ambientet e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” dokumentarin biografik “*Mirazhi i Adriatikut*”, i cili i kushtojë jetës së arbëreshit Terenc Toçi. Për herë të parë ky dokumentar, i ndërtuar mbi jetën dhe punën e madhe që Terenc Toçi bëri për vendin e tij, u shfaq para studentëve të programit të studimit Gazetari-Komunikim dhe Gjuhë shqipe-Letërsi të Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit tonë. Ka qenë dëshira e vetë producentëve dhe e nipit të Terenc Toçit që dokumentari fillimisht të shfaqej para një auditori të tillë të përbërë nga studentë dhe pedagogë.

Terenc Toçi ishte një intelektual i përgatitur, jurist, publicist, shkrimtar, botues, nëpunës i devotshëm i shtetit dhe patriot romantik arbëresh. 106 vite më parë ai themeloi në Shkodër gazetën “*Taraboshi*” me moton “*Thehem, por s'përkulem*”. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Shqipëri, duke e mbyllur në mënyrë tragjike. Gjykohet nga Gjyqi Special komunist, që e dënon me vdekje dhe pushkatohet më 14 mars 1945.

Kjo ishte jeta e një njeriu, i cili edhe pse e dinte se do të arrestohej nga regjimi i kohës nuk iku nga vendi, pasi siç thoshte dhe vetë “*Pse të ik nga vendi im ? Unë nuk ndihem se kam bërë faj, pasi gjithë jetën ia kushtova Shqipërisë*”.

Pas përfundimit të dokumentarit, Terencio D'Alena, nipi i Terenc Toçit, i pranishëm në këtë aktivitet u shpreh: “*Ju falënderoj për zemërsisht për këtë mikpritje. Unë jam rritur gjithë jetën duke sjellë në vëmendje sakrificën dhe veprën e gjyshit, pasi nëna ime na tregonte gjithmonë për punën e madhe që bëri Terenc Toçi për një Shqipëri të pavarur, për ngritjen për herë të parë të flamurit në Mirditë në vitin 1911, për themelimin e gazetës “*Taraboshi*”, një ndër të parat gazeta politike në Shqipëri. Lidhja dhe puna e gjyshit ishte e madhe veçanërisht me zonën e Mirditës dhe të Shkodrës. Si nipi i tij, jam shumë i emocionuar që sot ndodhem në Shkodër, në këtë ambient të mrekullueshëm, këtu mes jush*”.


BOTIME

Këtë vit u vunë në qarkullim këto botime të Qendrës së Studimeve Albanologjike:


1. *Komisia letrare shqipe 100 vjet më pas dhe mendimi albanologjik*, “Studime shqiptare” 27, Shkodër, prill 2019, ISBN 978-9928- 4341-5-9, botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike. Vëllimi përmban 28 punime dhe ka 282 faqe.



2. *Gjurmime albanologjike (Hulumtime për ndihmesat e disa albanologëve në kulturën shqiptare)*, “Studime shqiptare” 29, Shkodër, maj 2019, ISBN 978-9928-4341-6-6, botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike. Vëllimi përmban 35 punime dhe ka 312 faqe.



3. Tefë Topalli, "*Ushtrime për Stilistikën e gjuhës shqipe*", enti botues "Gjergj Fishta", Lezhë, 2019, ISBN: 978-9928-222-81-7, 626 faqe.



4. Alfred Çapaliku, *Veli Stafa [Platonicus], Jeta dhe vepra*, botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, enti botues “Gjergj Fishta” – Lezhë, 2018, ISBN: 978-9928-222-53-4, (monografi) ka 104 faqe.



5. Ermira Alija, *Letërsia shqipe si metafizikë dhe transhëndencë, Histori mendimi dhe përpjekje për interpretim në letërsinë shqiptare të traditës*, botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë, 2018, ISBN: 978-9928-234-28-5, (monografi) ka 304 faqe.



ISSN 2221 – 6855

*Doli nga shtypi qershor, 2019 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x
250 mm. Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*